

---

## LITERATURE, TRUTH AND REALITY (FICTION) IN THE POSTMODERN NOVEL LETËRSIA, VËRTETËSIA DHE REALITETI (FIKSIONI) NË ROMANIN POSTMODERN

SAMI HAJRA

Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Letërsisë Shqipe, Prishtinë, KOSOVË  
e-mail: samihajra@live.com

### Përmbledhje

Sipas Varfit "Gjuha si mjet komunikimi është jo vetëm një medium kulturor, por edhe një element thelbësor i vetë komunikimit". Prandaj, duke qenë pra, vetë gjuha një sistem i pasur simbolesh përmes të cilave njerëz të nacionaliteteve, kulturave dhe të traditave të ndryshme komunikojnë me ose pa vështirësi gjatë të mësuarit jetësor dhe atij skolasik megjithatë, ata në të njejtën kohë ndeshen me diverzitetet të konsiderueshme sociale, ndërgjuhësore dhe kulturore. Çështja e komunikimit ndërgjuhësor ngërthen faktorët të rëndësishëm si socio-kulturor, regjional, kohor dhe stilistik të cilët pasurojnë dhe plotësojnë njëri-tjetrin. Kompetenca inter-kulturore dhe komunikimi ndërgjuhësor në epokën e globalizimit paraqesin një proces të shkëmbimeve të ndërsjellta, që në prespektivën ndërgjuhësore kompetencat e tilla mbështeten në kapacitetin e lokutorëve që bartin mesazhin dhe transmetojnë atë. Prandaj, në këtë punim do të trajtojm aspektin socio-kulturor duke i dhënë prioritet thelbësor aspektit kulturor, komunikativ, edukativ dhe duke analizuar dhe shpjeguar fenomenin e shkëmbimeve inter-kulturore dhe gjuhësore.

**Fjalët çelës:** konglomerat, diverzitet, kompetencë, globalizim, social.

### Abstract

According to Varf "Language as a means of communication is not only a cultural medium, but also an essential element of communication itself. Therefore, since then the languages itself is a rich system of symbols through which people from different nationalities, cultures and different traditions communicate with or without learning difficulties during the life and scholastic learning. However, at the same time they face considerable social diversity, inter-linguistic and cultural. The inter-linguistic issue also, involves important factors such as, socio-cultural, regional, time frame and stylistic who enriches and complement each other. The inter-cultural competence and inter-linguistic communication in the era of globalization represents an mutual exchange process, such competences on the inter-linguistic perspective are based on the capacity of locators to carry the messages and to transmit it. Therefore, in this abstract we will treat the socio-cultural by prioritizing essential cultural aspect, communicative, educational and by analyzing and explaining the inter-linguistic and cultural phenomenon of exchanges.

**Key words:** conglomerate, diversity, competence, globalization, social

---

### Hyrje

E vërteta dhe realiteti, apo fikcioni letrar, nëse vë-sh-trohen nga aspekti formal si koncepte më vete, domosdoshmërisht shtrojnë pyetjen: cili është roli do-mi-nant i këtyre koncepteve jo aq domethënëse bre-n-da letërsisë?

Çështja e fenomeneve letrare sot, ka marrë rrjedhë ndryshe. Jo rastësisht janë marrë këto koncepte shqyrtuese për ndikimin dhe

domethënien e domo-s-do-shme në romanin postmodern.

Dihet tashmë se për t'u dhënë bazë argume-n-tu-e-se këtyre problematikave në letërsi, duhet t'u kthe-hemi pak esencave. Esenca, në këtë rast, quajmë këto koncepte të cilat duhen parë në dy linja: në atë të ro-manit modern dhe postmodern.

### Romani modern

Te romani modern, dihet se ruhej me fanatizëm krijimi i të vërtetave brenda metarrëfimeve. Tezë kjo, e trashëguar nga Krishti. Vetëm ai nuk qeshte kurrë me të vërtetën dhe të mirën. Me gjasë se ato kanë forcën që të përhapeshin natyrshëm e vetvetiu.

Romani modern i qëndroi besnik këtyre të vërteta-ve të “papekshme”, kësaj vërtetësie. Me intencën që, po u thyen rregullat e parimet, ajo nuk mbetet më le-tërsi. Por e vërteta qëndron ndryshe...

### Romani postmodern

Pasi vdiq zoti (F. Niçe), vdiq dhe autori (R. Bart), u shterrua letërsia. Pasi erdhi fundi i idealizmave, fundi i historisë, fundi i realitetit, fundi i origjinalitetit, i krijimit, romanit dhe fundi i seriozitetit, konceptet si: letërsia, vërtetësia dhe realiteti, marrin një qasje ndryshe dhe vërtetë të vërtetat qëndrojnë ndryshe. E kjo aktualizohet në romanin postmodern.

Në letërsinë shqipe, poetika e romanit post-modern shfaqet fillimisht me romanin Vdekja më vjen prej syve të tillë, të shkrimtarit Rexhep Qosja, botuar në vitin 1974. Më pas vijnë edhe romanet e tjera të këtij shkrimtari, si: Një dashuri dhe shtatë faje, Bijtë e askujt dhe romani Nata është dita jonë (Tri romanet e Rexhep Qosjes, evidentohen si inaugurim i postmo-de-r-nizmit në letërsinë shqipe).

### Kontradikta postmoderne

Më tej, Linda Haçion, teoricientja që i dha formë dhe mbrojtje argumentuese postmodernizmit, pohon se postmodernizmi “është thelbësisht kontradiktor, vendosmërisht historik dhe pashmangshmërisht po-li-tik” (Hutcheon 2005: 4). Kjo gjë i përmbahet romanit në fjalë, për poetikën postmoderne.

Por kjo gjë nuk ndodh vetëm në letërsi. Postmo-de-r-nizmi është shfaqur fillimisht në “arkitekturë”. (Ku-lla veneciane e vitit 1980 njihet si themeli unik i postmodernizmit në arkitekturë). Pastaj fillon e shfaqet edhe në fushat e artet e tjera, si: në pikturë, muzikë, vallëzim, fotografi, film, letërsi, filozofi, po-litikë etj..

Kjo poetikë, ndryshe njihet si poetika e para-do-k-sit. Është cilësuar kështu për shkak se ndër para-do-k-set themelore të romanit postmodern, është rivizitimi i së kaluarës. Megjithatë, jo me rivizitimin nostalgjik, por duke kritikuar, ironizuar dhe parodizuar atë.

Pas gjithë këtyre “humbjeve” dhe shfaqjes së një poetike të re, romani mbijetues, pra romani post-mo-dern, vihet në kërkim të së vërtetave dhe realiteteve të reja.

Në një nga këto, Bodriari merr si realitet simulacio-nin, apo botën e simuluar, ku thotë se realiteti i so-tëm nuk është më realitet, nuk i ngjan realitetit, “sep-se në të dominon virtualiteti”. Bota është bërë e simu-luar e asgjë nuk ndodh prej vërteti. “Në vend se filmi të bëhet nga realiteti, ne, - thotë Bodriari, jetojmë në hiper-realitetin e shfaqur nga filmat, ku bota është një “disneyland””. Madje, me rrëzimin e kullave binjake në Amerikë, thuhet se ai (Bodriari) “u gëzua”, për fa-k-tin që më në fund ndodhi diçka e vërtetë. Dekla-ra-ti-visht thotë se: “ata e bënë, por ne e dëshiroam”.

### Ironia e cinizmi posmodern

Në anën tjetër, fiksioni i romanit postmodern, si para-element fundamental, ka “mendjen cinike” që po-tencon filozofi Sloterdijk, apo ironinë që është si “një pancir racional” i romanit postmodern. Pra “iro-nia jo thjesht si një tallje, por më shumë si një pancir racional që e mbron shkrimtarin nga nostalgjia për të kaluarën. Pa këtë “pancir”, postmodernizmi përfu-n-don i shtrirë përdhë pa jetë” (Apolloni 2010: 232). Se-p-se, vetëm mendja cinike, apo ironia, i merr të gjitha pozitivitetet si mashtrime dhe kështu arrin në hulu-m-ti-min e të vërtetave dhe esencave njerëzore.

Lidhur me këtë parafrazim, mund të marrim si she-mbull heroin Mic Sokoli, ku më e vërtetë është ba-r-coleta për heroin, sesa vet heroizmi i tij. Pra, pse Mic So-koli i del topit me gjoks? – I del për shkakun se “nuk e di çka është ai” (Salihu 2005: 123) (topi-predha, gra-na-ta).

Kështu, në kontekstin e ri të kulturës liberale, tipik në romanet postmoderne, e gjejmë tek romanet e Re-xhep Qosjes, p.sh. tek Një dashuri

dhe shtatë faje, të artikuluar tek personazhi Rexhë. Rexha, “persona-zhi më tragjik në këngët popullore: viktimë e shqelmit të kalit” (Qosja 2003: 211), parodizohet nëpërmjet ironisë dhe kjo na dëshmon se ironisti është i adapatuar me kulturën liberale postfilozofike ose post-moderne.

Në këtë aspekt, Rorty kishte të drejtë kur pohonte se “reagimi i ironistit ndaj mizorisë, është më parë qeshja se veprimi” (Rorty 1990: 15) dhe se rol kyç në romanin postmodern luan ironisti dhe ironia.

Këtë rast, mund ta vërejmë më së miri te romani Nata është dita jonë të shkrimtarit Rexhep Qosja, kur narratori-tregimtar Budin Buda (me nofkën Kentauri), gjendet në hetime, në stacionin policor, ku ironia është thelbi i ironistit, dhe romanit. Ironizon policinë, marrëjen në pyetje nga policia. Për qeshja, parodija, ironia theksohet është evidente duke ngritur paralele mes diskuturës së pushtimit të Kosovës nga Serbia dhe lirisë, apo demokracisë së keqpërdorur, apo shpërdoruar nga koha e pasluftës, nga iks, e filan (komandantë, që bien të flenë fukarenj dhe mëngjesi i zgjon milionerë etj.).

### **Narratori personazh**

Pra, në roman, protagonist kryesor kemi intelektualin e shpërfillur nga rrethi (Vajazani) e shoqëria. Protagonisti, përveç që është i dijshtëm, ai bindet që jo dija, por fuqia është ajo që i zgjidhë problemet e jetës: “Jeta e vërtetë fillon kur vepron e jo kur mendon” (Qosja 2007: 33), ndaj, “nuk dua të jem as i dëgjues-shëm, as i mençur, as i urtë. Dua të jem ky që jam: Budin Buda-Kentauri” (Qosja 2007: 33).

Nga ky aspekt, protagonistin pasi bindet që jo dija, por fuqia të sjell dobi, diskursi meditativ shndërrohet në një diskurs kritik. Rrjedhimisht dhe këtu mënyra e rrëfimit është identike me poetikën e rrëfimit postmodern. Pra, ndërrohet dhe qasja e rrëfimit, siç do të mos ndarja nga tradita, apo rrëfimet e prozës moderne.

Kjo poetikë “e konteston dhe e problematizon kodin e paraqitjes dhe nëpërmjet manifestimit të rrëfimit antirealist, e jep variantin e vet diskursiv mbi realitetin. Autori nuk pranon ta

absolutizojë mendimin e tij mbi realitetin me anë të perspektivës së narratorit të gjithëdijshtëm. Në vend të tij, zgjedh narratorin-personazh për ta paraqitur thjesht një variant të realitetit të parë me dy sytë e tij dhe nëpërmjet konstruktimit personal të universit narrativ, ndërton vizionin tonë për realitetin e shenjuar” (Apolloni 2013: 198). Dhe këtu bëhet qëllimisht konfrontimi mes realitetit dhe fikcionit të romanit. Pra, Budin Buda-Kentauri, si narrator-personazh, vihet në siklet se a t’i thotë gjërat si janë, si ndodhin, apo të trillojë mbi to. Ai e di që trillimi është baza e letërsisë, mirëpo nuk ka dëshirë që t’i hidhërohet realiteti: “Vetëm një gjë është e sigurt si një e një që bëjnë dy: nuk do të hidhërohet njëmendësia. Nuk ka arsye njëmendësia të hidhërohet me mua. Ajo do të më thotë: Bravo! Përpara! Ti nuk po më tradhëton. Ti po e tregon fytyrën time siç është. Ti po më shikon në loqë të zemrës! Dhe në bebëzat e syve!” (Qosja 2007: 199).

Këtu, Budin Buda-Kentauri, vendos përfundimisht që mos t’ia bëjë qejfin jurisë së konkursit letrar të Ministrisë së Kulturës, ku do konkurojë për romenin më të mirë të mijëvjeçarit të tretë. Pra, Budini vendos të thotë realitetin që ta ruajë këtë miqësi mijëvjeçare mes jetës dhe veprës. Ani pse këto do e zënë vendin e njëra-tjetrës, anipse edhe protagonisti të ndodhë të jenë të gjithë negativë, për shkakun që autori është kritik ndaj realitetit në Vajazan dhe tepër i pakënaqur me jetën.

Pra, edhe sipas Rorty-t, romani postmodern kërkon ironistin liberal, i cili duhet të jetë i avancuar në dialog të hapur dhe duhet të jetë i papërmbullur socialisht.

### **Nga vetëdija kah komunizimi**

Në këtë aspekt dhe në këtë bazë, romani postmodern përfaqëson legjitimitetin e avancimit të së vërtetave njerëzore, tepër njerëzore. E kjo dëshkohet edhe me temat që hasim brenda romaneve që janë me tema sociale e jo siç ishte te romani modern me të vërtetat e “papakshme” dhe me ato fluturimet në

hapësirë, si: Zoti, e vërteta, e mira etj., pra, të meta-rrë-fimeve të mëdha.

Për të arritur deri te themeli unik i legji-ti-mi-te-tit të së vërtetave, si dhe te kristalizimi i koncepteve unike, Jurgen Habermas pohon se duhet kaluar nga para-digma e mendjes, në atë të mendjes komu-ni-ka-tive. Habermasi ka ngritur tezën e tij për zgjidhjen e definimit të problemeve dhe pohon se duhet kaluar nga “paradigma e vetëdijes” në atë të “komunikimit”. Sipas tij, vetëm me hapjen e perspektivës komu-ni-ka-ti-ve, mendja mund të riafirmohet me gjithë mundësitë e saj të tjera, sepse mendja komunikative nuk mund të jetë e kënaqur me ngushëllimin që ofron religjioni. Por nuk është edhe pa ngushëllim dhe shpjegohet se arsytet e mosprojektimit utopik të mendjes komu-ni-ka-ti-ve në të ardhmen, duhen kërkuar në sistemin e kësaj me-ndjeje. Me fjalë të tjera, në botën e vorbullës jetë-sore, në format e shumta me të cilat ajo po mani-fe-s-tohet e që Habermas-i i sheh si prodhime të vep-ri-me-ve të përbashkëta intersubjektive. Kjo është arsyeja që Habermas-i mbetet “modern” dhe në kërkim të pë-r-gjigjeve dhe koncepteve të reja.

Realisht, të gjitha rrjedhat e reja që kun-dë-r-sh-to-j-në traditën, siç ka bërë dhe bën tani romani postmo-dern si: romani Emri i trëndafililit i shkrimtarit italian Um-ber-to Eko, si dhe romanet Nata është dita jonë, Bijtë e askujt, Vdekja më vjen prej syve të tillë, Një dashuri dhe shtatë faje të shkrimtarit Rexhep Qosja. Pastaj romanet e Ridvan Dibrës Legjenda e vetmisë, Kanuni i Lekës së vogël, Triumfi i dytë i Gjergj Elez Alisë etj., nuk i ndanë ndonjë hendek i patejka-lu-e-shëm dhe që të gjithë shquhen në esencën e tyre për tema mjaft të vogla e sociale, sa që ironia është do-mi-nuese në çdo situatë dhe mendja cinike, siç pote-n-co-n-te Sloterdijk.

### **E vërteta e re – forma e hapur**

Mirëpo, identifikimi i romanit (edhe i filozofisë), me të vërtetën dhe të mirën, ka qenë presupozim i ve-të-kuptueshëm i periudhës moderne. Kjo është ar-sy-e-ja pse romani postmodern e kundërshtoi traditën e romanit modern. Ai u krijua si nevojë e kohës për një të vërtetë të re,

që Bodriari do ta quante “simu-la-c-rum”, apo simulim.

I tillë me romanin postmodern, i cili ndërtohet në bazë të parimeve, koncepteve dhe rregullave kon-ce-ptuale, është edhe ndërtimi dhe funksionalizimi i sistemit Evropian. Edhe Evropa u krijua në bazë të një koncepti idesh, apo të një vargu konceptesh, me që-llim që të jetë një lloj familjarizimi i harmonizuar i njerëzve. Pra, na ofron në njëfarë forme, pluralizmin demokratik. E kjo vjen si shkak i shterrjes, apo zbe-h-jeve të virtyteve njerëzore dhe me qëllim të një jete më solide, më efikase dhe më funksionale, ku bëhet “marrëveshja” e legjitimitetit dhe funksionimit të Ev-ro-pës që e kemi sot.

Pra, në këtë kontekst, edhe romani postmodern, në bazë të rregullave e parimeve, me qëllim që të ecë para e të mos ndalemi te “letërsia e shterruar”, hapet dhe krijon modele e variante duke sugjeruar që temat e vogla shpeshherë mund të prekin shpirtin e mijëra, apo miliona lexuesve të kësaj bote të madhe e me shpirtëra të mëdhenj.

Fatmirësisht, romani ka kaluar këto mbetje e apori, duke hapur variante të shumta dhe duke lënë edhe formën e hapur (open form).

Mbi këto parime, për shkak se “romanet post-mo-derne, jo rrallë janë vepra aposteriori karshi kri-ti-kës e për rrjedhojë, ai që bën metatekstin (kritikë, re-ce-nsion, studim) për akcilen vepër, bazohet pothuajse në të njëjtat studime në të cilat është bazuar edhe au-tori veprën e të cilit e ka për objekt”.

Pra, “studiuesit krijojnë rregullat, ndërsa shkri-m-ta-rët u përmbahen atyre. Ai që bën metatekstin ta-sh-më, i di rregullat, filozofinë, sensibilitetin, konceptet dhe terminologjinë që i karakterizojnë periudhën, poe-ti-kën dhe kritikën postmoderne, si dhe është i bindur se interpretimi i cilësdo vepër aktuale, nuk është hiç më shumë se hetim dhe evidentim i nocioneve kritike e filozofike”.

Mirëpo, këtu duhet të jemi të qartë. Nuk po flasim për vlerat specifike letrare. Po flasim për moda-li-tetet, variantet, format dhe elementet letrare, të cilat nuk i kontestojnë vlerat letrare, sepse, tek e fun-dit, “modern” mund ta quajmë

edhe Homerin, edhe Eskilin, edhe Shekspirin e Danten etj., vlera e të cilëve nuk kontestohet. Këtu po shohim më tepër variantet, të cilat erdhën si detyrime ose si pasojë e përmbysjes së njëra-tjetrës dhe këtu duhet të pranojmë pohimin afirmativ se edhe modernia, edhe postmodernia, janë letërsi dhe i përkasin letërsisë; këto dy formacione le-t-rare nuk duhen parë si të huaja ose si përmbysje të qëllimta të letërsisë, ose të njëra-tjetrës. Mirëpo, në këtë kontekst, më së miri do të lidhej kredoja e filozofit Jean-Jacques Rousseau, i cili beson se “çdo progres është doemos i paguar me një regres në një fu-shë tjetër”. Ndaj letërsia (në këtë rast, romani), për të mbijetuar dhe për të dalë nga zinxhirët e atyre klla-pa-ve të hekurta moderne, u detyrua në njëfarë forme të nisë

udhën e re dhe t’ia hapë dyert romanit dhe letërsisë drejt një të ardhmeje më të ndritur, t’ia lërë edhe formën të hapur (open forme) për variante dhe mundësi të reja.

### **Përfundim**

Këtu, së fundi, vërehet se letërsia si vërtetësi dhe realitet, në romanin postmodern, shenjon bazame-ntet e një ndjeshmërie të re, me të vërteta dhe re-a-litete të reja dhe normalisht “si pasojë” për-mbyll mo-dusin e modaliteteve të romanit modern, duke shfaqur ekzibicionet kreative në romanin postmodern dhe duke dëshmuar që të vërtetat, realitetet dhe le-të-r-sia, dijnë dhe mund të bëhen e shkruhen dhe krijo-het edhe më ndryshe.

**SHKURTIMET TERMINOLOGJIKE NË FJALORËT SHPJEGUES DHE NË FJALORËT  
DYGJUHËSH TË SHQIPES NGA GJYSMA E DYTË E SHEK. XX DERI SOT. VËSHTRIM I  
PËRGJITHSHËM E KRAHASUES.**

**THE TERMINOLOGY ABBREVIATIONS IN MONOLINGUAL AND BILINGUAL  
DICTIONARIES IN ALBANIAN FROM THE SECOND HALF OF 20TH CENTURY TILL  
NOWADAYS. A GENERAL AND COMPARATIVE OVERVIEW.**

ALMA TIRANA  
almaelita@yahoo.co.uk

**PËRMBLEDHJE**

Zhvillimet e leksikografisë në një gjuhë janë të lidhura drejtpërdrejt dhe me pasurimin e strukturës semantike të fjalëve, me përpunimin e terminologjisë tekniko-shkencore dhe me përvijimin më të qartë të stileve funksionale. Këto materializohen në shkurtimeve e fushave tematike dhe stilistike, që shoqërojnë çdo fjalor shpjegues apo dygjuhësh. Nëpërmjet disa pasqyrave krahasuese të shkurtimeve, jemi përpjekur të paraqesim zhvillimin e strukturës së fushave tematike në fjalorët shpjegues të shqipes dhe në fjalorët dygjuhësh të saj dhe kemi arritur në disa përfundime e rekomandime për një strukturë më të plotë e më të përmirësuar të fushave tematike, veçanërisht në fjalorët shpjegues të shqipes.

**Fjalët çelës:** *shkurtime, fjalor shpjegues, fjalor dygjuhësh, fushë tematike, terminologji.*

**SUMMARY**

The development of lexicography for a language is directly related to the enrichment of semantic structure of words, with the processing of scientific and technical terminology to outline more clearly the functional styles. These are reflected in the abbreviations of thematic fields and stylistic fields which are associated to each explanatory or bilingual dictionary. In this kind of investigation we're trying to present the development of structure in the thematic fields of Albanian explanatory dictionaries and bilingual dictionaries through some comparative statements of abbreviations. As a result we have reached some conclusions and recommendations for a more completed and improved structure of thematic fields, especially in explanatory dictionaries of Albanian.

**Key-words:** abbreviations, explanatory dictionary, bilingual dictionary, thematic field, terminology.

---

**Hyrje**

Periudha moderne e zhvillimit të leksikografisë shqipe ka nisur nga mesi i shek. XX, si për leksikografinë dygjuhëshe, ashtu edhe leksikografinë njëgjuhëshe (d.m.th. në fushën e fjalorëve shpjegues). Krahas punës konkrete për hartimin e fjalorëve, janë trajtuar e diskutuar edhe çështje të teorisë së leksikografisë. Si pasojë, është shënuar një rritje e ndjeshme cilësore për mënyrën e pasqyimit të leksikut të gjuhës, për qasjen më të mirë drejt normës

leksikore, si dhe për shënimin e fushave tematike e të vlerave stilistike të fjalës.

Zhvillime të tilla në gjuhë janë të lidhura drejtpërdrejt dhe me pasurimin e strukturës semantike të fjalëve, me përpunimin e terminologjisë tekniko-shkencore dhe me përvijimin më të qartë të stileve funksionale. Këto janë materializuar në shkurtimeve e fushave tematike (*anat.* anatomi, *arkit.* Arkitekturë, *bujq.* bujqësi etj.) dhe stilistike (*bised.* ligjërimit bisedor, *euf.* Eufemizëm. *famil.* Familjar etj.), që shoqërojnë çdo fjalor shpjegues apo dygjuhësh. Objekt i

studimit tonë nga kjo pikëpamje janë fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe (1954 [1], 1980 [2], 1984 [3], 2002 [4], 2006 [5]) dhe disa nga fjalorët dygjuhësh më të rëndësishëm shqip - gjuhë e fjalorët dygjuhësh të shqipes me fjalorët shpjegues të saj, vëmë re këto të dhëna numerike të shkurtimeve:

Fjalorët dygjuhësh:

*Fjalor Shqip – Anglisht* [6] – 32 shkurtime

*Fjalor Gjermanisht–Shqip* [7] - 74 shkurtime

*Fjalor Shqip – Italisht* [8] - 86 shkurtime

*Fjalor Frëngjisht – Shqip* [9] - 25 shkurtime

*Fjalor Spanjisht – Shqip* [10] - 14 shkurtime

*Fjalor Shqip – Anglisht* [11] - 62 shkurtime

*Fjalor Frëngjisht – Shqip* [12] - 66 shkurtime

*Fjalor Gjermanisht–Shqip* [13]- 53 shkurtime

*Fjalor Anglisht – Shqip* [14] - 41 shkurtime

*Fjalor Anglisht – Shqip* [15] - 65 shkurtime

*Fjalor Shqip–Gjermanisht* [16]- 77 shkurtime

*Fjalor Greqisht – Shqip* [17]- 65 shkurtime

Fjalorët shpjegues:

*Fjalor i gjuhës shqipe* (1954)–25 shkurtime

*Fjalor i gjuhës shqipe* (1980) – 73 shkurtime

*Fjalor i gjuhës shqipe* (1984) – 75 shkurtime

*Fjalor i gjuhës shqipe* (2002) – 75 shkurtime

*Fjalor i gjuhës shqipe* (2006) – 76 shkurtime.

Duke krahasuar fillimisht fjalorët shpjegues të shqipes me njëri-tjetrin, vihet re se numri i fushave tematike dhe i shkurtimeve të tyre ka ardhur duke u zgjeruar, sidomos duke krahasuar fjalorin e parë shpjegues (1954) me 25 shkurtime tematike me fjalorin e vitit 2006 me gjithsej 76 të tilla ose tri herë më shumë.

P.sh., në fjalorin e vitit 1954 ndeshen mungesa të shkurtimeve të një numri fushash tematike, si: *aviacion, arkeologji, hartografi, bujqësi, detari, gjueti, diplomaci, farmaceutikë, fiziologji* etj.

Duhet të kemi parasysh se numri i shkurtimeve varet dhe nga madhësia e fjalorëve shpjegues. Në rastin e dhënë numri i fjalëve të përfshira në fjalorët shpjegues është rritur në mënyrë sasiore dhe cilësore.

Në çdo fjalor nuk mungojnë shkurtime bazë të fushave tematike (*term në anatomi, arkitekturë, astronomi, gjeologji, kimi, matematikë, mjekësi, muzikë, ushtri, zoologji* apo *term i botanikës*).

huaj e gjuhë e huaj - shqip, që i përkasin periudhës së gjysmës së dytë të shek. XX.

Nëse

krahasojmë

Megjithatë, ka disa shkurtime që ndeshen në fjalorët dygjuhësh, të cilat mund të gjejnë përdorim edhe në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe në të ardhmen. Në fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe ndeshim shkurtime *fjalë ose shprehje e punëve zyrtare*, ndërkohë që tek fjalorët dygjuhësh ndeshet edhe shkurtime *administratë* (në fjalorët: Ali Dhrimo, Hamlet Bezhani: *Fjalor Gjermanisht -Shqip*, 1996 dhe Ali Dhrimo: *Fjalor Shqip – Gjermanisht, Tiranë* 2005, si dhe tek Drita Hadaj: *Fjalor Frëngjisht – Shqip*, 2000). Këto janë fusha tematike të afërta, ku njëra shpreh një koncept më të gjerë e tjetra më pak. Në fjalorin shpjegues ka ende mungesa të shkurtimeve për fjalë e kuptime të veçanta të fjalëve, si: *autorizim, dëftesë, organikë, plan-detyrë, raport, relacion, urdhëresë* etj.

Shkurtime *gram.* (*gramatikë*), që është përdorur në fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1954 te terma si *emërore, gjinore, dhanore, fjali, theks, zanore* etj., te fjalorët e mëvonshëm është zëvendësuar me *gjuh.* (*gjuhësi*), ndërkohë që tek fjalorët e tjerë dygjuhësh, mund të gjejmë *gjuhësi, gramatikë dhe fonetikë*.

Një dukuri e ngjashme ndodh me shkurtime *aut.* (për *automobilizëm* ose *automjete*), që gjendet në fjalorët dygjuhësh të shqipes (p.sh. tek F. Leka, Z. Simoni: *Fjalor Italisht - Shqip* dhe *Fjalor Shqip – Italisht*; P. Qesku: *Fjalor Anglisht - Shqip* dhe *Shqip – Anglisht*, D. Hadaj, *Fjalor Frëngjisht – Shqip*, dhe L. Marku: *Fjalor Greqisht – Shqip*). Sipas studimit mbi pasqyrimin e fushave terminologjike në FGjShS (1980) [18], “arsyeja është se emërtesa e automobilit në gjuhën shqipe është plot me italianizma dhe për këtë është vështruar si njëfarë zhargoni profesional. Vërtet që në fjalor janë përfshirë disa fjalë të kësaj fushe, si *diferencial, karrocери, marsh, qiri (kandele), radiator* etj., të cilat janë të shënuara me shkurtime *tek.* (term në teknikë) ose pa këtë shënim, si: *fshirëse (e xhamit), fren, timon* etj., por ka edhe fjalë me denduri jo të vogël që

mungojnë, si: *kruskot, marmitë, serbator, skapament*. Autorët e fjalorëve gjuhë e huaj – shqip nuk mund t’u shmangeshin emërtimeve të këtyre pjesëve të automobilin në gjuhët përkatëse dhe dashur pa dashur i kanë futur këta italianizma te pjesa shqipe e fjalorit”. Ky studim i përket vitit 2004 e mund të ishte marrë parasysh në hartimin e fjalorit shpjegues të shqipes të vitit 2006, pasi edhe sot këto fjalë të lartpërmendura nuk janë pasqyruar.

Në fjalorin shpjegues të shqipes përdoret i njëjti shkurtim për fushat *minierë* dhe *mineralogji*, ndërsa në fjalorët dygjuhësh këto fusha janë të dalluara nga njëra-tjetra.

Shkurtimet e ngjashme me njëra-tjetrën (ato të nënvizuara janë pjesë e FGjSh), si *fotograf* dhe *fototeknikë*; *drejtësi* dhe term *juridik*; *farmaceutikë* dhe *farmakologji*, *mjekësi* dhe *kirurgji*; *hidroteknikë* e *hidrologji*; *bletari* apo *bujqësi*; *radio*, *radioteknikë*, *radiotelevizion*; *ushtri* apo *artileri*; *iktiologji*, *entomologji* apo *zoologji*, tregojnë në një farë mënyre edhe shkallën e pasurisë leksikore të një gjuhe, që në shqipe është disi më e kufizuar.

Ka dhe nga ato shkurtime që ndeshen më rrallë në fjalorët dygjuhësh të shqipes, si shkurtimet për: *ekonomi politike*, *ushtarako-detare* apo e *drejtë romake*, e që në fjalorët tanë shpjegues mungojnë krejt.

Ndërkohë që tek fjalorët dygjuhësh të shqipes ndeshen shkurtimet për fushat *politikë* dhe *parlament*, në fjalorët shpjegues të saj këto nuk janë të pranishme. Leksiku politik përmbledh fjalë, terma, shprehje apo kuptime, të cilat zënë vend në fjalime publike, mbledhje partish e organizatash të ndryshme qeveritare ose jo, konferenca e ligjërime të mbajtura nga ana e politologëve, politikanëve, udhëheqësve (liderëve) etj. Fjalë të tilla, si: *monarki, demokraci, diktaturë, socialist, aderoj, militoj* (në FGjSh 2006 shpjegimi i *aderoj* dhe *militoj* shoqërohet nga shkurtimi *libr.*, *telefoni e urbanistikë*, që në fjalorët shpjegues të shqipes nuk janë të pasqyruara.

## PËRFUNDIME

(fjalë ose shprehje e ligjërimit libror), *miting, statut, udhëheqës* etj. mund të kenë “profilizimin” e tyre në fjalor njëlloj si shumë fjalë të tjera.

Në fjalorët shpjegues të shqipes (1980, 1984, 2002, 2006) për fjalët e sferës fetare përdoren shkurtimet *fet*. (fjalë ose shprehje fetare) dhe *kish*. term kishtar), ndërsa në fjalorët dygjuhësh ka edhe shkurtime për fusha fetare si: *biblike, katolike, ortodokse, protestant, myslimane*. P.sh. fjalët *namaz, myfti, iftar* janë shënuar me shkurtimin *fet*. (dhe jo *mysl.*), ashtu si *agjërim, kreshmë*. Nga ana tjetër, fjalë si *dhespot, prift, dhjak, kishë, xhami, teqe* nuk kanë asnjë nga shkurtimet e mësipërme.

E njëjta edhe me shkurtimin *sport*. (por edhe bashkë *sport e fizkulturë*) që shpjegon në një mënyrë të përgjithshme një lloj sporti; në fjalorët dygjuhësh ka dhe shkurtime, si: *atletikë, futboll, gjimnastikë, alpinizëm, shah*, të cilat në fjalorin shpjegues të shqipes mungojnë.

Në fjalorët dygjuhësh shkurtimet për *komputer* dhe *informatikë* shënojnë fusha të dallueshme tematike, ndërsa në FGjSh (2006) është dhënë vetëm shkurtimi për kompjuterin.

Edhe në fushën e kuzhinës e të gatimit, në FGjSh ndeshim shënimin për *gjellëtari*, ndërkohë që tek fjalorët shpjegues dygjuhësh gjejmë edhe *kuzhinë* e *gastronomi*. (huazimet e reja leksikore nga kjo fushë, si emërtime produktesh ushqimore, frutash, pijesh etj., që kanë ardhur bashkë me sendin përkatës mungojnë në fjalorët shpjegues, ndërkohë që ato janë bërë pjesë e ligjërimit tonë të përditshëm.)

Në disa fjalorë dygjuhësh (më shumë tek fjalori *Frëngjisht – Shqip* i Drita Hadajt - me rreth 15 mijë fjalë dhe tek fjalori *Greqisht – Shqip* i Lavdimir Markut - me rreth 40 mijë fjalë) ndeshim edhe shkurtime, si: *arsim, shkollor, ekologji, skulpturë, sociologji, antonomazi, retorikë, metrikë, filologji, gazetari, shoqëri, teknologji*

Leksiku i një gjuhe pasurohet kohë pas kohe me fjalë apo zhvillime semantike të reja dhe është thuajse i pamundur pasqyrimi adekuat i gjendjes reale të tij në fjalorë. Por nëpërmjet qasjeve të



tilla krahasuese mund të nxjerrim në pah të tjera zhvillime të fjalëve në gjuhë. E. Çabej shprehet se “*Pasurimi i leksikut mund të ndiqet hap pas hapi edhe nëpërmjet fjalorëve*” [19] e në këtë mënyrë, nëse krahasojmë shkurtime terminologjike nga fjalori i vitit 1954 e gjer në 2006-n, ato kanë pësuar një rritje sasiore dhe cilësore. Kësisoj, në të ardhmen mund të përzgjidhen fjalë apo terma të caktuar për t’u pasqyruar në fjalor edhe me shkurtime e tyre përkatëse, si: *automobilizëm, politikë, kuzhinë, informatikë, kompjuter* etj.

Zgjerimi i strukturës kuptimore ndodh më së shumti tek fjalët e leksikut të përgjithshëm sesa tek termat. Në fjalorët shpjegues, qoftë edhe në ata të tipit të madh, nuk mund të regjistrohen të gjitha kuptimet e fjalëve e megjithatë, nga krahasimi ndërmjet këtyre dy tipave të fjalorëve, arrijmë në mendimin se tashmë fjalorët shpjegues të shqipes duhet të kenë një strukturë më të plotë e më të përmirësuar të fushave tematike, sepse “*fjalët që përdor një bashkësi gjuhësore janë një tregues i drejtpërdrejtë i nivelit të saj kulturor e shkencor, i njohurive e i mjeteve që ka dhe që përdor ajo, i mënyrës së jetesës së saj* [18]” dhe në këtë vështrim ndryshimet janë të një shkalle mjaft të dukshme.

**Lista alfabetike e fushave terminologjike e tematike për të cilat janë përdorur shkurtime në fjalorët e marrë në shqyrtim:**

**Tabela 1**

administratë	aeronautikë
agronomi	alpinizëm
anatomi	antikitet
antropologji	arkeologji
arkitekturë	arsim
arte	artileri
astronautikë	astronomi
atletikë	automobilizëm
aviacion	bakteriologji
biblike	biokimi
biologji	blegtori
bletarisë	botanikë
bujqësi	detari
diplomaci	drejtësi
drejtë romake (e)	ekologji

ekonomi	ekonomi politike
elektricitet	elektronikë
elektroteknikë	entomologji
etnografi	farmaceutikë
farmakologji	fetar (term)
filologji	financë
filozofi	fizikë
fiziologji	fizkulturë
folkloristikë	fonetikë
fotografi	fototeknikë
futboll	gastronomi
gazetari	gjellëtari
gjeodezi	gjeofizikë
gjeografi	gjeologji
gjeometri	gjimnastikë
gjueti	gjuhë parlamenti
gjuhësi	gramatikë
hartografi	hekurudhë
hidrologji	hidroteknikë
histori	histori e Greqisë (së Vjetër)
histori e Romës	iktiologji
industri	industri tekstile
informatikë	juridik
katolik	këpucëtari
kimi	kinematografi
kirurgji	kishtar (term)
kompjuter	kopshtari
kozmetikë	kuzhinë
letërsi	letrar
logjikë	lojë me letra
lojë shahu	matematikë
mekanikë	metalurgji
meteorologji	metrikë
mineralogji	minierë
mitologji	mjekësi
motor	muzikë
ndërtim	optikë
ornitologji	ortodoksi
paleontologji	peshkatari
pikturë	poligrafi
politikë	postë
protestant	psikologji
pylltari	radio
radioteknikë	radiotelevizion
rrobaqepësi	shkencë

shkollor (term)	shoqëri
shtypshkronjë	skulpturë
sociologji	special (term)
sport	statistikë
teatër	teknikë
teknologji	telefoni
telegrafi	televizion
tipografi	topografi
tregti	urbanistikë
ushtarako-detar (term)	ushtri
veterinari	zdrukthëtari
zoologji	zooteknikë
zooveterinari	zyrtare

### BIBLIOGRAFI

- [1] Cipo, K., Çabej E., Domi, M., Krajni, A., Myderizi, O., Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 1954.
- [2] Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980.
- [3] Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë, 1984.
- [4] Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë, 2002.
- [5] Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 2006.
- [6] Duro, I., Hysa, R., Fjalor Shqip – Anglisht, “8 Nëntori”, 1988.
- [7] Dhrimo, A., Bezhani, H., Fjalor Gjermanisht – Shqip, Band I A-M. Band II N-Z. Harrassowitz Verlag Wiesbaden, 1996.
- [8] Leka, F., Simoni, Zef, Fjalor Shqip – Italisht, 1996.
- [9] Kokona, V., Fjalor Frëngjisht – Shqip, Tiranë, 1996.
- [10] Kokonozi, D., Fjalor Spanjisht – Shqip, Tiranë, 1996.
- [11] Qesku, P., Fjalor Shqip – Anglisht, Tiranë, 1999.
- [12] Hadaj, D., Fjalor Frëngjisht – Shqip, Dituria, 2000.
- [13] Fiedler, W., Klosi, A., Fjalor Gjermanisht – Shqip, Leipzig, 2001.
- [14] Stefanllari, I., Fjalor Anglisht – Shqip, Tiranë, 2001.
- [15] Qesku, P., Fjalor Anglisht – Shqip, Tiranë, 2004.
- [16] Dhrimo, A., Fjalor Shqip – Gjermanisht, Tiranë, 2005.
- [17] Marku, L., Fjalor Greqisht – Shqip, Pa vit bot., ISBN 987-99956-720-3-4.
- [18] Lafe, Emil; Çepani, Anila; Adelina Çerpja (2005), Rreth pasqyrimin të fushave terminologjike në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980). Leksikografia shqipe, trashëgimi dhe perspektivë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2005, 308-314.
- [19] Çabej, E., Studime etimologjike në fushë të shqipes, I, Tiranë, 1982, f. 36..

---

---

## OBSERVATIONS ON THE ALBANIAN TERMINOLOGY OF CLOTHING AND COSMETICS IN MODERN TIMES

### VËZHGIME PËR TERMINOLOGJINË E VESHMBATHJEVE DHE TË KOZMETIKËS NË GJUHËN SHQIPE NË KOHËT E REJA

DORIANA TUXHARI  
dorianatuxhari@gmail.com

#### PËRMBLEDHJE

Fusha tematike e emërtimeve të veshmbathjeve dhe të kozmetikës përfshin një varg fjalësh të fondit të shqipes dhe të shtresës së huazuar nga gjuhë të ndryshme. Gjatë shek. XX e sidomos pas shkëputjes nga Perandoria Osmane, te Shqiptarët filloi një modernizim i jetës shoqërore, që solli pasoja edhe në terminologjinë e veshmbathjeve e të kozmetikës. Objekt i punimit sonë janë pikërisht fjalët e kësaj shtrese të re kulturore moderne të shek. XX dhe fjalë të tjera që lidhen me kohën tonë, sidomos me kthesën politike në Ballkan në kapërcyell të viteve '90. Në punim diskutohen raste të shqipërimit të fjalëve të huaja të kësaj fushe, por sidomos çështja e përfshirjes së tyre në një fjalor të ardhshëm shpjegues si dhe në fjalorët dygjuhësh shqip – gjuhë e huaj e gjuhë e huaj – shqip. Jemi të mendimit se është e nevojshme të hartohet një fjalor i posaçëm i termave të këtyre fushave.

**Fjalë çelës:** *emërtim, fjalor, kozmetikë, term, veshmbathje*

#### SUMMARY

The field of clothing and cosmetics includes a range of words in Albanian language, and loanwords from different languages. In the 20th century, especially after the breakup of the Ottoman Empire, a modernization of the Albanians' social life began, which brought consequences in the terminology of clothing and cosmetics, too. The purpose of our paper are the words of clothing and cosmetics in the new cultural layer of the 20 century, and other words associated with our time, especially with the political turnaround in the Balkans at the beginning of the 90s. The translation of some loanwords is discussed, as well as the incorporation of these words in a future explanatory dictionary, and in bilingual dictionaries, especially in English - foreign language, foreign language - English. We believe that it is necessary to design a special dictionary of terms in this field.

**Keywords:** *reference, dictionary, cosmetics, term, clothing.*

---

#### Hyrje

Terminologjia e veshmbathjeve dhe e kozmetikës në gjuhën shqipe deri sot është pak e studiuar. Janë cekur kryesisht disa terma të veçantë nga pikëpamja etimologjike dhe janë përmendur shtresa të caktuara të saj në kuadër të studimeve të leksikut të shqipes nga pikëpamja burimore.

Fusha tematike e veshmbathjeve dhe e kozmetikës ka pësuar ndryshime të mëdha sidomos në kohët e reja, pra pas shkëputjes nga Perandoria Osmane (viti 1912), kur filloi një modernizim i jetës shoqërore të Shqiptarëve, e deri sot. Rruga kryesore e pasurimit të

terminologjisë së kësaj fushe ka qenë hyrja e fjalëve nga gjuhë të huaja, me të cilat shqipja ka qenë në kontakt. Sot në kushtet e globalizmit, leksiku i fushës së veshmbathjeve dhe e të kozmetikës po pasurohet me ritme të shpejta, duke u gjendur përballë një trysnie të madhe të fjalëve të huaja dhe për pasojë përballë një ngarkese terminologjike të panevojshme. Një studim më i hollësishëm i kësaj fushe, duke marrë parasysh historinë e zhvillimit të saj në kohët e reja dhe të parimeve të ndjekura nga leksikografia shqiptare, do të ndihmojë në mënjanimin e termave sinonimikë të huaj të

panevojshëm dhe në njësimin e tyre. Me krijimin e një sistemi terminologjik më të qartë dhe më të saktë, shtrohet rruga për hartimin e një fjalori terminologjik të kësaj fushe.

Terminologjia e veshmbathjeve dhe e kozmetikës përfshin emërtimet e veshjeve, të produkteve kozmetike e të pjesëve të tyre, si dhe termat që emërtojnë mjete, materiale e procese të prodhimit dhe të tregtimit të tyre. Në gjuhën shqipe vrulli i hyrjes së fjalëve të huaja në periudha të ndryshme të kohëve të reja ka krijuar disa shtresa kryesore fjalësh:

### **1. Huazimet e përshtatura me drejtshkrimin dhe gramatikën e shqipes**

Huazimet e përshtatura me drejtshkrimin dhe gramatikën e shqipes - këto janë bërë pjesë e fondit leksikor të gjuhës shqipe, megjithëse jo të gjitha janë përfshirë në fjalorët shpjegues. Në shtresën aktive të leksikut gjejmë:

**a) huazime nga italishtja (italianizma)**, që mund t'i klasifikojmë sipas periudhave kohore:

- **italianizma të periudhës ndërmjet dy luftërave botërore dhe të viteve të pushtimit (1914-1944)**, të cilat kanë hyrë në shqipe sidomos pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia (1939), si: *beretë, bobinë, borsalinë, brilantinë, damask, disenjator, filigran, gabardinë, gete, kaki, kamosh, kanotierë, kapotë, kapuç, kasketë, kaskë, kombinoj, koral, kostum, kravatë, krem, livandë, llak, mantel, medaljon, model, modelist, modeloj, modern, modernizëm, modernizoj, modë, modist, motiv, onde, palçeta, pantofël, pantallona, papuçe, parukë, parukier, portofol, pupë, sallon, sandale, seta, sintetike, stampë, stampoj, stof, terital, tirandë, tuta, uniformë, vazelinë, xhakëtë, xhelatinë* etj.

Për disa prej tyre është vështirë të caktohet me siguri nëse janë italianizma apo francezizma, p.sh. *krem, model, modist, modelist, pantofle, tirandë* etj.

- **italianizma të reja, që kanë hyrë në shqipe nga vitet '90 e në vijim**, si: *acid hialuronik, akuamarin, blefaroplastikë, dekloruj, depiloj, deskuamoj, difuzor, dizenjoj, eksfoliant* (sinonim i anglicizmit *skrab*), *fin, fondatintë, inestetizëm, integror, kremoze, lavatestë, locion tonik, marsupio, melazmë, mishelar, mokasina, najlon, parfumeri, pasarelë, pjastër, plazmë, sfilatë,*

*silikon, solar, spilë, sprucoj, stilist, strishë (depilimi), teksturë, ton, tonifikoj, tonik* etj.

**b) huazime nga frëngjishtja (francezizma)**, të cilat kanë hyrë kryesisht në periudhën midis dy luftërave botërore, kur në Shqipëri gjuha dhe kultura franceze gëzonin një prestigj të lartë, si: *azhur, atelie, bezhë, bigudë, bluzë, buduar, bukë, butik, dantellë, dekolte, demode, detaj, fildikos, frak, frizurë, gardërobë, galanteri, galloshe, garniturë, gri, karré* (model flokësh), *kilota, komplet, kordon, korse, manekin, manikyr, manto, masazh, makijazh, metrazh, pallto, pandatif, pardesy, papijon, parfum, pedikyr, pelerinë, penjuar, puçin, pudër, robëdëshambër, ruzh, sutiena, shifon, shik, triko, trikotazh, tualet, tyl, violet, zhaponë, zharrëtjerë, zhile, zhupon.*

**c) huazime nga anglishtja (anglicizma)**, pjesa më e madhe e të cilave ka hyrë nga fundi i shek. XX dhe fillimi i shek. XXI, si: *bluxhins, botoks, dizajn, dizajner, fard, fashioniste, golf, jogë, kardio, neon, pirsing, pop art, pulovër, rimel, rok, roller, seksi, skrab, spraj, streçe, supermodel, supermodern, sving, shampo, sharm, shifon, tiarë, ti-shërt, topmodel, trend, trendi, xhel, xhinse, xhuboks* etj.

Vala më e madhe e anglicizmave, që vijon ende, ka filluar pas vitit '90. Huazime më të vjetra nga anglishtja janë të rralla: *ovrolle* (nga anglishtja e Amerikës *overall*), e përdorur në Korçë [1], dhe *dok, akrilik, pizhame*, që mund të kenë hyrë në gjuhën shqipe nëpërmjet gjuhëve neolatine.

Në fund të viteve '90 dhe në vitet 2000 Shqipëria njohu një zhvillim të bizneseve të prodhimit dhe të shërbimit në fushën e veshmbathjeve dhe të kozmetikës, d.m.th. të industrisë së fasoneve dhe të qendrave e klinikave estetike. Paralelisht me to u zhvillua edhe media e specializuar e kësaj fushe, me revistat e modës e të kozmetikës. Termi *fason*, që po përdoret dendur tani me kuptimin "prodhim veshmbathjesh", me sa duket është francezizëm. Kjo fjalë në anglishten e mesme ka dhënë termin *fashion*, që ka hyrë së fundmi në shqipe si sinonim modern i fjalës *modë*, që është një huazim më i vjetër nga gjuhët neolatine.

Disa huazime të përshtatura me drejtshkrimin dhe morfologjinë e shqipes duhet të përfshihen në fjalorët e sotëm shpjegues, si dhe në fjalorët

dygjuhësh. Për shembull, mund të përfshihen termat: *fiston, flakon, fosforeshent, kapeleri, peliçe, peliçeri* etj., që gjenden në fjalorin italisht-shqip [2], po kështu *frizurë, penjuar* etj., që gjenden në fjalorin frëngjisht-shqip [3].

Prirja për mënjanimin e fjalëve të huaja, që zuri fill në Rilindje dhe u trashëgua edhe në hartimin e fjalorëve të shqipes pas çlirimit, mund të zbatohet për disa huazime edhe kur janë të përshtatura me drejtshkrimin dhe gramatikën e shqipes. Kështu *borsë, borsetë, bukle, detaj, deterisiv, dizenjo, filaturë, floreal, grixho, lisho, onde, permanent, tendencë, tirandë, ton, trekuart, violet, voluminoz* mund të zëvendësohen përkatësisht me fjalë të shqipes ose me huazime më të vjetra e më të njohura (disa i këshillon edhe libri “Për pastërtinë e gjuhës shqipe” [4]): *çantë, çantë e vogël, kaçurrel/ krelë, hollësi/ imtësi/ përimitim, larës, skicë/ vizatim/ motiv, tjerrotore, lulor, gri/ i hirtë/ i përhimë/ i përhimtë, njëngjyrësh, valë* (flokë me onde, valë-valë, të valëzuar), *floktore, prirje, krahoshe, hijezues, treçerekëshe, vjollcë, vëllimor*. Fjalët e fondit vendës, të formuara me mjete të shqipes, herë-herë prej temash me burim të huaj, janë një nga rrugët me të cilat shqipja vijon dhe duhet të pasurohet. Të tjera të kësaj shtrese mund të përmendim: *i beztë, dorashka, doreza, fundore* “ana e këmishës së gruas”, *gëzof, i gëzoftë, i kadifenjtë, i kamoshtë, këpucar, kësuljer, krehër, i meshintë, ndërresë, palapetë, palë, petk, pëlhurë, përparëse (përparje), punëdore, qimush, rrobënatë, treçerekëshe, i tyltë, veshje, veshmbathje, kashtor(e)* etj.

## 2. Fjalët e huaja që shkruhen sipas origjinalit dhe herë lakohen e herë jo

Fjalët e huaja që shkruhen sipas origjinalit dhe herë lakohen e herë jo janë një shtresë e paqëndrueshme e leksikut të shqipes, që ka hyrë kryesisht prej anglishtes, por edhe prej italishtes, nga vitet '90 e këtej dhe përdoren kryesisht në median e specializuar për fushën e veshmbathjeve dhe të kozmetikës, si: *acroyoga, animal flow, animal print, anti-age, anticelullit, antioksidant, aromatherapy, art work, babydoll, barbie girl, beauty, bikini, blumarine, body, bomber jacket, bon ton, bordo, boyfriend, candy, carnaby chic, casual, cateye, chic, classy, clutch,*

*coachella, cocktail dress, cowgirl, college girl, colour block, country, court shoes, crème de la crème, depilator, dress code, easy and chic, eyeliner, fashion blogger, fashion designer, fashion week, fashion icon, fotomodel, french, gipsy, glam, glamour, glamorous, gold, gomagge, haute couture, hippy, hydrobike, in, infrared, intimo, jacquard, kilt, lifting, limited edition, lip gloss, lipomassage, little black dress, look, make-up, mascara, maxiclutch, meny fashion, mix and match, modeling, must, neopren, nude, office style, oversize, pastel, pediluvio, peeling, pin up, pink, pixie, police, polka dots, pop, primer, print, pumps, punk, retro, sexy, shorts, skinny, slim-fit, smokey eyes, smoking, spf, suede, superchic, tartan, techno, tips, total black, total white, trendsetter, trendy, t-shirt, ultrachic, unisex, urban-glamour, vintage, vinyl, waterproof* etj.

Pjesa më e madhe e këtyre fjalëve emërtojnë sende dhe koncepte të reja të fushës së kozmetikës, jo vetëm për shqiptarët në vendet e tyre, por edhe për mbarë botën. Vitet e fundit kozmetika është zhvilluar me ritme shumë të shpejta si një shkencë e veçantë, duke u gërshetuar edhe me shumë disiplina të shkencave të tjera, si: kirurgjia plastike, fizioterapia, fizika, kimia, muzika etj., prej të cilave ka huazuar ose ka krijuar terma të rinj.

Një pjesë e fjalëve të huaja të mësipërme pothuaj nuk dëgjohen në gjuhën e folur ose janë të zëvendësueshme me fjalë të shqipes a me huazime më të vjetra që perceptohen si fjalë të shqipes: *animal print – stampa kafshësh, anti-age – kundër rrudhave, bikini – rroba banje të ndara, candy – karamele, cateye – symace, classy – me klas, dress code – kodi i veshjes, fashion icon – ikonë mode, fashion week – java e modës, fondatintë – krem-pudër, lip gloss – shkëlqyes buzësh, little black dress – fustani i vogël i zi, look – pamje, make-up – grim, must – i domosdoshëm, office style – stil zyrtar, oversize – masë e madhe, pink – rozë, print – stampë, spf – filtër mbrojtës, shopping – blerje, shorts – pantallona të shkurtra, (cohë) tartan – skoceze/me kuadrate, total black – tërësisht e zezë, total white – tërësisht e bardhë, waterproof – kundër ujit* etj.

Në përcaktimin e fatit të këtyre fjalëve, një rol të rëndësishëm luan identifikimi i tyre si

ndërkombëtarizma, pra i fjalëve që gjenden në anglishte, në gjuhët neolatine, gjermanike dhe sllave. Këto fjalë vështrohen si të pranueshme në fondin leksikor të shqipes dhe mund të përfshihen në fjalorët shpjegues e dygjuhësh.

### 3. Fjalë të njohura që kanë zgjeruar kuptimin

Fjalë të njohura që kanë zgjeruar kuptimin - në këtë grup përfshihen ato fjalë që janë bërë më parë pjesë e fondit leksikor të gjuhës shqipe me një kuptim tjetër dhe vetëm më vonë (kryesisht pas vitit '90) janë pasuruar dhe me një kuptim të ri të fushës së veshmbathjeve ose kozmetikës, si: *aksesor, aplikacion, aplikim, avangardë, baltë, barok, bordurë, bust/bustier*, (bizhuteri) *demokratike, detaj, detergjent, dizeno, estetikë, firmë, fortesë, furçë, koleksion, futuriste, gotik, hidratoj, hidratues, kalorësiak, klasike, kontur, korrektor* (për flokët dhe për fytyrën), *lazer, markë, maskë, neoromantike, penel, perçina, psikedelike*, (efekt) *riekuilibruet, rokoko, romantike, safari, serum, set* (kozmetik), *sezon* (mode), *solucion, sportiv, stampë, stampoj, kalorësiak, mashkullor, minimalist, stil skocez, thekë, ton, transgresiv* etj.

Në kuadër të përdorimit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm të një gjuhe të përbashkët standarde, leksikografët tanë kanë për detyrë të vendosin si do të trajtohen dallimet leksikore krahinore në fjalorët shpjegues të shqipes dhe në fjalorët gjuhë e huaj – shqip e anasjelltas.

Siç dihet, në disa fusha ka një numër dallimesh terminologjike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, duke u krijuar kështu një varg çiftesh sinonimike. Me ndihmën e koleges nga Kosova Sindorela Doli, nga fusha e veshmbathjeve dhe e kozmetikës mund të përmendim si të tilla: *atlete – patika, benevrekë – klina, bollqe, bezhë – drap, bigudi – llokne, bikini – kopaçe, borsalinë – shishir, brekë – klina, dantellë – tentene, gete – hollaope (hollaopke), grim – shmink, grimier – shminker, i kadifenjtë – sumollke (sumollte), kaki – qeremide, kanotierë – maic, korse – allter, krep – mafes, model flokësh – frizurë, mushama – vindjak, parukier – frizer, perlë – biser, pulovër – xhemper, qyrk – bundë, rimel – llabllanuz (maskarë), robëdëshambër – shllafurk, seta (çorape najloni) – dukelenica, tuta – trajnerka, tharëse flokësh – fren, xhinse – farmerka, xhup – setër* etj. Në

parim mendoj se në çiftet e mësipërme huazimet nga serbishtja a turqishtja mund të mënjanoheren krejt ose të cilësohen si të ligjërimin bisedor, krahinor a fjalë të vjetruara.

### Përfundime

Terminologjia e veshmbathjeve dhe e kozmetikës në kohët e reja shtrun disa detyra për gjuhësinë shqiptare. Zëvendësimi i fjalëve të huaja të panevojshme me fjalë të shqipes, identifikimi i ndërkombëtarizmave, përfshirja e huazimeve të përdorura gjerësisht dhe të përshtatura prej kohësh me drejtshkrimin dhe gramatikën e shqipes dhe e kuptimeve të reja të fjalëve ekzistuese në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe janë vetëm disa prej këtyre detyrave.

Dëshiroj të hyj në lidhje bashkëpunimi me kolege nga Kosova e Maqedonia për të përpiluar një listë më të plotë të termave dhe emërtesave të fushës së veshmbathjeve, modës e kozmetikës dhe më tej me një grup pune të hartojmë një material për diskutim në shtypin shkencor me synim që të arrijmë në disa rekomandime të Alb-Shkencës për një rregullim e kodifikim paraprak të leksikut të kësaj fushe. Pas kësaj mund të punojmë edhe për një fjalor të posaçëm të termave të kësaj fushe.

### BIBLIOGRAFI

1. Lafe, Emil (2011), Rreth fjalëve me burim nga anglishtja në shqipen e sotme. Gjuha shqipe, 1, 55-72, Prishtinë.
2. Leka, Ferdinand; Simoni, Zef (1986), Fjalor italisht-shqip. 8 Nëntori, Tiranë.
3. Kokona, Vedat (1989), Fjalor Frëngjisht-Shqip. shtëpia botuese "8 Nëntori", Tiranë.
4. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (1998), Për pastërtinë e gjuhës shqipe - Fjalor. Tiranë.
5. Lafe, Emil; Çepani, Anila; Adelina Çerpja (2005), Rreth pasqyrimin të fushave terminologjike në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980). Leksikografia shqipe, trashëgimi dhe perspektivë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 308-314.
6. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (2006), Fjalor i gjuhës shqipe. Tiranë.

7. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (1980), Fjalor i gjuhës së sotme shqipe. Tiranë.
8. Çabej, Eqrem (përkatësisht 1976, 1987, 1996, 2002, 2006), Studime etimologjike në fushë të shqipes, bleu II, III, IV, VI, VII, Tiranë.
9. Çabej, Eqrem (1986), Studime gjuhësore, I. Rilindja, Prishtinë.
10. Lafe, Genc (1988-1999), Der italienische Einfluß auf das Albanische. Erster Teil - Allgemeine Erörterungen. / Ndikimi i italishtes mbi shqipen. Pjesa e parë – Shqyrtime të përgjithshme. Ponto-Baltica 8-9, 47-172.
11. Lafe, Genc (2000), Der italienische Einfluß auf das Albanische. Zweiter Teil - Wörterbuch der Italianismen im Albanischen. / Ndikimi i italishtes mbi shqipen. Pjesa e dytë – Fjalor i italianizmave në gjuhën shqipe. Ponto-Baltica 10, 31-120..

## **SHPËRBËRJA JUGOSLLAVE (1989-1992) DHE QËNDRIMET E DIPLOMACISË ITALIANE NDAJ REALITETIT TË RI BALLKANIK DHE SHQIPËRISË JUGOSLAVIAN BREAK UP (1989-1992) AND THE ITALIAN DIPLOMACY ATTITUDE TOWARDS NEW BALKAN REALITY AND ALBANIA**

ANESTI NAÇI  
Universitë degli Studi di Udine, Lignano Sabbiadoro, Italy  
Email: anestinaci@hotmail.com

### **Përmbledhje**

Kriza lindur prej shpërbërjes jugosllave (1989-1992) që riktheu vëmendjen Europiane drejt Ballkanit, vuri përballë problemesh të reja dhe diplomacinë italiane. Në këtë studim, kërkohet të paraqitet qëndrimi i mbajtur prej politikës dhe përgjithësisht prej botës së kulturës italiane ndaj dezintegritimit jugosllav; pozicioni zyrtar i Italisë mbi pavarësinë e republikave ish-jugosllave si dhe preokupimi i diplomacisë italiane për Shqipërinë dhe të ardhmen e saj në mozaikun e ri Ballkanik. Paraqiten vlerësimet e partive politike italiane mbi krizën jugosllave dhe nuancat e pozicionit zyrtar italian krahasuar me vende të tjera Europiane dhe Vatikanin. Nënvizohet gjithashtu vështirësia e hasur për kuptimin në kohë të krizës jugosllave dhe nënvlerësimi i aspektit etniko-fetar me konsekuencat e tij dramatike. Por mbi të gjitha, kërkohet të theksohet megjulla që dominonte vizionet e politikës dhe të kulturës italiane mbi realitetin shqiptar në ato vite të fund-komunizmit, e karakterizuar nga një njohje e cekët e historisë së vendit përballë.

**Fjalët çelës:** Ballkani, Shqipëria, shpërbërja jugosllave, diplomacia italiane

### **Abstract**

The Yugoslavian crisis (1989-1992) turned the European attention to the Balkans, and also brought the Italian diplomacy to new issues to face. This paper shows how Italian politic as well as culture on its whole responded to the Yugoslavian breakup; what was the Italian attitude towards ex-Yugoslavian republics independence and the Italian concern for Albania and its future in the new Balkan scenario. The study tries to examine (even through quotes) how the Yugoslavian crisis was perceived by the main Italian parties and the official nuances emerged comparing Italy from other European countries and Vatican. The writing also aims to underline that the crisis was very hard to be comprehended and its complexity led to underrating the ethnic-religious aspect with all its tragic consequences. In particular, the main purpose is to expose the blindness affecting Italian politics and culture towards the Albanian situation during those years when Communism was ending.

**Key words:** Balkan, Albania, Yugoslavian break-up, Italian-diplomacy.

---

### **Hyrje**

Një prej momenteve më të rëndësishme të fundit të “shekullit të shkurtër”, denominuar gjerësisht si “çështja jugosllave”, jo më pra “ballkanase”, që risolli për të parën herë që prej Luftës së Dytë Botërore nëpër mendjet e njerëzve imazhet e

holokaustit nazist dhe urrejtjen e pashpjegueshme të njeriut kundër njeriut, u trajtua prej politikës evropiane me një indiferentizëm ose, në më të mirën e rasteve, nën shenjën e një pragmatizmi passiv, që rrezikoi të minonte stabilitatin internacional për më shumë



se një herë. Jemi në periudhën e shterimit të ideologjive të forta, në triumfin e mendimit të dobët dhe diktaturën e pragmatizmit aktiv, e megjithatë, qeveri të ndryshme dhe rryma të caktuara të mendimit dhe kulturës, të kushtëzuara prej inercisë pesëdhjetë vjeçare të *Aut-Aut*-it luftëftohtës s'janë akoma gati, ose ndoshta thjesht nuk janë në gjendje për të përballuar, qoftë dhe në planin teorik, këtë eveniment, më parë politiko-historik dhe më pas konkretisht social dhe dis-human.

### **Italia dhe Ballkani**

Gjithçka që mund të vlejë gjerësisht për Evropën, lidhur me këtë temë, vlen veçanërisht për Italinë dhe meriton të analizohet prej nesh si vend që për vetë pozicionin gjeografik-strategjik në lidhje me Ballkanin, është i lidhur ngushtë dhe me interesin shqiptar, si nga një pikëpamje kulturore e historike, si dhe politike e diplomatike.

Por ky moment nxori në pah dhe rikthehu tek klasa politike edhe ajo intelektuale e vendit tonë fqinj problemet e hershme, të trashëguara duke demonstruar në politikën e saj të jashtme të njëjtën mungesë pragmatizmi, vizion utopik dhe pse jo papërgatitje diplomatike, që e ka karakterizuar Shtetin e *Bel Paese*-s në periudha të ndryshme të historisë së tij, relativisht të re. Është e evidente që vallëzimi nën muzikën ballkanase nuk ishte i lehtë dhe ndoshta as i preferuar për diplomacinë italiane. Inercia e politikave me bazë ideologjike, konfirmimi i linjës tradicionale të politikës së jashtme italiane të pasluftës bazuar tek europeizmi e atlantizmi çoi në vlerësime vetëm mes termash opozitivë, si integracion-dezintegracion duke u larguar prej pragmatizmit. Jo vetëm kaq, por diplomacia dhe politika italiane treguan një injorancë dhe indiferencë të theksuar, si ndaj çështjes jugosllave, në veçanti, ashtu dhe mbi historinë, kulturën apo mentalitetin e vendeve ballkanike, në përgjithësi. Dhe kjo bëhet shumë më absurde dhe naive ose mendjengushtë, po të konsiderohet fakti që flitet për një vend për të cilin bota ballkanike ka përfaqësuar gjithnjë kudhrën e farkëtimit të politikave të jashtme.

### **Komisioni parlamentar i punëve të jashtme e komunitare**

Më konkretisht, paaftësia apo jo-pragmatizmi i qarqeve politike italiane lidhur me çështjen jugosllave mund të dalin nga disa shembuj lidhur me përballimin që i bëri realitetit të ri jugosllav *Komisioni Parlamentar i Punëve të Jashtme e Komunitare* (La Commissione degli Affari Esteri e Comunitari della Camera dei Deputati Italiana) të Italisë. Ministri i Jashtëm i atëhershëm i Italisë, Xhani de Mikelis referon në audicionin e datës 20 shtator 1989 mbi gjendjen e Jugosllavisë dhe pozicionin internacional të Italisë. Fjalët e ministrit lënë të kuptohet frikë nga rreziku i një shpërbërjeje kaotike dhe të pakontrollueshme të Jugosllavisë që mund të destabilizojë rajonin Adriatik dhe mund të ketë konsekuenca edhe për Evropën Perëndimore. I gatshëm për ndihma qoftë dhe materiale për evitimin e dezintegrimëve fatale e shkatërrimtare, De Mikelis flet për takimin e tij me qeverinë jugosllave nën shenjën e një bashkëpunimi reciprok. Ky bashkëpunim do të ishte një impenjim dypalësh për të evituar, atë që De Mikelis e quan “dezintegrim shkatërrues” të Shqipërisë (Duce 2009: 157).

Shqipëria, sipas De Mikelis, është, mes të gjitha vendeve ajo që rrezikon më tepër. Duke kaluar pa ekzaminuar në mënyrë të detajuar gjendjen e brendshme të Jugosllavisë, konfliktet etniko-fetare apo tensionet centrifugale, ministri vazhdon e flet për “vullnetin e bashkëngjitur mes Romës dhe Beogradit për të evituar shpërbërjen e Shqipërisë, e kërcënuar prej faktorësh antiunitarë” (Duce 2009: 157).

*Është, pra, evidente distanca prej realitetit të ri dhe mbi të gjitha miopia politike. Të shohësh te Shqipëria vendin e kërcënuar më tepër prej lëvizjeve anti-unitare kur ndërkohë Jugosllavia po grisit si letër e lagur tregon një mungesë ekstreme pragmatizmi si rrjedhojë e mosnjohjes, siç duhet e kësaj pjese kaq të afërt të Evropës.* Por ndërsa preokupimi për shpërbërjen e Shqipërisë De Mikelis-it mund t'i lindte prej pretendimeve absurde të Athinës, habit paaftësia për të lexuar realitetin jugosllav që, për shumë arsye gjatë luftës së ftohtë kishte impenjuar thellësisht politikën italiane. Kjo paaftësi nuk është thjesht e përkohshme apo e përcaktuar vetëm te një

formacion politik, por i përket të gjitha ngjyrave të ylberit politik italian, me përjashtime të vogla. Për shembull, i njëjti verbim vazhdon të dominojë brenda Komisionit edhe 1 vit e gjysmë më vonë dhe pikërisht më datë 23 maj 1991 kur referendumet për pavarësi në Slloveni dhe Kroaci kanë qenë plebishitare. Kështu, Xhorxho Napolitano, presidenti italian i tanishëm, për PDS<sup>-në</sup> (Partia e Demokratëve të Majtë) shprehet akoma që në shtetin jugosllav do pasur kujdes nga shtytjet nacionaliste, ku forcat centrale mund dhe duhet të garantojnë unitetin jugosllav. Antonio Rubbi i PDS<sup>-së</sup> kërkon impenjim për mbrojtjen e kufijve të federatës jugosllave, duke specifikuar që kjo s'do të thotë të mbështesësh pozicione panserbe. Xhorxho Gangi i PSI<sup>-së</sup> (Partia Socialiste Italiane) rilevon "centralitetin e tashëm dhe të shkuar të Jugosllavisë dhe se kriza e saj duhet evituar pasi mund të ketë rrjedhoja në Itali dhe Evropë" (Duce 2009: 160).

Demokracia Kristiane nën influencën e Vatikanit, edhe pse jo akoma e qartë në pozicionin e saj, nuk sheh si zgjidhje përpjekjet për të mbajtur në këmbë me çdo kusht Jugosllavinë Federale: në fakt Bruno Orsini flet për një lloj zgjidhjeje konfederale, ku të respektohet autodeterminacioni i popujve, po ashtu dhe kërkon një impenjim më direkt e konkret të Komunitetit Evropian (Duce 2009: 163-164).

Në seancën e 2 shtatorit 1991 De Mikelis përballë komisionit duket se pranon rrugën e pakthim të drejt shpërbërjes, por është kundër zgjidhjeve parciale e unilaterale dhe vë në evidencë mundësinë e një zgjidhjeje të përgjithshme të çështjes në një plan internacional. Ndërkohë që vetëm 3 muaj më vonë Gjermania dhe Vatikani do të njohin dhe pranojnë njëanshmërisht Kroacinë dhe Slloveninë, Italia është krejt pasive dhe preokupohet akoma për trashëgiminë e Akordeve të Osimo-s të 1975, ata që i dhanë fund preokupimeve kufitare dhe çështjes etnike mes Italisë dhe Jugosllavisë.

Në seancat e dhjetorit, gjithmonë 1991, gjërat fillojnë të ndryshojnë sidomos brenda Demokracisë Kristiane, ku Xhulio Andreotti, si kryeministër i Qeverisë (Andreotti 7), hipotezon njohjen unilaterale të republikave të

vetëshpallura indipendente dhe kjo është një kthesë e rëndësishme për politikën italiane, por e vonë. Që një muaj më parë Kancelari Gjerman Kohl kishte deklaruar hapur që Gjermania do të njihte pavarësinë e Sllovenisë dhe Kroacisë brenda krishtlindjeve të po atij viti (Caccamo 1992, 1: 61). Gjithsesi Italia, një vend kufitar me Jugosllavinë dhe i rëndësishëm për nga ana ekonomike e tregtare, u tregua tepër larg kompresionit dhe brendësisë së ngjarjeve, ekzigjencave të popujve jugosllavë dhe akoma më tepër e ngathët në të kuptuarit e interesave të vendeve të tjera evropiane, si Gjermania. Është e vërtetë, ama që pati në Itali elementë të politikës, rryma të caktuara idelogjike, apo edhe instanca politike që u shquan për një pragmatizëm dhe një vizion të qartë të situatës dhe të pozicionit konsekuent që duhej marrë.

Në panoramën e forcave politike - mund të duket paradoksale, por ekziston një shpjegim racional - forcat që u shquan për një analizë adapte të ngjarjeve ishin ato të skajeve. Më konkretisht mund të flitet për Grupin Radikal, ku Marco Pannella do të ishte ndër të parët që foli për miopi të Evropës në politikën orientale dhe rëndësinë vitale të integritit për shmangien e rreziqeve. Gjithashtu janë përsëri radikalët që, në seancat e dhjetorit konstatojnë se institucionet federale jugosllave nuk kanë asnjë bazë legaliteti dhe denoncojnë krimet kundër popullsisë shqiptare të Kosovës. Ndërkohë mund të vihet re "largpamësia" dhe pragmatizmi i forcave të ekstremit të djathtë. Pozicioni i MSI-Destra Nazionale (Lëvizja Sociale Italiane – e Djathta Kombëtare) nisur nga pikëpamje nacionaliste dhe djathtiste arrin të jetë më objektive. Rauti është një ndër të paktët, dhe të parët, politikanë italianë i bindur se uniteti federativ jugosllav është i komprometuar përgjithmonë. Ky është pak a shumë dhe opinioni që ndan dhe autori, Alessandro Duce, i cili ishte vetë pjesëmarrës nëpër seanca si deputet i partise (Duce 2009: 169). Ndërsa disa deputetë të tjerë kritikojnë hapur qeverinë e tyre që nuk diti të parashikonte dizegregacionin e paevitueshëm të një "entiteti shtetëror falls dhe artificial", i mbajtur në këmbë vetëm prej një ideologjie, komunizmit. Këta

shohin si zgjedhje të vetme integrimin në Evropë për t'i dhënë fund egoizmave nacionaliste (Duce 2009: 164).

Mund të vihet re fare lehtë, pra, distanca në opinione midis forcave politike të majta apo qendrës dhe ekstremeve të djathta dhe radikalëve. Demokristianët, trashëgimtarë të tendencave pluraliste të partisë së tyre, të udhëhequr dhe prej pozicioneve të Vatikanit arrijnë akoma, dhe pse jo më me largpamësinë e njëhershme, t'i paraprijnë ngjarjet. Por duhet theksuar se për ta, të paktën këtë radhë ishte paksa e thjeshtë: u duhej të mbanin anën e dy vendeve katolike, Kroacisë dhe Sllovenisë, kundër një vendi ortodoks; të mbanin anën e dy vendeve që cenoheshin dhe ushtarakisht prej një urrejteje etnike dhe së fundi kjo shpërbërje përkiste dhe me shkatërrimin definitiv të një regjimi komunist që Selia e Shenjtë s'mund të thuhet se e adhuronte.

Grupimi politik që duket më larg realitetit, më pak pragmatik, është ai i majtë. Këtu mund të futen si Partia Socialiste e ministrit De Mikelis, ashtu dhe komunistët, tashmë të ndarë në PDS dhe në Rifondacionin Komunist. Ajo që u gjend komplet e papërgatitur dhe anakronike në pozicionet e saj ishte ana e majtë apo e majta "ekstreme" e politikës italiane. Është për t'u çuditur, se si ata që kanë pas ditur qysh prej mbarimit të luftës të lexojnë me aq realizëm situatën italiane, të shpëtojnë më shumë se një herë popullin e tyre nga lufta civile dhe, deri diku të interpretojnë situatat internacionale me sy kritik, tani bien viktimë e ideologjisë së tyre tashmë të vdekur. Me ndryshimet internacionale që prej rënies së Murit të Berlinit komunistët italianë humbasin çdo kontakt me realitetin; mbyllen brenda vizionesh intelektualiste dhe teoriko-ideologjike duke humbur aderencën si me problemet e reja madhore të botës së globalizuar, ashtu dhe me realitetin konkret të masave të gjera të popullsisë tek e cila ishte bazuar për vite me radhë forca e asaj partie.

E majta italiane, me sa duket, dinte të luante vetëm kur ishin në akt kundërpozicione ekstreme; fliste një gjuhë dualiste dhe jo pluraliste, si demokristianët; kishte nevojë për një

pol të përcaktuar prej të cilit të ushtronte fuqinë e vet. Duhet të nënvizoj faktin se kur përdor termin "e majta italiane", i referohem njëherësh si klasës politike, ashtu edhe asaj intelektuale dhe kulturore. Sepse ndërsa në planin politik komunistët gjatë periudhës së Republikës I nuk kanë qeverisur kurrë drejtpërdrejt - ata kanë kontribuar si opozitë në mënyrë ekzemplare në konsolidimin e demokracisë dhe për të radhitur Italinë ndër vendet më të zhvilluara të botës - në planin kulturor ata arritën të krijonin njëfarë hegjemonie.

Njeriu më kulturë në Itali ishte, dhe vazhdon të jetë, i majtë, një stereotip ky ndoshta, por që mbart në vetvete një të vërtetë të madhe. Ky gërshetim i politikës së majtë me kulturën e lartë dhe i intelektualit me ideologjinë social-komuniste, duke mos qenë më prezente problemet madhore, si lufta e ftohtë apo "vuajtjet e proletarietit", çoi në një inerci nostalgjike dhe verbim kundrejt të resë, kundrejt ndryshimeve të paevitueshme të kohës, të cilat nuk mund të lexoheshin e interpretoheshin më në planin ideologjiko-kulturor, ose më saktë, jo më me atë tip ideologjie. Humbja e pikës së mbështetjes e lidhur ngushtë me idealizimin që i ishte bërë jetës në vendet komuniste dhe zhgënjimi që solli njohja e së vërtetës së realizmit socialist, në vend që t'i çonte drejt një etape të re, drejt idealesh të reja, shumë prej intelektualëve italianë, i braktisi mes nostalgjisë së një jete të kaluar nën shenjën e pasionit dhe së bukurës, ku edhe e keqja apo vuajtja kishin një pse-në e tyre estetike më parë e pastaj historike. Objekt i këtij vizioni poetik apo romantik të realitetit u bë, përveç URSS<sup>së</sup>, Kinës apo Kubës dhe Jugosllavia. Ideja e një federate të kuqe nën çatinë e së cilës jetojnë në paqe, liri e begati popuj të ndryshëm joshte pa masë dhe, ndoshta sinqerisht, shpirtrat dhe zemrat e shumë intelektualëve perëndimorë jo vetëm italianë. Tek elita e majtë italiane, shpërbërja e Jugosllavisë përfaqësonte më tepër një lloj zhgënjimi tjetër tek fetë e tyre ideologjike se sa një problem jetik për popujt që po e hiqnin në kurriz. Shumë prej tyre ishin të bindur, madje dhe vazhdojnë të ngelen, se Jugosllavia federale ishte

një shtet unitar i bazuar mbi një ozmozë etnike e lidhur pas ndjenjës kombëtare jugosllave dhe që funksiononte në mënyrë perfekte nën rrjedhën (diktatin) e ideve internacionaliste. Kur ky shtet ra, dhe në mënyrën më banale të mundshme, atyre nuk u kishte shkuar kurrë në mendje që s'ishte gjë tjetër veçse një shtet artificial që qëndronte në këmbë prej *coercionit* të një diktature, prej frikës që lufta e ftohtë ndillte. Shpërbërja e këtij shteti s'ishte veçse hakmarrja e historisë ndaj ideologjisë dhe triumfi i jetës së lirë të popujve ndaj politikës së imponuar. Por ata këtë s'mund ta shihnin, sepse për ta popujt janë të lirë veçse të bashkuar dhe pse bashkimi mund të mos jetë aspak i lirë, por i detyruar.

#### **Bibliografi:**

BIANCHINI S. (1999), *La questione jugoslava*, Giunti, Firenze.

BUCARELLI M. (2004), *L'Italia e le crisi jugoslave di fine secolo (1991-1999)*, në Botta F., Garzia I., *Europa adriatica. Storia, relazioni, economia*, Laterza, Roma-Bari.

BUCARELLI M., MONZALI L. (2009), *Italia e Slovenia fra passato presente e futuro*, Studium, Roma.

Caccamo D. (1992), *La questione jugoslava (1989-1992)*, në: «Rivista di Studi Politici Internazionali».

DUCE A. (2009), *La Commissione Affari esteri e comunitari della Camera dei deputati italiana di fronte alla disgregazione della Jugoslavia e alla questione slovena (1989-1992)*, in *Italia e Slovenia fra passato, presente e futuro*, a cura di Bucarelli M. e Monzali L., Studium, Roma.

KADARE I. (2013), *Mosmarrëveshja. Shqipëria përballë vetvetes*, Onufri, Tiranë.

*LA GUERRA in Europa* (1993), në «Limes» n. 1/2.

MALCOM N. (1999), *Storia del Kosovo. Dalle origini ai nostri giorni.*, Bompiani, Milano.

PIRJEVEC J. (2001), *Le guerre jugoslave*, Einaudi, Torino.

THOMAS R. (1999), *Serbia under Milosevic. Politics in the Nineties*, London.

---

---

**ALBANIAN LITERARY SCIENCE AND ETHICS  
SHKENCA LETRARE SHQIPTARE DHE ETIKA**

ARBEN HOXHA

Instituti Albanologjik – Prishtinë

Dega e letërsisë

Prishtinë, KOSOVË

Email: arbenhoxha69@yahoo.com

**Përmbledhja**

Qëllimi i punimit tonë është që të vëmë në pah raportin dialektik që ekziston ndërmjet etikës dhe shkencës letrare. Etika, si refleksion për zotërimin e kuptimit dhe funksionit të moralit në jetën e njeriut, dhe morali i shkencës letrare, si përcaktues i orientimeve njohëse letrar, janë të ndërlidhur njëri me tjetrin. Varësisht asaj se a do të ketë prejardhje nga etika e kognitivizmit empiricist apo racionalist; nga etika e kognitivizmit subjektivist apo objektivist, në shkencën letrare njohja do të marrë karakter empiricist, racionalist, subjektivist apo objektivist.

Qëllimi i etikës së studiuesit- njeri do të ndikojë në moralin e qëllimeve njohëse që ai do t'i ketë ndaj: (a) të vërtetës; (b) vlerësimit dhe (c) përgjegjësisë së punës kërkimore.

**Fjalët çelës:** etikë, virtyt, shkencë letrare, epistemologji, e vërteta.

**Summary**

The purpose of our paper is to point out the dialectic relation that exists between ethics and literary science. Ethics , as a reflection on the meaning and function possession of morality in human life, and the morality of literary science as a determinant of cognitive literary orientations , are interrelated. Depending on whether there will be originating from ethics of empiricist or racionalist cognitivism, ethics of subjectivist or objectivist cognitivism, in literary science recognition will take empiricist, racionalist, subjectivist or objectivist character. The purpose of the ethics of human researchers will affect the morale of cognitive goals that he will have: (a) the truth; (b) evaluation and (c) the responsibility of research.

**Key words:** ethics, virtue, literary science, epistemology, truth.

**HYRJE**

Njohja nënkupton një fuqi vullneti, i cili duhet t'i nënshtrohet një etike me qëllim që ajo të marrë orientim të drejtë ndaj argumentimit të kuptimit të ekzistencës dhe nevojave zhvillimore njerëzore. Në qoftë se për mendimin e Huserlit – thotë filozofi Mikel Dufren - aktet intelektuale kanë privilegjin noetik që të jenë të përveçuara nga trajtat shqisore të perceptimit, sepse te ato vullneti drejtohet vetëm nga ajo që është e njohur; në aktet e vullnetit secila njohje përfshinë një dëshirë që diçka të njihet (Dufren 1973: 240). Nga këtu edhe antitetika ndërmjet konceptit të dijes dhe njohjes. Dija përcaktohet nga aktet e

vullnetit, të cilat atë që e dëshirojnë parapakisht kërkojnë ta njohin. Pra, dija shërben si lëndë e një dëshire. Përkundër dijes, njohja nuk është qëllim e as lëndë e ndonjë dëshire (Dufren 1973: 240). Dija është kusht për njohje, por nuk është vetë njohja. Dija synon zotërimin e informatës (shenjës) për të dhënë, ndërsa njohja synon zotërimin e kuptimit të ekzistencës së asaj të dhënë. Dija njeriun e futë në marrëdhënie utilitare me botën, sepse i nënshtrohet dëshirës ndërsa njohja shkon përtej kufijve utilitarist të marrëdhënies që njeriu vendos me botën. Varësisht se me cilat nga këto binome atitetike (të njohjes apo dijes) do të vendosë raport, etika

njohjes do t'i japë karakter universal ose karakter partikular. Njohja merr karakter partikular kur etika hyn në marrëdhënie me dijen, si fakultet i njohjes, e cila është e ndërlidhur dhe e përcaktuar nga dëshira. Etika, e cila ekziston në bazë të kategorive modale “duhet të jetë”, është e prirur të bashkëveprojë me dijen, sepse përmes saj ajo e realizon veten e saj dhe vetë dijen, si mjet për përvetësimin utilitar të realitetit.

### **Etika dhe pozicionet epistemologjike**

Etika, si refleksion për zotërimin e kuptimit dhe funksionit të moralit në jetën e njeriut, dhe morali i shkencës letrare, si përcaktues i orientimeve njohëse, janë të ndërlidhura njëra me tjetrën. Ato mund të vihen në shërbim, por edhe në kundërshtim me njëra tjetrën.

Që nga gjysma e dytë e shek. XX, raporti i etikës me shkencën do të jetë në qendër të vëmendjes së filozofisë së shkencës.

Një prej problemeve thelbësore që në vazhdimësi do ta preokupojë filozofinë e shkencës është çështja se si mund të ekzistojë marrëdhënia ndërmjet njohjes konceptuale-kognitive, e cila orientohet nga interesi i arsyes së kthyer nga vetvetja, me filozofinë normative morale, e cila udhëhiqet nga interesi i zotërimit të realitetit empirik sipas kategorisë modale “duhet të jetë”? Pra, çështja është se si të harmonizohet universaliteti i interesit njohës për zotërimin e kuptimit objektiv të ekzistencës së gjërave që na rrethojnë, me partikularitetin e interesit subjektiv për përdorimin e asaj njohje brenda praktikave të caktuara jetësore.

Si të vihen këto dy interesa në raporte komplementare e jo antagonistë?

Varësisht se në cilën filozofi morale do të mbështeten, filozofë të ndryshëm të shkencës do t'i modelojnë idetë e tyre për raportin e shkencës me moralin; për qëllimet dhe funksionet e shkencës në jetën e njeriut.

Për shkak të ndikimit negativ që do të ushtrojë në praktikën e ekzistencës njerëzore, në njërën anë, etika e pozitivizmit logjik – si teori e filozofisë së moralit objektivist – dhe, nga ana tjetër, etika e konstruktivizmit – si teori e filozofisë së moralit relativist në etikën e shkencës - në fillimvitet 70-

të të shekullit të kaluar Pol Fajerabend do ta ngrisë çështjen e nevojës për mbrojtjen e shoqërisë nga shkenca (*Filozofija nauke*, 250:364).

Etika pozitivizmit logjik dhe ajo e konstruktivizmit, si dy teori mbizotëruese të filozofisë së moralit të shek. e 20-të, do të kenë ndikim përcaktues në formatimin e përmbajtjes së etikës së qëllimit të shkencës, në bazë të së cilës ajo do të marrë dy pozicione epistemologjike:

(a) pozicionin e realizmit epistemologjik, sipas të cilit shkenca do të konceptohet si raport ndërmjet mendjes me realitetin, të pavarur nga subjekti njohës; dhe

(b) pozicionin e konstruktivizmit epistemologjik, i cili shkencën do ta konceptojë si një realitet që e përcakton veprimi i subjektit njohës.

Duke e kundërshtuar si realizmin, ashtu edhe konstruktivizmin epistemologjik, si pozicione jo të shëndetshme për vetë etikën shkencore, në veçanti, si dhe për etikën njerëzore, në përgjithësi, Karl Poperi, përmes racionalizmit kritik, këto dy pozicione përjashtuese epistemologjike do t'i vendosë në një marrëdhënie ndërveprimi njohës mbi bazën e një koceptimi të ri që do t'i bëjë marrëdhënies, siç i quan ai kushtimisht, të tri botëve: (1) botës së gjendjeve fizike (realiteti objektiv); (2) botës së gjendjeve mendore, apo botës së rregullave morale për të vepruar, e cila është bota e subjekteve njohëse; dhe (3) botës së përmbajtjeve objektive të mendimit, banorë të së cilës janë teoritë, problemet dhe argumentet objektive” (Karl Poper: 57). Sipas Poperit paradigma epistemologjike tradicionale është ndërtuar mbi parimin e “botës 2” “Unë di” (Sokrati), “Unë mendoj”(Dekarti). Paradigma e tillë ka përcaktuar që “bota 2” (përmbajtja subjektive e mendimit) t'ia nënvendosë vetes “botën 3” (përmbajtjen objektive të kuptimit) duke ia humbur subjektivitetin e saj (“Botës 3”)(Poper, 57-58). Sipas Poperit shkenca e vërtetë ekziston vetëm në “botën 3”, e cila ndërtohet prej një subjekti njohës, ndërsa karakteri objektiv i përmbajtjes së kuptimit të saj do ruhet për aq sa ajo nuk e njej subjektin që e njej (Poper, 58). Të zhytur në botën e rregullave morale të veprimit njohës, subjektet njohëse, si banorë të “botës 2” do të diktohen prej asaj bote dhe do ta diktojnë “botën

3”, ku edhe do të prishen kufijtë ndarës ndërmjet subjektit dhe objektit.

Duke e konceptuar shkencën, në përgjithësi, si një akt njohës që merr drejtim nga intencionaliteti i ndërgjegjes të subjektit njohës, konsiderojmë se marrëdhënia e “botës 2” me “botën 3” do të përcaktohet prej konceptimit të qëllimit të shkencës, si përbërës intencional i ndërgjegjes njohëse.

Poperi qëllimin e shkencës e koncepton si veprimtari e cila duhet të bëjë shpjegimin e kënaqshëm të të gjithë asaj që neve na duket se kërkon shpjegim (grekët e vjetër do të thoshin të të gjithë asaj që na habitë – vërejtja ime), me ç’rast shpjegimin ai e konsideron si shumë të fakteve me anë të të cilave përshkruhet gjendja e gjërave që duhen shpjeguar, interpretuar, ndërsa, nga ana tjetër, faktet e shpjeguara e bëjnë “shpjegimin” në kuptimin e gjerë të fjalës *explicans explicanduma* (Filozofia nauke: 253). Përkufizimi i tillë i qëllimit të shkencës në vetvete, në mënyrë implicite përkufizon etikën e qëllimit, i cili, si banor i “botës 2”, e konfiguron gjendjen e gjërave në bazë të “vlerës” dhe të “mirës”, kategori këto të cilat, siç thotë teoricieni i etikës Xhon Dëueja (John Dewey), konceptohen nga ajo se “çfarë dëshirojmë” dhe nga ajo se “çfarë duhet të dëshirojmë” (Savremena metaetika, 1991:14). Dëshira njohëse (habia) si entitet i “botës 2” orientimin e vet e merr prej moralit të qëllimit njohës, i cili në rastin e parë mund të shërbejë si mjet intencional i “botës 3”, e cila e përdor atë për realizimin e vetes për t’u liruar më pas prej saj dhe, në rastin e dytë, si qëllim në vete që e instrumentalizon “botën 3” për nevoja praktike. Në rastin e parë, shprehur me terma kantian, morali i qëllimeve njohëse të arsyes praktike i nënshtrohet moralit të qëllimit të arsyes teorike, me qëllim që “bota 3” të ndërtohet mbi përmbajtjet objektive njohëse; ndërsa në rastin e dytë, morali i qëllimeve të arsyes teorike i nënshtrohet moralit të qëllimeve të arsyes praktike, me ç’rast njohja merr përmbajtje subjektive dhe do t’i nënshtrohet përmbushjes së nevojave utilitare, pragmatike. Përmbajtja e moralit të qëllimit, si entitet i “botës 2”, jo vetëm që e përcakton marrëdhënien

ndërmjet “botës 2” dhe “botës 3”, por edhe karakterin e qëllimit të shkencës, si entitet të “botës 3”. Jurgen Habermasi me të drejtë konstaton se ajo që e përcakton dallimin thelbësor ndërmjet një dogmatiku dhe një empiricisti janë dallimi i interesave të tyre njohëse (Habermas 1975: 251), përmbajtja dhe orientimi i të cilave, sipas mendimit tonë, përcaktohen prej etikës së qëllimeve njohëse.

Në kontekstin e shtjellimit të temës sonë, shtrohet pyetja sa dhe si ka ndikuar marrëdhënia ndërmjet njohjes shkencore letrare me etikën? Cila është praktika e marrëdhënies së etikës me shkencën letrare shqiptare? Sa ka ndikuar kjo marrëdhënie në karakterin dhe relievin e shkencës letrare shqiptare, në qëllimet dhe instrumente e saj njohëse? Historia e zhvillimit të shkencës letrare shqiptare a karakterizohet nga fenomeni i përveçimit të njërës disiplinë nga tjetra apo nga fenomeni i kolonizimit të zonës së ekzistencës së njërës disiplinë prej kategorive të disiplinës tjetër? Në praktikën e shkencës letrare shqiptare sa janë përzierë kategoritë etike të së mirës, të së keqes dhe vlerës me kategoritë e njohëse kognitive, siç është e vërteta, ligjësia, sistemi, qëndrueshmëria, vlefshmëria etj.? Si ka ndikuar marrëdhënia e kategorive etike e kognitive në strukturën e kulturës letrare shqiptare? Sa raporti ndërmjet tyre ka ndikuar që subjekti kulturor shqiptar të pajiset me fuqi përvojash reflektimi emancipues, dhe sa ai ka arritur që përmes kësaj fuqie të bëhet parashikues i ekzistencës së tij, e kjo do të thotë që ai të jetë subjekt i formimit të vetvetes?

### **Tipologjia e marrëdhënies së shkencës letrare me etikën**

Duke e konceptuar etikën e qëllimeve njohëse si subjekt i aktit intencional të ndërgjegjes njohëse, si forcë orientuese të ndërgjegjes njohëse, mund të themi se historia e zhvillimit të shkencës letrare shqiptare karakterizohet prej mbizotërimit të tre tipave të marrëdhënieve me etikën: (a) tipi i marrëdhënies që deduktohet nga morali i qëllimeve njohëse me prejardhje nga teoria e filozofisë së moralit të objektivizmit empiricist kognitiv (me përfaqësuesin e saj emblematik

Dhimitër Shuteriqin); (b) tipi i marrëdhënies që deduktohet nga morali i qëllimeve njohëse me prejardhje nga teoria e filozofisë së moralit të racionalizmit kritik kognitiv (me përfaqësues e saj emblematik Rexhep Qosjen); dhe (c) tipi i marrëdhënies që deduktohet nga morali i qëllimeve njohëse me prejardhje nga teoria e filozofisë së moralit të emotivizmit antikognitivist (me përfaqësues e saj emblematik Sabri Hamitin).

Në tipin e parë të marrëdhënies, morali empiricist i qëllimit njohës - si përmbajtje e aktit intencional të arsyes - do të drejtohet nga jashtë sepse do të bazohet në virtytet e vullnetit e jo në virtytet e arsyes (Aristoteli 2001: 160-181), me ç'rast lidhjen ndërmjet arsyes praktike me atë teorike në njohje do ta realizohen nëpërmjet parimit të varësisë së të dytës ndaj të parës. Në këtë tip të marrëdhënies "bota 3", si përmbajtje objektive e mendjes, i nënvendoset "botës 2", si botë e gjendjes mendore të subjektit njohës, me qëllim që bashkërisht, si "dy botë", të vihen në funksion të realizimit të "botës 1", si botë e gjendjeve objektive empirike të realitetit të gjërave. Në këtë tip të marrëdhënies tërësisë së kuptimeve dhe mënyrave të arsyetimit të objekteve njohëse i atribuohen tipare empirike utilitar në bazë të përcaktimeve që burojnë nga fuqia e dëshirave për përmbushjen e nevojave praktike shoqërore (trajtimi pozitivist i objektit njohës letrar)

Në tipin e dytë të marrëdhënies, morali racionalist-kritik i qëllimit njohës - si përmbajtje e aktit intencional të arsyes - do të drejtohet nga brenda, sepse do të bazohet në virtytet e arsyes, me ç'rast lidhjen ndërmjet arsyes praktike me atë teorike në njohje do ta realizohen mbi parimin e ndërvarësisë reciproke të njëjës ndaj tjetrës. Në

këtë tip të marrëdhënies "bota 3" e kolonizon "botën 2" dhe "botën 1". Në tipin e dytë të marrëdhënies, tërësisë së kuptimeve dhe mënyrave të arsyetimit të ekzistencës së objekteve njohëse i atribuohet tipare logjike racionale në bazë të përcaktimeve që burojnë nga dëshira e arsyes për përmbushjen e nevojave reflektive të subjektit njohës dhe logjikes së emancipimit e formimit të qenies humane shqiptare (trajtimi integral i objektit njohës letrar).

Në tipin e tretë të marrëdhënies "bota 3" dhe "bota 1" i nënvendoset "botës 2", me ç'rast lidhjen ndërmjet arsyes teorike me arsyen praktike realizohet mbi parimin e prejardhur nga virtytet e vullnetit, nga sfera vultive e subjektit njohës. Në këtë tip të marrëdhënies tërësisë së kuptimeve dhe mënyrave të arsyetimit të ekzistencës së objekteve njohëse i atribuohet karakteri emotivist antikognitiv, me ç'rast arsyeja i nënvendoset lëndës njohëse si objekt i perceptimit emocional të subjektit njohës (trajtimi tematik-subjektivist i objektit njohës).

#### BIBLIOGRAFIA

- ARISTOTELI (2001), *Etika*, Shtëpia botuese "Fillad", Tiranë.
- DUFRENNE, Mikel (1973), *Za coveka* (përkthyer në serbokroatisht nga Branko Jelic), Nolit, Beograd.
- HABERMAS, Jirgen (1975), *Saznanje i interes*, Nolit, Beograd.
- POPER, Karl, *Vepra të zgjedhura* (përgatitur nga David Muller dhe perkthyer nga Arjan Starova), Soros & Afërdita, Tiranë, (pa vit botimi).
- SESARDIC, Neven (përgatitur), *Filozofije nauke*, Nolit, Beograd (pa vit botimi).
- STOJANOVIC, Svetozar (përgatitur) (1991), *Savremena metaetika*, Societas, Beograd.



---

**PËR NJË LEXIM TJETËR TË FRAGMENTIT NGA RELACIONI I BROKARDIT *DIRECTORIUM  
AD PASSAGIUM FACIENDUM*  
FOR ANOTHER READING OF THE PASSAGE FROM THE REPORT OF BROCARDUS  
*DIRECTORIUM AD PASSAGIUM FACIENDUM***

ARDIAN DOKA

Universiteti i Tiranës, Departamenti i Gjuhësisë, Tiranë, Shqipëri

Email: ardi\_durrsaku@yahoo.com

**Përmbledhje**

«*Et licet Albanenses aliam omnino lingua a latina habeant et diversam, tamen litteram latinam habent in usu et in omnibus suis libris.*» Ky fragment i vitit 1332 në leximin e derisotëm ‘zyrtar’, që e do fjalëformën latine *litteram* me kuptimin shkronjë ose alfabet, u ka çelur shtegun hamendësimeve lidhur me ekzistencën e shkrimeve shqipe jo pak, por 223 vjet para Buzukut. Pikërisht për këtë arsye, nuk është e vështirë të kuptohet se pse ai e ka tërhequr prej kohësh vëmendjen e shumë prej filologëve tanë më në zë. Është e udhës të shënojmë se krahas leximit ‘zyrtar’ fragmentit në fjalë i janë bërë edhe lexime të tjera, të cilat te *litteram* nuk shohin shkronjën ose alfabetin latin, por gjuhën latine. Tash që kemi arritur ta shtiem në dorë tekstin e plotë të relacionit mund t’i qasemi këtij fragmenti edhe nga një rrugë tjetër. Pas identifikimit të të gjitha përdorimeve të fjalëformës *litteram* brenda konteksteve imediate në të cilat haset, na del se autori e ka përdorur atë rregullisht në kuptimet *gjuhë e shkruar, letërsi, kulturë*, madje edhe *letër* në ndonjë rast, por asnjëherë me kuptimin *shkronjë* ose *alfabet*. Prandaj, fragmenti i mësipërm duhet lexuar kështu: «Le të kenë arbërit një gjuhë /të folur/ krejt tjetër nga latinishtja e të ndryshme, prapëseprapë /ata/ gjuhën latine kanë në përdorim /letërkëmbim/ e në të gjithë librat e vet.»

**Fjalë çelës:** Brokardi, relacion, litteram, gjuhë, alfabet

**Absract**

According to a definition, about the linguistic norm can be spoken in a certain stage of the history of language, even when the codification is starting to crystallize. The *usus* on the other side it is held as an alternative or the *usus* in the first sense of the term, especially with those cases when it reveals a deviation from the norm, and therefore is opposed to what the status of a "linguistic error". According to a definition, about the linguistic norm can be spoken in a certain stage of the history of language, even when the codification is starting to crystallize. In this paper we will deal with the *usus* in the first sense of the term, especially with those cases when it reveals a deviation from the norm, and therefore is opposed to what the status of a "linguistic error".

**Key words:** Brocardus, report, litteram, language, alphabet.

---

Që nga viti 1909, kur u rizbulua prej Edit Durhamit e deri më sot, fraza «*Et licet Albanenses aliam omnino linguam a latina habeant et diversam, tamen litteram latinam habent in usu et in omnibus suis libris.*», vazhdon ta ngacmojë kërshërinë shkencore të mjaft albanologëve. Afërmendsh këtu nuk do të merremi me problemet e datimit dhe të atribuimit të tekstit, pasi ato janë zgjidhur prej kohësh<sup>1</sup>, por e shohim

të udhës të shtojmë se tekstin e plotë të relacionit të Guljelm Ades, i njohur ndryshe si *Brocardus monacus* ose /*Pseudo/ Brocardus*, drejtuar princit francez Filip VI Valua, e kemi gjetur<sup>ii</sup> brenda një vëllimi të përzier me titull *Përmbledhje e Historianëve të Kryqëzatave, Dokumente Armene* (Dokumente latine e franceze lidhur me Armeninë), vëllimi i dytë, botuar nga Akademia franceze e Letrave të

Bukura, në Paris, më 1906.<sup>iii</sup> Relacioni që na intereson mban titullin *Directorium ad passagium faciendum* (Udhëzime për t'u hedhur matanë detit) dhe zë brenda vëllimit faqet 367-517. Njësoj si pjesa tjetër e lëndës, ai mund të lexohet në latinishte e në frëngjishte.

Për t'u kthyer te fraza jonë, dihet mirëfilli se për interpretimin e saj ka pasur qysh herët dy qëndrime: njëri, le ta quajmë 'zyrtar', i përfaqësuar nga vetë Edit Durhami, prof. Mahir Domi, prof. Dhimitër Shuteriqi, prof. Eqrem Çabej e ndonjë tjetër, i cili e do fjalëformën latine *litteram* me kuptimin shkronjë ose alfabet<sup>iv</sup> dhe tjetri, 'i pazyrarizuar' ende, që e do të njëjtën fjalëformë me kuptimin gjuhë ose libër<sup>v</sup>, i përfaqësuar nga Zef Skiroi i Riu, prof. Selman Riza<sup>vi</sup> dhe Injac Zamputi.<sup>vii</sup> Natyrisht, nuk është e vështirë të kuptohet edhe që leximi i parë u ka çelur shtegun hamendësimeve lidhur me ekzistencën e shkrimeve shqipe jo pak, por 223 vjet para Buzukut. Për dy qëndrimet ka qenë 'i shtrënguar' të bëjë fjalë edhe prof. Shuteriqi. Ai, në të vërtetë, përmend vetëm Skiroin, të Riun, për të cilin na rrëfen se e ka datuar gabim relacionin<sup>viii</sup> (prandaj nuk duhet marrë fort seriozisht – nënvizimi im A.D.), kurse Rizën dhe shtjellimet e tij nuk i zë ngoje, edhe pse krestomacia e këtij të fundit, *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, ishte botuar si doracak nga USHT-ja që më 1961<sup>ix</sup>, pra së paku 4 vjet para variantit fillestar të *Shkrimeve shqipe* të prof. Shuteriqit, që e pa dritën e botimit më 1965<sup>x</sup>. Për këtë arsye nuk mund të pajtohem plotësisht me Robert Elsin kur shkruan se «kjo fjali u interpretua nga shkencëtarët shqiptarë si një dëshmi për ekzistencën e librave në gjuhën shqipe, por ka më shumë të ngjarë se Brokardi e kishte fjalën për gjuhën latine të përdorur në Shqipëri.»<sup>xi</sup>

Në mbështetje të hipotezës së vet prof. Shuteriqi përdor kryesisht argumente historike. Për të as që mund të dyshohet se kishte libra në gjuhën shqipe më 1332, madje ai shkon edhe më tutje kur pohon se «mund të thomi me plot gojën se letërsia shqipe /.../ ka filluar shumë më parë, e pakta që nga pjesa e dytë e shek. XIII, por edhe më herët.»<sup>xii</sup> Pyetjes a kishte mundësi që shqipja

të shkruhej në shekullin XIII? – ai i përgjigjet me po, sepse «jemi në kohën e shtetit të parë të Arbërit, i cili njihet i formuar më 1190 dhe që e njohim gjer në pjesën e dytë të shek. XIII, kur Karli I Anzhu shpallet "Rex Albaniae" (1272). Në kushtet kur feudalët arbër e ndjenë veten aq të fortë, sa të krijonin shtetin e tyre midis Drinit e Devollit, ka pasur mundësi që shqipja të shkruhej, pra të zhvillohej në vendin tonë një kulturë në gjuhën amtare të shkruar.»<sup>xiii</sup> Të njëjtin qëndrim mban ai në thelb edhe tek *Tekstet shqipe...*<sup>xiv</sup>, por këtë herë i kushton vëmendje më të madhe 'mendimit ndryshe', çka në radhë të parë i detyrohet ndihmesës së Zamputit. Riza anashkalohet përsëri. E pra *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe* qe botuar sërish si vepër postume brenda vëllimit IV që më 2002. A thua të jetë fjala për një harresë të rastit ose për një lajthitje të patëkëq? E vështirë të besohet. Ndryshe nga Shuteriqi, prof. Riza shtie në punë argumente gjuhësore për të na bindur se Brokardi e kishte fjalën për gjuhën latine dhe jo për alfabetin latin. Sipas tij, «në formulimin e kësaj fraze dy gjëra bien më së forti në sy:

a) Autori nuk është mjaftuar vetëm me kaq që të konstatojë thjeshtësisht se "gjuha e shqiptarëve qenka tjetër nga latinishtja": "*aliam linguam a latina*". Përkundrazi ai ka ndier nevojën që këtë tjetërsi ta cilësojë edhe si të krejtshme: "*aliam omnino linguam*". Madje ai nuk e ka gjetur të tepërt që këtë cilësim ta ripërforcojë me përsëritjen: e të tjetërlllojshme: "*aliam omnino linguam a latina et diversam*".

b) Po u nisëm nga hipoteza se shprehja "*litteram latinam*" dashka të thotë "alfabet latin", atëherë edhe fjalët "në përdorim e në të gjithë librat e vet" kurrsesi nuk shpjegohen dot kënaqshëm<sup>xv</sup>. Po ashtu, prof. Riza vëren jo pa keqardhje se «një interpretim rreptësisht shkencor i shprehjes *litteram latinam* (për të mënjanuar njërin nga dy kuptimet e saj të mundshëm) do të kërkonte një analizë paraprake jo vetëm të frazës përkatëse "Licet Albanienses" etj., por edhe të mbarë tekstit përkatës, d.m.th. të mbarë relacionit të Brokardit. Ndërkaq hëpërhë ky i fundit është për ne i paarritshëm.»<sup>xvi</sup>

Duke shtënë në punë argumente gjuhësore dhe historike Injac Zamputi ecën në shtegun e çelur nga Skiroi i Ri dhe prof. Riza. Si latinist me përvojë ai dallon brenda frazës së Brokardit *linguam = gjuhë e folur dhe litteram = gjuhë e shkruar*. Për Zamputin «fjala *littera* (edhe e vetme, pa cilësimin *latina*) mori pra atë kuptim që ka tek ne fjala *gramë; shkrim e këndim; shkollë; njeri me gramë; mësoi gramë; dinte gramë; siç shpjegohet te fjalori i gjuhës së sotme shqipe* (Tiranë 1980). E pra fjala *gramë*, në vështrimin e parë të saj d.m.th. *shkronjë*.»<sup>xvii</sup> Gjithashtu Zamputi rreket të na mbushë mendjen se librat e arbërve të shkruar në latinishte, për të cilët bën fjalë Brokardi, «ishin regjistrat e noterëve (kontrata, testamente, dotacione e donacione, marrëveshje të ndryshme etj.), ishin regjistrat e administratës bashkiake (llogari, kadastra, dogana, ankande etj.), regjistrat e gjykatave (hetime, dëshmi, vendime etj.), regjistrat e kishave (lindje, martesë, vdekje etj.), regjistrat e kancelarive për marrëdhëniet me bashkësi të tjera (korrespondenca etj.). Edhe sot e kësaj dite, ndër arkivat ku ruhen të tillë regjistra, përdoret shpesh emërtimi *libër*.»<sup>xviii</sup> Ndonëse e bëri dallimin *gjuhë e folur – gjuhë e shkruar* Zamputi e përdor vetëm përgjysmë në leximin e tij të fragmentit: «*Megjithëqë shqiptarët kanë një gjuhë krejt tjetër e të ndryshme prej latinishtes megjithatë kanë në përdorim (për nevojat e ndryshme) ashtu edhe në të gjitha librat e tyre, gjuhën e shkruar latine*.»<sup>xix</sup> Është me interes të vërehet që, megjithëse i shënon treguesit bibliografikë të po atij botimi që zotërojmë edhe ne, Zamputi nuk na thotë se e ka gjetur tekstin e plotë të relacionit. Nga ana tjetër, edhe pse njohja që ai shpërfaq lidhur me tekstin në fjalë tek trajtesa e vet është e një shkalle më të lartë krahasuar me të gjithë pararendësit e tij, fjala vjen ai është i vetmi që i përmend 6 qytetet të cilat Brokardi i quan të latinëve, por jo latine, prapëseprapë Zamputi nuk i përdor të gjitha argumentet që do t'i kishte dhënë teksti i plotë i relacionit në latinishte një latinisti të sprovuar si ai.

Prandaj besoj se ka vend edhe për një qasje tjetër. Në fillim do ta rifusim frazën e shumëpërfolur brenda kontekstit imediat nga

është nxjerrë, me bindjen se do të mësojmë më shumë.

*/.../ Hoc infer cetera facit ad dictum regnum facilius capiendum, quod sunt illi due naciones, una videlicet Albanensium et alia Latinorum, qui omnes sub fide, ritu et obediencia Romane Ecclesie perseverant. Et secundum hec habent archeipiscopos, episcopos et abbates, ac inferioris status et gradus religiosos et clericos seculares. Latini habent sex civitates cum suis episcopis: prima Antibarum, archiepiscopalem; deinde Chatarensem, Dulcedinensem, Suacinensem, Scutareensem et Drivascensem, quas quidem soli Latini inhabitant; populus vero earum sunt Albanenses in tota ipsarum diocesi extra muros. Sunt etiam Albanensium quatuor civitates, videlicet Polati Majoris, Polati Minoris, Sabatensis et Albanensis, que omnes cum predictis civitatibus Latinorum Anthibarensi archiepiscopo et ecclesie jure metropolitano sunt subjecte. Et licet Albanenses aliam omnino linguam a latina habeant et diversam, tamen litteram latinam habent in usu et in omnibus suis libris. Latinorum igitur potencia infra civitatum suarum ambitum continetur. Extra enim civitates suas, licet possessiones vinearum obtineant et camporum, tamen nullum quod latinum populum habeat, castrum possident neque villam. Albanenses autem, quia major nacio est, poverent in campo plusquam quindecim milia equitum, ad omnem actum belli, secundum morem et modum illius patrie, expeditos et strenuos bellatores. Et quia dicti, tam Latini quam Albanenses, sub jugo importabili et durissima servitute illis odiosi et abhominandi Sclavorum dominii sunt opressi, populus scilicet anguariat, clerus dejectus et minoratus, episcopi et abbates sepius vinculati, nobiles exheredati et in personis propriis captivati, ecclesie tam episcopales quam alie dissipate et in suis juribus annullate, monasteria disperdita et destructa, ipsi omnes et ipsorum singuli in predictorum Sclavorum sanguine manus suas crederent consecrare, quando viderent aliquem principem de Francorum eis partibus aparere, quem contra dictos Sclavos nefarios, nostre veritatis et fidei inimicos, facerent ducem belli. Cum predictis autem Albanensibus et Latinis mille*

*milites Franci, et quinque vel sex milia peditum, procul dubio, totum tale ac tantum regnum cum facilitate nimia obtinerent.*<sup>xx</sup>

/.../ Këtu mes të tjerash një gjë e bën më të lehtë marrjen e mbretërisë së lartpërmendur /të Rashës/, domethënë qenia e dy /popujve/, njëri i arbërve dhe tjetri i latinëve, të cilët mbeten nën fenë, ritin dhe dëgjuesën e Kishës së Romës. Të dytët kanë arkipeshkvi, ipeshkvi dhe abatë, me status dhe gradë më të ulët kishtarë, si dhe klerikë shekullarë. Latinët kanë gjashtë qytete me ipeshkvi të tyre: së pari Tivarin, arkipeshkvi; pastaj Kotorrin, Ulqinin, Shasin<sup>xxi</sup>, Shkodrën dhe Drishtin, në të cilat banojnë vetëm latinë; por popullsia anase në të gjitha këto dioqeza jashtë mureve janë arbërit. Janë edhe katër qytete arbëre, pikërisht Pulti i Madh /i Epërm/, Pulti i Vogël /i Poshtëm/, Sapa<sup>xxii</sup> dhe Zgërdheshi<sup>xxiii</sup>; të gjitha qytetet e lartpërmendura varen nga arkipeshkvi latin i Tivarit dhe janë /subjekt/ i së drejtës kishtarë metropolitane. **Le të kenë arbërit një gjuhë krejt tjetër nga latinishtja e të ndryshme, prapëseprapë /ata/ gjuhën latine kanë në përdorim e në të gjithë librat e vet.**<sup>xxiv</sup>

Pushteti i latinëve kufizohet brenda qarkut të qyteteve të tyre. Edhe pse ata zotërojnë disa vreshta ose ara jashtë qyteteve të tyre, gjithsesi nuk kanë kështjella ose vendbanime /të tjera/ ku të ketë popullsi latine. /Populli/ arbër, që është më i madhi, mund të nxjerrë në fushën e betejës më shumë se pesëmbëdhjetë mijë kalorës /të aftë/ për çdo lloj lufte, sipas zakonisht dhe mënyrës së vendit, të pajisur mirë, guximtarë dhe luftëtarë të zot. Të dy /popujt/ e përmendur, si latinët ashtu edhe arbërit, janë shtypur egërsisht nën zgjedhën e rëndë e të padurueshme të bujarëve të urryer dhe të neveritshëm sllavë. Sigurisht, është këtu një popull në ankth, një kler i nëpërkëmbur dhe i poshtëruar. Ipeshkvi dhe abatët e tyre shpesh të burgosur, fisnikët të shpronësuar dhe të cenuar në personin e tyre; kishat, si katedralet ashtu dhe kuvendet, të zhveshura nga të drejtat e tyre, ndërsa manastiret të humbura dhe të shkatërruara. Secili prej tyre dhe të gjithë bashkë do të besonin se po i shenjtëronin duart e tyre duke i lyer me gjakun e të lartpërmendurve sllavë; po të shihnin ndonjë

princ nga anët e Francës të dukej andejpari, do ta bënin prijësin e tyre /në luftën/ kundër të lartpërmendurve sllavë, armiq të të vërtetave tona dhe të fesë sonë. Me arbërit dhe latinët e përmendur, një mijë kalorës francezë dhe pesë ose gjashtë mijë këmbësorë, do ta fitonin pa dyshim me lehtësi gjithë këtë mbretëri, sado e madhe që është.

Nisur nga ato që na thotë në këtë pjesë të relacionit kuptohet se Brokardi nuk ishte thjesht e vetëm një vëzhgues i mprehtë që raportonte nga terreni. Ai ishte edhe një emisar që rrekej ta kandiste Filipin VI Valua të pushtonte edhe Mbretërinë e Rashës në rrugë e sipër për në vendet e shenjta /Palestinë/ ose për në Kostandinopojë. Prandaj do të ishte naive të besonim a priori që Brokardi do të mbetej pavarësisht kësaj objektiv e ca më tepër i paanshëm. Për të përmbushur misionin e vet frati i urtë që i detyruar që nga njëra anë ta përligjte ndërhyrjen ushtarake (këto vise janë shumë të pasura, Brokardi flet për pesë miniera ari, për toka pjellore, pyje e kullota), ndërsa nga ana tjetër duhej të tregonte se ajo nuk që edhe aq e vështirë (sllavët nuk kanë kështjella të gurta, fortifikimet e tyre janë prej druri), por edhe të kërkonte aleatë që do ta ndihmonin Filipin VI Valua në sipërmarrjen e tij. Në rastin tonë këta do t'i gjente tek latinët dhe arbërit, për bindjen dhe besnikërinë e të cilëve ndaj Kishës së Romës, por edhe ndaj pinjovje të njëjës prej dinastive frënge të kohës lipsej të jepte prova. E kjo, me sa duket, nuk ka qenë një punë e lehtë, meqë aleatëve të sotëm të luftës pasi të derdhnin gjakun, nesër, me të fituar, do t'u kërkohej të ulnin edhe zverkun. Natyrisht Brokardi nuk do të kishte dashur që 15000 kalorësit arbër, të cilët ai i mburr për vetitë e tyre luftarake, të bënin sehir teksa bashkëvendësit e tij kacafyteshin me sllavët, por do t'i vinte po aq keq, besoj, sikur ata (arbërit), si të mbaronin punë me sllavët, t'u ktheheshin edhe francezëve të Filipit VI Valua. Nga kjo pikëpamje latiniteti i këtyre trevave në kuptimin e gjerë merrte për të një rëndësi të dorës së parë. Për të qenë sa më bindës, përpos fesë dhe interesave të përbashkëta mes arbërve e latinëve ai kishte nevojë edhe për një argument

të tretë – gjuhën. Por këtu i dilte një problem i madh – gjuha e arbërve ishte *krejt tjetër dhe e ndryshme* nga ajo e latinëve. Mendja ma do që këtë problem Brokardi nuk e zgjidhte dot duke pohuar thjesht e vetëm se ata (arbërit) e shkruanin gjuhën e tyre me germa latine. Nuk qenë të vetmit (edhe kroatët e kishin braktisur ndërkohë glagolitikun për ta shkruar gjuhën e tyre me shkronja latine)<sup>xxv</sup> e, ç'është më e rëndësishmja, kjo nuk i bënte me doemos aleatë e shtetas kokulur të Filipit VI Valua. Që këtej del se ngulmimi i pazakontë Brokardit për të vënë në spikamë tjetërsinë e gjuhës së arbërve në raport me latinishten, nuk ka të bëjë me kurrfarë habie prej vizitori kureshtar, të pamësuar me gjëra të tilla<sup>xxvi</sup>, që sheh ca të krishterë të cilët flasin një gjuhë të ndryshme nga latinishtja, kurse për ta shkruar përdorin alfabetin latin. Përkundrazi, ai merr vlerë nëse fragmenti lexohet edhe 'politikisht' – *ndonëse arbërit janë një popull tjetër, me një gjuhë tjetër, të ndryshme nga latinishtja, ata mbeten prolatinë (kupto edhe profrancezë), sepse i përkasin ritit latin, i urrejnë sllavët (armiqtë e të vërtetave tona dhe të fesë sonë) dhe si gjuhë shkrimi përdorin latinishten.*

Arsyetimit tonë i vjen në ndihmë edhe një e dhënë tjetër. Pas identifikimit të të gjitha fjalëformave me bazë *litter* që hasen në tekst, na del se autori e ka përdorur këtë fjalë dymbëdhjetë herë gjithsejt, nga të cilat gjashtë herë me trajtën *litteris*, tri herë me trajtën *litteras* dy herë me trajtën *littera* dhe vetëm një herë me trajtën *litteram*. Për sa u takon kuptimeve, do të thoshim se të njëjtën fjalë e hasim si *gjuhë ëe shkruarç, shkrime, libra*, madje edhe *letër* në ndonjë rast, por asnjëherë me kuptimin *shkronjë* ose *alfabet*. Ja edhe fragmentet e tjera ku hasen fjalëformat që na interesojnë:

*/.../ Octava pars continet sex ordinationes neccesarias ad adquisitum edictumç imperium sub Francorum dominio conservandum. Prima, quod omnes Latini aut comburantur aut de imperio expellantur qui fidem Romane Ecclesie negaverunt et Greorum perfidie adhererunt; secunda quod omnes eorum monachi qui fidem veram non receperint, de imperio ad partes occiduas expellantur, et quod nullus ad illum*

*ordinem in posterum in monacum induatur; tertia, quod quilibet tradat unum de suis filiis latinis moribus et litteris imbuendum; quarta, quod omnes eorum libri diligentius comburantur in quibus errores contra fidem catholicam continentur; quinta quod omnes in Sancta Sophia congregati, facta confessione fidei, Francorum dominio spontanee se submittant; sexta quod a Greorum ecclesiis quinque observancie auferantur, quas in subversionem lidei et domini esse constat.*<sup>xxvii</sup>

*/.../ Pjesa e tetë përmban gjashtë porosi të nevojshme për ta shtënë në dorë Perandorinë /Bizantine/ dhe për ta mbajtur nën sundimin francez. E para, që të digjen ose të dëbohen nga perandoria të gjithë ata latinë që kanë mohuar fenë e Kishës Romane dhe kanë pranuar fenë e rreme të Kishës Greke; e dyta, që të gjithë ata murgj që nuk e pranojnë fenë e vërtetë të dëbohen nga perandoria në Perëndim dhe në të ardhmen të mos jenë pjesë e asnjë urdhri murgjish; e treta, që secili prej tyre të lërë njërin prej bijve të vet të mësojë sjelljet dhe gjuhën /e shkruar/ latine; e katërta, që të digjen me kujdes të gjithë librat e tyre që përmbajnë gabime kundër fesë katolike; e pesta, që të gjithë ata që ishin të lidhur me Shën Sofinë, pasi të pranojnë fenë katolike, t'i nënshtrohen me dëshirë sundimit francez; e gjashta, që të gjitha kishat greke që kapen në veprimtari armiqësore ndaj autoritetit hyjnor dhe atij shtetëror duhet t'u binden pesë urdhrave.*

*/.../ Totus autem Oriens scit quod imperator Greorum et rex Rassie duplicis note macula sunt infames, una scilicet quod esuntç heretici per Romanam Ecclesiam estimati, ac sicut tales a magnis temporibus condemnati; altera vero quod sunt juris alieni, falsi et proditorii invasores et violenti ac tyrannici detentores. Cum ergo nunc usque tales fuerunt a se ipsis et ab aliis reputati quod propter hereses suas ab Ecclesia Romana catholica sint divisi, quod et eis fratres Predicatores et Minores, ipsos ad reditum in sinum matris Ecclesie sepius adortantes, per **litteras** apostolicas ostenderunt et tam auctoritatibus quam rationibus pluries probaverunt, quando scilicet et quociens auditum*

*aurium probuerunt; si modo talis et tantus rex cum eis federa copularet, non aliud Orientalibus videretur nisi quod eorum errores et blasphemias contra nostros et scismata cum eorum superstitionibus approbaret; et per consequens predicti fratres cum suis litteris et assereionibus mendaces et frivoli redderentur.*

*Videretur etiam quod illa que tenent usurpata dominia solidaret, que non a quocunque, sed proprie ab illis de domo Francio, injuste et indebite ac proditorie detinent occupata, ut infra clarius ostendetur.*<sup>xxviii</sup>

/.../ Sigurisht e gjithë Lindja e di mirë se perandori i grekëve dhe mbreti i Rashës janë të njohur si dyfish të pabesë, e para, sepse ata u shpallën heretikë nga Kisha e Romës dhe u dënuan si të tillë para shumë kohësh; e dyta, sepse ata nuk njohin asnjë ligj, janë pushtues të pabesë e gënjeshtarë, zaptues tiranikë e të dhunshëm. Që atëherë e deri më sot, të njohur si të tillë nga vetja e të tjerët, mbetën për shkak të herezive të tyre të ndarë nga Kisha Katolike e Romës, gjë që fretërit predikues dhe fretërit e vegjël, duke i nxitur shpesh të kthehen në gjirin e Kishës sonë mëmë, ua kanë treguar si me anë letrash apostolike, ashtu dhe me anë të arsyes e autoritetit, sa herë që ata kanë dashur të dëgjojnë; nëse tani një princ i tillë kaq i madh, siç është mbreti i Francës, do të bënte aleancë me ta, lindorëve do t'u dukej sikur ai i miraton gabimet e blasfemitë e tyre kundrejt tanëve, si dhe skizmat e bestytnitë e tyre; dhe për pasojë vëllezërit e sipërpërmendur do të shiheshin si gënjeshtarë dhe joseriozë në çdo letër dhe pohim të tyrin. Do të dukej gjithashtu sikur ai po ua njeh ato zotërime që ata i kanë rrëmbyer duke i rënë ndesh së drejtës dhe arsyes dhe po i mbajnë padrejtësisht e me tradhti, e jo ndaj kujtdo, por pikërisht ndaj atyre të derës së Francës, siç do të tregohet më shkoqur në vijim.

*/.../ Postea vero pater misertus ejus, credens ipsum penitus esse cecum, cum post multos annos quibus [in] exilio fuerat, revocavit. Mortuo autem Urosio, patre suo, cunctis de regno per litteras scriptas manu propria manifestans et aperiens quod videret,*<sup>xxix</sup>

/.../ Dhe më pas babai i tij i mëshirshëm, duke kujtuar se ai ishte krejt i verbër, e thirri pas shumë vitesh mërgimi. Pasi vdiq Urosi, babai i tij, ai u tregoi të gjithëve në mbretëri me letra të shkruara nga dora e vet se shihte qartë.

*/.../ Tercia ordinacio est quod quicunque plusquam unum filium habuerit, alterum ad scolas ponere teneatur, latinis litteris imbuedum; et nisi quod littera greca una de principibus tribus extat, quibus tripliciter crucifixi Domini nostri titulus est inscriptus, consulerem salubriter, prout estimo, et prudenter ut omnino illa littera deleatur. Ad hoc autem bene posset modus possibilis iuveniri; non enim puto nec putant illi qui inter Grecos fuerunt aliquo tempore convorsati, quod ipsi tociens ad vomitum redivissent, si, deletis propriis, latinas litteras habuissent; et ideo dico Grecorum pueros nostris litteris imbuendos, ut saltem cum adoleverint sciencia et etate in nostris libris illa videant et intelligant per seipsos, quibus ipsorum errores rationibus veridicis ac Scripturarum testimoniis confutantur, et sana fides pariter et doctrina Ecclesie roborantur. Et sic alios confirmabunt et ipsimet in fidelitate domini verius atque libencius absque mutacione aliqua perdurabunt.*<sup>xxx</sup>

/.../ Urdhëresa e tretë është që kushdo që ka më shumë se një bir është i detyruar ta dërgojë njërin në shkollë për të mësuar gjuhën latine. E po të mos kishte qenë gjuha greke njëra nga tri kryesoret me të cilat u shkruan bëmat e zotit tonë të kryqëzuar, do të këshilloja fort dhe mençurisht, siç mendoj, që kjo gjuhë /shkrimet/ të zhdukej krejt, e për ta bërë këtë do të mund gjenim një mënyrë, sepse nuk mendoj, dhe kështu bëjnë ata që herë pas here kanë folur me grekët, se ata do t'u ktheheshin kaq shpesh gabimeve të tyre, po të kishin pasur shkrime /libra/ latine të vërteta. Për këtë arsye them, që fëmijët e grekëve të mësojnë gjuhën tonë, në mënyrë që kur ata të nxënë shkencat dhe të piqen, të mësojnë në librat tanë e të kuptojnë vetë se si dallohen gabimet e tyre nga arsyet e vërteta, si dhe që feja e vërtetë dhe doktrina e mirë vërtetohen së bashku; kështu ata do t'ua pohojnë të tjerëve dhe ata vetë do të qëndrojnë besnikë të palëkundur të fisnikërisë.

*/.../ Armeni siquidem isti Minoris Armenie, de quibus lexitur sermo presens, coronam et nomen regum a romanis Pontificibus et imperatoribus habuerunt; et tunc in signum subjeccionis, de pacto et de convencione, quedam optima castra et fortia Romane Ecclesie donaverunt, duas pro Latinis archiepiscopales ecclesias erexerunt, et cas redditibus et possessionibus dotaverunt, monachorum nostrorum monasteria construxerunt; pueros suos latinis imbuendos **litteris** tradere promiserunt. Postquam vero adepti sunt regium nomen et gloriam, affectatam manum, quam ad aratrum extenderant, retraxerunt; castra euim per ipsos prius data Ecclesie sunt ablata,<sup>xxxi</sup>*

*/.../ Këta armenë të Armenisë së Vogël /të Poshtme/, që po përmend, kanë marrë kurorën dhe emrin mbretëror nga papët e Romës dhe nga perandorët; më pas në shenjë bindjeje me marrëveshje dhe ujdj i dhuruan Kishës së Romës disa kështjella e fortesa shumë të mira, themeluan dy kisha arkiveshknore për latinët, u dhanë të holla e troje. Kanë ndërtuar gjithashtu disa manastire për murgjit tanë dhe kanë premtuar që fëmijët e tyre do të mësojnë gjuhën latine, por meqë e morën emrin mbretëror dhe lavdinë e dëshiruar nuk e mbajtën fjalën e dhënë, pasi ata i morën mbrapsht kështjellat që më parë ia patën dhuruan Kishës.*

*/.../ Tunc etiam socius meus et ego duo pacta ab eis promissa recepimus et firmata, videlicet quod conventus Predicatorum et Minorum ordinum construerent, et ibi fratribus moraturis de necessariis providerent; iterum quod pueros suos instrui facerent latinis **litteris** et moribus ac doceri. Qui omnia usque hodie perficere neglexerunt.<sup>xxxii</sup>*

*/.../ Pastaj shoku im dhe unë bëmë dy marrëveshje me ta, të cilat i nënshkruam, domethënë që do të ndërtonin disa kuvende për fretrit e urdhrin të predikuesve dhe të urdhrin të të vegjëlvë, dhe që ata do t'u jepnin fretërve gjithçka që u duhej. Po ashtu edhe që do t'i vinin fëmijët e tyre të mësonin gjuhën latine dhe të nxinin sjelljet e mira, nga të cilat nuk kanë bërë asgjë.*

Nga fragmentet e mësipërme kuptohet që Brokardi i njihte latinishtes së shkruar një vlerë të madhe si element vasaliteti dhe si mjet indoktrinimi. Nëse ai do ta kishte përdorur fjalëformën *litteram* në rastin tonë me kuptimin *shkronjë* ose *alfabet*, ky nga njëra anë do të ishte përjashtimi i vetëm, ndërsa nga ana tjetër do ta kishte detyruar autorin e relacionit t'i fuste edhe arbërit në radhën e atyre popujve që duhet ta mësonin latinishten për t'u bërë katolikë të mirë e shtetas të bindur, siç bën fjala vjen me armenët dhe grekët ëbizantinëtç. Por kjo nuk ndodh, prandaj unë jam i bindur që fragmenti i shumëpërfolur duhet lexuar kështu: «**Le të kenë arbërit një gjuhë /të folur/ krejt tjetër nga latinishtja e të ndryshme, prapëseprapë /ata/ gjuhën /e shkruar/ latine kanë në përdorim /letërkëmbim/ e në të gjithë librat e vet.**» Brokardi e ka fjalën për gjuhën latine dhe jo për alfabetin latin. Relacioni i tij nuk na ndihmon dot për të provuar, qoftë edhe tërthorazi, se shqipja shkruhej në shekullin XIV. Megjithatë ai nuk provon logjikisht as të kundërtën, kështu që çështja jonë mbetet gjithsesi e hapur. I kemi zënë besë Brokardit në cilësinë e dëshmitarit të vetëm duke e lexuar ligisht ose drejt fragmentin e tij, pa na vajtur ndër mend se ai mund të mos ishte i interesuar të thoshte të vërtetën. Pas një leximi të kujdesshëm të krejt relacionit të tij kjo nuk ngjan e pamundur. Në këtë kuptim pësia e dëshmisë së Brokardit, pavarësisht prej leximit që mund t'i bëhet, relativizohet mjaft.

#### Literatura

Dhimitër S. Shuteriqi, Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850, ASHRPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Shtypshkronja "Mihal Duri", Tiranë, 1976, f. 27.

Dhimitër S. Shuteriqi, Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850, ASHRPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Shtypshkronja "Mihal Duri", Tiranë, 1976, ff. 27-28.

Gjej rastin të falënderoj përzemërsisht z. Gjergj Roko që më ndihmoi për ta shtënë në dorë tekstin e plotë të relacionit të Brokardit. (Shënim i im. A.D.)

Shih Guillelmus Adae (Brocardus), *Directorium ad passagium faciendum në "Recueil des Historiens des Croisades, Documents Arméniens"*, (Documents latins et français relatifs à l'Arménie), tome second, publie par les soins de l'Académie des Inscriptions et Belles-Lettres, Imprimerie Nationale, Paris, MDCCCXVI, ff. 367-517.

Dhimitër S. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, ASHRPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Shtypshkronja "Mihal Duri", Tiranë, 1976, ff. 27-28.

Shih Dhimitër S. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, ASHRPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Shtypshkronja "Mihal Duri", Tiranë, 1976, ff. 27-28 dhe Selman Riza, *Vepra IV, Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, Toena, Tiranë, 2002, ff. 237-243.

Selman Riza, *Vepra IV, Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, Toena, Tiranë, 2002, ff. 237-243.

Injac Zamputi, *Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë shqipe*, Hylli i Dritës, 1-2, 1995, ff. 14-51.

Dhimitër S. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, ASHRPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Shtypshkronja "Mihal Duri", Tiranë, 1976, f. 27.

Selman Riza, *Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe*, krestomaci thjesht gjuhësore, Tiranë, 1961. Në këtë punim i referohemi variantit përfundimtar të së njëjtës vepër, atij të vitit 2002.

Dhimitër S. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Shtëpia Botonjëse Naim Frashëri, Tiranë, 1965. Në këtë punim i referohemi variantit të dytë të së njëjtës vepër, atij të vitit 1976.

Shih Robert Elsie, *Një vjedhje në Dubrovnik dhe dalja në skenë e gjuhës dhe e kulturës shqiptare*, Përpjekja, Nr. 6, 11.12.2012.

Dhimitër S. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, ASHRPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Shtypshkronja "Mihal Duri", Tiranë, 1976, ff. 27-28.

Dhimitër S. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, ASHRPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i

Letërsisë, Shtypshkronja "Mihal Duri", Tiranë, 1976, ff. 27-28.

Shih Dhimitër S. Shuteriqi, *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2005, ff. 39-46.

Selman Riza, *Vepra IV, Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, Toena, Tiranë, 2002, ff. 241-242.

Selman Riza, *Vepra IV, Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, Toena, Tiranë, 2002, f. 241.

Injac Zamputi, *Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë shqipe*, Hylli i Dritës, 1-2, 1995, f. 20.

Injac Zamputi, *Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë shqipe*, Hylli i Dritës, 1-2, 1995, f. 28.

Injac Zamputi, *Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë shqipe*, Hylli i Dritës, 1-2, 1995, f. 24.

Guillelmus Adae (Brocardus), *Directorium ad passagium faciendum në "Recueil des Historiens des Croisades, Documents Arméniens"*, (Documents latins et français relatifs à l'Arménie), tome second, publie par les soins de l'Académie des Inscriptions et Belles-Lettres, Imprimerie Nationale, Paris, MDCCCXVI, ff. 483-485.

Në latinishte Suacinensem, por përkthimi në frëngjishte këshillon gabimisht Sfetigradin. Në letërsinë tonë historike e identifikojnë me Shasin. (Shënimi im. A.D.)

Në latinishte Sabatensis, por përkthimi në frëngjishte këshillon Stephanie (Narenta), një qytet që mbronte Durrësin e që për këtë arsye nuk mund të ndodhej larg tij. Edith Durham te Shqipëria e Epërme, një udhëtim në Shqipërinë e Veriut të vitit 1908, Shtëpia botuese IDK, Tiranë, 2013, e identifikon me dioqezën e Sapës. (Shënimi im. A.D.)

Në latinishte Albanensis (Albanopoli), rëndom në letërsinë tonë historike identifikohet me Zgërdheshin. (Shënimi im. A.D.)

Kemi parapëlqyer të japim këtu njërin prej varianteve të njohura të përkthimit të kësaj fraze e pikërisht atë të prof. Selman Rizës. (Shënimi im. A.D.)

Selman Riza, *Vepra IV, Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, Toena, Tiranë, 2002, f. 241.



Shih edhe Selman Riza, Vepra IV, Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe, Toena, Tiranë, 2002, f. 241.

Guillelmus Adae (Brocardus), Directorium ad passagium faciendum në "Recueil des Historiens des Croisades, Documents Arméniens", (Documents latins et français relatifs à l'Arménie), tome second, publie par les soins de l'Académie des Inscriptions et Belles-Lettres, Imprimerie Nationale, Paris, MDCCCXVI, f. 374.

Guillelmus Adae (Brocardus), Directorium ad passagium faciendum në "Recueil des Historiens des Croisades, Documents Arméniens", (Documents latins et français relatifs à l'Arménie), tome second, publie par les soins de l'Académie des Inscriptions et Belles-Lettres, Imprimerie Nationale, Paris, MDCCCXVI, f. 429.

Guillelmus Adae (Brocardus), Directorium ad passagium faciendum në "Recueil des Historiens des Croisades, Documents Arméniens", (Documents latins et français relatifs à l'Arménie), tome second, publie par les soins de

l'Académie des Inscriptions et Belles-Lettres, Imprimerie Nationale, Paris, MDCCCXVI, f. 438.

Guillelmus Adae (Brocardus), Directorium ad passagium faciendum në "Recueil des Historiens des Croisades, Documents Arméniens", (Documents latins et français relatifs à l'Arménie), tome second, publie par les soins de l'Académie des Inscriptions et Belles-Lettres, Imprimerie Nationale, Paris, MDCCCXVI, f. 471.

Guillelmus Adae (Brocardus), Directorium ad passagium faciendum në "Recueil des Historiens des Croisades, Documents Arméniens", (Documents latins et français relatifs à l'Arménie), tome second, publie par les soins de l'Académie des Inscriptions et Belles-Lettres, Imprimerie Nationale, Paris, MDCCCXVI, f. 488.

Guillelmus Adae (Brocardus), Directorium ad passagium faciendum në "Recueil des Historiens des Croisades, Documents Arméniens", (Documents latins et français relatifs à l'Arménie), tome second, publie par les soins de l'Académie des Inscriptions et Belles-Lettres, Imprimerie Nationale, Paris, MDCCCXVI, f. 489.

---

## TË DHËNA HISTORIKE, DEMOGRAFIKE E ETNOKULTURORE RRETH EMIGRACIONIT TË SOTËM SHQIPTAR NË EVROPË

### HISTORICAL, DEMOGRAPHIC AND ETNOCULTURAL DATAS ABOUT ALBANIAN EMIGRATION IN EUROPE AND VICE-VERSE

BUKUROSHË ISUFAJ

Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Email: bukuroshe\_isufaj@yahoo.it

#### Përmbledhje

Jashtë shoqërisë nuk ka gjuhë. Gjuha ruan shumë gjurmë nga kultura e vjetër e shoqërisë. Shumë fjalë ruajnë formën e vjetër të tyre, megjithëse me kohë ato kanë marrë përmbajtje tjetër, prandaj, prej shumë kohësh, ka qenë dhe mbetet e qartë, se pa studimet ndërdisiplinare dhe, kur është e mundshme edhe të përbashkëta të gjuhëtarëve dhe të etnografëve, folkloristëve, arkeologëve etj. Gjuha shqipe sot flitet në Shqipëri dhe jashtë kufijve të saj në Kosovë, në territorin ndërmjet Shkupit, Kumanovës, Strugës, Gostivarit, Resnjës, Prilepit Tetovës e Dibrës; në Preshevë, në Bujanoc e në Medvegjë; në Krajë, në Ulqin me rrethina deri në Tivar dhe në Çamëri. Shqipja, pra, flitet në viset perëndimore të Ballkanit, aty ku kryqëzohen rrugët që lidhin Lindjen me Perëndimin, pikërisht në atë rajon që ka qenë djepi i qytetërimit antik evropian.

**Fajlet çelës:** gjuhë, histori, dokumentacion, të dhëna, shoqëri.

#### Abstract

Outside the society there is no language. Language reflects a culture of its people, their customs in the historical development. Many words retain their old form, although with time they have taken other content, therefore, for a long time, it has been and remains clear, that without interdisciplinary studies and when possible also common of the linguists and ethnographers, folklorist, archaeologists etc. The Albanian language is spoken today in Albania and outside its borders in Kosovo, the territory between Skopje, Gostivar, Tetovo and Debar, in Presevo, Bujanovac and Medvedja, in Kraja in Ulcin with the surroundings to Tivar and Chamëri. Albanian is therefore, spoken in rural western Balkans, where roads intersect connecting East and West, exactly in the area that has been the ancient cradle of European civilization.

**Key words:** Language, history, files, datas, society

---

#### Hyrje

Jashtë shoqërisë nuk ka gjuhë. Gjuha është e lidhur ngushtë me veprimtarinë prodhuese të njeriut. Gjuha e një populli pasqyron kulturën e tij, zakonet në zhvillimin e tyre historik. Prej këtej rrjedh edhe rëndësia e madhe e dëshimve gjuhësore, jo vetëm për gjuhësinë, por edhe për gati të gjitha shkencat e tjera albanologjike, si për etnografinë, folklorin dhe përgjithësisht për kulturën popullore, për historinë, por edhe për arkeologjinë etj.

Gjuha ruan vazhdimisht gjurmë nga kultura e vjetër e shoqërisë. Shumë fjalë ruajnë formën e vjetër të tyre, megjithëse me kohë ato kanë marrë përmbajtje tjetër, prandaj, prej kohësh, ka qenë dhe mbetet e qartë, se pa studimet ndërdisiplinare dhe, kur është e mundshme, të përbashkëta të gjuhëtarëve dhe të etnografëve, folkloristëve, arkeologëve etj. nuk mund të zgjidhet drejt çështja e origjinës së popujve me mungesa të mëdha dokumentacioni historik, sikundër është populli shqiptar.

Një popull i lashtë, fqinj i përhershëm me grekët e me romakët, gjuha e të cilit qëndron midis greqishtes e latinishtes, ka pasur edhe ndikime leksikore prej tyre, por është gjuhë më vete, pa lidhje birërie me asnjërën prej dy gjuhëve më të vjetra të Evropës, që përmendëm, po edhe, për fat të keq, me dëshmi të mekëta e gjithsesi të pakëta të dokumentimit të pranishëm së tij si popull e të shqipes si gjuhë.

Prej një trualli bregdetar dhe me mundësi të shumta lidhjeje me Evropën nëpërmjet tokës e detit, Iliria e moçme si dhe Shqipëria e sotme, në fakt, kanë qenë kurdoherë brenda Evropës, madje mu në zemër të saj. Për këtë, ndër të tjera, na dëshmojnë edhe gjuha dhe onomastika shqiptare, veshjet dhe traditat kulturore, sa të moçme e interesante, aq edhe tërheqëse e dëshmitare të kohërave.

### Elementi antik i gjuhës shqipe

Gjuha shqipe sot flitet në Shqipëri dhe jashtë kufijve të saj në Kosovë, në territorin ndërmjet Shkupit, Gostivarit, Tetovës dhe Dibrës, në Preshevë, në Bujanovc dhe në Medvegjë, në Krajë, në Ulqin me rrethina deri në Tivar dhe në Çamëri. Shqipja, pra, flitet në viset perëndimore të Ballkanit, aty ku kryqëzohen rrugët që lidhin Lindjen me Perëndimin, pikërisht në atë rajon që ka qenë djepi i qytetërimit antik evropian. Gjithashtu, shqipja flitet edhe në diasporë (në Itali, në Greqi, në Bullgari, në Ukrainë), edhe në shumë vende të tjera të kontinentit tonë dhe më gjerë, në Amerikë, në Azi dhe në Australi nga shqiptarët të vendosur atje në kohë më të hershme ose më të vonshme.

Gjuha shqipe i përket familjes së gjuhëve indoevropiane. Rreth dy mijë fjalë të shqipes janë me origjinë indoevropiane: **kokë, ditë, natë, dimër, ujë, ha, pi, jam, kam, zog, dem, elb** etj. Shqipja formon një degë më vete në familjen e gjuhëve indoevropiane. Gjuha shqipe pra nuk ka lidhje birërie me asnjërën nga gjuhët e sotme indoevropiane. Territori shqiptar ka qenë i banuar që nga paleolitiku i mesëm (100.000–40.000 vjet para erës sonë). Gjurmët e para të rëndësishme të qytetërimit i përkasin neolitit (6000-2000 vjet para erës sonë).

Në fillimet e kohës së bronzit fiset ilire shfaqen në një territor të gjerë që shtrihet nga gadishulli i Istrias në veri deri në gjirin e Artës në jug. Në lindje, kufiri i tyre shtrihet afërsisht deri te lumenjtë Vardari e Morava. Popullsia ilire është formuar nga popullsi autoktone të epokës së neolitit, pas ardhjes së popullsisve indoevropiane aty nga fundi i mijëvjeçarit të tretë para erës sonë.

Pra, Ilirët përbënin një popullsi shumë të vjetër të vendosur në perëndim të Ballkanit. Emrat e dy fiseve ilire, Pajonëve dhe Thesprotëve, i gjejmë tek "Iliada" dhe "Odiseja" e Homerit. Kjo popullsi del me këtë emër në shekullin e pestë para erës sonë. Në rrethinat e Durrachium-it (Durrësi i sotëm) u formua nyja e Shtetit të parë Ilir. Gjuha e kësaj popullsie ishte ilirishtja. Shqiptarët janë pasardhës të ilirëve dhe gjuha shqipe pasardhëse e ilirishtes.

Nga kjo gjuhë nuk kanë mbetur veçse pak fjalë, të cilat mund të shpjegohen me gjuhën shqipe dhe konkretisht, **sika**= thika, **pele**= pleq, **aspetos**= i shpejtë. Edhe disa emra gjeografikë dhe emra personash ilirë mund të shpjegohen me fjalë të shqipes. Kështu p.sh. **Dardania** është shpjeguar me shqipen dardhë, **Dalmatia** me shqipen delme, dele; **Ulkin** me shqipen ulk, ujk, **Dimalum** me shqipen di mal, dy male; **Bardhul** me shqipen i bardhë, **Dazme** shqipen dash.

Në vitin 168 para erës sonë, Iliria u pushtua nga romakët. Filloi kështu një periudhë pushtimi që zgjati për më shumë se pesë shekuj. Në shekullin e VII Shqipëria u pushtua nga sllavët, kurse në shekullin XV nga turqit otomanë. Pushtimi osman vazhdoi pesë shekuj deri më 28 nëntor 1912.

### Elementi mesjetar e pasmesjetar

Në Mesjetë, popullsia e territoreve të populluara nga fiset ilire, quhej **Albanoi** dhe vendi **Albanon**, prej nga ka dalë forma popullore **Arbënesh** ose **Arbëresh**.

Emrat e sotëm **Shqipëri, shqiptar**, shqip janë shfaqur në shekullin XVII. Gjatë kësaj periudhe të gjatë pushtimi, gjuha dhe kultura shqiptare kanë qenë nën ndikimin e gjuhës e të kulturës latine, greko-bizantine, sllave e turke. Gjenden në shqipe fjalë me origjinë nga greqishtja e vjetër,

latinishtja, greqishtja bizantine, sllavishtja, turqishtja etj.

Nga greqishtja e vjetër kanë hyrë fjalë të tilla si: drapër, lakër, qershi, shpellë; nga latinishtja: arë, kalë, mbret, furkë, ungj; nga greqishtja bizantine: fis, ikonë, kollogjer, manastir; nga sllavishtja: gjobë, lopatë, pushkë, opingë, rob, si edhe toponime: **Berat** (bel+grad), **Dropull** (Dri-no+polje), **Konispol** (konis+polje), **Velipojë** (veliko+polje), **Zadrimë** (Za+Drin), **Zagori** (za+gor); nga turqishtja: **tepsi**, **pazar**, **cohë**, **bahçe**, **oxhak**, **sobë**, **jastëk**, **ilaç** etj.

Është e vërtetë që shqipja ka pësuar ndikime nga gjuhët e huaja, sidomos në leksik, po është po kaq e vërtetë që ajo ka shfaqur aftësi për t'i asimiluar dhe ndryshuar sipas modelit të vet huazimet, duke treguar forcën dhe gjallërinë e saj.

Kështu fjalët e greqishtes së vjetër *drapanon*, *kerasia*, *spileon* në shqip dalin drapër, qershi, shpellë, në latinisht *arvum*, *vicinium*, *impertorem*, në shqip arë, fqinj, mbret; në sllavisht *glob*, *opanak*, *ravnica*; në shqip: gjobë, opingë, rrafshë. Gjithsesi, gjatë periudhës që vendi ynë, kultura jonë, gjuha jonë ishin nën ndikimin e kulturës e të gjuhës latine, greko-bizantine, sllave e turke, gjuha shqipe ka ruajtur origjinalitetin e saj si gjuhë indoevropiane me strukturë fonetike, gramatikore e leksikore të veçantë.

Me rëndësi janë shqyrtimet e thelluara që ka bërë në këtë fushë studiesi i shquar, prof. Eqrem Çabej. Ndër çështjet teorike me rëndësi që trajtohen në veprën e tij është vendi që zë shqipja në mes gjuhëve të tjera indoevropiane, çështja e origjinës së saj dhe fatet historike, që ka ndjekur. Shenja më e dukshme e kontaktit të shqipes me gjuhët e huaja, veçanërisht me vendet ku ndodhen arbëreshët a shqiptarët në botë janë huazimet leksikore, por edhe morfosintaksore.

Kështu, përmendim huazimet greke në të folmet e arvanitëve, italianizmat në të folmet e arbëreshëve të Italisë, bullgarizmat në të folmet e shqiptarëve të Mandricës, dalmatizmat në të folmen e arbëreshëve të Zarës, rusizmat në të folmen e shqiptarëve të Odesës (Shkurtaç 1996: 158). Njohja dhe studimi i gjeobilinguizmit gjuhë-

sor të shqipes ndihmon sot në sqarimin sa më të plotë të pozicionit të saj.

Gjendja e bilinguizmit ka çuar në ndikime më të mëdha, deri edhe në strukturën gramatikore të shqipes. Detyrat teorike të gjuhësisë shqiptare ai i shtron me qartësi shkencore dhe fisnikëri. Në mes tjerash nënvizon: "*Studimet albanologjike, përveç interesit thjesht shkencor, kanë medeomos edhe një anë praktike, pse gjuha shqipe për ne s'përbën vetëm një objekt studimi, por është edhe shprehja kryesore e jetës sonë nacionale.*" (Çabej 1975: 213).

Fjalët e huaja kanë hyrë në gjuhën shqipe në rrjedhë të kohërave deri në ditët e sotme me veçoritë e tyre specifike në dy pjesë kryesore të leksikut: në leksikon e përgjithshëm dhe në atë terminologjik. Në leksikon e përgjithshëm ato janë përfshirë në kushtet e kontakteve qindravjeçare të drejtpërdrejta të shqipes me gjuhët e pushtuesve ose të fqinjëve, duke u përzier me leksikon vendës e duke formuar, sipas gjuhës hyrëse, shtresa të ndryshme leksikore, si, latinizmat (gjatë 500 vjet të pushtimit romak), greqizmat (nga fqinjësia e përhershme me popullsinë greke), sllavizmat tre shekuj (shekulli V deri në shekullin VIII dhe turqizmat (rreth 500 vjet të pushtimit turk).

Në leksikon terminologjik, në kushtet e kontakteve përgjithësisht jo të drejtpërdrejta e më rrallë të drejtpërdrejta me gjuhët e huaja janë formuar në kohët e vona (dy shekujt e fundit) në periferi të leksikut shtresime të tilla, si, italizmat, francesizmat, anglicizmat (anglicizmat) e më rrallë rusizmat e gjermanizmat.

### Periudha e Rilindjes dhe pas saj

Për shtresimet e huaja të leksikut të përgjithshëm ky proces ka vijuar për qindra a mijëra vjet deri në fundin e shekullit XIX, si rrjedhojë e të cilit pjesa më e madhe historikisht e huaj ndihet a perceptohet si shqipe (si, p.sh., edhe ato fjalë, të cilave nga forma mund t'u zbulohet origjina: *oxhak*, *xhëp*, *çarçaf*, *dauille* (turq.), *çekiç*, *çudit*, *vadit* (sllav.), kurse, për shtresimet e leksikut terminologjik procesi në fjalë është kryer për një kohë relativisht të shkurtër (rreth mbi njëqind vjet deri në ditët e sotme, çka lidhet me formimin

e gjuhës së shkencës e të teknikës gjatë kësaj kohe. Kjo ka bërë që në to të ndihet (perceptohet) pak a shumë prejardhja e huaj dhe të mund të përcaktohet origjina e tyre: *bankë, karrocë* (it.), *byro, depo, dosje, bordero, meny* (fr.), *sport, basketboll, regbi, futboll* (angl.).

Në kohë afërsisht të barabarta, qysh nga fundi i shekullit XIX, sidomos nga fillimi i shekullit XX, procesi i hyrjes në shqipe kryesisht të fjalëve nga italishtja, frëngjishtja dhe anglishtja, të cilat kanë funksionuar si terma, ka përfshirë pothuajse plotësisht leksikon libror dhe, në mënyrë të veçantë, atë pjesë të tij që lidhej me terminologjitë e fushave të ndryshme të dijes, duke filluar qysh nga formimi në zanafillë i këtyre terminologjive (në fushat bazë të tyre, si p.sh, matematika, gjeometria, gjeografia, etj.) e deri më sot, kur ato paraqiten të kristalizuara dhe të formësuara përfundimisht si sisteme të qëndrueshme e homogjene.

Në krahasim me huazimet e leksikut të përgjithshëm, tashmë të ngulitura në gjuhë dhe që bëjnë jetë të përbashkët me leksikon vendës, huazimet e terminologjive, si emërtime të gjuhës së shkencës dhe të teknikës, të grupuara në qindra fusha dije, vijnë në hyjnë në sasi të mëdha në gjuhë, sidomos sot, nën ndikimin e shfaqjes së pandërprerë të koncepteve, të lidhura me zhvillimin e shkencës dhe të teknologjive moderne, me përdorimin e objekteve të sofistikuar të industrive të reja (të kompjuterit, të celularit e të çdo pajisjeje a makine tjetër elektronike).

Një pjesë e termave të huaj nguliten si të vetëm, si elemente të nevojshme të sistemeve terminologjike (sidomos sot: *harduer, softuer, tastierë, monitor*), një pjesë tjetër funksionon në kushtet e konkurrencës me termat barasvlerës shqip (krahas dimension edhe përmasë, krahas maus edhe mi), kurse një pjesë nuk gjen vend në këto sisteme, për shkak se lëvruarit e terminologjisë, specialistë a gjuhëtarë, kanë gjetur ose kanë formuar barasvlerës të përshtatshëm për ta (inf. ruaj, përpunoj, kujtesë).

Kufizueshmëria e hyrjes së leksikut të huaj në leksikon e përgjithshëm, qysh nga fundi i shekullit XIX, dhe dendësimi i depërtimit të tij në leksikon terminologjik, pas kësaj periudhe e deri më sot, ka bërë që pesha specifike e huazimit të

zhvendoset nga qendra në periferi të gjuhës, çka e ka shndërruar terminologjinë në portën kryesore të hyrjes së leksikut të huaj.

Kjo situatë problematike për terminologjinë është ndërfort qysh nga rilindësit, të cilët duke punuar për hartimin e teksteve shkollore, ndonëse të nivelit të ulët shkencor-teknik, janë ndeshur me termat e huaj, që shërbenin si shënues të koncepteve të fushave bazë të shkencës si: të matematikës (aritmetikës), të gjeometrisë të anatomisë (N. Frashëri), të gjuhësisë e të gjeografisë (S. Frashëri).

Për kapërcimin e kësaj situatë ata gjithnjë, krahas futjes në tekstet mësimore të fjalorëve (termave) të huaj janë përpjekur që të krijojnë a të gjenin për ta mundësisht sa më shumë barasvlerës shqip, çka ndihmonte për t'i kuptuar sa më lehtë dijenitë shkencore, në kushtet edhe të padijes që ekzistonte në atë kohë në vendin tonë. Më tej dijetarë të tjerë janë përballur me termat e huaj për nivelin e shkollës unike e të mesme, si *psikologji, pedagogji* (A. Xhuvani), *letërsi* (L. Gurakuqi), *teknikë* (M. Logoreci) etj.

Merita e rilindësve dhe e pasuesve të tyre është se ata, duke punuar për lëvrimin e terminologjive bazë u orientuan kaq shumë pas shqipërimit të termave të huaj, sa që krijuan edhe sisteme termash vetjakë shqip për fusha të caktuara, ndër të cilët mund të përmendim sidomos dijetarin arbëresh Dh. Kamarda për fushën e gjeografisë. Një pjesë e shqipërimeve që ata krijuan nuk i qëndruan kohës dhe u zëvendësuan përsëri nga termat e huaj (si *dheshkronjë* me gjeografi, *shkronjëto* me gramatikë).

### **Përfundim**

Duhet nënvizuar në mënyrë të veçantë se në fushën e terminologjisë rilindësit dhanë shembullin se kundër termave të huaj duhet luftuar në mënyrë ballësore. Me punën që u bë më vonë në luftën kundër termave të huaj u arrit që terminologjia e shkencave bazë në shqipe të vihej mbi themele të shëndosha dhe t'u jepej vlerë elementeve autoktone të shqipes.

Me zhvillimin në gjerësi e në thellësi të shkencave dhe të teknologjisë në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar fushat e dijes u shtuan dhe u diferencuan kaq shumë, sa që plotësimi i tyre me terma

mund të bëhej në radhë të parë përmes termave të huaj, të cilët vërshuan në masë të madhe sidomos në tekstet mësimore të shkollave të larta, si edhe në dokumentet shkencore e teknike, në doracakët e të gjitha llojeve e deri në thjeshtligjërimit.

Megjithatë, mbështetja mbi një politikë gjuhësore të drejtë në fushën e terminologjisë në vendin tonë, duke zbatuar orientimin bazë të kësaj politike se ndërhyrja e shoqërisë në terminologji është e domosdoshme dhe e mundshme, çoi në krijimin e komisioneve e të organizmave përkatëse për ndjekjen e saj. *Kjo dha mundësi t'u vihej ledh një pjese të termave të huaj nëpërmjet termave shqip si zëvendësues të tyre, të cilët u pasqyruan në fjalorët e shumtë të llojeve të ndryshme, si shpjegues-gjuhësorë, terminologjike, mësimore e përkthimorë.*

Kjo situatë u mbars me një kontradiktë të thellë, që vihet re edhe në ditët tona, ndërmjet krijimit të një sasive të madhe termash shqip, të pasqyruar në fjalorët e përgatitur nga gjuhëtarë e specialistë, të hartuar mbi bazën e parimeve e kriteve të rrepta shkencore dhe përdorimit të kufizuar të tyre në tekste mësimore, dokumente teknike dhe në praktikën ligjërimore. Termet e huaj kanë mbizotëruar dhe mbizotërojnë edhe sot sidomos në tekstet mësimore të shkollave të larta. Mund të vërehet gjithashtu, se në fushat themelore të dijes (*matematikë, gjeometri, fizikë, kimi*) mbizotërojnë termet me bazë shqipe, kurse në fushat speciale takohen me tepri termet e huaj. Ndërsa për italianizmat e francesizmat në fushën e terminologjisë mund të pohohet se janë arritur rezultate nëpërmjet shqipërimeve të mundshme, çka ka çuar në uljen relative të numrit të tyre, për anglicizmat terma mund të pranohet pa mëdyshje se ata po pushtojnë pothuajse të gjitha fushat e dijes, por edhe po futen thellë në gjuhë, duke depërtuar edhe në zonën librore (masmedia, publicistikë) e deri në thjeshtligjërimit, ku dëgjohen në të folurit edhe të njerëzve të zakonshëm terma të përdorur si fjalë nga fusha e informatikës: *klikoj, tastierë, maus, monitor etj.*

Termet përdoren madje deri në kuptime figurative, siç mund të takohen si të tillë: bunker, format, klon, pingpong, në kontekste nga më të

ndryshme, si: *bunker* (nga usht.) në: "Shqipja në bunker" (M. Elezi); *format* (nga inform.) dhe *i klonuar* (nga gjenet.) në "...*formati me famë botërore Big Brother është klonuar pastaj në rreth 60 vende të botës*" (Gazeta "Shqip"); *pingpong* në: "Një pingpong ndërmjet forcave politike" (TV).

Futja e termave të huaj, sidomos e termave me burim nga anglishtja, në qendër të gjuhës dhe aktivizimi i tyre në ligjërimin e zakonshëm krijon një situatë problematike, sepse u jep atyre të drejtën për t'u përdorur në kushte të barabarta me fjalët shqipe, çka bën që të rrënjosen në gjuhë dhe të mund të mos dalin më prej andej (Duro 2009).

## BIBLIOGRAFIA

- DERIAJ, Adriatik (2010), Dukuri dhe probleme të huazimeve turke në shqipen: *Malësia*, Podgoricë, 5: 137-142.
- ÇABEJ, Eqrem (1975), *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe 2. Fonetika historike*, Tiranë: 111-132.
- ÇABEJ, Eqrem (1972), *Italo-Albanische Studien*, Universitat Wien, 1933 (doktorat); Ngulimet shqiptare në Itali dhe gjuha e tyre: *Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike*, Tiranë: 107-115.
- ÇABEJ, Eqrem (1981), Për pastërtinë e gjuhës shqipe: *Gjuha jonë*, Tiranë, 1: 36-47.
- ÇABEJ, Eqrem (1975), Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes, *Studime Filologjike*, Tiranë, 4.
- ÇABEJ, Eqrem (1975), *Studime gjuhësore*, Vëllimi V, Prishtinë.
- CALLARI, Galli (1977), *Bilinguismo instabile nelle comunità arbëresh dellaprovincia della Cosenza*, in AA. VV. *Aspetti sociolinguistici dell'Italia contemporanea*, SLI, Bulzoni, Roma.
- DEDAJ, Ndue (2013), Shqipja e bjerrë e emigracionit: *Shqip*, 21 mars 2013.
- DEMIRAJ, Shaban (2001), Rreth huazimeve prej burimit turk, arab dhe persian në gjuhën shqipe. *Univers*, 1: 15–30.
- DEMIRAJ, Shaban (2006), Rreth huazimeve të shqipes prej burimi persian. *Perla* Tiranë, 11/2006, 1: 29–36.
- DURO, Agron (2009), Fjalët e huaja dhe gjuha shqipe: *Shqip*, Tiranë, 9 tetor.

ISLAMAJ, Shefkije (2004), Anglishtja dhe latinizimi i ri i shqipes: *Akte të Konferencës Shkencore*, 16 dhjetor 2004, *Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar*, Tiranë: 56-62.

LAFE, Emil (1999), Persizmat në kuadrin e orientalizmeve të shqipes. *Perla*, Tiranë 4/1999, 1: 39–46.

MEMUSHI, Luan (2004), Shkolla dhe shoqëria përballë zbatimit të kulturës gjuhësore: *Akte të*

*Konferencës Shkencore*, 16 dhjetor 2004, *Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar*, Tiranë: 5-9.

GJINARI, Jorgji – SHKURTAJ, Gjovalin (2003), *Dialektologjia*, SHBLU, Tiranë: 46.

SHKURTAJ, Gjovalin (1996), *Sociolingustika*, Tiranë.

## DISTINCINE FEATURES OF THE ORNAMENT IN THE GJIROKASTRA BEAUTIFYING ART AND ARCHITECTURE

### TIPARET DALLUESE TE ORNAMENTIT NE ARTIN E ZBUKURIMIT DHE ARKITEKTURES GJIROKASTRITE

DASHMIR ÇUBERI

Universiteti Politeknik i Tiranës, Tiranë, ALBANIA

Email: dashocuberi@live.com

#### Summary

In this paper is treated popular decorative art in civil on theory and practical. Treated beautifying art and space where it comes: utility role of internal environment and its report with beautifying decoration elements, motives and general harmony. Also, it stresses the role of popular craftsmen report in relation to psychology of the community. Treated, between art and tradition is speaking for distinctive and common among art in general, its transmission in generations, in sense of artistic motives and techniques applying in building of Gjirokastra of XVIII-XIX Centuries. Treated connection between popular art and tradition, as reflection of faith symbols artistically and esthetically like form of community mindset. Treated the distinctive of beautifying techniques, reflected distinctive features between these types of carvings and painting visual popular art. In the end is to apply the art of decoration techniques in both carvings and painting in the Gjirokastra building of XVIII and XIX.

**Key words:** inlay; tradition; building; artistic; skilful.

#### Përmbledhja

Referimi trajton artin popullor dekorativ në banesën qytetare nga aspekti teorik dhe praktik. Trajtohet arti i zbukurimit dhe hapësira ku bëhet fjalë: për raportin e banesës me elementët dekorative të zbukurimit. Gjithashtu theksohet roli i mjeshtrit popullor, i psikologjisë dhe botëkuptimit komunitar. Flitet për të përbashkëtat dhe veçoritë e artit popullor, për motivet, për mjeshtërinë dhe teknikat e ndryshme artistike të aplikuara në banesën gjirokastrite të shek. XVIII-XIX. Arti i zbukurimit pasqyron simbole të besimit tradicional në mënyrë estetike dhe artistike. Teknikat e zbukurimit, pasqyrojnë të përbashkëtat dhe dallimet midis dy llojeve të artit pamor, të pikturimit dhe të gdhendjes. Kjo tregon shkallën e lartë të zhvillimit të artit të zbukurimit dhe harmonizimin me vlerat e arkitekturës së banesës gjirokastrite të kohës, trashëgiminë vendase të teknikave artistike dhe përcjelljen në breza e vlerave të pasura të traditës.

**Fjalë çelës:** zbukurim, traditë, banesë, artistik, mjeshtëri.

---

#### Hyrje

Të dhënat e këtij punimi janë burim i drejtpërdrejtë i kontaktit me artin e mjeshtrove të zbukurimit në banesat gjirokastrite. Këtu jam ndalur në banesat më të spikatura qytetare të ndërtuara në shekujt XVIII dhe XIX. Në formulimin e këtij punimi, janë marrë parasysh të dhëna, që u përkisnin burimeve dokumentare ndonëse të pakta. Këto të dhëna janë më shumë me karakter historik, arkitektonik dhe më pak në planin artistik. Gjithashtu janë shfrytëzuar konstatime dhe përfu-

ndime të studiuesve Dh. Shuteriqi, Emin Riza, F. Shkupi, M. Tirta. Evidentimi i vlerave estetike e artistike, analiza e procesit krijues, tiparet dalluese të ornamentit dhe teknikave të aplikuara, raportet midis artit dhe arkitekturës në kuadrin e zhvillimit të banesës gjirokastrite, parë këto si përpjekje për një vështrim më të thelluar janë qëllimi i këtij punimi.

#### Zbukurimi dhe oda e miqve

Sfondi social në të cilin zhvillohet arti i zbukurimit është sfondi i Gjirokastrës të shekujve të XVIII



dhe XIX, në të cilin ka ndodhur një ndryshim i pozicionit që individi zinte në shoqëri. Fillimet e këtij ndryshimi do të duken në zhvillimin e mardhënieve ekonomiko-shoqërore dhe krijimin e shtresave të pasura. Këto shtresa u bënë financuese të ndërtimeve të shquara qytetare, të artit të zbukurimit të mureve dhe ornamentikës të realizuara në gdhendjet e gurit e të drurit për të lënë kështu gjurmë të fuqisë së tyre ekonomike duke u bërë direkt ushqyese të një shije estetike e artistike të komunitetit.

Duke parë mënyrën e të ndërtuarit, krijimin e hapësirave, ambienteve me funksione të ndryshme na krijohet mendimi se, kësaj i përgjigjej një mënyrë e veçantë jetese që padyshim ishte e ndryshme brenda komunitetit. Kjo shtresë e pasur mendonte dhe kujdesej njëkohësisht për zbukurimin, aredimin deri te orenditë dhe veshja. Gjithçka ishte e lidhur me prezantimin, shkëlqimin dhe mirëqënien ekonomike të familjes. Prandaj për realizimin e këtij qëllimi afroheshin mjeshtrat vendas më të mirë të fushave të ndërtimit dhe zbukurimit.

Artisti popullor merr përsipër zbukurimin e ambientit kryesor përfaqësues, ku çdo element funksional utilitar bëhej bartës dhe i vlerave dekorative shpesh me realizime të shënuara artistike (Riza 2004: 106). Ky ambient i përzgjedhur për këtë qëllim, emërohej në mënyra të ndryshme si oda e miqve, oda e madhe ose oda e mirë (fig. 1). Mund të themi se oda e miqve është vendi me ngarkesë të plotë artistike ku përfaqësohen gjithë vlerat e teknikave tradicionale të zbukurimit.

Hapësira e konsiderueshme që zë oda e miqve nga ana planimetrike është një drejtkëndësh me kompozim gjeometrik qëndror. Nëpërmjet një kuadrati sa  $1/3$  e ambientit të odës, krijohet ambient i qoshkut vendit të veçuar dhe të preferuar për qëndrimin në kryet e odës.



Fig. 1 Oda e miqve (Zekatët)

Në referim të odës së mirë të banesës së Zekatëve (1811-12) në qendër zhvillohet volumi kryesor i ambientit me tavan të veçantë i një dimensiononi më të madh, që lidhet me fasadat anësore murale të panove të pikturuara, midis të cilave qëndron oxhaku me formë gjysmëprizmi me kurorë, i dekoruar me motivet e njohura floreale në teknikën "al seco" (punim në sipërfaqe të thatë), ndërsa pjesa e sipërme e tij është realizuar në teknikën stuk-reliev dhe njëkohësisht i pikturuar me ornamentikë bimore.

Shpërndarja e ornamentikës në dru (në harqet e dyerve, në kollonat prej druri, në tavanët, dollapët e murit në sergjenët jo funksionale) dhe në pikturë, (në oxhakun qëndror, në panotë piktorike, dritarëzat me xham të ngjyrosur të faqes balllore), sjellin ekuilibër në kompozimin e përgjithshëm. Të gjithë këta elementë kanë në përbërjen e tyre motive të shumëllojshme, që dallojnë si në formë ashtu dhe në ngjyrë. Atje vërejmë forma gjeometrike katrore, trekëndësha, tetëkëndësha, motivin e yllit, motive floreale e frutore të përdorura në panotë murale. Dyert, dollapet e mureve, musandërdhipatoja me forma svastike, janë të vendosura në mënyrë simetrike dhe së bashku me dritaret funksionale dhe ato me ngjyrë rrethojnë hapësirën e madhe të odës. Prania e tyre plotëson më së miri pjesën fundore të odës me ornamentet e gdhendura dhe të pikturuara njëkohësisht. Përveç odës së miqve dekoracioni trajtohet më pak në odat e zakonshme dhe ambientet (siç janë divanet) me funksione të caktuara. Ngarkesa dekorative e tyre është më e thjeshtë. Ky diferencim vërehet në mungesën e panove murale. Oxhakët janë funksionale dhe pa dekoracione. Elementët dekorativë këtu i gjejmë vetëm në punimet e drurit.

### Tradita dekorative dhe arkitektura

Zbukurimorja do të përdorë arkitekturën qytetare si sfond të motiveve të saj. Arti dekorativ dhe arkitektura, ndonëse kanë pikësynime të ndryshme, bashkëjetojnë dhe ndërhyjnë reciprokisht natyrshëm te njëra-tjetra, duke qartësuar identitetin tipologjik e artistik të banesës. Zbukurimin në planin arkitektonik e gjejmë të zbatuar në modelimin dekorativ të veprës, në marrëdhëniet e elementëve të formës, në mënyrat kompozicionale të vendosjes dhe trajtimit të gurit dhe drurit, si elemente të rëndësishëm për të krijuar figuracionin me efekt dekorativ në pamjen e jashtme dhe të brendshme të banesave. Kjo është mjaft e dukshme në banesat e Kikinos, Bakirit dhe Ficos ku ornamentet prej guri e druri bëjnë lojën e tyre dekorative në raport me objektin. Banesa e Ficos është tepër e pasur dhe origjinale në punimet e mjeshtrave të gdhendjes së drurit. Mjaft e dukshme kjo në sprethet e çatave, në dritaret e fasadave të jashtme, duke e bërë këtë banesë të një karakteri tepër të veçantë, me një stilistikë origjinale dizenjimi.

Duke parë interierin dhe eksterierin e banesave, prerjet brenda tyre, kuptojmë edhe lojën proporcionale që mjeshtrat e projektimit dhe zbukurimit përdorin. Për mjeshtrat proporcionet mes ndërtesës dhe dekoracionit, ishin të rëndësishme për realizimin e një ekuilibri kompozicional të zbukurimit. Proporcioneve i kushtohej vëmendje dhe ishin një nga arsyet kryesore të arritjeve estetike. Këtë shpërndarje të ekuilibrit proporcional e vërejmë në raportet e punimeve të drurit, pikturës murale me hapësirat boshe të sipërfaqeve në odat e miqve por jo vetëm këtu. Harmonia proporcionale përshkon edhe eksterierin, si pjesë e pandarë e dekoracionit, e ndjeshme kjo në kompozimin dekorativ të kateve të dyta dhe të treta. Dritaret ballore sipër të cilave qëndrojnë dritarëzat me ngjyrë shoqërohen përqark tyre me pikturë murale me figura luanësh me motive floreale. Edhe dritaret harkore të kateve të dyta janë të pikturuara me motive floreale duke marrë pjesë në dekoracionin e jashtëm, karakteristikë kjo për banesat e Skëndulajve, Bakirit dhe të Brajës.

Në fasadën e jashtme, paraqitja e simetrisë arkitektonike të dritareve e shoqëruar përreth me pikturë murale dhe kombinuar me vendosjen në forma të ndryshme dekorative të gurit në vende të veçanta, si p. sh. te kamerietë në qemerët harkorë të portave krijojnë unitetin dekorativ të jashtëm, karakteristikë kjo e banesave më të shquara të Gjirokastrës.

Veprat e realizuara flasin qartë për një edukim të mjeshtrave me traditën e pasur artistike të trashëguar nga e kaluara. Këta mjeshtra ishin të njohur jo vetëm brenda vendit, por dhe në mbarë rajonin e Ballkanit. Pa dyshim ata janë udhëhequr nga arkitektë të aftë që kanë qenë në gjendje të vënë në zbatim vepra të tilla të rëndësishme. Njëri prej tyre ishte Petro Korçari kryearkitekti i Ali Pashë Tepelenës, që udhëhoqi punimet e disa ndërtesave të Janinës, Gjirokastrës e Korçës (Shuteriqi 1976). Në mes grupeve të ndërtuesve vepronin mjeshtrat e skalitjes së gurit, gdhendjes së drurit dhe piktorët e mureve (Shkupi 1986).

Si element i rëndësishëm figurativ u përdor ornamentet me shumëllojshmërinë e formave të tij, që shërbeu për realizimin e kompozimeve unike. Kështu ornamentet zhvillohet në funksion të qëllimit dekorativ në variante të ndryshme gjeometrike, në forma të stilizuara dredhkash të motiveve floreale e bimore ku ndjehet ndikimi oriental i tyre.

### Pikturimi mbi dru

Dekoracioni karakteristik barok ka fazat e zhvillimit të tij. Deri rreth çerekut të parë të shek. XIX mbisundon pikturimi i elementeve të drurit (Riza 2004: 156). Mjeshtëria e *pikturimit në dru* prezanton arritje cilësore në ndërtimin dhe pikturimin motiveve floreale. Efekti dekorativ krijohej nga përdorimi i ngjyrave të ngrohta dhe të ftohta (fig.2). Sipërfaqja e drurit tonohej me të kuqen karakteristike që anonte nga vishnja e cila vlerësonte ngjyrat e tjera; të bardhën, të kaltrën, jeshilen dhe blunë të vendosura mbi të. Kjo karakteristikë pikturimi përfshinte të gjitha punimet e drurit në odën e miqve. Kështu të krijohej mendimi, se për mjeshtrat e kësaj periudhe nuk kishte rëndësi vetëm realizimi i dekoracionit me cilësi, por edhe plotëria, që nënkupton plotë-

simin me ngarkesë artistike të çdo sipërfaqeje të lirë, veçori kjo e Barokut.

Periudha në të cilën pikturimi gjen përdorim të gjerë është periudha e realizimeve më të shquara të artit të dekorimit në banesën gjirokastrite, që lidhet me dhjetvjeçarët e parë të shek. XIX. Pas kësaj periudhe në banesat qytetare dekoracioni me ngjyrë mbi gdhendje dhe panotë e fasadave të brendshme nuk përsëriten, si në banesat e Zekatëve, Belajve dhe Çuberatëve duke shënuar kështu fillimin e shkëputjes nga kjo ngarkesë dekorimi. Pikërisht këtë largim nga pikturimi i brendshëm e vëmë re tek banesa e Resajve dhe Kikinos. Dekorimi me ngjyrë në banesën e njohur të Skëndulajve përqëndrohet vetëm te oxhaku, ndërkohë që nuk përdoret më në sipërfaqet e mureve dhe në punimet prej druri. Më vonë oda e mirë merr një dimension të ri me pamje më të thjeshtë, duke ju larguar detajeve dhe trajtimit të stilit Barok. Rëndësi të veçantë i jepet teknikës së gdhendjes me forma gjeometrike (Riza 2004: 107). Kjo dukuri është e lidhur me zhvillimet ekonomike dhe konceptimin e ri brenda një stili apo trajtimi të elementëve të tjerë të dhomës së mirë.



Fig. 2 Pikturim mbi dru



Fig. 3 Tavan dekorativ

### Ornamenti dhe teknikat e realizimit

*Gdhendja e drurit* është një nga teknikat e artit të zbukurimit që dallohet për veçoritë e saj të krijimit e praktikimit. Gdhendjet në dru brenda kontekstit të banesës me karakter të veçantë, janë të destinuara të gjejnë zbatim në tavane, rozeta, parmakë, trapazane, dollape muri e dyer. Në modelimin e elementëve të drurit dallojmë format e rregullta gjeometrike, drejtkëndësha, katrorë të dimensioneve të ndryshme duke krijuar sipërfaqe dekorative me volum formash të vogla. Këto forma shpesh kalojnë në thjeshtëzime dekorative dhe shkallëzime në disa plane.

Sipërfaqet e tavaneve formulohen nga motivet gjeometrike në formë katrori. Në disa prej tyre katrorët mbajnë në mes motivin e yllit (fig. 3). Ky dekoracion katrorësh është bërë me një qëllim të caktuar nga mjeshtrat për të vlerësuar më mirë dhe ndarë më qartë sfondet e tavaneve nga rozetat. Në dallim nga dekoracioni i sfondeve rozetat janë të formuara nga një rreth i mbushur me motive të gdhendura gjetshesh apo motivesh të tjera që konturohen nga tetëkëndësha ose gjashtëkëndësha disa brezash në odën e miqve. Rozetat prej druri të odës së miqve ndryshojnë nga ato të ambienteve të tjera, pasi kanë ngarkesë më të madhe motivesh gjeometrike dhe floreale. Në këtë teknikë motivet mund ti gjejmë dhe me simbolika trashëgimore të besimit ndaj fenomeneve të natyrës, p. sh. përmendim motivin e hënës dhe diellit (fig. 5), si një forcë pozitive e natyrës, të përdorur në pjesën e sipërme të hapësirës së dymës brendshme, motivin e bimësisë që simbolizon kultin e prodhimit apo motivin e gjarpërit që simbolizon kultin e të parëve si mbrojtës i jetës familjare.

Gjithashtu si elementë shumë të qartë të mbeturinave të kultit të diellit janë svastika, rrathët koncentrikë, vija të valëzuara, paralele të thyera dhe motive të tjera të diellit. Këto motive na paraqiten në format nga me të thjeshtat e deri te më të ndërlikuarat (forma floreale, zoomorfe, antropomorfe etj). Dyert, oxhakët, harqet e gurta të portave, si vende ku janë fiksuar këto motive e simbole dëshmojnë për karakterin religjioz, magjik mbrojtës që kishin dikur këto zbukurime (Tirta 2004: 70, 74, 79, 152).

*Piktura murale* në banesën gjirokastrite, mban një peshë të konsiderueshme në organizimin dhe harmonizimin e përgjithshëm dekorativ. Në përgjithësi motivet kryesore mbizotëruese të dekoracionit janë floreale, frutore e gjeometrike. Panotë piktorike janë të kompozuar qartë dhe në mënyrë simetrike në të dy anët e faqeve anësore të odës së mirë. Brenda tyre janë pikturuar motivet floreale dhe frutore të grupuara në marrëdhënie të ndryshme me njëra tjetrën. Ato shprehin ndërkohë idenë e bollëkut dhe mirëqenies. Ngjyrat që përshkojnë këto motive janë transparente, të freskëta dhe me kontrast, në

shërbim të mendimit për të krijuar një ambient estetik dhe sa më të gëzuar. Mjeshtrit popullorë nëpërmjet lojës së të kundërtave, midis ngjyrave të ngrohta dhe të ftohta kanë fiksuar vizualisht forma volumore me plasticitet dhe kontraste dritë-hije. Ata aplikojnë teknikën e lirë duke shpalosur variantshmërinë dhe kalimet delikate e të ndjeshme të toneve me ngjyrë. Veçoria specifike e pikturës murale është e lidhur ngushtë me teknikën e ngjyrave të ujit të punuar direkt mbi një sipërfaqe të sheshtë suvaje me përbërje gëlqereje, rëre dhe një pjesë allçi.

Te zbukurimorja duket sikur motivet përsëriten ose ngjasojnë, por ajo që e bën të dallojë një punim artistik, është stili, forca përfytyruese, përdorimi i shprehive teknike dhe artistike. Mjafton të krahasojmë kompozimin dhe ngjyrat e panove që gjenden në gjysmën e sipërme të odave të mira në banesat e Zekatëve, Belajve e Çuberatëve vemë re të njëjtën zgjidhje të përgjithëshme të kompozimit. Shfrytëzimi i sipërfaqeve të lira është shumë i përafërt sikurse dhe gama e ngjyrave të përdorura, ndërsa shprehitë teknike paraqien me vlera të ndryshme. Shpërndarja dhe trajtimi i motiveve janë të ngjashme me motivet e veshjeve popullore. Kjo influencë shpjegon më mirë faktin e mbështetjes në traditën vendase.

Përgjithësisht ruhet një ndjenjë kompozicionale që përpiket të theksojë marrëdhënie të ndryshme midis motiveve dekorative. Gjithë motivet janë vendosur në lëvizje të grupuara dhe pikturuar në mënyrë tepër të sigurtë dhe të saktë. Vizatimi është i shkathët dhe i zhdërvjelltë.

Faktorë të tillë të procesit krijues janë tipar thelbësor i krijimtarisë popullore. Lëvizjet e shpeshta të mjeshtrave, prirjet e shtresave të pasura për huazime në trajtimin dekorativ flasin për një lloj ndikimi oriental. Disa motive tavanesh gjithashtu të çojnë në lindje (Riza 2004: 230).

Në banesën e Zekatëve ka raste ku në panotë piktorike midis dritarëzave të odës së mirë, në një periudhë të caktuar për arsye të dëmtimit dhe rifreskimit të tyre, është ndërhyrë me tone ngjyre me kontrast në konturet konstruktive të motivit, duke bërë të pranishëm një gamë ngjyrash të një stili tjetër. Prania e dy stileve si rezultat i këtyre ndërhyrjeve e bën këtë pjesë më të dukshme nga

pjesa tjetër e panove të pikturuara (fig. 4). Kjo mendojmë të ketë ndodhur në fund të shek. XIX ose në fillim të shek. XX, duke u nisur nga fakti i një niveli artistik më të ulët të ndërhyrjes.



Fig.4 Motive frutore

Fig. 5 Motivi i Diellit

*Guri* në Gjirokastrë përbën elementin bazë të ndërtimit. Në planin dekorativ të jashtëm të banesave ornamentet e realizuar në materialin e gurit paraqiten në forma gjeometrike të thjeshta që realizohen nga vendosja ritmike e gurit të skalitur me një figuracion që bie në sy. Theksojmë këtu kornizat ballore të kamerisë në banesën e Kikinos, që përbën një shembull të veçantë. Ndërsa në harqet e portave prej guri të hyrjes të kësaj ndërtese, ndodhen të gdhendura me një pretendim më të qartë figurativ, figura shpendësh, kafshësh, motive me simbolikë të ndryshme pagane apo fetare, në formën e basorelievit. Dekoracionet që veshin muret e jashtme të mbrojtura nga sprethet e çative dhe, që i kanë shpëtuar, në pjesën më të madhe, veprimet të agentëve atmosferikë janë gjithashtu pjesë e zbukurimores.

Shumë nga këto dekoracione janë realizuar mbi suva të shtruara mbi struktura druri. Shpesh në to gjejmë motive floreale, figura zogjsh, figurën e luanit, elementë të peisazhit dhe skena nga gjuetia. Një shembull të tillë kemi në banesën e Kikinos mbi kamerienë e së cilës në fasadën anësore, shfaqet kompleksi piktorik me këto motive. Këtu vërejmë faza të ndryshme pikturimi, që i përkohjnë dy stileve të veçanta.

Kjo trashëgimi e kulturës popullore është dashur të bashkëjetojë me kushtet atmosferike dhe me disa breza banorësh, ku shpesh herë, jo me pronarët e tyre. Dëmtimi i suvase dhe shtresa gë-

lqereje kanë pasë mbuluar sipërfaqe të pikturara. Në banesën e Skëndulajve pas ndërhyrjeve restauruese, pastrimi i tamburit të oxhakut nga gëlqerja nxorri në dritë pikturimin e tij duke fituar vlerën e mëparshme. Megjithë punën e mirë restauruese të kryer, ende sot gjenden pjesë fragmentesh të dëmtuara. Ka shumë mundësi që në brendësi të suvave të ruhen akoma gjurmë të formulimit origjinal. Këtë mendim na i krijojnë zbulimet e fundit nga ndërhyrjet restauruese të vitit 2011, të motiveve në stuk-reliev në odën e miqve të banesës së Babaramos dhe pikturave murale në banesën e Kikinos.

### **Përfundim**

Duke ndjekur veprimtarinë e mjeshtrave dhe duke marrë shkas nga niveli i arrirë i artit të zbukurimit në banesën qytetare mund të themi

se në shek. XVIII-XIX qyteti i Gjirokastrës ka patur një shkallë të lartë zhvillimi, veçanërisht në gjininë e artit të zbukurimit dekorativ, ç'ka shpjegohet me pasurinë e gjerë të veprave të krijuara në këtë periudhë.

### **Bibliografia**

RIZA, Emin (2004), *Qyteti-Muze i Gjirokastrës*. Botimet Toena.

SHUTERIQI, Dh. S. (1976), *Petro Korçari - Kryearkitekti i Ali Pashë Tepelenës*, Tiranë.

SHKUPI, Fatbardha (1986), Zbukurimorja e disa banesave gjirokastrite, "*Monumentet*", Tiranë, nr. 2.

TIRTA, Mark (2004), *Mitologjia ndër shqiptarë*, Botimet "Mësonjëtorja" Tiranë.

---

## PRINCIPLES AND CRITERIA FOR THE DEVELOPMENT OF A TEMPLATE DICTIONARY FOR THE LEGAL TERMINOLOGY PARIME DHE KRITERE PËR HARTIMIN E NJË FJALORITHI MODEL PËR TERMINOLOGJINË E SË DREJTËS

EDA SHEHU

Universiteti i Tiranës, Tiranë, ALBANIA

Email: edashehu\_2006@yahoo.com

### PËRMBLEDHJE

Deri më sot në fjalorët terminologjik si dhe në fjalorin terminologjik të së drejtës pasqyrohen termat si emra, apo termat togfjalësh me bazë emërore dhe nuk paraqiten termat të përdorur si pjesë të ndryshme të ligjëratës, për shembull, në fjalorin terminologjik të së drejtës pasqyrohet termi administratë dhe mungojnë termat si, *administroj* - *administrues-i* - *administrativisht*. Në këtë trajtesë jepen vijat e përgjithshme për ndërtimin e një fjalori terminologjik, që do të paraqes më tej funksionimin e termave në sistem duke pasqyruar në të edhe pjesët e tjera të ligjëratës (emër, folje, mbiemër, ndajfolje). Zgjidhja e këtyre problemeve do të ishte një lehtësi për përdoruesin e fjalorit, i cili do të gjej termin në një sistem të plotë lidhjes, si krahas *ligj* të pasqyruar në fjalor dhe *ligjësoj* - *ligjësim* - *ligjësisht*, apo *abdikim* - *abdikoj* - *abdikues*. Pra, fjalori terminologjik do të ishte më i pasuruar nga përmbajtja e tij.

**Fjalë çelës:** hartim, fjalor, sistem i lidhjeve, sistem

### SUMMARY

To date in terminological dictionaries as well and in the dictionary of legal terms reflected terms as names or phrase terms with nominative base and not appear the terms used with different parts of speech, such as in the dictionary of legal terms reflected the term *administratë* and absent terms as *administroj*- *administrues-i*- *administrativisht*, which used in the terminology of law. In this paper will be presented the general lines for the construction of a dictionary, that will show further the functioning of terms in system reflecting in it and other parts of speech (noun, verb, adjective, adverbs). The solution of these problems would be a convenience for the user of the dictionary, who will find the term on a complete system of links, such as *ligj* - *ligjësoj*- *ligjësim*- *ligjësisht*, or *abdikim* - *abdikoj* - *abdikues*. So, the terminological dictionary would be enriched from its content.

**Key-words:** design, dictionary, system of links, system.

---

### HYRJE

Në Shqipëri, por, kohët e fundit, edhe në Kosovë, aty këtu e dhe në Maqedoni, janë ha-r-tuar një numër i madh fjalorësh termino-lo-gjikë për fusha të ndryshme të dijës, të gjëra dhe të ngushta, të cilët shërbejnë si bazë për studime, si edhe mbështetje për t'i shfrytëzuar për ti për-mirësuar me tej, duke i zgjeruar sasio-risht dhe ngritur nga ana e nivelit cilësor. Në më--nyrë të ve--çantë këtu mund të veçojmë dhe një varg fjalorësh të fushës të së drejtës, duke filluar nga

Fjalori i Komisë së Shkodrës (1912) e, pas vi-te-ve 50-të - 60-të, të shekullit të kaluar një varg fjalorësh po të kësaj fushe në shqipe me dy tre gju-hë të huaja. Ndërmjet tyre mund të përme-n-den fjalorët me një autor ose bashkautor si L. Dodbiba etj, (1986), F. Leka, etj. (1970), P.Kalo (2002), Nj.Uka (2012), etj. Vetëm ky fakt mund të vinte para vështi-rë-sive, por edhe përgje-gjë-si-ve të mëdha këdo që do të mëtonte të ndër-me-rrte një fjalor të ri të kësaj fushe.

Për të hartuar një fjalor të tillë, mendojmë se duhen ndjekur disa drejtime themelore për disa probleme që hidhen me mënyrat dhe format e përfaqësimit të terma-ve me fjalorët e hartuar deri më sot, zgjidhja e të cilave mund të bëhej duke zgjeruar konceptimin e termit si njësi e vetme e përbërjes së termësit (fjalësit) të këtyre fjalorëve, e përfaqësuar kryesisht deri më sot nga termat emra dhe termat togfjalësha me bazë emërore. Kjo ka bëri që, termat që dalin si pjesë të tjera të ligjëratës si folje, mbiemra, ndajfolje ose të përfaqësohen në mënyrë shumë të kufizuar, ose të mungojnë pothuajse tërësisht. Kështu jepen ligj-rrallë ligjor (ligj i huaj, e drejta penale etj.).

Këtu, në këtë trajtesë, bëhet përpjekje për ta zgjidhur këtë problem, duke u mbështetur në paraqitjen e një Fjalorthi modelor, në bazë të lëndës së tre fjalorëve ekzistues (L.Dodbiba, F.Leka, Nj.Uka), të dhënë në mënyrë të kufizuar në shkronjën A. Kontributi ynë modest këtu do të qëndronte në format e tjera të përfaqësimit të termave në këto modele jo vetëm nga termat emra, por edhe nga termat që dalin si pjesë të tjera të ligjëratës, duke i futur si pjesë përbërëse të termësit të Fjalorthit modelor.

Këtu si term ne do të pranojmë jo vetëm një-sitë njëfjalëshe emërore dhe ato togfjalëshe me bazë emërore, si psh. e drejta dhe e drejta ci-vile, që shprehin koncepte të fushës, por edhe një-si që dalin në pjesë të tjera të ligjëratës si fo-l-je: zgjedh, votoj, mbiemra: zgjedhor, juridik, ma-d-je edhe ndajfolje: ligjërish, njëzëri. Ky kon-ceptim më i gjerë për termin ka të bëjë me cilësimin si terma edhe të njësive që dalin edhe në pjesë të tjera të ligjëratës, në ato raste kur njësia (folje, mbiemër, ndajfolje) futet në mikro-si-s-tem fjalëformues (termformues) me njësi të tjera si ligj – ligjor – ligjësoj – ligjë-sisht, admi-ni-stroj-ad-mi--nistrativ-admini-s-t-ra--tivisht, ashtu edhe kur termi shpreh specifikën e fushës si juridik-ju-ri--dikisht. Për arsyen që shprehëm më sipër ne do të mbështetemi mbi dy korpusë: në rastin e pa--rë, në një korpus kur shqyrtohen si terma edhe pjesët e tjera të ligjëratës dhe në rastin e dy--të në fjalorët terminologjikë të fushës të së drejtës,

si, psh., “Fjalor i termave të së drejtës shqip-frengjisht-rusisht” (1986), në të cilin pa-s-qy-rohen si terma vetëm njësi njëfjalëshe emë-ro-re dhe tog-f-ja-lësha me bazë emërore në të dyja gjuhët.

Më poshtë po bëjmë një paraqitje të dy këndvështrimeve, gjuhësor. Konceptor dhe thjesht gjuhësor duke shtuar në grupin e kënd-vë-shtrimit gjuhësor edhe termat mbiemra, folje, ndajfolje që lidhen në mikrosistem me termat emra që shprehin specifikën e fushës:

A	B
Sipas kriterit të	ndërtimit
Sipas këndvështrimit gjuhësor gjuhësor të fjalorit terminologjik (Dodbiba 1986: 23)	(Dodbiba
(kriteri gjuhësor-konceptor)	
1. identitet	1.
identitet	2.
identik-e	3.
identikisht (potenciale)	4.
2. identifikimi i kufomës	5.
identifikim	6.
identifikoj	7.
i identifikuar	8.
kufomë	9.
kufomor (potencial)	10.
3. shpërdorim i së drejtës	
1. shpërdorim	1.
shpërdoroj	2.
e drejtë	3.
juridik	4.
4. mbrojtje e interesave të shtetit	
1.mbrojtje	1.
shtetëror	2.

shtet

3.

edhe për krijimin e një baze më të gjerë për hartimin e një Fjalori të përmirësuar të ter-*ma-ve* të fushës përkatëse, duke u mbështetur në lëndën e fjalorëve të kaluar për fushën e dhë-në, do të ishte paraqitja e një Fjalorthi Model, që do të kufizohej me terma të vendosur me rend alfabetik në një shkronjë (psh. në shkro-njën A). Në këtë punim do të paraqiten tre Fja-lo-r-thë të veçuar : I, II, III. Në Fjalorthin e I, në një pjesë të shkronjës A do të përfshihen Fj. i së drejtës (1986) (Do) edhe Fj. i së drejtës ndër-ko-m-bë-tare (1970) (Le) në Fjalorthin II, do të për-f-shi-hen termat e nxjerrë nga Fjalori i së drejtës (Nj. Uka, 2012) (Uk) (një pjesë e shkronjës A). Pas kë--tyre do të jepen në tërësinë e tyre të gjithë termat e fjalorëve të mësipërm në një Fjalorth Model III, duke hequr disa njësi, që sipas ko-n-ce-p-tit të mbajtur në punim, nuk plotësojnë kush-tet për t'u pranuar si terma të fushës, meqë i përkasin fushave të tjera të dijes si ekonomisë, politikës etj. Po kështu do të hiqen emërtimet e personave, të dukurive që i përkasin historisë e ndonjë tjetër. Nga ana tjetër në Fjalorthin Model III do të shtohen disa njësi që, sipas konceptimit që kemi mbajtur gjitha-sh-tu në punim, do të konsiderohen terma, pava-rë-sisht se dalin në pjesë të tjera të ligjë-ra-tës si kra-has abdikim (që pasqyrohet në Fjalorët e mëpa-rshëm) do të shtohen edhe abdikoj – abdikues, meqë lidhen në sistem me abdikim dhe shprehin specifikën e fushës, me shkurtesa (She = Eda Shehu autorja).

interes (etj)

4.

Siç mund të shihet, sipas paraqitjes së gru-pit A, mund të përfshihet në përzgjedhje një nu-mër i kufizuar njësisish, ku terma cilësohen vetëm njësi njëfjalëshe emërore dhe togfjalësha me bazë emërore (me më shumë se dy gjymtyrë të tipave: shpërdorimi i së drejtës dhe mbrojtje e interesave shtetërore dhe kjo i përgjigjet konce-p-timit të terminologjisë si sistem termash që pasqyrojnë një sistem konceptesh të fushës përkatëse. Sipas paraqitjes së grupit B në përzgjedhjeje futen edhe kritere gjuhësore të trajtimit të termit, ku ai vështrohet edhe nga ana e lidhjes semantiko-gjuhësore (fjalëfor-muese ose termformuese) dhe derivatet e termit emër cilësohen dhe ata si terma, për-derisa shfaqen në forma të tjera, por që lidhen në sistem me termin bazë emëror. Në këtë më-nyrë zgjerohet inventari i leksikut terminologjik i çdo fushe dije, sikurse edhe në fushën në fjalë, çka mund të pasqyrohet edhe në një fjalor terminologjik të paktën me orientim mësimor.

Në këtë rast termat mbiemër, folje ose edhe nda-jfolje, për të përforcuar karakterin e tyre spe-cial, mund të paraqiten duke dhënë në fjalor në kllapa fjalën që plotëson atë, si, psh. Shpë-r-do-roj (të drejtën), identifikoj (kufomën), shte-të-ror (pushtet). Në këtë mënyrë shtohet sasia e te--rmave në përgjithësi dhe si bazë e fja-lorit shë-r-bej-në termat njëfjalësh dhe dyfja-lësh, duke e le-htësuar fjalorin nga termat e shu-m-të togf-ja-lësh. Përveç kësaj, vetë fjalorët mund të shër-be-j-në për të nxjerrë prej togfjalëshave shu-më-gjy-m-tyrësh ato elemente që janë në vetvete terma, duke dhënë në shumë raste në kllapa pjesën që plotëson atë. Kështu, psh. nga nda-li-mi për të nënshkruar kapitullimin e vendit (mund të nxi-rren si terma më vete: kapitullim, nda-lo-het, në-n--shkruaj një pjesë nga të cilat mungojnë në fjalor si: ndalim ←ndalohet, nënshkruaj, vend.

Me vlerë të veçantë praktike, si në punën për përpunimin e terminologjisë të së drejtës, ashtu

Paraqitja e këtyre tre pjesëve si fjalorthësh ka edhe vlerë teorike, meqë ndërtimi i tyre bëhet mbi bazën e disa koncepteve më të gjera rreth termit, të cilat shërbejnë edhe si parime e kritere për mënyrën e hartimit të Fjalorthit Mo-del, që kemi shënuar me III. Përveç kësaj, duhet shtuar se në të gjithë Fjalorthat, përbri çdo njësie, do të jepet në formë të koduar Fjalori nga është nxjerrë termi, i përfaqësuar nga mbie-mri i autorit (autorit të parë) të Fjalorit, i dhënë në mënyrë të shkurtuar me dy shkronjat e para të mbiemrit si (Do) (Lirak Dodbiba, Fj. 1986), (Le) (Ferdinand Leka, Fj.1970), (Uk ) (Njazi Uka, Fj.2012), kurse me kodin She (Eda Shehu, autore e kumtesës, sipas konceptimit të të cilit bëhet përfshirja në



Fjalorthin Model III të njërive që dalin si terma në pjesë të tjera të ligjeratës (folje, mbiemra, ndajfolje), kur lidhen në sistem fjalëformues (termformues) me termat e pasqyruar në Fjalorthat, si edhe kur shprehin specifikën e fushës, si krahas administrim (Do) edhe si plotësues administroj (She) – administrues-i (She) – administrativisht (She.)

Para se të flasim për kriteret e ndërtimit të Fjalorthit Model III dhe kushtet e kalimit të Fjalorthave I dhe II tek Fjalorthi Model III, do të bëjmë një vlerësim të secilit prej tyre sipas koncepteve të mbajtura për hartimin e tyre vështruar nga pikëpamja e identitetit të termave në një fjalor terminologjik të fushës.

#### FJALORTHI I

(NGA FJALORI I SË DREJTËS VITI 1986 (Do) DHE FJALORI I SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE (Le))

-A -

1. abstenim (Do) 2. adaptim (përshtatje) (Do) 2.1 aderim (Le) 3. administratë (Do) 4. administrativ (Do) 5. administrator (Do) 6. administrim (Do) 7. adoptim (birësim) (Do) 8. adoptues (birësues) (Do) 8.1. aeroport ndër-ko-m-bëtar (Le) 9. afat (Do) (+ 25 tf.) 9.1. afrim (Le) 10. i/e aftë (1) (Do) 11. aftësi (Do) (+ 2 tf.) 11.1. agre-ment (Le) 12. agresion (Do) 12.1. agresor (Le) 13. agjenc (Do) 14. agjent (Do) (+ 3 tf.) 15. agitacion (Do) 15.1. ajranije (Le) 16. Akademi (Do) 17. akaparim (Do) 18. akaparues (Do) 19. akreditoj (Do) 19.1. aksedim (Le) 20. aksident (Do) (+ 2 tf.) 21. aksionar (Do) 22. akt (Do) (+ 8 tf.) 23. aktakuzë (Do) 24. aktiv (Do) 25. activist (Do) 26. aluvion (Le)

Dy fjalorët e parë të fushës (1986 dhe 1970) të përfshirë në Fjalorthin e I pasqyrojnë gjendjen e terminologjisë të fushës përkatëse të një periudhe të dhënë (deri 1970) dhe vlera e tyre lidhet me shërbimin që i kanë bërë përdoruesve të tyre gjatë kësaj kohe. Ata janë hartuar sipas parimeve dhe kriterëve shkencore të caktuara në përputhje me konceptimin e hartimit të të gjithë fjalorëve të serisë terminologjike dhe kanë dhënë ndihmesë të vyer për sistemimin, një-simin dhe shqipërimin e terminologjisë të fu-shës në fjalë. Megjithatë aty ka terma që nuk li-dhen dre-jtpërdrejt me fushën e dhënë dhe u

pë-r-kasin fushave të tjera dhe si të tillë nuk do të pa-s-qy-ro-hen në Falorthin Model III. Nga ana tje-tër, në ta nuk përmbahen një varg njësisish që da-lin në pje-së të tjera të ligjeratës, por që lidhen në sistem fja--lëformimi (termformues) me ter-mat e dhënë në Fjalorë, prandaj ata do të gjejnë vend në Fja-lo--rthin Model III. Kështu që në këto dy raste do të zbatohet kriteri i heqjes së disa te-r-mave që s'ja-në të fushës (ankand, arkë), por do të shto-hen në Fjalorthin Model III disa terma që dalin në pjesë të tjera të ligjëratis (abstenoj, akuzoj).

NGA FJALORI I DREJTËSISË (NJAZI UKA (UK), 2012) + Fj.1986 (Do) + Fj. 1970 (Le)) - A-

1. AAA (Uk) 2. ABA (Uk) 3. "a fortiort" (Uk); 4. "a non dominio" (Uk) 5. "a priori" (Uk) 6. "ab initio" (Uk) 7. "ab intestat" (Uk) 8. "abandon" (Uk) 9. abandonim (Uk) 10. abdikim (Uk) 11. abduksion (Uk) 12. abort (Uk) 13. abrogim (Uk) 14. absolut-i (Uk); 15. absolutizëm (Uk) 16. Abs-te-nim (Uk) (Do + Le) 17. abstenoj (Uk) 18. Absti-ne-ncë (zverdhje) (Uk); 19. abstraksion (Uk) 20. absurd-i (Uk) 21. abuzim (Uk) 22. abuzoj (Uk) 23. acensus (Uk) 24. "acquis communautaire" (Uk) 25. "accessorium se quitur principale2 (Uk) 26. "actor sequitur forum rei" (Uk) 27. "ad hoc" (Uk) 28. "ad interim" (Uk) 29. "ad litem" (Uk) 30. "ad litteram" (Uk); 31. "ad probatiem" (Uk) 32. "ad referendum" (Uk); 33. "ad substantiam" (Uk).

Përsa i përket Fjalorthit II (Nj. Uka, 2012), ai përbën një vepër leksikografike, të hartuar nga një specialist i përgatitur me kompetencë të lartë njohëse për fushën përkatëse. Si veçori më të spikatur të këtij Fjalori do të përmendnim pasurinë e madhe në terma (rreth 20.000 njësi , terma fjalë e togfjalësha), të cilët përfaqësojnë terminologjinë e fushës, por edhe një varg fushash të tjera që lidhen me fushën e dre-j-të-sisë, si ekonominë, politikën, mjekësinë etj. deri edhe historinë. Aty përfshihen një varg latini-z-mash, emërtime personash historikë, du-ku-rish his-to-ri-ke nga fusha juridike e fusha të tje-ra. Duke u nisur nga kriteri të cilit i jemi për-m-ba-j-tur në punim, gjatë pasqyrimin të një-sive të këtij Fjalori si terma në Fjalorthin

Model III janë he–qur një pjesë njësisish që nuk mund të cilë–so–hen realisht si terma të fushës, si edhe janë shtuar di–sa njësi që dalin si terma të fushës, si edhe janë shtuar disa njësi që dalin si terma në pjesë të tjera të ligjeratës të lidhur në sistem si term–fo–rmues me termat e pasqyruar në Fjalor (II).

Më poshtë po paraqesim disa kategori njësisish nga Fjalori II që nuk pasqyrohen në Fja–lo–r–thin Model III dhe pjesa tjetër që shtohet. Kë–shtu do të hiqen:

- Emra personash historikë: Aristoteli, Mark Antoni
- Disa terma (shprehje) latine që s’lidhen me fushën: a priori, ad hoc.
- Terma që s’lidhen drejtpërdrejt me fushën: afekt, afazi, asfiksi.
- Do të shtohen disa njësi që lidhen në sistem fjalëformues (termformues) me termat e pasqyruar në Fjalor (II) dhe që shprehin spe–ci–fi–kën e fushës: abrogjoj, abrogues, administroj.

#### FJALORTH MODEL

- A-

1. AAA (UK) (American Arbitration Association)
2. ABA (UK) (American Bar Association) 4. “a non dominio” (UK) 6. “ab initio” (UK) 7. “ab intestat” (UK) 8. abandon (UK) 9. abandonim (UK) 9.1 abandonoj (She) 10. abdikim (UK) 10.1 abdikoj (She) 10.2 abdikues (She) 12. abort (UK) 13. abrogim (UK) (shfuqizim) (She) 13.1 abrogjoj (shfuqizoj)(She) 13.2 abrogues (shfuqizues) (She) 16. abstenim (Do. Le. UK) 17. Abstenoj; 17.1 abstenues (She) 18. abstenencë (UK) 20. absurd (UK) 21. abuzim (UK) (keqpër–do–rim) (She); 22. abuzoj (UK) (keqpërdorj) (She); 22.1 abuzues (keqpër–do–rues) (She).

- Në Fjalorthin Model III, sikurse dhe në Fjalorët e tjerë (I, II), jepen vetëm termat fjalë, kurse për termat togfjalësh që lidhen me termat fjalë do të jepen sasia e tyre numerike e shënuar me numra (duke paraqitur në kllapa me sasinë numerike përkatëse, si, psh., (+ 2), (+ 5) etj.)

Së fundi duhet nënvizuar se secili term ka barazvlerësin në gjuhë të huaj si edhe treguesin përkatës me barazvlerësit në gjuhën shqipe, të dhënë me numër referues në këtë gjuhë, i cili

figuron në pjesën bazë shqip–rusisht të Fjalorthit III.

#### FJALORTH MODEL

shqip – rusisht

- A-

8. abandon (UK); 8. абандон 9. abandonim (UK); 9. Отказ; 9.1 abandonoj (She); 9.1 отказать; 10. abdikim (UK); 10. отречение 10.1 abdikoj (She) 10.1 отречься; 10.2 abdi–kues(She); 10.2 отрекающийся 12. abort (UK) 12. аборт 13. abrogim (UK) (shfuqizim) (She); 13. отмена 13.1 abrogjoj (shfuqizoj)(She) 13,1 аннулировать (отменять); 13.2 abrogues (shfu–qi–zues) (She) 13.2 отменяющий 16. abstenim (Do. Le. UK) 16. Воздержание; 17. Abstenoj; 17. Воздержатъ; 17.1 abstenues (She); 17.1 воздерживающий; 18. abstenencë (UK); 18. Абсти–не–н–ция; 20. absurd (UK); 20. Абсурдный; 21. abuzim (UK); (keqpërdorim) (She); 21. Злоупо–т–ре–б–ле–ние; 22. abuzoj (UK) (keqpërdorj) (She); 22. злоупотреблять .

#### KONKLUZIONE

Duhet nënvizuar se para se të hartohet një Fjalor i përmirësuar i së drejtës në shqipe, është i domosdoshëm të merret parasysh përvoja e kaluar e hartimit të fjalorëve të derisotëm të kësaj fushe. Hartimi këtij fjalori duhet të mbështetet në një këndvështrim më të gjerë mbi termin si përfaqësues i tij, ku duhet të mbizotërojë kriteri gjuhësoro–konceptor, duke përfshirë në të jo vetëm termat emra dhe togfjalësha me bazë emërore, por edhe një pjesë termash emrash, foljesh, mbiemrash, ndajfoljesh(administratë–administroj–administrativ–administrativisht), por edhe duke përjashtuar një varg termash që nuk lidhen me fushën. Fjalori duhet të mbështetet edhe mbi përvojën e punës së kryer nga Drejtoria e Përkthimit në Ministrinë e Integritit, e cila jep ndihmë të çmuar në këtë drejtim

#### BIBLOGRAFIA

DURO Agron, (2009), Termi dhe fjala në gjuhën shqipe, Tiranë.

LAFE Emil, (2001), "Fillimet e formimit të terminologjisë juridike në gjuhën shqipe", Perla, Tiranë.

LEKA Ferdinand, etj, (1970), "Fjalor i termave të së drejtës ndërkombëtare", Tiranë.

DODBIBA Lekë, etj, (1986), "Fjalor i termave të së drejtës", (shqip-frengjisht-rusisht), Seria (24), Tiranë.

UKA Njazi,(2012),"Fjalor i drejtësisë", Tiranë.

KALO Paskal, 2002, "Fjalor terminologjik për drejtësinë" (shqip-anglisht, anglisht-shqip), Tiranë.

PROKO Vilma, etj., (2009), "Bibliografi e terminologjisë" në përmbledhjen "GJENDJA DHE ZHVILLIMI I TERMINOLOGJISË SHQIPE", Tiranë.

АЛЕКСЕЕВНА, Вербичка Людмила, (2005), "Давайте говорить правильно"(Юридическая терминология современной России), (Санкт-Петербург)

---

## SHTRESËZIMI KULTUROR MUZIKOR BIZANTIN NË SHQIPËRI BYZANTINE MUSICAL CULTURAL STRATIFICATION IN ALBANIA

EDMOND BUHARAJA  
Departamenti KMDP, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri  
Email: e.buharaja@libero.it

### Përmbledhje

Shtresëzimi kulturor bizantin duhet të jetë përhapur në territorin e Shqipërisë së sotme — për të mos thënë që ky territor, ndonëse në periferi të atij qytetërimi, ishte gjithsesi pjesë qytetërim-formuese e Bizantit — që në fillimet e tij më të hershme, pra duke filluar nga viti 330 kur u themelua Konstantinopoja e duke vijuar edhe pas rënies së saj më 1453. Pranohet paqësisht se i ashtuquajtimi ‘qytetërim bizantin’, nga ana e tij, ishte i formuar nga shumë shtresëzime kulturore që më pas morën një formë më të spikatur e më origjinale duke u përmbledhur në një tërësi më të gjerë e më të rëndësishme. Pranohet, gjithashtu origjina e përbërë që gjurmohet nga prodhimi artistik dhe teknik i kohës klasike dhe i muzikës hebraike, nga *canto piano* e fillimeve të kulturës latine, nga dialektologjia e përbashkët në Lindje dhe në Perëndim e muzikës pastërtisht vokale dhe eksklusivisht monodike. Gjithsesi, duke lënë mënjanë pohimet polikrone më tepër se sa duhet entuziaste, me aq sa kemi në dispozicion, tekstet janë të vetmet që e lidhin këtë muzikë me disa liturgji lindore. Kështu dokumentimi më i hershëm na bën të mendojmë se fillimisht këndimi ishte në stil silabik ose pothuajse i tillë, e mban gjurmët recitative *para-oktōēchos*. Shtrirja e manastirizmit duke filluar nga Palestina për të arritur në Konstantinopojë e më gjerë, çoi në krijimin e koreve secili me drejtuesin e tij — *protopsáltes*, për korin djathtas dhe *lampadários*, për atë majtas — si dhe të solistave — *domestikos* ose *kano-narch* — duke marrë një zhvillim më të plotë muzikor.

**Fjalët çelës:** muzika, bizantine, qytetërim, Konstantinopojë, ekfonetike, semiografia.

### Abstract

Byzantine cultural stratification should have spread on the territory of modern Albania — not to mention that this territory, although on the outskirts of that civilization, was certainly a part of the Byzantine civilization forming—ever since his earliest initiation, thus starting from 330 A.D. when Constantinople was founded and continuing even after its collapse in 1453. Peacefully accepted that the so-called ‘Byzantine civilization’, in turn, was formed from many cultural layers, later took a more prominent and original form, being summarized in a broader and more important set. It is also accepted that these composite origins can be traced from the artistic and technical production of the classic era to Jewish music and from plainchant of Latin culture beginnings to common dialectology in the East and West of purely vocal and exclusively monodic music. In any case, leaving aside the more than enthusiastic polychrome claim, to the extent of documentation that is available to us, the texts are the only record that connects this music with eastern liturgy. So the earlier documentation makes us think that singing was originally in syllabic style or almost so, and includes traces of pre-*oktōēchos* recitative. The monastic extension ranging from Palestine to Constantinople and far beyond, led to the creation of choirs with their leaders - *protopsáltes* for the right choir and *lampadários* for the left one - and soloists - *domestikos* or *kanonarch* - thus taking a fuller musical development.

**Key words:** music, Byzantine, civilisation, Constantinople, ekphonetic, semiography.

---

### 0.0 Faza para-bizantine

Nuk ka mbetje muzikore që të na flasë për një fazë të tillë edhe pse është e hamendsueshme

ekzistenca e një ‘veshje’ muzikore për shërbesat e kultit. Gjithsesi hasen gjurmët e kësaj periudhe në dorëshkrimet e mëvonshme që na

mundësojnë të hedhim ndonjë ide, sesi mund të ketë qenë muzika e kultit në këtë fazë prehistorike të muzikës, ndonjëse është e qartë se synimi nuk do të jetë arritja e saktësisë dhe besueshmërisë, por më së shumti inferenca e ndonjë gjurme të modeleve kryefillëse që mund të nxirret nga burimet më të hershme të notëzuara.

Besohet se në këtë fazë duhet të ketë patur një pjesëmarrje masive në ceremonitë liturgjike, posaçërisht në thënien me zë të lartë të himneve, psalmeve ose përgjigjeve, aq sa termat *chorós*, *koinonia* dhe *ecclesia* përdorshin si sinonime. Hebrejtë përdornin termin *machol* (valle ose festim në grup), i cili u përkua në greqisht me atë *chorós*. Kuptohet se termi fliste për një veprimtari në grup, këndim në kor drejtuar qiellit dhe tokës e ndoshta *chorós* mund të jetë përkuesi i termit *kléros*.

Periudha e parë duhet të jetë zhvilluar sipas cerimonive hebraike, deduktiv ky i faktit se ka në një masë të madhe një vazhdimësi midis veprës së kultit të hebrenjve dhe asaj të bashkësive kristiane. Zhvillimet muzikore kristiane janë mbështetur në Lindjen helenistike, më konkretisht në teorinë dhe praktikën e judaizmit të helenizuar. Dihet se këndues me origjinë hebraike shpesh emëroheshin si mësues për bashkësitë kristiane, për mësimin e këndimit të psalmodive përmes transmetimit gojor.

Në *Dhiatën e Re* nuk ka shumë të dhëna rreth këndimit liturgjik e kjo gjendje ndjehet edhe në dokumentacionet deri aty nga shek. III e. j., ku flitet për lutjet, por jo për mënyrën e këndimit të tyre.

Të gjithë studiuesit pajtohen në faktin se muzika bizantine ishte monofonike, e ndërtuar mbi një melodi të vetme. Përkundër sa mendohet, vetëm shekuj më pas do të hasim në këtë liturgji përdorimin e *ison-it*<sup>xxxiii</sup> thjesht si praktikë ekzekutive, por jo kompozitive. Melodia e shoqëruar me *ison* që pasuronte dhe fuqizonte këndimin me një ton solemniteti, është huazim i vonë i teknikave vokale shekullare. Nuk mund të mos arsyetohet fakti se një teknikë e tillë ku, në mungesë të një instrumenti, i cili do të mundësonte mosndryshimin e *echos* së zërit, detyrohet përdorimi i një tingulli të mbajtur në formë pedali nga një ose më shumë persona, përgjithësisht në

notën më të ulët të këndimit, është i përdorur në të ashtuquajturën 'iso-polifonia' ende aktive në Shqipëri. Vështirë të besohet që kjo mënyrë të jetë huazuar nga riti liturgjik në një kohë kur teksti laik i polifonisë nuk ka asnjë ndikim në përmbajtjen e tij nga teologjia. Veç kësaj në isopolifoninë toske kemi shembuj këndimi në këtë stil edhe nga gratë, fakt që është absolutisht i pamundur të haset në liturgjinë kristiane, gjë që na bën të mendojmë se *ison-i* të jetë një teknikë parakristiane, me burim gjithsesi nga kultura laike e etiketuar që në kohën e hershme si "pagane". Pranimi i stileve rajonale të këndimit është një realitet i njohur në shërbesën e kultit, e kjo ka rrjedhur edhe dallimet midis liturgjive të kishave kristiane.

Sidoqoftë, rezultati i këtij këndimi ishte principi që gjithçka të dilte nga një gojë e vetme, gjë që e hasim në përshkrimin e Chrysostomo-s: «Në të vërtetë duhet të ketë gjithnjë vetëm një zë në kishë, sikur të ishte një trup i vetëm. Kështu lexuesi vetëm flet dhe vetë prifti kënaqet të rrijë ulur në heshtje; e kënduesi vetëm këndon. Edhe pse gjithçka përgjigjet, tingulli përhapet si [të ishte] prej një goje [të vetme]» (MIGNE 1856 – 7: 14/33).

### 1.0 Kryefillet e muzikës bizantine

Kuptohet se një kulturë, sado origjinale qoftë, nuk mund të krijohet në një boshllëk kulturor. Ajo është shfaqje mbresëlënëse e një ngrehine që arrin të përmbledhë në vetvete ambiente kulturore të cilave ndoshta iu injorohet apo nuk arrihet t'u dokumentohet prania, por që janë përbërës të cilët mund të individualizohen vetëm përmes një shqyrtimi analitik.

Prania e një psalmodie të hershme egjiptiane dhe e bashkësive të shkretëtirave palestineze, e kënduar nga një solist që i shqipton vargjet me ngadalë dhe me zë të fortë, është mjaft e dukshme në psalmet bizantine. Vërtet gjithçka shfaqet nën petkun e meditimit apo të shërbesës, por ceremonia liturgjike ishte e ndërtuar gjithsesi në formën e një 'spektakli', ku kishte një rend të caktuar e një ritmikë interpretuese të tekstit të alternuar me përvijime melodike të përshtatura me situatën, me momentin, me ditën, madje

edhe me orën. Specifikimi i saktë i ndërthurjes së materialit muzikor, në fund të fundit, përbënte kontekstin apo referimin jashtëmuzikor të tij, domethënë vlerën semantike të imazhit muzikor, e është kjo vlerë që do të përkufizojë tiparet dalluese midis muzikës së kultit dhe asaj laike. Domethënia semantike e faktit tingëllor është argumenti kryesor që do të përcaktojë “fatin” e një krijimi muzikor, estetikë apo estezikë kjo që do të vijojë edhe në shekujt e mëpasshëm deri në ditët tona.

Këndimi i periudhës kristiane do t’i largohet ikonizimit muzikor të bedunit vetmitar të shkretëtirave në Lindjen e Afërme, domethënë: portretizimit muzikor përmes një solisti të vetmuar që ia shpalos këngën e tij një hapësire të pamasë e të shurdhër. Liturgjia kristiane shndërrohet gradualisht në ikonë muzikore e një bashkësie të përmbledhur rreth një besimi unik — domethënë e një solisti i cili këndon në mënyrë *responsoriale* ose *antifonale* me grupin që e rrethon. Kjo prurje muzikore nuk do të humbasë edhe pas skizmës apo përplasjeve të herëpashershme që dy qendrat e Krishtëritimit (Roma dhe Konstandinopoja) realizojnë përgjatë shekujve (SAVAS 1965: 80–105).

Në shek. IV, si rezultat i rindërtimit të Konstandinopojës e të përmasave imponuese që mori ceremonia imperiale dhe solemniteti liturgjik në katedralet e reja, të mëdha e të stërmëdha, ku muzika lartësohej prej akustikës në zëra të mrekullueshëm, monodia dhe polifonia, e kuptuar kjo e fundit si “lineare”, pra si kontrast *refren-strofë*, *soggetto-controsoggetto*, vijuan të ekzistonin, duke shmangur apo shkrirë progresivisht dhe vendosmërisht kontekstin pagan ose laik në një ligjëratë e në një pozicionim të ri kulturor, të destinuar të marrë përmasat e një shprehje perandorake. Manastiret do të ktheheshin në qendra studimi dhe prodhimi të ideologjisë së re muzikore, e cila për t’u përhapur kërkonte shkrimin dhe riprodhimin muzikor.

Si reagim ndaj kësaj hegjemonie kulturore do të shfaqen në shek. IV dhe V e. j. “herezira” muzikore me risi kompozitive, të cilat do të jenë aq të sukseshme, sa të detyrojnë himnografinë ortodokse t’i pranojë në gjirin e saj.

Duhet nënvizuar fakti se duke filluar nga shek. IV e. j. muzika do të bëhej një element i domosdoshëm i liturgjisë, qoftë i asaj ortodokse, e qoftë i asaj katolike, e cila nënvizon konceptin themelor në *koinonia* ose në *communio*, institucione aq jetësore në Kishën e hershme. Gjithkush i pranishëm duhet të ishte bashkëpjesëmarrës në këndim, duke iu përgjigjur zërit të celebruesit me shpirt e me tingull.

A është kjo fillesa e polifonisë?! Ndoshta është ky momenti, kur solisti fillon të humbasë progresivisht rëndësinë e tij në favor të shumëzërësit, por duhet thënë gjithsesi se solisti-subjekt nuk do të mungojë, edhe pse funksioni i tij do të ripërmasohet në rolin e drejtuesit dhe *souffleur*-it të tufës (së besnikëve) gjithnjë e më larg rolit të improvizuesit apo të risuesit. Kështu u ideuan dhe u zhvilluan dy tipat e këndimit: *responsoriali* (recitues) dhe *antifonali*. I pari realizohet nga një solist që këndon *response*-n e tij, zakonisht varg i zgjedhur nga një psalm, duke dhënë njëkohësisht lartësinë e tingullit edhe për korin që përsërit po atë *response* dhe vijon, si në traditën gojore, në pasurimin e teksit me vargje të reja, duke mbajtur megjithatë të pandryshuar ose me pak ndryshime përvijimin melodik. Me krijimin e koreve të specializuara kjo praktikë do të shkojë drejt hiçëzimit.

### 1.1 Faza ekfonetike<sup>xxxiv</sup>

Librat me përmbajtje liturgjiko-muzikore bizantine edhe në nivel botëror nuk janë bërë ende një objekt studimesh të përgjithshme (HANNICK 1990: 84) dhe vetëm kohët e fundit (KUJUMDŽIEVA 1992) janë përcaktuar disa principe të një metodologjie sistematike për karakterizimin e trashëgimisë bizantine deri në shek. XVII, të cilët mund të përmblydhën: (i) tipologjia e dorëshkrimit në bazë të përmbajtjes, (ii) tipi i notëzimit sipas sistemit notëzues (niveli i zhvillimit dhe tiparet ortografike), (iii) veçanësia e tekstit, (iv) atribuimi lidhur me: autorët, shkruarit, kopistët dhe ekzekutuesit, (v) praktikat lokale dhe/ose rajonale, etj.

Shkrimi muzikor mendohet të jetë shumë i lashtë, madje «ekzistojnë tregues të një notëzimi babilonas<sup>xxxv</sup> dhe supozime mbi shkrime të mun-

dshme egjiptiane dhe kreteze, por i pari sistem notëzimi i vërtetë dhe i mirëfilltë është ai grek» (L'UNIVERSALE 2005: 604). Megjithatë do theksuar se ka mjaft zëra që mendojnë të mos ketë pasur grafi, për të kujtuar apo fiksuar muzikën deri para shek. IX duke marrë si argument se Shën Isidore i Seviles (ISIDORE I SEVILLE 2006) në shek. VII qahej, se tingujt muzikorë humbisnin dhe nuk kishte mënyrë për t'i shkruar. Edhe dorëshkrimet e këngëve bizantine datohen nga shek. IX, ndërsa *Beratinus 1*, i cili përmban disa shenja ekfonetike duhet të jetë i mesit të shek të VI (apo edhe disa dekada më herët), e këtu lindin disa probleme të cilat dalin jashtë doktrinës, por që nuk janë objekt i këtij shkrimi.

Në AQSH numri i kodikëve që përmbajnë edhe shenja grafike ekfonetike është nëntë<sup>xxxvi</sup>, duke dokumentuar kështu një prani të hershme të këtij sistemi edhe në Shqipëri që përfshin një hark kohor midis shekk. VI–XIV.

Nisur nga repertori i mbijetuar dhe mekanizmi që drejton funksionimin e sistemit, notëzimi muzikor grek dallon dy faza: *instrumentale* dhe *vokale*. Në të parën përdorehin shenja e pjesërisht edhe gërma të një alfabeti arkaik (të vendosura drejt, të përmbysura dhe horizontale), ndërsa në fazën e dytë të mëvonshme nuk përdoren më dallimet e pozicionit, por gërma të alfabetit ionik për çdo tingull dhe simbole të tjera konvencionale për kohëgjatjen e tyre<sup>xxxvii</sup>.

Në fazën më të hershme kemi shenjat prozodike të deklamimit me synim qartësimin e theksave, kohëve të shkurtëra dhe të gjata apo mënyrave të përgjithshme të shprehjes. Më pas u kalua në simbolet ekfonetike të cilat ishin shenja të vogla të vendosura në çifte (në fillim e në fund të një numri të caktuar fjalësh) për të treguar përvijime të frazimit, ngritje dhe zbritje të kufizuara të zërit etj. Notëzimi ekfonetik përmban pra një sistem shenjash të afta për të kujtuar dhe shënuar formula të njohura, për t'iu zbatuar këndimeve 'me zë të lartë' të *Shkrimeve të Shenjta* në mjedisin liturgjik. Duhet nënvizuar gjithsesi se një rindërtim tërësor dhe i saktë i linjës melodike është i pamundur, e është këtu që nga pikpamja doktrimore gjejmë një çarje të mendimit të nyjëtuar në termat nëse (i) shkrimi ekfonetik

duhet pranuar thjesht si element i prozodisë që përmirëson aktin e interpretimit verbal gojor e që saktëson segmentimin formal sintaksor të shkrimit apo (ii) si kryefill për një notëzim muzikor, me synimin e interpretimit dhe dokumentimit të faktit tingëllor.

Ajo që tipizon të kënduarin e transmetuar përmes shenjave ekfonetike, është të bazuarit e këndimit kryesisht në një tingull unik e vetëm në disa momente modulohet zëri mbi tinguj të tjerë të afërt, për të mbështetur shprehshmërinë semantike të disa termave (fjalëve) që në substancën tekstuale mbartin një vlerë të posaçme psikologjike. Ia vlen të kujtojmë se në gjuhën shqipe termi 'këndim' vijon të përdoret si i barsvlershëm me atë 'lexim' (FSHS 1984: 513). Por, nëse leksiku i shqipes ruan ende ekot e *recitar cantando-s* së hamendësuar të tragjedive të periudhës helene, madje të një faze ndoshta edhe më të hershme, duhet theksuar se mendimi teorik i kohës në kulturën muzikore bizantine, sikurse edhe në atë kristiane në përgjithësi, dominohej nga idea e thjeshtëzimit të skajshëm të shprehjes së gjuhëshmërisë së tingujve, për të mos korruptuar kuptueshmërinë e mesazhit, gjë që na bën të arsyetojmë edhe kufizimin e këndimit mbi një tingull kryesisht në frekuenca të ulta, mjaft pranë të folurit.

Disa shenja të quajtura *somata* (*trupa*) i referoheshin lëvizjeve graduale në ngjitje ose në zbritje, ndërsa *pneumata* (*shpirtra*) shënonte kërcimin intervalor. Disa përmbanin vlera dinamike dhe në shoqërim me *pneumata-t*, humbisnin vlerën e lëvizjes për të shënuar thekse ose nuanca. Gjithsesi përdorimi i shenjave grafike veç anës pozitive (domethënë atë të transmetimit të saktë të *canto piano-s*), ka edhe anën negative (atë të frenimit të procesit krijues), pasi meloditë, duke u fiksuar një herë e përgjithmonë filluan t'i largoheshin përherë e më shumë interpretimit krijues e risues. Përpara përdorimit të grafive muzikore kishte një farë lirie improvizuese e cila shfaqej përmes spontanitetit të kënduesve. Notëzimi e kufizoi këtë liri interpretuese, duke "ngjirë" procesin e risimit që përcjellja gojore siguron, por, nga ana tjetër, i fuqizoi mundësitë e kompozitorëve për eksperimente artistike, për

shqyrtime analitike e krahasimore. Gjithsesi, tradita e anonimatit do të vijojë për një kohë të gjatë duke ndërtuar praktika krijuese të cilat dalëngadalë do të përfshinin të tëra individualitetet nën një emërtesë të vetme: muzika bizantine. Nuk jemi ende në konceptin modern të termit *kompozim*, domethënë, të vendosurit e gjërave së bashku, por kemi më shumë praktika përshtatëse, aranxhuese, rregulluese dhe stilizuese të një fondi copëzash dhe frazash të vjetra melodike që ishin në pronësi të memories kolektive. ‘Melodia e re’ ishte më shumë përsosje e një ekzistueseje, e cila vinte nga një kohë që nuk i kujtohej më kryefilli dhe as që mund t’i hamendësohej edhe përkatësia etnike.

Duhet theksuar se në krejt trashëgiminë bizantine nuk ka mbijetuar ndonjë *doracak* (gjithnjë nëse ka ekzistuar ndonjëherë) që të parashtrojë rregulla kompozimi, por ka mjaft traktate teorike ende ekzistuese të cilat fokusojnë me detaje sistemin unik të notëzimit bizantin dhe ndërlikohet e tij me modet kishtarë (CONOMOS 1985; HANNICK dhe WOLFRAM 1985 dhe 1997; SCHARTAU 1998 dhe 1990; BENTAS 1971).

Praktika e përgjithshme dallon tre tipa leximesh në traditën antike:

- i. *Prophetologion*, domethënë libri i Profecive që përmbante lexime të *Dhiatës së Vjetër*;
- ii. *Apostolos*, përmbledhje e perikopëve nga *Aktet e Apostujve*, të letrave të Shën Palit dhe të apostujve kristianë gjatë liturgjisë;
- iii. *Evangelion*, libri i proklamimit liturgjik të Ungjillit.

**Codex Graecus Purpureus Beratinus**  $\Phi$  i përket tipit së dytë, pra *Akteve të Apostujve* dhe është datuar sipas Scrivener<sup>xxxviii</sup> në kapërcyell të shek. v dhe vi, ose sipas Aland-it i mesit të shek. vi, më saktë i vitit 550 e. r. Në kategorizimin e dorëshkrimeve të *Dhiatës së Re* duket se i përket Kategorisë V<sup>xxxix</sup>, ku futen dorëshkrime të tipit tekstual bizantin ose kryesisht bizantin. Nga katër kodikët e këtij grupi *Beratinus* mbahet si më i veçanti. Ai përmban një kopje të *Ungjillit sipas Mateut* dhe *Ungjillit sipas Markos* (ky i fundit me disa mungesa), por, duke u nisur nga miniatura e parë që përmban simbolet e katër evangjelistëve

dhe posaçërisht nga prania e të ashtuquajturave *bashkëndime eusebiane*<sup>xi</sup>, supozohet se fillimisht duhej të përfshinte të katërt *ungjijtë* kanonikë, kështu që duhej të numëronte rreth 400 fletë. Kodiku në fjalë bën pjesë në dorëshkrimet ‘ociali purpurei’<sup>xii</sup> i shkruar në flori dhe në argjent në gjuhën greke dhe përbëhet nga 190 fletë pergameni (31x27 cm).

## 1.2 Faza semiografike e organizuar

Neumat<sup>xiii</sup> mesjetare do të rrjedhin nga simbolet ekfonetike të cilat, nga shek. VIII deri XIV shkojnë drejt një përdim gradual e të pandalshëm, e vërtetuar kjo nga numri gjithnjë e më i vogël i kodikëve që i përmbajnë e, sidomos, nga përdorimi i shenjave përherë e më të çlira nga rregullat, gjë që rrjedhuan humbjen e principeve të sistemit, duke i shndërruar shenjat ekfonetike pothuajse në elemente zburuese<sup>xliii</sup>.

Procesi neumatik është përvijuar në tri faza (HØEG 1935):

- i. sistemi arkaik<sup>xliv</sup> — deri në shek. IX–X,
- ii. sistemi klasik — përfshin shek. XI–XII,
- iii. sistemi i degjeneruar — shek. XIII–XIV.

Është e qartë se veç *Kodikëve* të sipërpërmendur duhet të kenë ekzistuar në Shqipëri edhe materiale të tjera, të cilat do t’u përgjigjeshin kërkesave të rritit ortodoks. Fakti se shqiptarët e Italisë, institucioni i të cilëve quhet «Kisha Greke e Shqiptarëve», ndonëse të konvertuar në katolikë, ruajnë ende ritin bizantin të shërbesës, flet se përpara largimit nga Ballkani perëndimor, tradita e kësaj liturgjie ka qenë shumë e rrënjësuar. Pra, në Shqipëri, së paku deri në shek. XV, duhet të ketë ekzistuar struktura e plotë muzikore që u përgjigjej tre cikleve liturgjike: ciklit të Pashkës (me datë të lëvizshme), ciklit të festave (me datë të caktuar) dhe atij javor. Kështu duhet të kemi patur:

– *Októechos*<sup>xlv</sup>, cikël 56-ditor i nyjtuar në 8 seksione njëjavore. Secilës ndarje i përgjigjej një nga tetë modet muzikore (*ēchoi*) që hamendësohet të kenë shërbyer, duke filluar nga shek. VIII, si elemente strukturuese të kësaj shërbese të ndarë në: *e vogël*, domethënë vetëm për të dielat, e kjo ishte në fazën e parë dhe *e madhe* (*parakleitike*), domethënë edhe për ditët e tjera të javës, fazë e



shtuar më pas, duke e kompletuar kështu ciklin e plotë.

– *Triodion* — liturgjia e periudhës para dhe gjatë kreshmës deri tek e Shtuna e Shenjtë dhe *Pentekostarion* — liturgjia e Javës së Shenjtë.

– *Menaia* e nyjëtuar në 12 vëllime, ku përfshihen përkujtimet e shenjtoreve, si dhe festat e kalendarit bizantin nga 1 shtator deri më 31 gusht.

Tekstet e ruajtura të kësaj liturgjie, të pajisur me notëzime muzikore, tashmë jo më ekfonetike, por me semiografi tipike muzikore, fillojnë me *Tropologion*, i cili mbahet si më i hershmi, për të vijuar me *Sticherarion*, *Hermologion*, *Asmatikon*<sup>xlvi</sup>, *Psaltikon*.

Semiografia muzikore bizantine u zhvillua në dy faza: *paleobizantine* (përafërsisht deri në 1175) dhe *medio bizantine* (pas 1177<sup>xlvii</sup> deri në fund të shek. XIII).

Në *fazën e parë* neumat ishin të pakta dhe kishin funksion *mnemonik* (*kujtues*), prandaj quheshin edhe *kironomike* (*gjestuale*), sepse ikonizonin në formë grafike lëvizjet e duarve të mjeshtrit të korit. Ato duhej të ndihmonin në përcjelljen gojore për të sqaruar një farë strukture embrionale të disa formulave melodike në përdorim e të njohura nga të gjithë<sup>xlviii</sup>. Neumat nuk vendoseshin rregullisht mbi të gjitha rrokjet e hasen shembuj, ku ato shtohen edhe midis rreshtave të tekstit. Përdoreshin gjithashtu edhe neuma pa tingull të cilat shërbenin thjesht për të treguar zburime dhe formacione melodike që ndaheshin në shenja moduluere dhe formula intonacioni. Secila zgjedhje e shenjave të nevojshme dhe e kombinimeve të përshtatshme të tyre quhej *formula* (*ῥέσις*) e këto ishin «kombinime tingush që përbënin melodinë. Sikurse kombinimi i njëzetekatër gërmave të alfabetit krijon fjalë, kur aranzhohen në rrokje, në të njëjtën mënyrë shenjat muzikore krijojnë melodi, kur kombinohen me art e një kombinim i tillë quhet kështu një formulë» (CONOMOS 1985).

Doktrina e ndan shkrimin paleo-bizantin në *Koislina* (*Coislina*), të lindur ndoshta në Palestinë nga ku kemi edhe dëshmitë më të vjetra dhe *Kartres* (*Chartres*), të lidhur me Kostantinopojën dhe Athinën.

Notëzimi *Koislina* përdorte neuma të thjeshta bazë të plotësuar me pak shenja ndihmëse, ndërsa ai *Kartres* mbeti me një përhapje më të kufizuar. Zhvillimi i këtij sistemi shkrimi<sup>xlix</sup> çoi në bashkësinë e shenjave që pasojnë në grupe notash ose melizmash. Duhet thënë se notëzimi *Koislina* nga gjysma e dytë e shek. XI filloi të marrë epërsi dhe nga fundi i atij XII u plotësua, duke u zhvilluar bashkë me reformën e repertorit dhe gjurmët e tij i hasim edhe tek “shenjat e mëdha” të aparatit neumatik medio bizantin. Në *koislina* përdoren, veçmas ose të kombinuara, një numër i kufizuar neumash diastematike kryesore (*oxeia*, *bareia*, *apostrophos*, *petastē* dhe *klasma*), si dhe disa shenja ndihmëse me përdorim të herëpashershëm.

Zhvillimi i shkrimit muzikor ka rëndësi të jash-tëzakonshme, sepse, përveç ruajtjes dhe dokumentimit të traditave anonime përgatit presupozimet për shprehjet stilistike individuale të kompozitorëve të shek. XIV dhe XV, pra ardhjen e figurave të tilla, si Jan Kukuzeli (Ioannes Koukouzeles), i cili do të mbetet më i njohuri nga krijuesit e kohës së vet dhe figura më përfaqësuese e shkollës së re. Duhet pohuar gjithashtu se fakti muzikor i kohës shihej si mbizotërim i gojëtarisë ndaj shkrimit dhe se këndimi nuk shoqërohej me leximin e tekstit. Mund të besohet pra pa mëdyshje se notëzimi e ruante vlerën e vet për konsultimin apo për dokumentimin e faktit muzikor, por jo për realizimin efektiv të tij, ndaj, moskontrollimi apo vërtetimi, gjatë këndimit i saktësisë së shkrimit, rrjedhon edhe pamundësinë e vlerësimit të besnikërisë së tekstit grafik ndaj imazhit akustik të prodhuar asokohe nga përvijimi melodik i formuluar nga bashkësia vokale e koristëve.

Të bie në sy fakti se meloditë e trashëguara demonstrojnë të jenë tejet individuale, ndaj nuk gjen dy të njëjlojta, duke e vështirësuar kështu edhe më tej traskriptimin e mundshëm të tyre. Në këtë mënyrë, në mungesë të kronologjive të sakta dhe dokumentimit të sigurtë të zonave gjeografike të prejardhjes, propozimi i datimeve të burimeve mbi bazë notëzimit muzikor nuk është imun ndaj rrezikut të pasaktësisë.

## 2.0 Organizimi sipas përmbajtjes

Përmes dëshmimeve himnografike dhe muzikore, të cilat janë burime njëlloj të rëndësishme për historiografinë liturgjike, është arritur në një ndarje që pranon si kriter bazë organizimin në varësi të përmbajtjes.

*Stikerarion-i* (*Sticherarion*<sup>1</sup>) në hipotezën e studuesve (TROELSGÅRD 2001: 564 – 565) duhej të përfaqësonte një repertor të përdorur si referues apo si material didaktik, i cili më pas mund të pasurohej me variante melodike. Kështu ekzekutimi, i mbështetur kryesisht në praktika lokale, do të përfaqësonte një lloj paradigme individuale ndaj modelit *stikerarion* të standardizuar të përcjellë përmes kodikut, prania e të cilit nuk ishte e domosdoshme gjatë ekzekutimit, aq më tepër që, në atë format të vogël prezantimi, do të ishte edhe i palexueshëm nga i gjithë kori.

*Stikerarion idiomela* (teksti dhe melodia përkatëse ekzekutohej një herë të vetme gjatë vitit liturgjik), *stikerarion automela* (nuk përbëjnë repertor të kënduar, por modele ekzistuese melodike dhe metrike të gatshme për t'u përdorur në prodhime të reja), apo *stikerarion prozomoia*, nuk ishin veçse disa forma të himnografisë liturgjike.

Kalimi në sistemet më të përparuara ka përkuar me harrimin dhe mënjanimin e shumë himneve të cilat përgjatë shek. XII nuk ishin më në përdorim duke arritur tek i ashtuquajtura SAV<sup>II</sup>. Janë pikërisht himnet e përjashtuar nga ky i fundit të cilët, pa pësuar ndikimet e mëvonshme, mbeten dëshmi të traditave më të vjetra antike të stilit *stikerian*, gjë që mund të kërkohet në *Beratinus 2* apo në ata që shkojnë deri në shek. XII–XIII.

Meloditë *stikerariane* janë përgjithësisht silabike me një ose dy nota për rrokje e me disa melizma mbi rrokje të theksuara në fjalë të rëndësishme të tekstit, ndërsa për të përcaktuar modin muzikor përdorej në fillim të këngës *martiria* (*martyria*).

Duhet theksuar gjithashtu se teksti shkruhej zakonisht përpara neumave, e më pas, kur sistemi medio-bizantin fiton një rëndësi të madhe, duke rivlerësuar edhe semiografinë muzikore, neumat do të gjurmëzohen me një penë më të gjerë sesa ajo e përdorur për grafina e tekstit. Në vijim, me zhvillimin gjithnjë e më të madh të melizmave,

filloi edhe praktikimi i të shkruarit paraprakisht i neumave, për të shmangur në këtë mënyrë shpërndarjen e gabuar të tyre mbi fjalë apo rrokje jo përkuese. Kështu sistemi i ri përpiquej të unifikonte traditën dhe t'ia ngushtonte gjithnjë e më shumë rrugën e paqëndrueshmërisë së trasmetimit gojor dhe diversitetit të praktikave muzikore.

*Heirmologion-i*<sup>III</sup>, një tjetër libër liturgjik muzikor me karakter didaktik që përfshin *kanones* (VELIMIROVIĆ 1973 e 2001) (kompozime tekstesh strofike), alternon nëntë (ose edhe tetë) këndime (*ode*) biblike me himne të shkurtëra duke formuar një sekuencë sipas rendit të tetë modeve (autentike dhe plagiale). Me kalimin e shekujve numri i *kanones* për mod kalon nga 40 (midis shek. X dhe XII) në 12–15 *kanones* për mod (deri në rënien e Kostantinopojës më 1453).

*Faza e dytë* u shfaq nga fundi i shek. XII. Duhet të jetë kjo koha, kur u arrit saktësimi intervalor duke mundësuar transkriptimin në një sistem më modern, më të plotë e më të përpiktë të faktit tingullor, përfshirë këtu edhe detaje të imta të ekzekutimit, me rrjedhje pasurimin me një aparat semantik më të saktë *diastematik*. Me notëzim medio-bizantin<sup>III</sup> janë edhe koleksionet *Asmatikon* dhe *Psaltikon*. I pari ka funksion orientues për korin, ndaj stili i të kënduarit është melizmatik i përmbajtur, ndërsa i dyti i drejtohet solistëve, ndaj shprehet edhe me një stil më të përpunuar. Gjithsesi, duke nisur nga realiteti se kori dhe solistët e shërbesave të kultit janë protagonistë të të njëjtit akt muzikor, koleksionet trajtohen në përgjithësi së bashku si plotës të njëri-tjetrit. Duhet shtuar gjithashtu se dorëshkrimet janë krejt të ndryshme në përmbajtje. Përhapja e tyre është shtrirë deri në Itali e kopjet italo-greke janë të datueshme midis shek. XII dhe XIV (STRUNK 1977; BUCCA 2000; MARTANI 2002). Nga ana melodike *Asmatika* nuk jep referime për ndonjë origjinë të mundshme, por flet vetëm për një përkatësi të përbashkët ndaj një tradite. Formulatat melizmatike melodike, tipike të këtij repertori, janë të mbështetura me ndërhyrje tekstuale bashkëtingëlloresh dhe rrokjesh pa ndonjë domethënie (DONEDA 2006). *Asmatika* dhe *Psaltikon* mund të shikohen si replika të një

polifonie në distancë, të cilat po i afroreshin dallëngadalë njëra-tjetrës për t'u mbivendosur.

Është pikërisht koha (shek. IX–XII), kur në Europë po shfaqeshin e po përhapeshin format e para të polifonisë përmes ideimit të diskantit mesjetar, periudhë e cila duhet supozuar si potencialisht e mundur që edhe në Arbërinë e Jugut (Epir) të jenë shfaqur format e para të polifonisë, nëse nuk pranohet apo nuk arrihet të arsyetohet teza, e cila e kërkon ekzistencën e polifonisë shqiptare në kohë edhe më të hershme.

Në këtë mënyrë mund të shpjegohet fakti i një Arbërie të ndarë edhe përsa i përket mënyrës së të kënduarit: në pjesën malore veriore, më e izoluar në jetesë, konservohet tradita e një substrakti shumë të hershëm, të hamendësuar ilir<sup>liv</sup>, më i lashtë sesa kultura kristiane, gjithsesi jashtë ndikimeve të Kishës së Lindjes apo të asaj të Perëndimit; në hapësirën fshatare jugore, më shoqërore në mënyrën e jetesës, shfaqet edhe "kooperimi" muzikor, përmes refuzimit të *monologut* dhe privilegjimit të *dialogut*. Kështu epërsia e ligjëratis monodike, ikonë e strukturimit ekzistencial të stilit jetësor alpin, në Epir shndërrohet gradualisht në "bashkegzistencë", ku hijerarkia e vlerave tingëllore ridimensionohet në favor të pluralitetit tingëllor, ikonë kjo e një mënyre të re jetese që po hynte gjithnjë e më intensivisht. Gjithsesi, një karakteristikë e përbashkët i dallonte këto dy mënyra gjallese muzikore nga ajo e fqinjëve që trysnonin nga të gjitha anët me pretendime territoriale: të qenurit të pavarura nga strukturimi perandorak, qoftë administrativ e qoftë teologjik.

Ndërkohë qytetet arbëre, më të kontrolluara nga pushteti perandorak, si dhe nga pushtimet e drejtpërdrejta, ishin të pambrojtura nga depërtimi i trajtave liturgjike në formën e besimit. Në këtë optikë mund të shpjegohet pse Berati, mesa duket një kryeqendër e besimit ortodoks në territorin e Arbërisë jugore, prezanton një numër aq të madh kodikësh e këndon në monodi, mënyrë e privilegjuar kjo e ritit bizantin, por edhe e kulturës myslymane që do t'i mbivendosej, ndërsa bota fshatare përfaqë do të prodhojë e do të ruajë të paprekur traditën e këndimit polifonik. Janë po të kësaj periudhe edhe risitë që shfaqen

në teknikat kompozitive, të cilat vetëm nga fundi i shek. XIII do të emërtohen *kalophonikon*, etiketim i alternimit të pjesëve nga teksti liturgjik me vargje rrokjesh pa të shenjuar (*teretismata*) (Conomos 2001), teknikë kjo mjaft e përdorur edhe në polifoninë e jugut, e shfaqur kryesisht në fillimet e frazimeve me funksionin e intonimit dhe prezantimit të zërit të ri, i cili propozohet të merrte pjesë në dialogun muzikor.

Nga fundi i shek. XIII arrijmë në një fazë të re të përpunimit të materialit muzikor që lejon më së fundi shfaqjen e stileve personale të krijimit e është këtu që lartësohet Jan Kukuzeli<sup>lv</sup>, më i njohuri i kohës së vet, kompozitor e teoricien, organizator *Akolouthiai*<sup>lvi</sup> (urdhri/rendi i Shërbesës) i vitit 1336, domethënë i antologjive të mëdha me repertorin e kohës (RAASTED 1995). Na jepet kështu shembulli i parë i një koncepti të ri botimi, ku do të përmbliidhen së bashku trashëgimia antike, tradita më e hershme dhe krijimtaria e re të shfaqura këto në formate psalmodish e himnesh, të cilat deri në atë kohë u ishin besuar përcjelljes gojore. Kjo tipologji e re transmetimi është një provë e mëtejshme për rëndësinë që kishte në kulturën muzikore bizantine koncepti i dokumentimit dhe i unifikimit të shtresëzimeve të ndryshme etniko-kulturore që një perandori e atij niveli mbante të qarkuar në vetvete.

Krahas kompozimeve të reja me stil melodik të thjeshtë apo përpunimeve *kalafonike* muzikore të teksteve liturgjike, përfshiheshin në *Ako louthiai*, nën termat *palaion* dhe *archaion*, edhe formula të shkurtra e të thjeshta shumë antike të papërfshira në dorëshkrimet e mëparshme.

Ajo që bie në sy është idea e krijimit të një *do-racaku* që të kishte një hapësirë vepruese më të gjerë, duke filluar nga aparati teorik (*Papadike*), i cili mund të paraprijë për të shpjeguar principet e notëzimit. Këtu Kukuzeli ndërhyr teknikisht qoftë për të dhënë skema dhe/ose formula intonimesh të modeve, qoftë edhe për të ilustruar studimin didaktik të këndimit, duke furnizuar shpjegime rreth semiografisë apo duke shtuar diagrama dhe shembuj grafikë që identifikojnë neumat dhe modet.

Ikonografia e kohës dhe ajo pasardhëse fillojnë të fiksojnë edhe funksionet dramatiko-liturgjike.

Repertori muzikor përfshin *hesperinos* (kompozime autorësh të ndryshëm), *orthros* si dhe repertorin muzikor të liturgjive të Shën Cristostomo-s, Shën Basilio-s etj. Në dorëshkrimet më të pasura hasen jo në pak raste edhe *kratemata*, pjesë me virtuozytet melizmatik, me shembuj tipikë të stilit *kalofoniki* (*kalophonikon*). Fillojnë të shfaqen, pra edhe në ritin lindor fenomene të ngjashme me ato të liturgjisë perëndimore, domethënë pranimit në heshtje i shpërthimeve ndjesore të shprehshmërisë tingëllore në funksion të kënaqësisë shpirtërore, duke i lejuar kështu muzikës të tejshkojë rolin e pranuar jo pa mëdyshje nga Baballarët e Kishës, funksion i përkufizuar thjesht si transportuese e mediumit verbal.

Me kohë, riti imperial karakteristikë e Shën Sofisë së Konstantinopojës fillon të zbehet e bashkë me të mënjanohen edhe *Asmatikon* dhe *Psaltikon* për t'i lënë vendin një praktike liturgjike që buron nga manastiret bizantine, duke prodhuar vërtet shembuj liturgjikë më pak të përpunuar, por, e kjo është edhe më e rëndësishmja, duke krijuar mundësi për originalitete më të spikatura krijuese. Në këtë mënyrë nevojat e praktikës liturgjike bashkërendohen me tipare stilistike më të veçanta, më origjinale. Kështu shpjegohet pse në shekujt e mëparshëm e kemi të vështirë të individualizojmë kompozitorë të veçantë, aq më tepër ata që vepronin në periferi të perandorisë. Administrimi i gjatë osman si dhe presioni i kulturës orientale, do të kufizojë e rrudhë së tepërmi praninë e shtresëzimit bizantin në Shqipëri e më gjerë, por në dekadat e para të '800, bashkë me ndryshimet historike që përjetuan disa vende të Ballkanit, në muzikën bizantine filloi era e të ashtuquajturës "reforma e Chrysanthos"<sup>lvii</sup>. Te *Teoria e madhe e muzikës* e viti 1816, ky njohës i thellë i latinishtes dhe frëngjishtes, i muzikës europiane dhe arabe, kompozitor dhe edukator, mori përsipër përmirësimin e neumave mesjetare aq komplekse dhe teknike, të cilat vetëm një këndues shumë i shkolluar mund të ishte në gjendje t'i interpretonte. Duke perifrazuar notëzimin latin, ai ideoi, përmes përdorimit të shtatë gërmave të para të alfabetit grek, emërtesat e tingujve të shkallës muzikore eu-

ropiane<sup>lviii</sup>. Veprimtaria e tij teorike iu drejtua edhe risistemimit të tetë modeve (në tre lloje: *diatonike*, *kromatike* dhe *enharmonike*), duke realizuar, përmes përllogaritjesh matematikore një progresion të ri intervalor e si rrjedhojë, ideon procese të reja modulimi apo alterimi kromatik. Me synimin didaktik për ta bërë sa më të lehtë për kënduesit e pashkolluar përmbajtjen melodike dhe dinamike të këngëve dhe himneve të vjetra, Chrysanthos orientoi edhe mënjanimin e disa simboleve grafike.

Padyshim teoria muzikore e Chrysanthos ka arritur dhe është përhapur edhe në Shqipëri. I akuzuar se synonte të "importonte djaj të rinj" në Kishë, u dërgua në ekzil në Madytos e vetëm pas vitit 1815 fillon rivlerësimi i veprës së tij. Kështu, më 1819 ai u zgjodh nga Këshilli i Shenjtë si Peshkop i Durrësit e ka ndenjur në këtë funksion deri në mesin e vitit 1833<sup>lix</sup>.

Gjithsesi te Chrysanthos do të mbetet i pandryshuar koncepti i hershëm që mbart kultura bizantine me rrënjë në atë helene e më gjerë. Për të «melosi është një varg notash që ndjekin njëra-tjetrën, të pëlqyeshme për dëgjimin». Kështu muzika do të jetë «një shkencë e melosit dhe e gjërave të lidhura me melosin» (CHRYSANTHOS I MADYTOS 2010: 33).

Pas vitit 1820 u shkua drejt standartizimit të repertorit ritual bizantin, duke pranuar njëkohësisht edhe prurje të cilat ishin bërë ndërkohë popullore, melodi të stilit perëndimor, të stilit italian, por edhe tingëltime të reja nga Azia e Vogël etj., që sot përcaktohen si 'turqizma'.

Pas 'incidentit të Hudson-it' më 1908, ortodoksizmi shqiptar me bazë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do të pozicionohet prerazi në favor të krijimit të një kisha autoqefale<sup>lx</sup> me në krye Fan Stilian Nolin, i cili, tashmë në rolin e një 'Luther-it' shqiptar, i vihet përkthimit të teksteve liturgjike, për të mënjeluar krejtësisht greqishten nga ritet liturgjike.

Pothuajse e shkatërruar në periudhën që pasoi Luftën e Dytë Botërore, që nga viti 1990 vihet re një përpjekje gjithnjë e në rritje për ta rindërtuar këtë shtresëzim, por duhet thënë edhe se numri i ortodoksëve, pra i ushtruesve potencialë të kësaj

kulture, është ulur mjaft në përqindje duke rrezikuar hiçëzimin.

### 3.0 Mënyra e këndimi bizantin

Sipas *ktetorika typika* (DUBOWCHIK 2003: 282 – 289) vërehet se këndimi ishte ndër veprimtaritë kryesore të *ekklesiastikoi-ve*, murgjërve të cilët i kushtoheshin tërësisht apo kryesisht këndimit liturgjik, veprimtari kjo në të mirën e përgjithshme. Kori funksiononte si bashkësi e dy njësisive të vendosura përkrah njëra-tjetrës, por të ndara fizikisht, të cilat alternonin vargjet e këndimit liturgjik. Pasimi i ndërsjelltë, ndonëse ndihmonte në shplohjen e zërit, duket se shërbente edhe për të krijuar hapësirën e duhur, ndoshta për të medituar mbi tekstin e sapokënduar.

Roli i drejtimit të korit i takonte *domestikos* (shpesh edhe nga një për secilin grup) që duhej të kishte njohuri të thella rreth shërbesës fetare. Përkujdesja ndaj librave dhe dokumentave ishte pjesë e pandarë nga aftësia e këndimit të intonuar dhe me mjeshtri. Kënduesit (*psaltai*) duhet të shpreheshin me qartësi dhe me volum mesatar për të ndjekur kështu zërin e murgut drejtues. Duhet mbajtur parasysh se kishte sidoqoftë një dallim midis grafive notëzuese (*σημεία*) dhe tingullit (*φωσῶν*) të prodhuar.

Karakteristikat e këndimit bizantin mund të përmbliidhen si më posht:

(i) Këndimi bizantin është muzikë vokale e cila presupozon gjithmonë një tekst liturgjik të kënduar më afër deklamimit sesa vokalit të mirëfilltë. Melodia mbetet përherë një veshje e tekstit, të cilin e ndihmon me shprehshmërinë e saj për t'i dhënë formë dhe për të nënvizuar kuptimet e fshehura tek fjalët.

(ii) Psalmodia bizantine mbetet ende e palëkundur në përjashtimin e përdorimit të ndonjë instrumenti muzikor. Për të qëllimi i këndimit është i foluri i drejtpërdrejtë me Zotin pa patur nevojë për ndërmjetës, sepse marrëdhënia është personale, ndaj zëri njerëzor është i vetëmjaftueshëm.

(iii) Nga këndvështrimi i mësipërm rrjedh edhe preferenca për monodinë, duke përjashtuar polifoninë, edhe pse këndohet në kor. Muzika monofonike rezulton më e qartë ngaqë melodia

mbështetet sipas thekseve të të folurit duke e kthyer notëzimin muzikor si shprehje më të saktë të prozodisë.

(iv) Në bazë mbetet gjithnjë *melopoiia* që kuptohet si 'arti i modeve' dhe i poetikës krijuese të tingullit, domethënë si melodi.

(vi) Në përkufizimin e Platoni-t [PLATONE 1990: 216 – 217 (398d)] «një melodi përbëhet nga tre elemente: nga fjala, nga harmonia dhe nga ritmi. [...] Por midis këndimit dhe recitimit të thjeshtë nuk ka asnjë diferencë [...] Harmonia dhe ritmi duhet të ndjekin fjalën. [...] vajtimet dhe rënkimet nuk duhet të kenë vend në ligjërata». Në këtë mënyrë *melopoiia* duhet realizuar sipas kanuneve të tri mjeshtrove: poetike, muzikore dhe ritmike. Fjalët në funksion të mesazhit të dëshiruar mbeten elementi gjenerues, ndërsa muzika — *ἀρμονία* (*harmonia*), domethënë melodia — dhe ritmi — si lëvizje dhe impuls jetëdhënës — shërbejnë si trasmetues të *pathos*-it ose të ndjenjës së fjalëve në mënyrën më të saktë.

(vii) Gjithsesi, ndryshe nga shprehshmëria tragjike me shpërthime dhe alternime të skajshme të mjeteve teknike vokale, këndimi bizantin duhet t'i nënshtrohet një *ethos*-i të caktuar e të pranueshëm, ku të mbizotërojë prehja dhe meditim i amëshuar.

### Përfundim

Shembëllen e pabesueshme, por një fill i vetëm ka mbajtur të unifikuar prej së paku 2400 vjetësh, një qytetërim heterolit gjithsesi multikulturor dhe multietnik, e tashmë edhe multikombëtar. Për disa çështje koha duket sikur nuk ka lëvizur e mbërthyer pashkëputshmërisht në një substrakt parakristinan, sepse pannjerëzori, i cili është radikalizuar në çdo qelizë të ekzistencës, si inferencë psikologjike tipike e universalizmit.

Të kërkosh përkatësinë etnike në gjuhën ose alfabetin e përdorur, apo në ndonjë intonacion që ngjan familjar, do të thotë të përcudnosh misterin e madh të këndimit/ekzekutimit, i cili mbetet akt i mirëfilltë krijues aq herë sa realizohet, sepse 'interpretimi' nuk është ajo që shprehet, por ajo që perceptohet, një fakt ky tërësisht privat, intim, i pashpjegueshëm dhe i pa-

trashëgueshëm, domethënë edhe mbietnik e mbikombëtar.

### Bibliografi:

ALAND, Kurt dhe Barbara (1989), *Der Text des Neuen Testaments. Einführung in die wissenschaftlichen Ausgaben sowie in Theorie und Praxis der modernen Textkritik*, botimi i dytë, Stuttgart, Deutsche Biblegesellschaft, 1981, RHODES, Erroll F. (përkthyer nga), *The text of the New testament. An Introduction to the Critical Edition and to the Theory and Practice of Modern Textual Criticism*, Grand Rapids (Michigan), William B. Eerdmans Publishing Company, (botimi i parë) 1987 dhe (botimi i dytë) 1989.

AMARGIANAKIS, George (1997), 'An Analysis of Stichera in the Deuterios Modes: The Stichera Idiomela for the Month of September in the Modes Deuterios, Plagal Deuterios, and Nenano' (Transkriptuar nga 'Dorëshkrimi i Sinai-t 1230, A.D. 1365'), botimi i 23-të, në *Cahiers de l'Institut du Moyen-Âge Grec et Latin* 22/23, Copenhagen, Københavns Universitet, Institut for græsk og latinsk middelalderfilologi.

BENTAS, Christos J. (1971), 'The Treatise on Music by John Laskaris', në WELLESZ, Egon dhe VELIMIROVIĆ, Miloš, (aktet e) *Studies in Eastern Chant* 2, New York.

BUCCA, Donatella (2000), 'Quattro testimoni manoscritti della tradizione bizantina nell'Italia meridionale del secolo XIII', në *Musica e Storia* 8/1, Bologna, Edizione Fondazioni Levi – Il Mulino, 145–167.

CHRYSANTHOS I MADYTOS (2010), *Great Theory of Music*, përkthyer nga Katy Romanou, New Rochelle (New York), The Axion Estin Foundaton.

CONOMOS, Dimitri (botuar nga) (1985), *The Treatise of Manual Chrysaphes, the Lampadarios: on the theory of the art of chanting and on certain erroneous views that some hold about it*, në *Monumenta Musicæ Byzantinae – Corpus Scriptorium de Re Musica*, 2, Viena Verlag der Österreichischen Akademie der Wissenschaften.

CONOMOS, Dimitri (2014), 'Preface: A Brief Survey of the History of Byzantine and Post-Byzantine Chant': *The Divine Music Project*, <http://www.stanthonysonastery.org/music/History.htm#Psalmody>.

tory.htm#Psalmody.

CONOMOS, Dimitri dhe KENNETH, Levy (2001), 'Liturgy and Liturgical Books, IV: Byzantine Rite', në *The New Grove Dictionary of Music and Musicians*, Stanley Sadie (botuar nga), vol. 15, ff. 7–10, bot. i dytë, London, Macmillan.

CSNTM (2010), © *The Center for the Study of New Testament Manuscripts*, [www.csntm.org/manuscript](http://www.csntm.org/manuscript), Siti i ndërtuar nga GurryDesign.com.

DONEDA, Annalisa (2006), 'I manoscritti liturgico-musicali bizantini: tipologie e organizzazione', në CHICO ESCOBAR, Angel (botuar nga), *El palimpsesto grecolatino como fenomeno librario y textual*, Zaragoza, Institución Fernando el Católico, 2006, ff. 83–112.

DUBOWCHIK, Rosemary (2003), 'Singing with Angels: Foundation Documents as Evidence for Musical Life in Monasteries of the Byzantine Empire', në *Dumbarton Oaks Papers*, Nr. 56, Washington, D.C., Alice-Mary Talbot.

ENGBERG, Susse Gudrun (1980-1981), (botuar nga), *Prophetologium. Lectiones anni mobilis, Monumentæ Byzantinæ, Lectionaria* 1/2, Copenhagen, Havnix & Munksgaard.

ENGBERG, Susse Gudrun (1995), 'Greek Ekphonic Notation: The Classical and the Pre-classical System', në RAASTED, Jørgen dhe TROELSGÅRD, Christian, *Pallæobyzantine Notations: A Reconsideration of the Source Material*, Hernen, Brendius Foundation, ff. 33–55.

ENGBERG, Susse Gudrun (2002), 'Ekphonic notation', *The New Grove Dictionary of Music and Musicians*, vol. 8, bot. i dytë, London, Macmillan.

FLOROS, Constantin (1970), *Universale Neumenkunde*, Kassel-Wilhelmshöhe, Bärenreiter-Verl. [in Komm.].

FSH (1984), *Fjalor i Shqipes së Sotme*, A.A. (autorë të ndryshëm), Tiranë, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

HANNICK, Christian (1990), 'Reference materials on Byzantine and Old Slavic music and hymnography', *Journal of the Plainsong & Medieval Music Society*, vol. 13, ff. 83–89.

HANNICK, Christian dhe WOLFRAM, Gerda (botuar nga) (1985), *Gabriel Hieromonachos: Abhandlung*

- über den Kirchengesang*, në Monumenta Musicæ Byzantinæ – Corpus Scriptorum de Re Musica 1, Viena, Verlag der Österreichischen Akademie der Wissenschaften.
- HØEG, Carsten (1935), *La notation ékphonétique*, Monumenta Musicæ Byzantiæ, Subsidia 1/2, Copenhagen, Levin & Munsgaard.
- HØEG, Carsten dhe ZUNTZ, Günter (botuar nga) (1939-1970), *Prophetologium. Lectiones anni mobilis*, Monumenta Musicæ Byzantinæ, Lectionaria 1/1, Copenhagen, Havnix & Munksgaards.
- ISIDORE I SEVILJES (2006), *Etymologie*, në BARNEY, S.A., LEWIS, W.J., BECH, J.A., BERGHOF, O. (përkthyer me hyrje dhe shënime të) dhe HALL, M. (me bashkëpunimin e), *The Etymologies of Isidore of Seville* Cambridge, Cambridge University Press.
- KILMER, Anne Draffkorn (1965), 'The Strins of Musical Instruments: Their Names, Numbers, and Significance', në *Studies in Honor of Benno Landsberger on His Seventy-fifth Birthday*, në GÜTERBOCK, Hans G. & JACOBSEN, Thorkild (botuar nga), *Assyriological Studies* 16, ff. 261–268, Chicago, University of Chicago Press.
- KILMER, Anne Draffkorn dhe CIVIL, Miguel (1986), 'Old Babylonian Musical Instruction Relating to Hymnodý', në *Journal of Cuneiform Studies* 38, no. 1, Michigan, Piotr Michalowski – University of Michigan – Ann Arbor, ff. 94–98.
- KREMENLIEV, Boris (1952), *Bulgarian-Macedonian folk music*, California, University of California Press.
- KUJUMDŽIEVA, Svetlana (1992), 'Dynamics between written and oral music', (lexuar në takimin e katërt, Pécs, Hungary, 3–8 September 1990, në International Musicological Society Study Groups, *Cantus Planus*, DOBSZAY, L. (botuar nga), Budapest, ff. 283–292.
- L'UNIVERSALE (2005), *L'Universale. La grande Enciclopedia Tematica* 13, A.A., Milano, Garzanti.
- MAGUIRE, Robert A. dhe TIMBERLAKE, Alan (botuar nga)(1988), *American contribution to the Twelfth International Congress of Slavists*, Bloomington, Slavica Publisher, Indiana University.
- MARTANI, Sandra (2002), 'La Musica Bizantina in Italia. Fonti Musicali e Testimonianze Letterarie', në *Rivista Internazionale di Musica Sacra*, nuova serie, 23, II (2002), ff. 1–30.
- MIGNE, Jacques-Paul (1856-7), 'Patrologia Graeca', në *Patrologiae cursus completus*, vol. 61. kol. 315 (*Komentime mbi I Cor. nga Shën John Chrysostomo, Omilia* 36).
- PLATONE (1990), *Πολιτεία*, në, PLATONE, *La Repubblica*, LOZZA, Giuseppe (përgatitur nga), Milano, Mondadori.
- RAASTED, Jørgen (1989), 'Compositional Devices in Byzantine Chant', në *Cahier de l'Institut du Moyen Âge Grec et Latin* 59, ff. 247–269.
- RAASTED, Jørgen (1995), '“Koukouzeles” Revision of the Sticherarion and Siani gr. 1230', në SZENDREJ, Janka & HILLEY, David (botuar nga), *Laborare fratres in unum: Festschrift in honor of László Dobszay's 60th birthday*, Spolia Berolinensi, Hildesheim, Zurich, Weidmann, 7, ff. 261–277.
- RAASTED, Jørgen (1997), 'Koukouzeles' Sticherarion", në TROELSGÅRD Christian (botuar nga), *Byzantine Chant: Tradition and Reform*, Aktet e takimit mbajtur në «Danish Institute» të Athinës në vitin 1993, Athinë.
- RAASTED, Jørgen dhe TROELSGÅRD, Christian (1995), *Paleobyzantine Notations. A Reconsideration of the Source Material*, Hernen (Netherlands), Bredings Foundation.
- SAVAS, Savas I. (1965), *Byzantine Music in Theory and in Practice*, DUFAULT, Nicholas (përk. ang.), Boston, Hercules Press.
- SCHARTAU, Bjarne (botuar nga)(1990), *Hieronymos Tragodistes: Über das Erfordernis von Schriftzeichen für die Musik der Griechen*, në Monumenta Musicae Byzantinae – Corpus Scriptorum de Re Musica III, Viena, Verlag der Österreichischen Akademie der Wissenschaften.
- SCHARTAU, Bjarne (1998), *Anonymous: Questions and Answers on the Interval Signs*, në Monumenta Musicae Byzantinae – Corpus Scriptorum de Re Musica IV, Viena, Verlag der Österreichischen Akademie der Wissenschaften.
- SCHIØDT, Nanna (1992), 'The 741 Final Cadences from the Hymns of the Twelve Months Compared with Other Cadences in the Byzantine Sticherarion Coislin 42 from Paris', në International Musicological Society Study Group, *Cantus Planus*, lexuar në takimin e katërt, Pécs,

- Hungary, 3–8 September 1990, DOBSZAY, L. (botuar nga), Budapest, ff. 267–281.
- SCRIVENER, Frederick Henry Ambrose (1853), *A full and Exact Collation of About Twenty Greek Manuscripts of the Holy Gospels*, Cambridge & Londra, John W. Parker and Son.
- SOKOLI, Ramadan (1966), *Figura të ndritura*, Tiranë.
- SOKOLI, Ramadan (1995), *16 shekuj*, Tiranë, Eurorilindja [pa vit botimi, por duhet të jetë i vitit 1995].
- STATHIS, Grigorios (1983), 'Ioannes Koukouzeles "Method of Theseis" and Its Application', në *Byzantine Chant, Cahiers de l'Institut du Moyen-Âge Grec et Latin* 44, ff. 189–203.
- STRUNK, William Oliver (1966), *Specimina notationum antiquiorum. Pars Principalis et Pars Suppletoria*, në *Monumenta Musicæ Byzantinæ – Corpus Scriptorum de Re Musica*, VII, Copenhagen, Haunia, E. Munksgaars
- STRUNK, William Oliver (1977), *Essays on Music in the Byzantine World*, New York, Norton.
- THODBERG, Christian (1966), 'Der byzantinische Alleluiarionzyklus: Studien im kurzen Psaltikonstil', *Monumenta Musicæ Byzantinæ*, Subsidia 7, Copenhagen, Haunia, E. Munksgaard.
- THODBERG, Christian (1988), 'Ancient Musical Theory in Byzantine Environments', në *Cahiers de l'Institut du Moyen-Âge Grec et Latin* 58, ff. 228–259.
- THODBERG, Christian (2001), 'What kind of chant books were the Byzantine Sticheraria?', në *International Musicological Society Groups, Cantus Planus*, lexuar në takimin e nëntë, Estergom dhe Visegrad 1998, Budapest, Hungarian Academy of Sciences, Institute for Musicology, ff. 563–574.
- TROELSGÅRD, Christian dhe WOLFRAM, Gerta (1999), *Palaeobyzantine Notation II*, Akte të Kongresit mbajtur në Hernen Castle (Netherlands), në tetor 1996, Hernen (Netherlands), A.A., Brediusstichting.
- UNESCO (2006), në *web.archive.org*. (përditësuar më 13.11.2006).
- VELIMIROVIČ, Miloš (1973), ' "Persian Music" in Byzantium', në VELIMIROVIČ, Miloš dhe WELLESZ, Egon, (botuar nga), *Studies in Eastern Chant*, 3, London-New York-Toronto, Oxford University Press.
- VELIMIROVIČ, Miloš (2001), 'Russian musical Azbuki: a turning point in the history of Slavonic chant', në JEFFERY, Peter, *The Study of Medieval Chant. Paths and Bridge, East and West* (In Honour of Kenneth Levy), Cambridge, ff. 257–268.
- WEST, Martin Kitchfield (1994), 'The Babylonian Musical Notation and the Hurrian Melodic Texts', në *Music & Letters* 75, nr. 2 (maj), ff. 191–179.
- WILLIAMS, Edward Vinson (1968), *John Koukouzeles's Reform of Byzantine Chanting for Great Vespers in the Fourteenth Century*, Ph.D. Yale University, Yale University Press.
- WILLIAMS, Edward Vinson (1972), 'A Byzantine Ars Nova: The Fourteenth-Century Reforms of John Koukouzeles in the Chanting of Great Vespers', në BIRNBAUM, H. dhe VRYONIS, S. (botuar nga), *Aspects of the Balkans: Continuity and Change: Contributions to the International Balkan Conference held at UCLA, October 23–28, 1969*, Paris, The Hague, Mouton, ff. 211–229.
- WOLFRAMM, Gerda, (botuar nga) (2004), *Palæobyzantine notation III*, akte të kongresit të mbajtur në mars të vitit 2001 në Kështjellën e Hermen-it (Netherlands), Leuven (Belgium), Uitgeverij Peeters.



---

## PROBLEME TË PËRDORIMIT TË NORMËS DREJTSHKRIMORE PROBLEMS OF USING THE ORTHOGRAPHIC NORM

HELENA GRILLO

Universiteti " Aleksandër Moisiu", Durrës, Shqipëri  
helenagrillo@yahoo.com

### PËRMBLEDHJE

Në këtë fazë të zhvillimit të shqipes sot, kur shtrohen diskutime problemore për sistemet themelore të standardit: drejtshkrim, gramatikë e leksik nevojitet hetimi i zbatimit të parimeve normative të gjuhës në bashkësi të ndryshme gjuhësore. Procesi i kodifikimit të normës gjuhësore fillon me përcaktimin e normës drejtshkrimore, e cila, nga ana e vet, pasqyron atë që është arritur në kodifikimin e normës morfologjike e fonetike. Punimi ynë është një qasje hulumtuese në hullinë e diskutimeve të sotme rreth standardit, ku krahas matjeve konkrete në terren merr në shqyrtim mes rezultateve konkrete përdorime të normës, kryesisht drejtshkrimore duke analizuar sistemin gjuhësor e shumëllojshmërinë e mjeteve gjuhësore që përdor shqipja në dikotominë sistem-ligjërimit.

**Fjalët çelës:** normë, normë drejtshkrimore, përdorim gjuhësor, përvetësim

### ABSTRACT

At this stage of development of Albanian language when added to topical discussions regarding basic systems of official language spelling, grammar and lexicon, is indeed needed the investigation of the implement of the normative principles of language in different linguistic communities. The coding process of linguistic norm begins with determining of orthographic norm which reflects what was agreed in the codification of morphological and phonetic norm. In our paperwork we will investigate the rate of acquisition of orthographic norm in linguistic communities comparatively different. We have selected different ages from different provinces for the comparative analysis of causes in different uses. Ultimately the orthographic norm reflects what was achieved in the phonetic structure grammar and lexical of national literary language. The results of quantitative process will provide valuable contributions for the frequency use of linguistic forms which govern the direction of use by planning linguistic development.

**Key words:** rate, orthographic norm, linguistic use, acquisition

---

### Hyrje

Punimi është pjesë e një studimi kombëtar të matur mbi një test të tillë. Testi është hartuar në tri rubrika. Rubrika e parë mat përdorime të numrit shumës me mjete gjuhësore të ndryshme. Në bazë të analizave statistikore jemi përpjekur të krahasojmë formime të shumës me mjete të njëjta gjuhësore duke hulumtuar mbi shkaqet e përdorimeve të gabuara. Bashkësia gjuhësore që kemi përzgjedhur, treguesin moshor e ka të pandryshueshëm (studentë të gjuhës e letërsisë në Universitetin "Aleksandër Moisiu") dhe relativisht

të pandryshueshëm treguesin dialektor. (Kryesisht studentët janë banorë të Shqipërisë së Mesme). Nuk duhet lënë pa përmendur vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies në shkollat e mesme nga vijnë studentët, por kjo del jashtë caqeve të lejuara të kumtesës. Duke pasur parasysh që programet e gjuhës e letërsisë shqipe janë të unifikuara, edhe këtë tregues e konsiderojmë relativisht të pandryshueshëm. Standardi mësohet në shkollë dhe duhet zbatuar në të gjitha ato fusha ku është i domosdoshëm, si arsim, administratë etj.

### Drejtskrimi dhe faktorët që ndikojnë në zotërimin e tij

Drejtskrimi pasqyron në fund të fundit atë që është arritur në strukturën fonetike, gramatikore e leksikore të gjuhës letrare kombëtare. Në përvetësimin e drejtskrimit luajnë rol të rëndësishëm shkalla e zotërimin e përvetësimit të normës morfologjike, fjalëformuese dhe drejtshqiptimi.


Gjendja e zotërimin dhe e përdorimit të normës drejtskrimore është tepër shqetësuese. Nga klasa e pestë në klasën e dymbëdhjetë përparimi në përvetësimin e këtyre normave është i papërfillshëm, çka do të thotë se mësimi i gjuhës shqipe në shkollë nuk arrin një nga objektivat kryesore të programit të kësaj lënde: përvetësimin e normës drejtskrimore. Ky konstatim thellohet me treguesit e analizave të mëposhtme, ku bashkësia gjuhësore ka qasje ndaj gjuhës (student të gjuhës e letërsisë).

Në analizat statistikore do të mbështetemi në rastet që janë propozuar për ndryshim nga Këshilli Ndërkademi.

### Matje të propozimeve të Këshillit Ndërkademi

Propozohet: Shumësi i emrave të tipit teatër, kablllo, kuadër, të bëhet teatra, kablla, kuadra, rrjedhimisht njëjësi: teatër, kabëll, kuadër, i cili përfaqëson zgjidhje që i fusin këta emra në klasën e emrave me -ër që shumësin e bëjnë me -a, si libër - libra etj.

#### Një teatër




Matjet për formimin e shumësin në bashkësinë tonë gjuhësore rezultojnë: 28% mire / 72% gabim. Përdorimet më të shpeshta gabim janë format: *teatra, teatëra* që gjykohen si ndikime dialektore.

Në formimin e shumësin në emra me -ër kemi bërë matje krahasimtare në përdorimet: *prinër, nipër* që shënojnë kryesisht frymorë. Këtu kemi qëndrueshmëri të përdorimeve e ngulitje të normës.

Një prind;

Një nip



Për të hulumtuar mbi ndikime të nënsistemeve gjuhësore shqyrtojmë shembujt: *një libër i keq; një orë e keqe, mjeshtri i cirkut, një fshat i ri.*


Matjet i pasqyrojmë në grafikët e mëposhtëm:



Mirë 4%, gabim 96 %

Mirë 24 %, gabim 76%

Një fshat i ri




Studentët gabojnë në përshtatjen e emrit me mbiemrin. Gabimet më të përdorshme janë: *ora të keqja, ora të këqija*. Konstatohet se gabohet në përshtatje të mbiemrit dhe në shumësin e emrit. Mbiemri i keq – të këqij (a të këqinj) merr për analogji me mbiemrat i ri, i zi, mbaresën – inj (më fort se – ij) duke errësuar, për shkak të lëvizjes së theksit, zanoren e theksit në – ë. Konstatohen trajtat konkurente – inj/ij.

Vërehen përdorime të gabuara të shumësin të emrit orë (25/57).

Një libër i keq

Një orë e keq





Shqipja ka mbaresa të veçanta për trajtat rasore të numrit shumës. Mbështetur në “Drejtshkrimin e gjuhës shqipe” *prapashtesën – e e marrin vetëm emrat mashkullorë me kuptim abstrakt. Emrat e prejardhur me –im , fjalët e huazuara me –on, -um, -ium, -azh, në shumës marrin – e, si dhe shumica e emrave që mbarojnë me bashkëtingëlloret t e d. Marrin këtë prapashtesë dhe emrat e jofrymorëve më –al, -an, -ar, -el, -er dhe –on. Me –e formojnë temën e shumësit dhe mjaft emra jofrymorësh që mbarojnë me bashkëtingëllore të ndryshme.*


Po analizojmë grafikisht përdorime të shumësit me – e. Nga grafiku vërejmë se kemi luhatje më të mëdha në *një gardh- e*, ndërsa të përdorimi i shumësit të emrit dokument-e , konkuron forma dokumenta, si varietet i gjuhës së folur. Disa nga të anketuarit pohonin se e njihnin rregullin përkatës të formimit me – e, por në varietetin e gjuhës së folur përdorin variantin me –a.( dokumenta)

Një dokument

Në gardh



Në rastin e mësipërm mendojmë se në vetëdijen e folësit, gjuha e shkruar, po shkon drejt gjuhës së folur. Kjo pohohet dhe me shembullin e shumësit të emrit oxhak-, ku konkurojnë dyshorët *oxhakë- oxhaqe*, 12% përdorin *oxhakë* dhe 88% e përdoruesve përdorin formën me qiellzorizim të bashkëtingëllores dhe me prapashtesën – e njëkohësisht: *oxhaqe*.




Nëse do pohonim se një ndër shkaqet e mosnëgjatjes së normës është shumëllojshmëria e formave gjuhësore, paraqitja grafike e grupimit të emrave të njëjtë shfaq polemika diskutimesh. Vërejmë se kemi qëndrueshmëri përdorimi në shumësin e emrit koment- e, dhe luhatje në përdorim të emrit dokument- e, përkatësisht (80/4; 43/41).

E njëjta dukuri vërehet edhe në përdorime të tjera të shumësit.

Prapashtesën – *nj* e marrin vetëm emrat mashkullorë që mbarojnë me zanore të theksuar (me përjashtim të fjalëve *bri, dre, dhe, fre, sy, tra, zë*). Shumicën e përbëjnë emrat që gjatë lakimit në njëjës nxjerrin bashkëtingëlloren *r* para mbarësës –*i*: *hu- hunj, kalli- kallinj*, Emrat që e formojnë shumësin me – *nj* nuk janë shumë: *barinj, drunj, ciliminj, florinj, mullinj, penj, turinj, shalqinj etj*


Në shënim, rregullin përjashtues nga grupi i mësipërm nënvizohet: Emrat *kalama* dhe *kufi* në shumës dalin me – *j*: *kalamaj, kufij*.

## Një kufi




Nga raporti sasior konstatohet luhajtje e mosngulitje e rregullit, përkatësisht 14% mire / 86% gabim. Përdoruesit duket se e kanë rrënjësor përdorimin e shumësit me –nj.

Kjo duket në grafikun e mëposhtëm:




Luhajtjet në përdorim të formave të ndryshme shfaqen si nga shumëllojshmëria e mjeteve dhe nga mungesa e një kufiri ndarës midis temave, ashtu dhe nga ndikimi i dialekteve.

Luhajtje dysorësh konstatojmë dhe në foljet me s/t. Në matjet e mëposhtme përdoret përkatësisht 20% forma me s, dhe 35% forma me t, kundrejt 80% me 65% forma me t.



Ngulitje të normës konstatohet në fjalët e prejardhura, që megjithëse formohen nga tema më bashkëtingëllore shkruhen me ë (si zanore mbështetëse)



## Rezultatet dhe diskutimi

Nga rezultatet e analizuara shqyrtohet raporti i nënsistemeve gjuhësore dhe roli i drejtshkrimit në përvetësimin e standardit.

Në punim hetohet drejtshkrimi i zanores /ë/ të patheksuar, formimi i shumësit me mbaresa, formimi i fjalëve të përbëra e prejardhura. Rezultatet e përpunimeve sasiorë do të japin kontribut me vlerë për dendurinë e përdorimeve të formave gjuhësore, të cilat drejtojnë kahjen e përdorimit duke planifikuar zhvillimin gjuhësor. Jemi përballë situatës se si duhet të rrënjësojmë standardin, i cili për më se katër dekada është luhatur “mes asaj që përdoret në terren” dhe asaj që “duhet të jetë”. Folësi përdor mjete gjuhësore e idioma që njëh dhe i ka më të lehta në zgjedhje. Ka ardhur koha kur gjuhëtarët e hartuesit e teksteve, të thellohen të gjejnë rrugë për ngulitjen e normës, e të mos mbetemi vetëm në shkaqet e mosngulitjes së saj.

## Bibliografia

Demiraj, Sh. (), *Morfologjia e gjuhës shqipe 1*, ASHSH (2002), *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë. ASHAK (2005), *Drejtshkrimet e shqipes*, Prishtinë. (Përgatitur nga Rexhep Ismajli).

---

## THE CAVES, AS MYTHOLOGIC LIVINGPLACES AND OFFERING TOPOS SHPELLAT SI VENDBANIM MITOLOGJIK E TOPOSE BLATIMI

IRENA GJONI

Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, Fakulteti i Edukimit, Departamenti: Letërsi shqipe  
E-mail: gjoniirena@yahoo.com

### PËRMBLEDHJE

Botëkuptimin e vetë për hapësirën, njeriu arkaik e ka ndërtuar mbi distinkcionin e hapësirës së njohur e të banuar dhe hapësirës së panjohur e të pabanuar që e ka rrethuar. Shpellat futen te të dytat. Në këtë studim nënvizohet se nëpër këto topose kanë jetuar e kanë pasur vendqëndrimin e tyre përfaqësues të ndryshëm e të llojllojshëm të së mirës e të keqes. Që këtu ka qenë edhe nevoja e krijimit të kultit për to. Lënda e shtruar rrihet në kontekst të ruajtjes së mbijetojave të kulteve të blatimit, gjithnjë duke e krahasuar me mitologjinë antike greke dhe areale të tjera mitike mesdhetare e botërore. Paraqitja e shpellave në shpjegimet mitologjike veçon dhe përpunon disa nga anët e faltores. Në secilën periudhë historike ka pasur të papriturat e tyre, të cilat kanë krijuar kushte të volitshme për lindjen e zhvillimin e fantazisë, të përcjellë përmes besimesh e legjendash të ndryshme dhe për dhënien e tipareve ktonike ose hyjnizuese. Shpjegimet që u jepen shpellave janë pjesë përbërëse e dëshirës së njeriut të hershëm t'i shpjegojë fenomenet e natyrës në mënyrë naive, atëherë kur kanë munguar shpjegimet dhe interpretimet shkencore. Përveç kësaj, dëshkohet se shpellat shpesh kanë luajtur role të rëndësishme praktike për jetën e njeriut. Shpellat paraqiten si vendlindje dhe vendqëndrim i hyjnive e shenjtoreve (Hadi, Zeusi, Dionisi, pse jo edhe Krishti) vendblatim i shenjtoreve (Shpella e Spilesë, Shpellat e Panit nëpër Greqi; Shpella Halile – vendnderim i hyut të udhës), vendmitizim i personazheve mitike (Jansoni me Medenë, Eneu me Didonën); vendstrehim i luftëtarëve dhe vendngritje e sundimit (Shpella e Gramës, Shpella Halile, Shpella e Haxhi Aliut), vendqëndrim i iniciantit për ta fituar statusin e ri shoqëror, por në to mbyllen përkohësisht edhe personazhet e eposit heroik pasi kanë përfunduar misionin e tyre (për t'u shfaqur më vonë kur të ndihet nevoja), vendjetesë e përbindshave (Lubia, Kuçedra në Palermo). Si përfundim, shpellat shihen si vendbanim mitologjik e topose blatimi.

**Fjalët çelës:** shpellat, vendbanim, mitologjik, topos, blatim, krahasim, Bregdet.

### SUMMARY

The outlook for the space, the archaic man has built it on the distinction of known space and the inhabited and uninhabited unknown surrounded space. Caves are introduced to the second. In this study is noted that in these topos they had lived in their current residence of various representatives of diverse of good and evil. Since there has been the need of creating cult for them. Beaten paved content in the context of preserving the offering cults survive, always comparing ancient Greek mythology and other mythical realm Mediterranean world. Presentation of caves in mythological explanations separates and processes some of the sides of the shrine. In each historical period had their contingencies, which have created favorable conditions for the emergence and development of fantasy, followed by the legends of different faiths and providing ktonike or divinizing features. Explanations given to the caves are an integral part of early human desire to explain the phenomena of nature naively, when there were no scientific explanations and interpretations. In addition, it is proven that the caves have often played important roles in practical for human life. The caves are presented as the birthplace and residence of the deities of the saints ( Hadi, Zeus, Dionysus, why not Christ ) place for the saints ( SPILE Cave, Cave of Pan in Greece; Halil Cave – honorplace for the deity of way ), mythicplace for the characters of heroic epos ( there Muji gain extraordinary power of Halili ), marriage places for mythical characters ( Jansson with MEDENA , Eneu with Didona ); hidingplace for fighters shelter and rule ( Cave of Grama , Halil Cave , Cave of Haji Ali ), site of iniciantit to win new social status, but also to

temporarily shut heroic epos characters after completing their mission ( to be shown later when a need), livingplace of monsters(Lubin, dragon Palermo). In conclusion, the caves are seen as the mythological abode of offering TOPOS.

**Keywords:** caves, township, mythological, TOPOS, offering, comparison, Coast

### Shpellat

Megjithëse prezenca e shpellave është më pak dominuese në natyrën e Bregdetit të Jonit se ajo e maleve apo ujërave, ato (shpellat) janë një anë tjetër e gjeologjisë së kësaj zone. Mendohet se kanë luajtur një rol të rëndësishëm në lashtësi. Karakteristikë e tyre ishte fakti që ato gjendeshin afër bregut të detit, por njëkohësisht ato dëshmojnë edhe lashtësinë e miteve, jo vetëm të kësaj krahine, por edhe në traditën e përgjithshme shqiptare.

Shpellat janë vende ndenjeje, por ruajnë njëkohësisht edhe karakterin e egër të tyre – vendstrehime për ata që kishin nevojë, larg nga vendbanimet njerëzore.

Ashtu si dhe malet, shpellat krahasohen në mite me një periudhë të së kaluarës së largët. Paraqitja e shpellave në shpjegimet mitologjike veçon dhe përpunon disa nga anët e faltores.

Shpella paraqet parimin femëror, sepse i ka tiparet e barkut të Nënës Tokë. Si pjesë përbërëse e malit, shpella ka të ngjashme shumë nga simbolikat, por tek ajo dominojnë parimet e mbyllura të femërores, përballë malit që i përket të jashtmes, të dukshmes.

Shpellat ishin të futura brenda në një perëndi, d.m.th. Gjean. Për këtë fakt, hyrja në një shpellë do të thoshte se dikush vinte në takim të afërt me shenjtin. Një destinacion në të cilin ofroi shteg një shpellë, ishte vetë mbretëria e Hadit.

Lindja dhe ditët e para të disa prej perëndive u bënë në shpella. Zeusin, që foshnjë e mbajtën në një shpellë, megjithëse kishin mëdyshje se në cilën prej tyre. Nuk është shumë çudi që shumë vende si në Kretë dhe në Arkadi kërkonin këtë nder. Dionisin, gjithashtu e mbajtën në një shpellë. Një çast i bukur, i vizatuar paraqet Ermin të dorëzohet fëmijën e sapolindur të saj tek nimfat për ta rritur (Larson 2001: 54).

Në shpellë, si simbol i botës nëntokësore dhe e varrit, më shpesh janë bërë ritet e iniciacionit. Hyrja në shpellë është hyrje e dytë në barkun e Nënës Tokë. Kalimi nëpër të paraqet ndryshimin

e pozitës shoqërore (Lampic 1999: 107-108). Besohet se kur lindin fëmijët, vijnë nga shpellat ose nga humnera të ngjashme.

Eliade përmend një besim që ka të bëjë me shtatzaninë. Sipas tij, gratë mbeten shtatzanë kur i afrohen vendeve të ndryshme: shkallëve, shpellave, drunjve, lumenjve (Elijade 1992: 185). Kjo më tej interpretohet sipas besimit në pavdekshmërinë e shpirtit, sikur në vende të këtilla kanë bërë roje shpirtërat e të parëve dhe për fekondim ata kanë pritur nëpër këto vende sekrete të Tokës – Mëmë.

Pra edhe shpella, si personifikim i lindjes së jetës, shpesh është ndërlidhur me blatimin. Nëpër shpella janë bërë edhe martesat mitike, siç është martesa midis Jasonit e Medesë në mitologjinë greke, ose i Eneut me Didonën te *Eneida* e Virgjilit.

Kjo ndërlidhje e shpellës me blatimin vërehet në Bregdetin e Jonit te shpella e **Spilesë**. Është konsideruar si një ndër shpellat më të hershme të kësaj krahine dhe jo vetëm kaq. Arkeologu italian L.Kardini, në vitin 1939 bën gërmimin e parë në shpellën e Spilesë (Himarë), (botuar nga D. Mustili). Ai provoi se shpella ishte banuar në Epokën e Neolitit të Ri (3000 – 2100 p. l. K.). Sipas gojëdhënave, thuhet se në shpellën e Spilesë në Himarë jetojnë zanat e detit dhe njerëzit e konsideronin si vendkult ku i adhuronin këto zana. Kjo vërtetohet akoma më tepër gjatë gërmimeve arkeologjike në këtë shpellë, ku, sipas Ilir Gjipalit, shpella nuk ka shërbyer si vendbanim i përhershëm, sepse nuk janë gjetur mbetje të strukturave të qëndrueshme. Por kjo shpellë është përdorur si vend kult, ku janë ngritur struktura druri të futura në tabanin e shpellës nëpërmjet gropave të hapura për fiksimin e shtyllëzave (Gjipali 2004: 43).

Për vetë lashtësinë e saj, shpella e Spilesë përmendet sipas gojëdhënës popullore si vendi ku gjeti strehim Odisea i Homerit, që përjetoi me shokët e tij peripecitë me ciklopin Polifem.

Edhe në Greqi shpellat ishin një vend për adhurimin e nimfave. Dy nga shembujt më të njohura janë: shpella Vari në lmito të Atikës dhe Korrikio në Delfi të Parnasos (Brewster 1997: 97). Perëndia Pan ishte i lidhur gjithashtu me shpellat, kryesisht pas fillimit të adhurimit të tij në Atikë në shek. V p. l. K.. Megjithëse shumica e shpellave të Panit gjendeshin në vend të hapur, kishte dhe përjashtime. Kur athinasit e vendosën faltoren e tij në një shpellë në pjerrësinë jugore të Akropolit, i bashkangjiten qytetit një pjesë të egërsisë bujqësore.

Ka dhe një lidhje simbolike më të qartë në sistemin e ideve që e lidhin një perëndi nga e quajtura “protokulturë”, Arkadia prehistorike, me një pjesë të natyrës-shpellën, që ndihej se i përkiste të kaluarës së largët. Me një simbolikë të tillë, Eriniet nderoheshin në një shpellë të shenjtë afër Areo Pago. Pamja e jashtme e frikshme e këtyre perëndive dhe roli i tyre në ndjekjen e vrasësve, sollin një zgjidhje logjike në veçimin e tyre në një vend të egër të natyrës.

Në këtë kontekst, në Bregdetin e Jonit është edhe shpella e Palermos. Sipas traditës gojore në Palermo (pranë kështjellës sot) ishte një gropë e thellë ku mendohej se rronte Lubia (Arkivi vetjak i familjes Gjoni. Mblodhi Irena Gjoni nga Maro Kodhima, 84 vjeçe, Qeparo 1996). Qeniet gjysmë kafshë e gjysmë njeri popullonin edhe shpellat buzë detit. Ato ishin tinzare e të fuqishme dhe lëshonin klithma. Po t’u afrohej ndokush, ato dilnin te gryka e shpellës dhe njerëzit iknin të lemerisur. Nuk rrëmbenin as fëmijë, as bagëti. Po t’i shihje këta përbindësia, ishte ogur i keq për të dalë në det (Papleka 2004: 445).

Gryka e Shpellës (Hidronim buzë detit Jon në Lukovë). që e ka marrë emrin nga shpella që gjendet m’u në buzë të detit Jon, është një tjetër vend i rëndësishëm në këtë kategori. Aty përfundojnë ujërat e Përroit të Hundecovës bashkë me Xhindet, që mendohet se jetojnë në to.

Në eposin heroik shqiptar dhe në mbijetojat e mitologjisë së Bregdetit të Jonit, hasen gjurmë të attributeve të mësipërme që u vishen shpellave.



Shpella në Bregdetin e Jonit zakonisht është e pranishme si vendstrehim i personazheve për t’iu shmangur rrezikut:

- a. si një vendstrehim dhe stacion i detyrueshëm,
- b. si një vendqëndrim i përzgjedhur për t’iu shmangur një rreziku evident; dhe
- c. si vendtërheqje, për t’u paraqitur përsëri.

### 1. Shpella e Gramës

Rastin e parë e gjejmë te **Shpella e Gramës**, një ndër shpellat më të rëndësishme në Bregdetin Jonian (mund ta gjejmë të emërtuar edhe shpella e Gramatës). Kjo shpellë është krijuar nga shfrytëzimi i gurores më të madhe të vendit tonë me një hapësirë prej 200000 m<sup>3</sup> me faqe vertikale deri në 50m. I ndodhur në një pozicion të favorizuar, midis ngushticave të Korkyrës dhe Otrantos ku kalonin rrugët e rëndësishme, bregdeti Kaon e pikërisht Grama rrihet edhe prej darëve të antikitetit (si stacion i detyruar).



## Gjiri i Gramës

Në shek. III p. I. K., në faqet shkëmbore të saj ka filluar gdhendja prej detarëve e mbishkrimeve që zgjaten gjatë gjithë anës lindore të Gjirit. Siç e ka vënë në dukje Paçi, mbishkrimet u takojnë kohëve të ndryshme. Duke bërë një klasifikim të tyre, do të dallojmë mbishkrime të shkruara drejtpërsëdrejti në shkëmb dhe të tjera të vendosura brenda një sipërfaqeje katërkëndëshe të thelluar në shkëmb.

### 1.1 Mbishkrimet e Gramës

Gjithashtu, nga mënyra e të shkruarit dallohen mbishkrime të skalitura dhe një grup më i vogël të shkruara me bojë të kuqe. Një pjesë e mbishkrimeve i përkasin periudhës shek. III – I p. I. K.. Përgjithësisht janë lutje kushtuar Dioskurëve, perëndive mbrojtëse të tyre. Një vend të veçantë zënë edhe figurat e gdhendura në shkëmb ku dallohen anije, një skenë me një kasolle dhe një grua pranë saj, amfora dhe shenja të tjera.

Periudhës së dytë të mbishkrimeve në Gramë i përkasin ato të shekujve VI – XI pas Krishtit. Gjithsej janë rreth 500 mbishkrime (Ceka/ Zeqo 1984/2: 131). Një vizatim na jep një kompozim, një anije e pranë saj figura amforash të mëdha. Njëri vizatim është bërë në një sipërfaqe vertikale të shkëmbit, me një përpunim të bazamentit të poshtëm tamam si për vendqëndrim (Zeqo 1986: 135). Mendoj se kemi të bëjmë me nderimin e kultit të ujit të pijshëm të paraqitur simbolikisht me figurën e amforës, enës ujëmbajtëse.

## 2. Shpella Halile

Në atributin, si një stacion i detyrueshëm, është edhe **Shpella e Halile**. Horaci na dëshmon se “Shkëmbinjtë Akrokeraunianë janë shumë të famshëm për shkatërrimin e anijeve” (shek. I p. e. s.) (Pukëvil 1999: 66). Në tabelën e Pentigerit, një hartë rrugore e shek. III – IV, Acroceraunia përmendet si një stacion i rëndësishëm në rrugën nga Aulona në Foinike, për në Nikopol. Traseja e kësaj rruge dhe mure mbështetëse të saj, ruhen në Shpellën e Halile, në të vetmin shteg natyror, midis fushës së Qeparoit dhe të Borshit (Koçi

2006: 5). Sipas gojëdhënës, në këtë shpellë duhej bërë një pushim si një nderim ndaj hyut të udhës.

## 3. Shpella e Haxhi Aliut

Shpella, si një vendstrehim i përzgjedhur për t’iu shmangur një rreziku evident, është ajo e **Haxhi Aliut**. Konsiderohet si një ndër shpellat më të mëdha në bregun e Jonit e legjendarizuar në folklorin detar shqiptar. Kënga popullore e quan këtë detar “Hyri të detit” (është fjala për një figurë mitologjike femër që përfaqëson detin, një Posejdon femër). Shpella e Haxhi Aliut, nga arkitektura e saj shkëmbore, të kujton përshkrimin që i bën Homeri shpellës së Polifemit. Brenda shpella i ngjan mjedisit të një katedraleje gotike që kulmohet deri në 60m. Në hyrjen e shpellës, në thellësi 40m, janë gjetur amfora të shekujve V – II p. I. K.. Në thellësi 8 – 9m duke zbritur, duket një grykë tjetër nën ujë, një shpellë e cila quhet me kate. (Zeqo 1986: 67-68).

Emërtimi i myslimanizuar tregon për mbishtresëzimet fetare dhe për përdorimin funksional të këtyre shpellave edhe në kohë më të vona. Sipas M. Zeqos, Haxhi Aliu te kjo shpellë fuste anijen e tij, derisa u vra nga venecianët:

*“Haxhi Aliu me të birin*

*Porsi mbreti me të birin”.*

Këto dy vargje, të mbledhura nga Thimi Mitko, tregojnë se mbretëria e këtij detari me të birin, ishte deti e brigjet e tij. (Mund të jetë shpella e vendstrehimit të detarit ulqinak Haxhi Alia, me çka përkon edhe emri i të vrrarit nga venecianët rreth vitit 1710). (Shuteriqi 1959: 93).





### Shpella e Haxhi Aliut

Heronjtë e eposit heroik strehohen nëpër shpella, njësoj si Haxhi Aliu i mitologjisë bregdetase të Jonit. Gati edhe konteksti i strehimit është i njëjtë: Muji e Halili të mos e paguajnë haraçin, kurse Haxhi Aliu të mbetet gjallë.

#### 4. Shpella si vendstrehim

Shpella është konsideruar edhe vendstrehim i dashnorëve (Haxhihasani/ Sako 1966: 283), si është rasti i strehimit të Halilit me të dashurën e tij Tanushën, që të mos zbulohet nga ndjekësit:

*"Met e foli nusja pej oxhaku:*

*- Mos ki dert, thotë, Sokole Halili!*

*Kam ndi babën, tha, dert-e tu e ba:*

*"Me ba mreti ndojherë me na ra,*

*ën qet bjeshk-e ni shpellë qi e kam,*

*për tri vjet-e myhmat qi ka,*

*topi as pushka s'kanë ca me na ba.*

*Msyje shpellën, Halil! i ka thanë"* (Çetta 1974: 6).

Sipas teorisë së iniciacionit, me këtë rast do të flitej për iniciacionin e dasmës, me hyrjen e iniciantëve në botën e kaosit, vdekjen e përkohshme, si konsiderohet ky akt, dëshirohet të rilindet në një status social tjetër.

Në këtë kontekst shpella është vendburgosja e të Bukurës së Dheut nga Kuçedra, për shpëtimin e të cilës do të angazhohet i Bukuri i Dheut, personazhe të shpeshta të përrallave shqiptare dhe jo vetëm shqiptare, por edhe të popujve të tjerë.

Shpella në folklor, zakonisht është e pranishme jo vetëm si vendstrehim i personazheve për t'iu shmangur rrezikut, por ka edhe atributin ritual të transformimit të statusit të njeriut, kur bëhet fjalë për teorinë e iniciacionit, si dhe të mbretërisë së ndonjë luftëtari. Në eposin heroik ajo zë një vend të rëndësishëm, ka një rol të veçantë dhe ndërlihet me jetën dhe veprimet e personazheve. Paraqitet edhe si qendër e botës dhe "simbol i kozmosit." Por edhe vendtakim i individuale me hyjnoren, pra i takimit të botës njerëzore me atë qiellore.

Shpella në eposin heroik shqiptar shërben edhe si vendburim i forcës fizike. Në shpellë Mujin e kohnë orët "me tamël gjini" ose me lëng lulesh dhe e transformojnë nga një qenie njerëzore, në një kolos mitik:

*"Larg ni shpellë sa ni dritë e ki pa;  
shkoi pas drite e shpelln e ki gjetë,  
qaty bajke konak për me fjetë"* (Çetta 1974/1: 2).  
Këto vargje mund të interpretohen edhe si faza e "vdekjes së përkohshme", por këtu nuk bëhet fjalë për fazën e iniciacionit të Mujit, edhe pse pas daljes nga shpella ky ndryshon statusin e tij: fiton forcë kolosale, në sajë të qumështit që i kishin dhënë zanat si shenjë falenderimi për kujdesin që tregoi për foshnjat e tyre. Muji tani fiton një status të ri dhe me këtë rast ndërron edhe emrin, sepse ia kërkonte pozita e re shoqërore:

*"E terno ai emnin e babs t'vet,*

*ja ka ngjitë as posestrima e vet –*

*"Mujë" i tha, e Mujë, besa i ka petë,*

*me qat emen ka rrnuu 'iqin vjet.*

*E ka njoftë, po, besa, krajl e mret"* (Çetta 1974/1:3)

Shpella ka edhe atributet e ringjalljes: heronjtë e eposit heroik shqiptar, kur u kalon koha, tërhiqen në shpellë, për t'u rikthyer përsëri kur të paraqitet nevoja.

Po kështu në Bregdetin e Jonit e përmendur dhe e rëndësishme është edhe **Shpella e Piratëve** me gojëdhënat e saj. Apo **Shpella e Pëllumbave**, një vepër arti e natyrës, simbiozë pasionante e skulpturore e detit dhe e gurit. Emërtimi i saj e fut te kategoria e shpellave që kanë një lidhje mitike, si dhe Shpella e Dukë Gjoni me shumë mbishkrime të lashta (Zeqo 1986: 67-68, 160).



Shpella e Dukë Gjoni Karaburun

**Përfundim**

Siç e shohim, shpellat janë të pranishme si në mitologjinë e Bregdetit të Jonit, ashtu edhe tek areale të tjera mitike. Mes tyre vërehen pika të përbashkëta, por edhe dallime. Ndër të përbashkëtat veçojmë:

1. Tek të dyja mitologjitë, shpellat ruajnë karakterin e tyre të egër.
2. Paraqitja e tyre veçon dhe përpunon disa nga anët e vendkultit e faltores.
3. Kryesisht popullohen nga shumë hyjni që i përkasin së njëjtës kategori (zanat, xhindet, nimfat, eriniet).
4. Hyjnitë që i popullojnë, përgjithësisht mbartin një konotacion frike.
5. Tek të dyja mitologjitë, shpellat shërbejnë si rrugë lidhëse drejt Hadit.

Ndërsa përsa u përket prioriteteve përmes dallimeve, mendoj se:

1. Shpellat e Bregdetit të Jonit janë shpella në buzë të detit dhe mund të jenë më të hershme si vendkulte, sesa shpellat e arealeve të tjera mitike.
2. Këto të fundit, mendoj se kanë një prioritet përsa i përket popullimit të tyre nga disa prej hyjnive që janë ndër më të rëndësishmet në mitologji si: Zeusi, Dionisi, Pani (paçka se mund të ishte një popullim momental).

3. Shpella në Bregdetin e Jonit zakonisht është e pranishme si vendstrehim i personazheve për t'iu shmangur rrezikut:

- a. si një vendstrehim dhe stacion i detyrueshëm,
- b. si një vendstrehim i përzgjedhur për t'iu shmangur një rreziku evident.

**BIBLIOGRAFIA**

- ARKIVI vetjak i familjes Gjoni.
- BREWSTER, H. (1997), *The river Gods of Greece; Myths and Mountain Waters in the Hellenic World*, London and New York.
- Ceka, N. / Zeqo, M. (1984/2), *Mbishkrimet e Gramës: Monumentet*, Tiranë.
- ELIJADE, M. (1992), *Aspekti na mitot*, Kultura, Skopje.
- GJIPALI, I. (2004), *Kërkime arkeologjike në bregdetin Jonian*, Tiranë.
- LAMPIC, M. (1999), (Përgatitur), *Mali recnik tradicionalnih simbola*, Beograd.
- LARSON, J. (2001), *Greek Nymphs: Myth, Cult, Lore*, Oxford.
- PAPLEKA, A. (2004), *Deti dhe ulliri në traditën gojore të Bregut: Himara në shekuj*, Tiranë.
- PUKËVIL, F. (1999), *Në oborin e Vezirit të Janinës*, Tiranë.
- TIRTA, M. (2004), *Mitologjia ndër shqiptarë*, Tiranë.
- ZEQO, M. (1986), *Motive arkeologjike*, Tiranë.

---

---

## THE TYPOLOGY OF THE ANCIENT CITY OF ANTIGONEA TIPOLOGJIA E QYTETIT ANTIK ANTIGONE

KLODIAN GJONI

Ministria e Turizmit, Zyra Rajonale e Kulturës Kombëtare, Sarandë, Shqipëria  
e-mail: klodgjoni@yahoo.com

### PËRMBLEDHJE

Objekti i këtij studimi është tipologjia e qytetit antik Antigone, i njohur si një ndër qytetet kryesore të Kaonisë, i cili ka tërhequr vëmendjen e historianëve e të arkeologëve të ndryshëm. Qyteti antik i Antigonesë në historinë e tij është i lidhur me Pirron dhe të shoqen e tij të parë Antigonea. Antigonea përbën etapën e fundit në rrugën e gjatë të formimit të qyteteve ilire – epirote. Më 295 para Kr. Pirrua për nder të Antigonesë ndërtoi qytetin e Antigonesë. Antigonia ishte vajzë e fisnikëve maqedonas Vereniqi dhe Filipi. Si themelim i njëhershëm qyteti Antigoneinon dallohet nga realizimi i një ideje të vetme urbanistike me ndarjen e sipërfaqes në katër zona kryesore: ushtarake me Akropolin, zonën e banuar, agoranë dhe një zonë të lirë për strehimin e popullsisë fshatare në rast rreziku. Sipas modeleve të qyteteve të kohës, zona e banuar në Antigone ndahej nëpërmjet kryqëzimit të rrugëve të gjera në parcela banimi në forma katërkëndëshe 51 m x 102 m, me nga tetë shtëpi secila. Qyteti ishte i organizuar në katrorë ndërtimi në bazë të sistemit urbanistik bashkëkohor. Muri ka qenë i përforcuar me një numër të konsiderueshëm kullash, nga të cilat janë ruajtur në gjendje të mirë vetëm tetë. Një tog tesarash të rrumbullakta prej bronzi me mbishkrimin "ANTIGONEAN" janë objektet që dëshmojnë dhe shërbejnë si dokumenti i parë epigrafik që identifikon qytetin. Antigonea, e dyta në madhësi dhe rëndësi si qytet i Kaonisë së lashtë pas Foinikes, kontrollonte rrugët e famshme që bashkonin Apoloninë dhe Aulonën me rrafshin e Janinës dhe Epirin e Jugut. Në sajë të vendndodhjes gjeografike merr rëndësi të madhe ky qytet, afërsisht në mesin e luginës së Drinos, duke njohur një kulm zhvillimi të paparë. Antigonea ka përjetuar ngjarje të rëndësishme historike. Më 168 para Kr. si gjithë qytetet e Epirit dhe ajo u dogj nga Paul Emili romak. Kjo djegie i solli shkatërrime të pallogaritshme. Si përfundim, studimi i materialit arkeologjik dhe i monumenteve të zbuluara, dëshmojnë për tipologjinë e qytetit antik Antigonea dhe për rëndësinë e tij.

**Fjalët çelës:** qytet antik, Antigone, Pirro, Epir, urbanistikë, material arkeologjik, mbishkrim.

### SUMMARY

The object of this study is the typology of the ancient city of Antigonea, known as one of the main cities of Chaoniav, which has attracted the attention of different historians and archaeologists. The City of Antigonea in its history is connected with Pyrrhus and his first wife Antigonea. Antigonea constitutes the last step on the long road to forming Illyrian - Epirus cities. In 295 BC. Pyrrhus in honor of Antigona built the city of Antigonea. Antigona was the daughter of Macedonian nobles Vereniqi and Philip. As the simultaneous establishment Antigoneinon, the city was distinguished by the realization of a single idea sharing the urban area in four main areas: the military area with Acropolis, the inhabited area, agora and a free area to accommodate the rural population in case of danger. According to models of cities, the inhabited area in Antigonea was separated by broad streets intersect residential plots in rectangular form 51 mx 102 m, with eight houses each. The city was organized in square building under contemporary urban system. The wall has been reinforced with a number of towers, which are preserved in good condition only eight. A medical card round mound of brass with the inscription "ANTIGONEAN" are objects that testify and serve as the first epigraphic document that identifies the city. Antigonea, second in size and importance as the ancient city after Foinike, controlled famous streets of Apollonia and Aulona join the Plains and Southern Epirus Ioannina. Due to geographical location takes great importance this city, roughly in the middle of the valley Drinos, recognizing a peak unprecedented development. Antigonea has experienced significant historical events. On 168 BC. like all cities of Epirus and it was burned by Emily Paul Roman. It burns brought incalculable mischief.

In conclusion, the study of archaeological material discovered monuments attest to the typology of the ancient city Antigonea and its importance.

**Key words:** ancient city, Antigone, Pyrrhus, Epirus, urbanization, archaeological material, inscription.

## HYRJE DHE PAK HISTORI



Objekti i këtij studimi është tipologjia e qytetit antik Antigone, i njohur si një ndër qytetet kryesore të Kaonisë, i cili ka tërhequr vëmendjen e historianëve e të arkeologëve të ndryshëm. Qyteti antik i Antigonesë në historinë e tij është i lidhur me Pirron dhe të shoqen e tij të parë Antigonea. Antigonea përbën etapën e fundit në rrugën e gjatë të formimit të qyteteve ilire – epirote. Më 295 p.e.s. Pirrua, për nder të Antigonesë ndërtoi qytetin e Antigonesë. Antigonion ishte vajzë e fisnikëve maqedonas Vereniqi dhe Filipi. Rezultatet e gërmimeve arkeologjike tregojnë se Antigonea u formua si një qendër e madhe e rëndësishme ekonomike, shoqërore, kulturore e politike, që në fillim të shek III para Kr. Kjo kohë përputhet me periudhën e fuqizimit më të madh politik të shtetit të Epirit. Ajo vazhdoi jetën e saj gjatë gjithë shek III dhe pati një veprimtari prodhuese intensive. Nga fundi i këtij shekulli dhe fillimi i shek. II para Kr., Antigonea u zhvillua si polis (qytet-shtet). Në vitin 198 para Kr. afër Antigonesë legjionet romake mundën ushtrinë e mbretit të Maqedonisë Filipo V.

Antigonea ka përjetuar ngjarje të rëndësishme historike. Më 168 para Kr. si gjithë qytetet e Epirit, edhe ajo u dogj nga Paul Emili romak.

## ASPEKTI GJEOGRAFIK

Qyteti i Antigonesë ndodhet në Shqipërinë e Jugut, në një luginë shumë të pasur me monumente arkeologjike (Budina 1/1985: 151), në një mjedis gjeografik të përshtatshëm për zhvillimin bujqësor e blegtoral, në udhëkryqe të rëndësishme tregtare (Budina 1/1985: 157).

Lugina e Drinos formonte një njësi gjeografiko – etnografike të veçantë brenda krahinës së gjerë të banuar nga kaonët epirotë, njësi e cila ka pasur padyshim dhe vlera ekonomike e politike të veçanta. Qyteti antik i Antigonesë në historinë e tij është i lidhur me Pirron dhe të shoqen e tij të parë Antigoneën.

Antigonea, e dyta në madhësi dhe rëndësi si qytet i Kaonisë së lashtë pas Foinikes, kontrollonte rrugët e famshme që bashkonin Apoloninë dhe Aulonën me rrafshin e Janinës dhe Epirin e Jugut. Në sajë të vendndodhjes gjeografike me rëndësi të madhe, Antigonea, afërsisht në mesin e luginës së Drinos, njohu një kulm zhvillimi të lartë.

Qyteti antik i Antigonesë ka pamjen e një delfini, pasi ndodhet midis dy kreshtave që lidhen me njëra-tjetrën nëpërmjet një qafe të ngushtë. Kreshta e anës veriore me lartësi 700m mbi nivelin e detit ka në majë një shesh të vogël, kurse kreshta jugore e lartë 600m është e formuar nga një numër terracash që palosen me njëra-tjetrën.

## TIPOLOGJIA E QYTETIT TË ANTIGONESË

Antigonea përbën etapën e fundit në rrugën e gjatë të formimit të qyteteve ilire – epirote. Antigonea bën pjesë në tipin e qyteteve me akropol të mbrojtur me një mur të vetëm rrethues. Muri ka qenë i përforcuar me një numër të konsiderueshëm kullash, nga të cilat janë ruajtur në gjendje të mirë vetëm tetë. Ato janë në planimetri drejtkëndëshe dhe të ndërtuara me të njëjtën teknikë dhe stil sikurse edhe vetë muret rrethuese. Të dhënat stratigrafike dhe veçoritë stilistike të murit e

datojnë rrethimin e qytetit në fillim të shek. III p.l.k. në të mirë të datimit tonë, përveç të tjerave, flet dhe gjetja e disa monedhave prej bronzi të Argosit, të Amfilohisë, të qyteteve të Peloponezit e të Maqedonisë, si pranë mureve rrethuese ashtu edhe në belat e fundit në sektorët e gërmuar.

Sipërfaqja urbane e qytetit brenda dhe jashtë mureve fortifikues llogaritet në rreth 60 ha. Pas plotësimit të veshjes së jashtme të mureve rrethuese, vëmendja e ndërtuesve u kthye nga pamja e brendshme, duke përdorur për këtë mjetet financiare të krijuara nga grumbullimi i pasurisë si rrjedhim i fushatave ushtarake në Epir, apo nga përfitimet ekonomike të një periudhe të qetë në Ilirinë e Jugut (Ceka 2001: 102).

Si themelim i njëhershëm, ajo që e dallon Antigonenë nga dhjetra qytete të antikitetit, është planimetria kuadratikë dhe mjaft e rregullt urbane. Qyteti dallohet nga realizimi i një ideje të vetme urbanistike me ndarjen e sipërfaqes në katër zona kryesore: 1. Ushtarake me Akropolin, 2. zonën e banuar, 3. agoranë dhe 4. një zonë të lirë për strehimin e popullsisë fshatare në rast rreziku. Zona e banuar në Antigone ndahej nëpërmjet kryqëzimit të rrugëve të gjera në parcela banimi në forma katërkëndëshe 51 m x 102 m, me nga tetë shtëpi secila. Një rrugë me gjatësi 900 m dhe gjerësi 4,80 m përbënte aksin urbanistik të qytetit nga lindja në perëndim, duke lidhur dy portat kryesore të tij. Në drejtim të kundërt e priste atë një tjetër plateia – rrugë kryesore me gjerësi 6,80 m, që lidhte dy hyrje të tjera kryesore dhe përshkonte agoranë. Kjo e fundit është vendosur njësoj si në Kasope e Bylis, në anë të qytetit, me pamjen e hapur ndaj luginës dhe në kontakt të drejtpërdrejtë me rrethinat fshatare të qytetit.

Nga hyrjet e qytetit është zbuluar deri tani vetëm një. Kjo është një portë e vogël 1 m e gjerë dhe paraqet tipin e hyrjeve të thjeshta me një korridor ose udhë kalimi të formuar nga ndërprerja e murit rrethues.

Sipas modeleve të qyteteve të kohës, disa dhjetëvjeçarë pas themelimit të saj, Antigonea u mbush me popullsi dhe fitoi përparësi mbi qendrat më të hershme qytetare të krahinës në saje të një

veprimtarie zejtare dhe tregtare. Si qendër e një koinoni të veçantë, qyteti luajti edhe një rol historik në ngjarjet e fundit të shekullit (Ceka 2001: 100-101).

Përsa i përket rregullimit të brendshëm urbanistik, është akoma herët të japim një mendim të prerë, meqenëse deri tani gërmimet janë të veçuar nga njëri-tjetri. Megjithatë që tani duket qartë se plani urbanistik i qytetit duhet të ketë pasur për bazë vetë relievin tarracor të kodrës. Në dy prej tarracave të gërmuara që gjenden, njëra afërsisht në qendër të qytetit dhe tjetra në veri të tij, janë zbuluar dy blloqe, të përbëra nga 2- 3 banesa. Këto blloqe kanë forma drejtkëndëshe dhe zënë sipërfaqe të mëdha nga 625 m<sup>2</sup> deri 1400 m<sup>2</sup>. Përmasat dhe sipërfaqja e blloqeve të Antigonesë afrohen shumë me ato të shumë qyteteve të tjera të Greqisë helenistike (Krizhinski 1968: 104). Deri tani janë zbuluar në Antigone tetë banesa me sipërfaqe relativisht të mëdha që shkojnë nga 180- 650 m<sup>2</sup>. Sipas planimetrisë dhe ndërtimit të tyre të brendshëm, ato paraqiten në disa tipe.

Tipi i parë përfaqësohet nga banesa me oborr katërkëndësh peristil, rreth të cilit janë vendosur dhomat me destinacione të ndryshme. Këtë tip e përfaqëson shtëpia e banimit 1 e zbuluar në qendër të qytetit, që zë një sipërfaqe prej 650 m<sup>2</sup>.

Elementi karakteristik në këtë tip banese është portiku që gjendet në anën lindore të oborrit dhe që të kujton një komponent të rëndësishëm në tipin e banesave pastas (Prendi 1972: 88). Kështu kemi një tip banese peristil- pastase, që mund ta konsiderojmë si veçori lokale në artin e ndërtimit të Antigonesë.

Banese formohet prej 6 dhomash të grupuara, tri në anën veriore dhe tri në anën lindore. Dy dhomat anësore të ansamblit lindor kanë shërbyer për pritje, ndërsa ambienti i mesit si korridor ose hajat që lidh këto dy dhoma. Tri ambientet tjera të anës veriore të oborrit kanë shërbyer si anekse për ekonominë shtëpiake.

Pragu që zë të gjithë gjatësinë e anës perëndimore të ambientit të mesit, të anës lindore, ka shërbyer si sti lobat mbi të cilin ngriheshin katër shtylla të stilit dorik të punuara

prej guri gëlqeror konglomerat. Shtyllat bashkë me pilastrat dhe kapitelet kanë një lartësi prej 2.66 m. Në mes të çdo dhome u zbulua nga një bazament i ndërtuar me gurë që kanë shërbyer si mbështetje e kolonave për mbajtjen e çatisë. Në një pjesë të murit të dhomës anësore u gjetën edhe gjurmë suvatimesh.

Një tip të dytë formojnë banesat me oborr dhe portik në njërin ose në të dy krahët. Këto të kujtojnë tipin pastas të banesave greke, i cili është i njohur edhe në Maqedoni, Thraki, etj.. ((Prendi 1972: 89)

Këtij tipi i përket banesa 5, portiku i së cilës gjendet në anën veriore, ndërsa përreth janë vendosur në dhomat e ndryshme. Në të dy rastet shtyllat e portikëve kanë qenë prej druri.

Tipi i tretë përfaqësohet nga banesa e mbyllur pa oborr, me një korridor të ngushtë e të gjatë, me dhomat përbri tij ose nga banesa pa korridor me planimetri të zakonshme. Këtij tipi në Antigone i përkasin banesa nr. 3 dhe banesa nr. 6.

Në lidhje me planin e brendshëm urbanistik dhe arkitekturën e banesës qytetare ilire në periudhën helenistike, disa të dhëna të rëndësishme i kemi nga qyteti i Antigonesë. Në këtë qytet të madh antik janë gjetur disa blloqe banesash të kufizuara nga rrugë të gjera që ndërpriten nga njëra- tjetra nën një kënd të drejtë. Blloqet qëndrojnë mbi tarraca të shkallëzuara pak a shumë në mënyrë të rregullt. Nga këto elemente planimetrike krijohet menjëherë përshtypja se qyteti, pavarësisht nga relievi tarracor i tij, duhet të ketë patur një plan të rregullt urbanistik të tipit hipodomik. Elemente të shkëputura të një plani të tillë të rregullt qyteti, kanë filluar, të shfaqen edhe në Dimal, ku është zbuluar një rrugë të gjerë me banesa buzë saj.

Banesat qytetare ndryshojnë nga pikëpamja e detajeve të tyre planimetrike; ka banesa me oborr dhe pa oborr. Banesat me oborr duket se janë të një tipi jo të zhvilluar pastadi dhe peristili. Këto tipe banesash qytetare të përhapura edhe në krahina të tjera periferike të botës së Egjeut si në Thraki, Maqedoni dhe Epir, janë produkt i ndikimit të drejtpërdrejtë të banesës së vjetër greke; por krahas këtyre ndeshen dhe banesa të mbyllura pa oborr, për të cilat është vështirë të

thuhet me siguri nëse janë ndikim apo vazhdim i traditave të banesës lokale.

Banesat në qytetet tona ilire ndërtoheshin, siç duket, poashtu sikurse edhe në Antigone, me skelete druri të mbushura me qerpiç dhe të ngritur mbi xokol muri, teknikë kjo e njohur, jo vetëm në Greqi dhe në vendet periferike të Egjeut, por dhe në lindjen e afërme dhe deri në Evropën Qendrore. Në Iliri ndërtohej pra sipas një tradite të vjetër të përbashkët (Prendi 1974: 117).

## GJETJET ARKEOLOGJIKE NË ANTIGONE

### Foto e Peristilit



Një tog tesarash të rrumbullakta prej bronzit me mbishkrimin "ANTIGONEAN" janë objektet që dëshmojnë dhe shërbejnë si dokumenti i parë epigrafik që identifikon qytetin. Territori i qytetit antik ka qenë i rrethuar me mure të forta me gjatësi rreth 4000 m linear që mbronin qytetin nga të gjitha anët e sidomos në pjesën jugore dhe perëndimore, ku rrezikohej më tepër për vetë natyrën e terrenit. Kodra më e lartë lidhet me vendbanimin me anë të një korridori 4m të gjerë, të formuar nga dy linjat e mureve rrethuese. Shumica e banesave janë të ngritura me blloqe të mëdha e mesatare të gurëve gëlqerorë, të nxjerra nga shtresat shkëmbore të malit të Lunxhërisë. Janë zbuluar 10 objekte private, rrugë të shtruara me pllaka, tubacione të ujërave të zeza dhe trotuare si dhe një tunel, i cili përbënte një nga ndërtesat e tregut. Rruga qendrore me gjerësi afro 6 m e përshkonte këtë qytet në gjatësi të paktën një kilometër nga hyrja veriore deri tek ajo jugore.

Nga zbulimet arkeologjike në këtë qytet të tërheq vëmendjen inventari i pasur zejtaro-bujqësor. Ai përbëhet nga kosore, kosa, drapërinj, dalta, sqepare, çekiçë, kompase, vegla për regjien e lëkurëve, enë të ndryshme prej bronzi, të zbuluara me figura plastike zoomorfe ose me figura mitologjike siç është ajo e Poseidonit, Sfinksit apo Serenas. Një pjesë e këtyre objekteve pa dyshim janë prodhime vendi, gjë që e tregojnë edhe vetë punishtet në të cilat janë gjetur. Veglat e ndryshme zejtare tregojnë se ishin zhvilluar dhe degë të tjera të zejtarisë si punim i lëkurës, gurëskalitja, punimi i drurit etj. Ka pasë një zhvillim të gjerë të prodhimit të qeramikës. Repertori i qeramikës përbëhet nga objekte të poçarisë të cilat riprodhojnë në përgjithësi tipare të njohura të poçarisë, të punishteve qytetare ilire si dhe ekzemplarë të qeramikës artistike si: terrakota, antefiksa e rozeta. Nga prodhimi i objekteve artistike metalike vlejën për t'u përmendur figura e Poseidonit dhe ajo e Sfinksit të punuara me mjeshtëri sipas stilit të epokës. Të gjitha këto tregojnë se Antigonea ka qenë një qendër e zhvilluar zejtare me një larmi zejsh (Budina 1/1985: 156). Zhvillim të madh në Antigone kishte marrë farkëtaria. Kudo në gërmime janë gjetur sasira të konsiderueshme zgyre, hekuri, vegla të ndryshme pune, materiale ndërtimi dhe deri punishte të veçanta hekurpunuesish. Në qytet funksiononin dhe punishte artizanale ku prodhoheshin objekte të ndryshme bronzi, vegla pune, stoli, figurina të ndryshme kafshësh, perëndish, atletësh. Janë gjetur vula prej balte për dekorimin e qeramikës, kallëpe të medaljoneve (Prendi 1972: 117-118). Gjithashtu në Antigone janë zbuluar 800 monedha, pjesa më e madhe e të cilave janë të Koinonit të Epirit, kurse të tjerat i përkasin Ambrakisë, Korinthisë, Maqedonisë, Dyrrahut, Apolonisë, Bylisit, Orikut, Korinthisë, Argosit, Larisës, qyteteve të Peloponezit dhe Ahesë së Tarentit etj.. Zbulimi i disa copave prej bronzi në trajtë monedhash me diametër të barabartë me atë të monedhave të Epirit, na shtyn në mendimin se Antigonea ka prerë vetë monedha. Nëpërmjet këtyre treguesve numizmatikë shprehen qartë marrëdhëniet e ngushta tregëtare që ekzistonin

midis Antigonesë dhe qyteteve e shteteve të tjera helenistike.

Shtëpia nr. 3 zë një sipërfaqe 275 m<sup>2</sup>. Në një nga kthinat e kësaj banese, nën tjegullat e rrëzuara të çatisë, u zbuluan vegla pune metalike, zgyrë hekuri, bronzi e plumbi, që tregojnë se kjo kthinë shërbente si punishte e një artizani metalpunues të quajtur "Pirro".

Banese nr. 6 ka një sipërfaqe prej 245 m<sup>2</sup>; formohet prej një korridori të gjatë dhe nga 6 dhoma. Ndryshe nga ambientet e tjera të kësaj banese të përdorur për qëllime shtëpiake, dy ambiente prej tyre qenë lënë në shërbim të punishtes së lëkurëpunuesit. Në dyshemenë e njërit nga këto ambiente u zbuluan brenda në tokë pesë qypa me grykë të gjerë të haptë. Gjetja në disa prej tyre e krueseve të mëdha prej hekuri të lëkurëregjësve dhe e veglave të tjera për prerjen dhe rrahjen e lëkurës, dëshmon fare qartë se për ç'qëllim u përdor ky ambient. Ambiente të tilla kanë pasur, siç duket funksion të dyfishtë, si punishte dhe si dyqan, duke qenë të lidhura dhe me vetë banesën. Banese të tilla të pajisura me dyqane punishte janë të njohura në qytetet greke të Prienes, Olimpisë dhe në disa qytete provinciale (Krizhinski 1968: 104).

Duke gjykuar nga mbeturinat e banesave të zbuluara, mund të pranohet se banesat kanë qenë njëkatëshe. Banesat e Antigonesë kanë qenë ndërtuar me një xokol gurësh të lidhur me baltë; xokoli është ngritur me gurë të zakonshëm paksa të punuar, ose dhe me blloqe paralelopipedi të trajtuar njëllor si edhe blloqet e mureve rrethuese. Mbi këto themele guri ngrihej banesa me patavra druri të suvatuara me baltë, siç mund të shihet nga zbulimi i shumë copave prej balte të pjekur me gjurmë patavrash, nga kllapat prej hekuri me përmasa të mëdha dhe nga gozhdët e hekruta.

Në ndërtimin e banesave në Antigone, një veçori që u imponua nga vetë karakteri i thyer i terrenit, është roli i dyfishtë që luan muri i shpinës së banesave, i cili shërbente si mur mbajtës i terracës dhe si pjesë e mureve perimetrale të banesave. Ky funksion i dyfishtë përcaktonte dhe vetë trashësinë më të madhe të këtij muri kundrejt pjesëve të tjera.

Ndarja e banesave brenda bllokut bëhej në dy mënyra; me mur ndarës të përbashkët, ose me një rrugicë të kalueshme që shërbente edhe për përcjelljen e ujërave të çatave në sistemin e kanalizimit të qytetit.

Dyshemetë e banesave të zbuluara këtu janë në përgjithësi prej balte të ngjeshur dhe rrallë me rrasa guri (Budina 1974: 415).

Çatitë e banesave të Antigonesë kanë qenë të mbuluara me tjegulla solene dhe kaliptere. Në dallim nga qendrat e tjera ilire si Dimali, Irmaj, Amantia, etj, këtu solenet përbëjnë një numër të kufizuar. Kjo tregon se në Antigone për mbulesën e banesës është përdorur më tepër tjegulla e tipit kalipter. Deri tani nuk kemi gjetur ndonjë tjegull të plotë që të na japë përmasat e saj. Për këtë mund të gjykojmë në mënyrë të tërthortë nga tjegullat e mbulesës së një varri të veçuar, të zbuluar jashtë qytetit, në bregun e Latovishtës, të cilat janë të njëjta me ato të qytetit.

Këto forma tjegullash në përgjithësi janë konsideruar si forma kalimtare midis kaliptereve të periudhës helenistike dhe atyre të shek. I p.l.k. (Mano 1961: 65). Në Antigone këto lloj tjegullash kanë qenë përdorur mesa duket që në shek. III p.l.k., meqënëse janë gjetur në shtresa kulturele të datuara mirë, të shek. III- II p.l.k. Shpeshherë gjatë gjurmimeve kalipteret janë zbuluar së bashku me solene helenistike.

Më së fundi, zbulimi i tjegullave të këtilla në varre, me monedha të shek. III- II p.l.k., na shtyn të mendojmë se këto lloj tjegullash kanë qenë prodhuar e përdorur së paku nga shek. III p.l.k.

Banesat megjithëse paraqesin tipe të ndryshme dhe konstruksione jo gjithnjë të njëjlojta i përkasin një periudhe të vetme dhe pikërisht shek. III- II p.l.k. (Budina 1972/2: 346). Ndryshimet në konstruksionet e banesave duhen lidhur me gjendjen e ndryshme sociale të banorëve të saj. Pikërisht banesa e tipit peristil-pastas me dimensione të mëdha dhe me ndërtimin e vet solid dhe dekorativ, në krahasim me banesat e tjera, shpreh diferencimin social të banorëve të Antigonesë (Budina 1974: 417).

Një gjetje e rëndësishme në Antigone, janë edhe mozaikët. Mozaiku përbën veprën artistike më të rëndësishme që është zbuluar në fushën e

pikturës në Antigone dhe zonën përçark saj. Mozaiku i Antigonesë që në vështrim të parë të befason me stilin dekorativ dhe me motivin e tij antropozoomorf.

Mozaiku është i aplikuar në dyshtemenë e një kishe trikonkëshe me përmasa 15x10m, të orientuar me altar nga Lindja. Kisha ndodhet në skajin juglindor të qytetit. Të njëjtin pozicion zë edhe tempulli i hershëm në Amantie i adaptuar nga një godinë e vjetër (Anamali 1972: 70).

Drejtimi gjatësor i planit të saj përputhet plotësisht me lëvizjen e besimtarëve që hynin nga dera e hapur në faqen e ngushtë (Dhamo 1981/1: 141), ndryshe nga bazilikat romake që e kishin hyrjen në faqen anësore dhe synonin në drejtim të altarit, atje ku afërsisht ndodhet emblema, kuadri kryesor i mozaikut të saj.

Dyshemeja është e shtruar me mozaikë me ngjyrë të kuqe, të zezë, të bardhë, kryesisht me origjinë nga formacionet gëlqerorë të zonës përçark. Motivet janë vizatuar me konturë të dukshëm. Ka mjaft motive gjeometrike dhe motive bimore, mes të cilave spikasin trekëndëshat në varg, rrathët e brendashkruar me origjinë pagane dhe ornamente të vona antike si: motivi me gjethe në trajtë zemre. I stilizuar në atë variant që haset në pagëzimoren e Butrintit.



Edhe motivet zoomorfe që përbëhen nga gjarpriinj të trashë, ndoshta për të rënë në sy nga larg, gjithashtu nuk janë të panjohur në vepra të tjera paleokristiane (Dhamo 1981/1: 141).





E pazakontë në këtë kompozim është figura që paraqet qenien fantastike me trup njeriu dhe kokën kafshe, vizatuar me qëndrim thuajse ballor, me këmbët paksa të hapura dhe me kokën e çuar përpjetë e të pajisur me motivin karakteristik të gjetes në formë zemre (foto 3). Gjarpëri pranë duket sikur e ka kafshuar dhe e ka paralizuar me njëren dorë lart e tjetrën poshtë. Motivi antropozoomorf dhe i gjithë mozaiku i Antigonesë ndryshon shumë për nga trajtimi nga mozaikët e tjerë të dyshemeve.



Pranë blloqeve të banesave janë zbuluar edhe dy rrugë magjistrale njëra me drejtim lindje-perëndim, tjetra veri- jug, me gjerësi 6 m, të shtruar me gurë të vegjël e mesatarë. Rruga me drejtim veri- jug ka në të dy anët e saj një trotuar rreth 1 m të gjerë. Këto rrugë ndërpriten në një kënd të drejtë nga rrugë të tjera të tërthorta më të ngushta. Në bllokun e banesave të bregut verior të kodrës është zbuluar një rrugë tjetër e

ngushtë 2 m e shtruar gjithashtu me kalldrëm, e cila ndan banesat ndërmjet tyre.

Rrugët e Antigonesë megjithë ndryshimet që paraqesin nga pikëpamja e ndërtimit, kanë ngjashmëri me rrugët e zbuluara në Apolloni e Dimal (Dautaj 1971: 75).

Qyteti ka pasur edhe një sistem të mirë e të rregullt kanalizimesh. Në mesin e njëres prej rrugëve kryesore u zbulua një kanal i formuar nga katër rrasa guri, i cili mblidhte ujërat e kanaleve të tjera që dilnin nga banesat e ndryshme të vendosura gjatë rrugës.

Kjo mënyrë vendosjeje e rrugëve dhe e blloqeve të banesave buzë tyre, tregon për ekzistencën e një sistemi të rregullt urbanistik pavarësisht nga relievi tarracor i qytetit. Konfiguracioni i terrenit midis tarracave të banimit jep të kuptohet se lidhja midis tyre duhet të jetë bërë me anë shkallësh, pa përfillur aspak rrjetin e drejtë të rrugëve. Kjo na bën të mendojmë për ekzistencën e një sistemi hypodomik në planin urbanistik të qytetit të Antigonesë (Budina 1972/2: 345).

**Si përfundim**, Antigonea bën pjesë në tipin e qyteteve me akropol të mbrojtur me një mur të vetëm rrethues. Ky qytet antik në historinë e tij është i lidhur me Pirron dhe të shoqen e tij të parë Antigonea për nder të së cilës ai e ndërtoi më 295 p.e.s.. Qyteti ishte i organizuar në katrorë ndërtimi në bazë të sistemit urbanistik bashkëkohor. Studimi i materialit arkeologjik dhe i monumenteve të zbuluara, dëshmojnë për tipologjinë e qytetit antik Antigonea dhe për rëndësinë e tij.

#### BIBLIOGRAFIA

- ANAMALI, S. (1972/2), *Amantia, Iliria*, Tiranë.  
 BUDINA, Dh. (1/1985), *Iliria Harta arkeologjike e luginës së Drinos*, Tiranë.  
 BUDINA, Dh. (1972/2), *Antigonea*, Iliria, Tiranë.  
 BUDINA, Dh. (1974), *Antigoneja e Epirit, Kuvendi i Studimeve Ilire*, Tiranë.  
 BUDINA, Dh. (1985/1), *Vendi dhe roli i Antigonesë në luginën e Drinos*, Iliria, Tiranë.  
 CEKA, N. (2001), *Ilirët*, Tiranë.  
 DAUTAJ, B. (1971), *Zbulimi i një rruge magjistrale në Apoloni, Dorëshkrim në arkivin e Sek. Ark.*

*1958 dhe Rezultatet e gërmimeve në Dimal,*  
Buletini Arkeologjik, Tiranë.

DHAMO, Dh. (1981/1), *Figura antropozoomorfe e mozaikut të Antigonesë, Monumentet,* Tiranë.

KRIZHINSKI, S. D. (1968), *Arkitektura Elenisticskih zhilih Domov, Dacia XII.*

MANO, A. (1961), *Qeramika masive e Apollonisë,* Tiranë.

PRENDI, F. (1972), *Urbanizimi i Ilirisë së Jugut në dritën e të dhënave arkeologjike,* Tiranë.

---

## SIMBOLIKA E VDEKJES NË VEPRËN E PENGUARA TË KADARESË DEATH SYMBOLISM IN THE WORK OF KADARE THE PREVENTED

KLOTILDA MARGJEKA

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Histori Filologjisë, Tiranë, SHQIPËRI

klotilda.margjeka@yahoo.com

mail@klotildamargjeka.com

### Përmbledhje

Një ndër qasjet ndaj veprës së I. Kadaresë E penguara është marrëdhënia e jetës dhe vdekjes si lar-mishmëri konceptuale në varësi të mjeshtërisë së të rrëfyerit nga autori me anë të artit letrar, universal dhe simbolikës së të trajtuarit të enigmës më të lashtë që ka shoqëruar njerëzimin, vdekjen. Ky do jetë qëllimi i punimit, i cili strukturohet në disa çështje që janë në funksion të zbulimit të vdekjes së personazhit Linda B. nga personazhet Rudian dhe Migena. Këto çështje do të jenë format intertekstuale të ndërfutjes së dramës, këngëve mesjetare, detajeve estetike, simboleve, shenjave mitike etj., si mjete të lidhura me artin poetik duke marrë përmasa universale dhe simbolizuese. Zbulimi i kësaj vdekjeje shoqërohet me detaje të tjera njerëzore dhe letrare, si: makthet, parandjenjat, ëndrrat të cilat janë të lidhura me jetën dhe vdekjen e njeriut. Ky depërtim kërkon ndërhyrjen e thellë brenda psikologjisë së individit/personazhit që përbën edhe një ndër teknikat e Kadaresë në trajtimin e temave të tij letrare. Pra, kjo do jetë edhe mënyra së cilës do t'i qasemi në këtë punim: trajtimi universal dhe simbolik i enigmës së vdekjes.

**Fjalët çelës:** enigma e vdekjes, arti, universalizimi i vdekjes

### Abstract

One of the approaches to the work of I. Kadare Prevented is the relationship of life and death has a conceptual variety depending on the mastery of telling it from the author through universal literary art and symbolic that has treated the most ancient enigma that has accompanied humanity, death. This will be the purpose of the paper, which is structured on some issues that are in the discovery of the death of Linda B character from the characters Rudian and Migena. These issues will be the forms of introduction of the drama, medieval songs, aesthetic details, symbols, mythical signs etc., as tools associated with the art of poetry taking universal and symbolic proportions. The discovery of this death is associated with other human and literary details, such as nightmares, intuition, the dreams that are related to the human life and death. This insight requires deep intervention into the psychology of the person/ character that is one of the Kadare's technique in the treatment of his literary topic. So this will be the way which will be approached in this paper: universal and symbolic treatment of the puzzle of death.

**Key words:** The enigma of death, art, universalization of death.

### Hyrje

Veprës së Ismail Kadaresë mund t'i qasesh në mënyra të ndryshme duke qenë se paraqet larmi-shmëri konceptuale në varësi të mjeshtërisë së të rrëfyerit. Ai është një ndër autorët që në veprat e tij dominon marrëdhënia e jetës me vdekjen. *E penguara* shihet si një pengim për të jetuar në të gjitha dimensionet e saj »si një “kulturë e dhu-

*nës”, e shtresëzuar në të gjitha nivelet: shtetëror, politik, social dhe etik në shoqërinë komuniste shqiptare» (Asllani 2013/2: 144).*

E ndërtuar mbi zbulimin e “enigmës së vdekjes”, romani mer karakter universal; ku “e penguara” simbolizon pamundësinë për të jetuar jetën, për të ndërë lirinë, për t'u përfshirë në shoqëri, etj., të ardhura nga forca politike. Kjo merr përmasën

e dhunimit të individit në shoqëri e shfaqur me anë të kodit letrar.

Nisma për të zbuluar pse-në dhe si-në e vdekjes së personazhit Linda B. nga personazhet e tjerë, fillon dhe mbaron me ankth, makthe, me parandjenja, ëndrra e deri në halucinacione. Kjo pra arrihet me anë të disa teknikave letrare si: **inter-tekstualiteti i dramës, detajeve estetike (Migena-enigma), simboleve, shenjave mitike etj**, si mjete të lidhura ngushtësisht me artin poetik. *“Ishin nyjëtime të fshehta, të parrëfyeshme, si gjithë enigmat e artit.”* (Kadare 2009: 177).

Është ky koncepti i Kadaresë për artin për ta lidhur ngushtë me teknikën e përdorimit të enigmës së vdekjes si mjet që bën shtjellimin e veprës. Këto teknika do jenë dhe çështjet tek të cilat do të ndalemi në këtë punim, pra strukturimi letrar i zbulimit të enigmës së vdekjes do të organizohet në disa çështje:

- Enigma nëpërmjet Migenës...;
- Drama si formë intertekstualiteti;
- Intertekstualiteti i këngëve mesjetare;
- Simbolika antropologjike (emërtimet gjeografike, simbolika e numrave biblikë, etj).

### 1. Enigma nëpërmjet Migenës...

Romani fillon me rëndësinë që ka marrë vetëvrasja e një vajze, e Lindës B. tek personazhi kryesor Rudiani., që vjen e përhumbe e përhumbe shkallë-shkallë psikologjinë e Rudianit, duke marrë përmasa gati të frikshme. Çdo gjë rreth tij vërtitet mbi këtë vdekje, madje do të ndikonte edhe në artin e tij të dramës së tij. *“Ashtu siç thuhej se jo çdo gjë e keqe nuk vinte veç për keq, prej atij kallëzimi mund të merrte vesh atë që e kishte torturuar më tepër se katër javë radhazi: enigmën e vajzës”* (Kadare 2009: 12). Pikërisht këtu fillon dhe nisma e Rudianit për të zbuluar enigmën, e cila merr karakter gati torturues për personazhin. Kjo është teknikë e njohur a autorit. *“Shumë nga temat e procedurat e Kadaresë përdoren duke filluar me një enigme që duhet zbërthyer.”* (Wood 2011: 177). Në përgjithësi enigmat tek Kadare janë në funksion të **vdekjes**, vetëvrasjes, dënimit me vdekje (*E penguara*), me ngritjen e një të vdekuri nga varri (*Kush e solli*

*Doruntinën*), me gjakmarrjen (*Prilli i thyer*), me vdekjen nga shkaqe natyrore (*Aksidenti*), etj.

Këto enigma apo tema shoqërohen me makthe ashtu si dhe në rastin tonë pra *“do të thotë të hysh në një makth ku s’mund të banojmë, por ndiejmë se ai banon me ne.”* (Eder 2011: 203). Enigma është një nocion, kuptimi i së cilës i varur nga konteksti, ka shoqëruar për vite me rradhë njerëzimin si forma më errët. Enigma e vdekjes është enigma më e madhe që ka shoqëruar njerëzimin për vite e shekuj: ajo është forca më e madhe simbolizuese/universale. Ajo është frikë nga e panjohura.

Personazhi nëpërmjet të cilit do të zbulohet enigma e vdekjes së Lindës B., është Migena. Ky emër është vënë jo rastësisht si emër që do zbulojë enigmën e vdekjes së Lindës B, i cili është një procedim artistik mbi të cilin shtjellohet enigma. Nga vepra: *“Emri i Migenës dhe fjala “enigmë” i flatruan në kujtesë, sit ë donin të lidheshin... Migena, enigma, përsëriti me vete... Ishin vërtet ashtu një anagram. Gjashtë shkronjat e emrit “Migenë”, të renditura ndryshe, jepnin saktësisht “enigmën”* (Kadare 2009: 35).

Enigma e zbulimit të vdekjes së Lindës B. nga Migena pranëvitet me pjesën teatrale që futet si nëntekst në vepër për t’iu paraprirë ngjarjeve të zbulimit të saj. Nga vepra: *“në një rast tjetër, kjo e fundit (Migena) do t’i shkakatonte më shumë ankth se pjesa teatrale”* (Kadare 2009: 10). Pra, kemi lidhjen mes enigmës me dramën e autorit / personazh, Rudianit.

Vendosja e enigmës së vdekjes në terrenin shqiptar e bën edhe më të vështirë zbardhjen e saj. Nga vepra: *“ai tha se që nga koha e vetëvrasjes së kryeministrit, asaj që, siç e dinte tjetri, kishte zbuluar komplotin më të madh në historinë shqiptare, pas çdo vetëvrasjeje, sado e thjeshtë të dukej, mendohej se fshihej zakonisht diçka.”* (Kadare 2009: 26).

Vështirësia me të cilën përballet Rudiani për zgjidhjen e saj shoqërohet me parandjenja dhe ankth. Nga vepra: *“ngrirja në fytyrën e Migenës, tani që e rikujtoi, iu duk e pazbërthyeshme.”* (Kadare 2009: 31).

Fytyra e pazbërthyeshme e Migenës është ajo që konsiston pazbërthyeshmërinë e vetë enigmës së

vdekjes së shoqes së saj. Kjo ngrirje është detaji i gjurmëve që ka lënë vdekja e saj. Nga vepra: *“Dhe asgjë për Migenën, shoqen e ngushtë, që çonte e binte nga Tirana librat për të, kumtet, kodet e fshehta ndoshta.”* (Kadare 2009: 49). Ky ishte mendimi i hetuesisë për Migenën.

Ankthi siç e thamë është ai që i shoqëron personazhet e Kadaresë si shenjë paralajmëruese e diçkaje të keqe që do vijë. Ai është element i pashmangshëm në vërtitjen e enigmës. Tek Rudiani ankthi i zbulimit të vdekjes së saj **merr shka-llëzim rritës**, që nis nga pezmi i mjegullt *“tek zbrazëtia që rritet me shpejtësi”* (Kadare 2009: 19), derisa *“poshtë brinjëve ndjeu një trak”* (Kadare 2009: 20), që vazhdonte të përsëritej edhe më shpesh ku *“pezmi po e kapte përsëri”* (Kadare 2009: 22) derisa *“po jepte shenjat e para të marrëzisë”* (Kadare 2009: 191).

Makthet e Rudiani janë aq të forta sa e çojnë drejt fundit. Kjo është forma me të cilën letërsia procedon vazhdimisht: *“makthi ka një lemeri të pakrahueshme e kjo lemeri mund të shprehet nëpërmjet fabulës, si te Wordsworth-i me beduinin dhe Don Kishotin, apo me gërshërët që presin fijet e zeza, me mbretin e ëndërrës time, me makthet e famshme të Edgar Poe-s etj”* (Borges 2013: 43). Më vonë Borges shtron pyetjen se nëse makthet kanë forcë të mbinatyrshe, pyetje që mbetet pa përgjigje. Kjo gjendje i kishte ndodhur edhe Lindës B. pak para vdekjes, gjë që tregon se vdekja rreth këtij ankthi është e pashpjegueshme.

Nga vepra: *“një hetues i paparë gjer më sot, që kishte frikë, për të mos thënë tmerr, pikërisht nga zbulimi.”* (Kadare 2009: 50); *“Ishin ditët e fundit të maturës, me një atmosferë që dihej, ankthi i të drejtave të studimit, pikëllimi i ndarjes, pengje të mbetura.”* (Kadare 2009: 109). Ishte kjo gjendja që po e shoqëronte Lindën disa ditë para vetëvrasjes, e cila po i rëndonte jetën. Ajo dukej sikur po e priste vdekjen. Zbulimi i gjendjes shpirtërore të Lindës para vdekjes nga Migena zbulon edhe arsytet që e kanë çuar atë drejt vetëvrasjes. Kjo mënyrë zbrëthimi vjen e interpretuar në disa variante që ngrihen duke u hamendësuar nga Rudiani. Çdo frazë e komunikuar nga Migena është çelësi i ngritjes së një varianti nga Rudiani. Pra, pse dhe si vdiq Linda B.?

Vetëvrasja nga kanceri është një hetim hamendësor i Rudiani që e ka zanafillën nga një pjesë e bisedës me Migenën në lidhje me një mamografi të bërë për kontroll. Kjo mund të ishte arsyeja që mund ta ketë çuar Lindën deri në vetëvrasje. Nga vepra: *“Ajo mamografi ndryshonte befas ndryshonte gjithçka në lidhje me vetëvrasjen. Pas një analize që dilte keq, mendimi i parë ishte vetëvrasja. Përse nuk ia thoshte? Ta çlironte nga ai tmerr.”* (Kadare 2009: 105).

Hipoteza tjetër mund të ishte lesbizmi i dy vajzave: Migenës dhe Lindës B. Kjo do të ndikonte aq shumë tek Rudiani sa që do ta çojë në një botë të trilluar e deri në halucinacione apo vdekje. Nga vepra: *“Dramaturgu Rudian Stefa po jepte shenjat e para të marrëzisë.”* (Kadare 2009: 191). Kjo gjendje vështirësohet edhe më tutje për ta çuar drejt një lloji vdekjeje të lënë pezull, të pakuptimtë. Nga vepra: *“Dhe ashtu ndodhi, vajza (Linda) e kapi më në fund, dhe vetëm një çast gishtat e tyre u përkitën, të ftohtë, në terr e mosgjë.”* (Kadare 2009: 213). Kështu mbyllet romani dhe historia e enigmës së vdekjes së Lindës, ku çdo gjë i ka kapërcyer kufijtë e realitetit, ku i vdekuri (Linda B.) kap dorën e të gjallit (Rudiani) për ta marrë me vete drejt vdekjes *“në terr e mosgjë”*.

## 2. Drama si formë intertekstualiteti

Drama në këtë roman është element artistik në funksion të zbulimit të zbrëthimit të enigmës së vdekjes së Lindës B. Ajo ndërtohet si tekst brenda tekstit, pra si formë intertekstualiteti. I përkufizuar si *“lëvizje nëpërmjet së cilës një tekst rishkruan një tekst tjetër”* (Gros 2011: 15), në rastin tonë drama është një teknikë e përpunuar mirë, ku bashkërendohen kohët e lashta të tragjeditive, miteve (Orfeu...) dhe kohëve bashkëkohore (realizmi socialist).

Por si procedohet me të? Ç’funksion ka ai në vepër?

Prirja për të depërtuar në botën tjetër duke marrë kufijtë e ireales shfaqet artistikisht me anë të krijimit të dramës nga personazhi/dramaturg Rudiani. Ajo merr funksion paralajmërues për ngjarjen që do pasojë në vijim. Drama ecën paralel në vepër me ngjarjen, enigmën e vetëvrasjes së Lindës.

Nga vepra: “Në një rast tjetër, kjo e fundit do t’i shkaktonte më shumë ankth se pjesa teatrale.” (Kadare 2009: 10). Rudiani, tipi i personazhit të ngarkuar psikologjikisht me ç’do gjë, do të mbetet mes dy ngjarjeve të pazbërthyeshme për të: enigma e artit dhe ajo e vdekjes.

Nga vepra: “jo vetëm ngulte këmbë se realizmi socialist parimisht nuk mund ta pranonte fantazmën, por çështja shkonte më thellë dhe lidhej me ca ndikime të rrezikshme kohët e fundit, uf...” (Kadare 2009: 46). Këtu fillon dhe paralelizimi i pjesëve tetrale me ngjarjen e vdekjes së Lindës.

Pas marrjes në pyetje nga hetuesi rreth vetëvrasjes së Lindës dhe shënimit të emrit të saj në një libër të Rudianit, ai zgjedh personazhin që do bëhet pjesë e dramës së tij: një fantazmë.

Nga vepra, (për dramën): “Fantazma e partizanit, te bregu i kënetës, në fund të aktit të dytë, shfaqej e palëvizshme në trurin e Rudianit.” (Kadare 2009: 66).

Drama organizohet jashtë realitetit, përtej jetës, aty ku personazhet e vdekura flasin, shprehin ndjesi rreth vdekjes, mënyrës si ata kanë vdekur etj. Kjo i paraprin Rudianit kuriozitetin për të depërtuar thellë mbi vdekjen e përkatësisht mbi vdekjen e Lindës B dhe krijimi i akteve të dramës së tij është pjesë e fantazisë së Rudianit në lidhje me vdekjen e Lindës.

Nga vepra (pjesë e dramës):

“FANTAZMA: Së paku ta di. Isha nëntëmbëdhjetë vjeç. Përse duhej të vdisja?

VRASËSI: Më mirë të mos e dish.” (Kadare 2009: 82).

“VRASËSI: Errësirë, kthehu nga ke dalë!

FANTAZMA: Ky është shkaku. Ai që s’e zbulojnë dot as Markssi, as Bakunini e Plutarku, as Adam Smithi a Berdajevi. Thelbi i zi, ashtu siç emrin e ka në shqip: smira e zezë.” (Kadare 2009: 87).

Kjo pjesë e dramës përkon me ngjarjet e sipërpërmendura, të cilat kanë depërtuar në ndërjegjen e Rudianit. Sa më shumë depërtonte ngjarja në psikologjinë e tij aq më shumë ai po e humbte kontrollin e të krijuarit, të menduarit, të vepruarit. Nga vepra (pjesë nga drama): “Teksti sa vente bëhej më i errët. Fantazma s’më bindet më. Arsyen s’e gjej dot.” (Kadare 2009: 193). “Tjetri ankohet se nuk i bindet fantazma... E dini

ç’kërkon?... Nuse të vdekur.” (Kadare 2009: 200). Kjo gjendje po vërehej edhe tek të tjerët që konceptoheshin si dështime në skenë, si shenja çmendurie të tij.

Nga vepra (mendim mbi dramën, aktet e skenës): “Atëherë s’më mbetet veç ta çoj atë vetë te nusja... Pavarësisht nga lajthitjet e tyre, unë i mbroj shkrimtarët.” (Kadare 2009: 201).

Futja e dramës në ngjarjet e ndodhura në vepër jo vetëm i paraprin atyre, por edhe është mjeti për të depërtuar në psikologjinë e personazhit, arsyet pse ai shkruan, sa ndikon realiteti tek ai, çdo të thotë të jesh i/e penguar për të jetuar, cila është arsyeja e vdekjes së njerëzve kur ajo nuk vjen natyrshëm, çfarë ndodh pas saj etj.?

### 3. Intertekstualiteti i këngëve mesjetare

Procedimi me këngët e vjetra mesjetare, mitet është një tjetër mjet intertekstual në funksion të ngjarjeve në roman, pra vdekjes së Lindës B. Ajo vjen në çdo moment si pasojë e gjurmëve që ka lënë vetëvrasja e Lindës e herë si katarsis për personazhet. Kjo është një tjetër teknikë e krijimtarisë së Kadaresë me anë të arratisjes në kohë e hapësirë me anë të formave të ndryshme. Kujtojmë këngët mesjetare të baladës së vëllait të vogël tek romani *Kush e solli Doruntinën*.

Në romanin *E penguara* ato vijnë nëpërmjet dramës së ndërfutur në tekst, si dhe si formë e pandërgjegjshme e Rudianit dhe Migënës.

Le t’i shqyrtojmë me rradhë se si kanë ardhur në tekst/roman. Në dialogun mes Rudianit dhe Migënës, kjo e fundit i shpjegon atij vështitësitë e shkaktuara nga politika, internimi i familjes së Lindës B.

Nga vepra: “si në atë këngën arbëreshe, gjithë mbuluar nënë dhe. Të kujtohet ajo këngë?

Atje kam unë zotin tatë,

Atje kam unë zonjën mëmë,

Atje kam unë tim vëlla

Gjithë mbuluar nënë dhe.”

(Kadare 2009: 136-137).

Në rastin tjetër kënga shfaqet komplet në mënyrë të pavetëdijshme nga personazhi Rudian:

‘Nëse një ditë nga vdekja vjen

Më kërkon e nuk më gjen

Mos u huto pse ndodh kështu

Që sjam atje, që sjam këtu.

*Shpjegimin mos e lyp e mos derdh lot,  
Jam gjetkë, jam në tjetër mort"*

(Kadare 2009: 179).

Kjo këngë është shkruar nga dramaturgu në një moment që nuk e mban mend, pra të pavetëdijshëm. Ajo përkon me ngjarjet në vepër, pra me vdekjen e Lindës. Mendimi i Rudianit që Linda B. është vetëhelmuar shoqërohet me një tjetër këngë. Nga vepra:

*"Vajzë nga Kolonja  
Rritur Roskovec.  
Se ç'e mbyte veten  
O me helm kinez."*

(Kadare 2009: ).

#### 4. Simbole antropologjike

Duke e filluar me thënien e Borgesit: "Njeriu që vetëvritet jeton përherë në botë e ëndrra" (Borges 2013: 75), për ta konkretizuar se pjesë e kësaj bote nuk është vetëm e vetëvrasja Lindës B., por i është bashkangjitur edhe personazhi Rudian. Simbolika e vdekjes në roman vjen e ndërtuar në bashkëveprim me disa simbole të tjera të lashta, mitologjike/antropologjike. Këto simbole janë elemente të nënshtruara artit letrar me të cilat procedohet mjeshtërisht nga Kadare. Kjo dëshmon edhe njohjen nga autori të mitit, vdekjes, ringjalljes, tabusë, seksit, ligjit etj., që janë pjesë e kulturës dhe rrjedhimisht letërsisë. Për të mos u ndalur në dallimet mes simbolit dhe elementëve të ngjashëm me të, ritit, mitit, magjisë, ëndrrës etj., (sepse nuk e lejon ky punim i shkurtër) e as përkufizimet që i janë bërë atij, le të japim vetëm një përkufizim, ndoshta më të saktin: "Unë quaj simbol çdo strukturë të kuptimësisë, domethënies, në të cilën një kuptim direkt, primar, literal, simbolizon për më tepër një kuptim indirekt, dytësor, figurativ, që nuk mund të ketë kuptim veçse në lidhje me të parin." (Jakllari 2010: 137). Funkzioni i tyre në veprën e Kadaresë është i kushtëzuar nga poetika e vdekjes.

**Ëndrra** është element i studiuar nga fusha të ndryshme të jetës, psikologjia, mitologjia, antropologjia etj. Ajo është e shkruar në gjuhën e simboleve: "Ajo është një shprehje, e pajisur me një kuptim a domethënie e çdo lloj veprimtarie që kryhet gjatë kohës së gjumit" (Fromm 1998: 19).

Ajo që është e vështirë për t'u kuptuar, është çfarë ajo shënon varur nga individ, rrethana apo gjendja e tij, pra cila është domethënia e saj. Çdokush e interpreton në mënyra të ndryshme në bazë të njohjes së tij të përgjithshme.

Si shfaqet ëndrra tek personazhi Rudian? A është e lidhur ajo me ngjarjet në vepër? Natyrisht që po, ajo jo vetëm që është pjesë e jetës së tij e kryesisht pjesë e asaj që po lë gjurmë në çdo aspekt, por është edhe shenjë paralajmëruese e asaj që do të ndodhë më tej. Ëndrrat me Lindën B. Janë pjesë e dëshirave të porealizuara nga të dy.

**Ringjallja** është simbol i shfaqur tërthorazi në vepër, e cila simbolizon besimin në një forcë hyjnore. Ajo e ka zanafillën mjaft të largët: "Ritualet funerale te foksët duken në të vërtetë të rrymëzuara nga brenga e madhe për t'u liruar nga të vdekurit, dhe për të penguar ata që të hakmerren mbi të gjallët" (Strauss :55). Eksplorimi mbi vdekjen e Lindës B., si dhe hamendësimi artistik mbi atë çfarë mund të ketë ndodhur pas vdekjes së saj të çon tek ringjallja, apo dëshira për t'u ringjallur.

Kjo arrihet nëpërmjet dy rrugëve:

- dramës, personazhit të fantazmës, i cili kërkon të dijë arsyen e vdekjes së saj; dhe
- nëpërmjet personazheve mitkë: Euridikës.

Mamografinë e Lindës e veçon nëpërmjet personazhit të Euridikës. Jo vetëm kaq, por edhe ngjarjet e tjera lidhen me elemente mitike. Nga vepra: "U desh një kohë e gjatë, që e vërteta të pikonte, sidomos pas vdekjes së Euridikës. Orfeu nisi të kërkonte diçka të pamundur: kthimin e saj nga përtejvarri." (Kadare 2009: 117). Rudiani mitizohet nëpërmjet Orfeut, që në momentin kur Linda (personazh i vdekur) kishte filluar të depëronte çdo ditë e më tepër në jetën dhe psikologjinë e tij. Edhe mbyllja e romanit finalizohet me prekjen jo vetëm shpirtërore, por tashmë fizike të një të gjalli me një të vdekur (Lindës dhe Rudianit).

**Ëngjëlli** është simbol i besimit nga njerëzimi të jetës pas vdekjes, është njeriu që i është bindur Zotit dhe ai e ka kthyer në krijesë pozitive të përtejjetës. Rudiani është parë në ngjashmëri me këtë ëngjëll në momentin që e ka humbur ndërgjegjen, atëherë kur e vdekura ka depërtuar thellë

tek ai. I tillë është konsideruar nga njerëzit që e kanë parë. Nga vepra: “Ç’është ky ëngjëll, tha prapë gruaja. Ky meleq.” (Kadare 2009: 201). Të njëjtën gjë afërsisht mund të themi për simbolin e **fantazmës**, i cili shfaqet nëpërmjet dramës së Rudianit.

**Miti i Orfeut** është pjesë përbërëse e ngjarjeve në vepër që del i errët, ashtu si historia e romanit. Nga vepra: “*Historia mund të mbartte emërtimin »Mashtrimi i Orfeut«*. Nuk quhej më kot miti më i errët i njerëzimit” (Kadare 2009: 122).

Shpendi i konsideruar si më keqndjellësi nga njerëzit është **korbi**. Ajo është shenjë paralajmëruese e diçkaje të errët që do vijë, kryesisht vdekjes. Historia e tij është e ndryshme në popuj apo krahina të ndryshme, por gjithnjë simbolizon të keqen. Në këtë roman ai përdoret si element krahasues: “*heshtte si korb*” (Kadare 2009: 50).

Të njëjtin funksion ka edhe simboli i **qyqes**.

**Guri** është simbol, i cili në shoqëritë e lashta ka pasur domethënie të shumta: “Ata (gurët) shpesh konsideroheshin vende të banimit të shpirtrave ose zotave dhe përdroreshin në kulturat primitive si statuja për varre, si shtylla kufitare ose objekte adhurimi fetar.” (Jung 2010: 244). Nga vepra: “*Gur je, kalë je, që nuk flet?*” (Kadare 2009: 58). Edhe këtu ky simbol ka funksion krahasues për të shprehur ndjenjat, por më pas ai merr një trajtë tjetër, një trajtë të errët që lidhet me një emërtim gjeografik. Nga vepra: “*Guri i nuses së vvarë nga rrufeja. Ose thjesht: Guri i Zi.*” (Kadare 2009: 176).

Edhe **kali** është simbol i lashtë që, në kohët e lashta i vizatuar nëpër mure apo shpella ka pasur domethënie simbolike dhe magjike. Ai është konsideruar si shpëtimtar i njerëzimit. Në roman ky simbol vjen tërthorazi në mënyrë gati të pavetëdijshme, me anë të hamendësimeve të Rudianit. Nga vepra: “*Në vend që ta dëgjonte tjetrin, fare padashur përfytyronte monologun e Kaligulës me kalin e vet konsull.*” (Kadare 2009: 49).

**Shkronja Z** nuk është thjesht një shkronjë, ajo është simbol i rrezikshmërisë, pengesës. Të njëjtin funksion ka edhe në vepër. Nga vepra: “*Si nëpër gjumë, e kishte vënë në tekst, me ngut, vetëm me shkronjën Z, ashtu si në tabelat*

*rrugore, përballë kthesave të rrezikshme.*” (Kadare 2009: 90).

Procedimi me simbolet nuk mbaron me kaq. Kadare vepron edhe me emërtimet gjeografike dhe numrat biblikë.

#### (a) Simbolet e emërtimeve gjeografike

Ngjarjet shpesh shoqërohen edhe me vendndodhje apo emra gjeografikë, ku secili simbolizon diçka me domethënie dhe në funksion të ngjarjeve.

**Fusha e Qyqes** është emërtimi gjeografik, ku në përbërjen e tij janë dy nocione: (1) fusha, element natyror; dhe (2) qyqja, simbol i diçkaje të errët, të keqe. Nga vepra: “*në vendin e quajtur Fushë e Qyqes, në bregun e një kënete pa emër.*” (Kadare 2009: 81). Pikërisht në këtë vend, i identifikuar në dramë, është kryer një vrasje, pra ka ardhur vdekja.

**Tri Kryqet, Guri i Mortit, Prita e Keqe, Kodra e Qyqes, Korbi, Gropa, Rrëzoma e keqe** etj., janë emërtimet e tjera simbolike, ku secila ka një kuptim të varur nga konteksti dhe ka ndodhur ose pritët të ndodhë një ngjarje e keqe. Nga vepra: “*Emërtime vendesh, përrënsh e shtigjesh shembeshin prore: Kodra e Qyqes, Gropa, Korbi*” (Kadare 2009: 23).

#### (b) Simbolet e numrave biblikë

Simbolet e numrave biblikë janë mjaft të përmendur tërthorazi në roman.

**Shtata** simboli i përsosshmërisë. Nga vepra: “*numri i muzave të shtohet nga shtatë në nëntë*” (Kadare 2009: 93).

Numri **tre** është simbol me të cilin procedohet kryesisht për ditët që do vijnë.

**Dyzeta** dhe **nënta** janë të tjerë numra simbolikë. Dyzeta simbolizon kohën e një breznie, ku në roman vjen nëpërmjet sekondave.

#### BIBLIOGRAFIA

ASLLANI, P. (2013/2), “Requiem i orfik dhe misioni etik i vdekjes në romanin *E penguara* të Ismail Kadaresë”: *Studime albanologjike*, Tiranë.

BORGE, J. L. (2013), *Ligjërata, pika pa sipërfaqe*, Tiranë.

EDER, R. (2011), *Pushteti i alegorisë*, Jeta e Re, Prishtinë.

FROMM, E. (1988), *Gjuha e harruar*, Dituria, Tiranë.



GROSS, N. P. (2011), *Poetika e intertekstualitetit*, Parnas, Prishtinë.

JAKLLARI, A. (2010), *Leksione për antropologjinë kulturore*, Shblu, Tiranë.

JUNG, C. G. (2010), *Njeriu dhe simbolet e tij*, Fan Noli, Tiranë.

KADARE, I. (2009), *E penguara*, Onufri, Tiranë.

STRAUSS, C. L. (1999), *Mendim i egër*, Fryma, Pejw.

TODOROV, T. (1986), *Poetika e prozës*, Panteon, Tiranë.

WOOD, J. (2011), *Kronika dhe fragmente*, Jeta e Re, Prishtinë.

---

## TË PËRKTHESH FIGURAT RETORIKE TË ROMANIT NJË, ASNJË DHE NJËQINDMIJË TRANSLATING THE RHETORICAL FIGURES OF ONE, NO ONE AND ONE HUNDRED THOUSAND

MIRELA PAPA

Departamenti i Gjuhës Italiane, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës  
e-mail: papamirela@yahoo.com

### Përmbledhje

Përkthimi është art i vështirë, sidomos përkthimi i veprave letrare. Kur flasim për formën e një teksti nënkuptojmë mënyrën e të shkruarit të shkrimtarit, stilin e tij. Dhënia e stilit të shkrimtarit është, pra, një ndër detyrat e përkthyesit letrar. Figurat retorike përbëjnë një ndër pikat më të brishta në përkthimin e një veprave letrare, sepse jo gjithmonë përcillen si duhet në tekstet e përkthyer duke u bërë shkaktare të mjaft humbjeve në procesin përkthimor. Në këtë kumtesë do të marrim në analizë figurat retorike të përdorura nga Pirandello në veprën e tij *Një, asnjë dhe njëqindmijë* si dhe mënyrën se si këto figura janë përkthyer në gjuhën shqipe. Kjo kryevepër e Pirandelos është përkthyer nga dy përkthyes kështu që do të kemi mundësi të shikojmë edhe strategji të ndryshme për të dhënë figurshmërinë letrare të kësaj veprave.

**Fjalët çelës:** përkthim, letërsi, stilistikë, figura retorike

### Abstract

Translation is a difficult art, especially the translation of literary works. When we talk about the form of a text we mean the way of writing of the writer, his style. So, reflecting the style of the writer is one of the duties of the literary translator. Rhetorical figures are among the most fragile elements while translating a literary text, because they are not always rendered as they should in the translated texts, causing many losses during the process of translation. In this paper we are going to analyze the rhetorical figures used by Pirandello in his work "One, no One and one Hundred Thousand" and how these figures are translated in the Albanian language. This masterpiece of Pirandello has been translated by two different translators so we will have also the opportunity to see different approaches and how ductile this work is while translating it.

**Key words:** translation, literature, stylistic, rhetorical figures..

### Hyrje

Përkthimi është art i vështirë, sidomos përkthimi i veprave letrare që ngjan me një betejë të humbur *a priori* në përpjekjen e mundimshme për të rikrijuar në një gjuhë tjetër mrekullinë e harmonizimit mes formës dhe përmbajtjes së tekstit burimor. Kur flasim për formën e një teksti nënkuptojmë mënyrën e të shkruarit të shkrimtarit, stilin e tij. Dhënia e stilit të shkrimtarit është, pra, një ndër detyrat e përkthyesit letrar, prandaj përkthyesit letrar përveç problemeve leksikore dhe gramatikore i duhet të zgjidhë edhe probleme retorike dhe ritmike.

Në këtë kumtesë kemi marrë në analizë figurat retorike të përdorura nga Pirandello në veprën e tij *Një, asnjë dhe njëqindmijë* si dhe mënyrën se si këto figura janë përkthyer në gjuhën shqipe. Kjo kryevepër e Pirandelos është përkthyer nga dy përkthyes (Dritan Çela dhe Zija Vukaj) kështu që kemi patur mundësi të shikojmë edhe strategji të ndryshme për të dhënë figurshmërinë letrare të kësaj veprave.

### 1. Figurat retorike

Për të studiuar figurat retorike që ka përdorur Pirandello në veprën e tij, i jemi referuar ndarjes

që Marisa Napoli bën në librin e saj *I linguaggi della retorica* dhe që nga ana e saj i referohet ndarjes që bën grupi  $\mu$  (mi) i Liezhit. Kjo ndarje na lejon të përcaktojmë ndryshimet në kuptimin e ligjërit që bëhen në bazë të *elocutio*-s, sipas faktit që përdoren figurat që veprojnë në planin e shprehjes apo të përmbajtjes dhe, përkatësisht, në nivel të kuptimeve (metaplasamat) dhe të sintaksës (metataset) për njërin, apo për kuptimin e fjalës (metasememat) apo të vlerës logjike të fjalës dhe të fjalisë (metalogjizmat) për tjetrën. Figurat e mendimit kanë të bëjnë me idetë e gjetura nga ai që përpunon ligjërimin dhe, më saktë, do të ishin objekt i *inventio*-s. Trajtimi i tyre në *elocutio*, bashkë me figurat e tjera retorike, shpjegohet me faktin se përpunimi i mendimit dhe riformulimi gjuhësor janë një proces i pandashëm dhe prandaj ndryshimet e sjella në një plan prodhojnë efekte në tjetrin.

### 1.1. Figurat e morfologjisë

Të quajtura ndryshe metaplasamat, janë figura të shprehjes dhe kanë të bëjnë me formën dhe diksionin e shenjave (fjalë, rrokje, tinguj); veprojnë pra në nivel të *significantit* (Napoli 1995: 55).

Aliteracioni dhe asilabacioni, asonancat dhe konsonancat përfshijnë njësi të vogla si tinguj, gërma, rrokje dhe formohen me mekanizmat e përsëritjes.

Onomatopeja, paronomazia, kalemburi, anagramat kanë të bëjnë me njësinë e fjalës. Rebusi realizon një lojë zëvendësimi tejet interesante duke përdorur fjalë, shenja të ndryshme dhe imazhe.

#### 1.1.1. Onomatopeja

Onomatopeja është figura morfologjike që sugjeron apo ripropozon një tingull apo një zhurmë ekzistuese në natyrë. Bëhet dallimi mes onomatopesë së formuar nga imitimi i drejtpërdrejtë dhe atyre të formuara si pasojë e disa shndërrimeve dhe që kanë marrë karakter imitues, ndonëse ky është tërësisht subjektiv. Këto të fundit mund të quhen edhe fjalë shprehëse. Luixhi Pirandelos i pëlqejnë onomatopetë, të cilat si të njëres klasë si të tjetres janë gjithnjë shumë të pranishme në kriji-

met e tij. Duhet të shtojmë këtu se gjuha italiane është shumë e pasur me fjalë onomatopeike.

➤ Malato forsanche per la malinconia dei **cigolii** della carrucola...

- E sëmurë ndoshta edhe prej melankolisë së **gërvimave** të pulexhës... (ÇELA, Libri i Dytë, II, 34);

- E sëmurë ndoshta, edhe nga melankonia e **kërkëllimave** të çikrikut... (VUKAJ, Libri i Dytë, II, 39).

➤ La mosca, e il dispetto del suo aspro fastidio **ronzante**.

- Miza dhe mllefi i bezdisë së saj të vrazhdë **zukatëse**. (ÇELA, Libri i tretë, II, 57)

- Miza dhe rrengu i besdisjes së saj **gumëzhitëse**. (VUKAJ, Libri i tretë, II, 65)

Strategjia e ndjekur nga përkthyesit është e njëjtë, kemi përcjellje të onomatopeve edhe në gjuhën shqipe.

Të shohim edhe një rast onomatopesh të formuara me imitim të drejtpërdrejtë.

➤ Lo piantai lí, e via. Fatti pochi passi, mi sentii richiamare. «**Ps!**»

- E lashë atje dhe ika. Me të bërë pak hapa, dëgjova të më thërrisnin sërish:

- **Pst!** (ÇELA, Libri i parë, II, 13)

- E lashë atje dhe ika. Me të bërë ca hapa, e ndieva të më thërriste përsëri:

- **Ps!** (VUKAJ, Libri i parë, II, 16)

Lidhur me strategjinë e ndjekur nga përkthyesit vëmë re se ÇELA preferon natyralizimin në gjuhën shqipe, ndërsa VUKAJ përdor përsëritjen.

Pirandelo e përdor edhe në mënyrë të figurshme onomatopenë. Deri tani kemi parë riprodhimin e tingujve realë të prodhuar nga njerëz, kafshë dhe objekte prodhuese të drejtpërdrejta apo jo të këtyre tingujve. Por shpesh ndodh që këtyre prodhuesve u vishen tinguj që nuk janë karakteristike për ta, si p.sh. tinguj që i prodhojnë kafshët u vishen njerëzve. Këta tinguj të përdorur në këtë mënyrë mbushin me ekspresivitet narrativën pirandeliane. Të shikohen për këtë qëllim shembujt e mëposhtëm:

➤ ...mi vidi attorno certe vecchie suore **pi-golanti** spaventate..

- ...pashë rreth vetes shtatë murgesha plaka të trembura që **pingërinin**... (ÇELA, Libri i shtatë, III, 148);
  - ...pashë përreth shtatë motra murgesha të vjetra që **rënkonin** të trembura... (VUKAJ, Libri i shtatë, III, 166).
- Vëmë re se onomatopetë janë dhënë nga përkthyesit.

## 1.2. Figurat e sintaksës

Të quajtura ndryshe metatase, janë figura që tregojnë ndryshime formale të strukturës së fjalisë dhe të rendit të shenjave. Kanë të bëjnë me *elocutio*-n në nivel sintaksor.

Rendi i fjalëve dhe fjalive në pjesën dërmuese të gjuhëve i përgjigjet një logjike dhe një qëllimi komunikues. Mënyrat në të cilat termat e ndryshëm gjuhësorë kombinohen në ligjërim, janë shumë të ndryshme dhe të lira, mjaft që të respektohen disa norma të përgjithshme, të parashkuara nga gramatika, që lejojnë kuptimin (Napoli 1995: 69).

### 1.2.1. Hiperbata

Hiperbata është një figurë që konsiston në ndarjen e dy termave zakonisht të bashkuar, duke ndërshtënë të tjerë. Pra, është ndryshimi i termave të fjalisë. Rastet që dalin te ky roman i Pirandello, janë kryesisht ndryshimi i rendit të kryefjalës dhe kallëzuesit.

- Orecchi, non mostrano di averne.
  - Ato nuk tregojnë se kanë veshë. (ÇELA, Libri i Dytë, XI, 46);
  - Veshë, nuk duket se kanë. (VUKAJ, Libri i Dytë, XI, 54).
  - Incompatibili non erano tra loro quei due,.
  - Ata të dy nuk ishin të papërputhshëm, ... (ÇELA, Libri i Tretë, X, 76)
  - Të papajtueshëm nuk ishin mes tyre ata të dy (VUKAJ, Libri i Tretë, X, 87)
- Për sa i përket strategjisë përkthimore që kanë ndjekur përkthyesit, duhet thënë se VUKAJ e përcjell figurën retorike edhe në tekstin e përkthyer, ndërsa ÇELA jo.

### 1.2.2. Asindet

Është figura sintaksore që konsiston në eliminimin e lidhëzave dhe të ndonjë konektori tjetër mes termave apo fjalive të një periudhe.

Asindet i jep një enfazë më të madhe dhe shpejtësi ligjërit. Përdoret sipas mënyrash të ndryshme: në enumeracione, duke eliminuar pikësimin dhe duke gjetur një barasvlerës ritmik në hapësirat e bardha.

- Dunque dunque... concludiamo.
- Mirë pra... le ta mbyllim. (ÇELA, Libri i Dytë, IV, 39);
- Hë de, hë... mbaruam. (VUKAJ, Libri i Dytë, IV, 46);
- No no, basta Bibi – le dissi.
- Jo, jo, mjaft, Bibi, i thashë. (ÇELA, Libri i Pestë, III, 115)
- Jo jo, mjaft Bibi – i thashë. (VUKAJ, Libri i Pestë, III, 130)

Mungesa e shenjave të pikësimit, pra, asindet te Pirandello, ka si qëllim të japë vrullin e mendimeve dhe të fjalëve. Një teknikë, kjo, që është shumë e shpeshtë te shumë autorë të Nëntëqindtës, veçanërisht te futuristët që do të arrijnë të shkruajnë faqe të tëra pa përdorur shenjat e pikësimit, për të dhënë fluksin e pakontrolluar të mendimeve të tyre.

Në përkthim vëmë re se mungesa e shenjave të pikësimit dhe përsëritja nuk është ruajtur.

### 1.2.3. Përsëritja

Më shumë sesa një figurë, është një nga mekanizmat retorikë më të thjeshtë dhe më të përdorur. Konsiston në përsëritjen e të njëjtit term, sipas mënyrave të ndryshme stilistikore për të kujtuar koncepte apo imazhe.

Kemi të bëjmë me dyfishim apo *geminatio* (konsiston në rimarrjen e menjëhershme të së njëjtës fjalë apo grupi fjalësh në çdo pjesë të tekstit, në fillim, në mes, në fund) në këto raste.

- Ah, **inconfessabile, inconfessabile**, perché solo del mio spirito, quell'angoscia...
- Ah, **i parrëfyeshëm, i parrëfyeshëm**, sepse ishte vetëm i shpirtit tim ai ankth... (ÇELA, Libri i Pestë, II, 110);
- Ah, **i parrëfyeshëm**, sepse ishte vetëm i shpirtit tim ai ankth... (VUKAJ, Libri i Pestë, II, 124).

ÇELA e ruan përsëritjen edhe në tekstin e përkthyer, ndërsa VUKAJ jo:

- **Pazzo! Pazzo! Pazzo!**
- **I çmendur! I çmendur! I çmendur!** (ÇELA, Libri i Katërt, VII, 107)
- **I çmendur! I çmendur! I çmendur!** (VUKAJ, Libri i Katërt, VII, 121);
- **Giochiamo, giochiamo!**
- **Luajmë, luajmë!** (ÇELA, Libri i Pestë, V, 118);
- **Luajmë, luajmë!** (VUKAJ, Libri i Pestë, V, 133).

Në këta shembuj kemi ruajtjen e përsëritjes edhe në tekstet e përkthyer nga ana e të dy përkthyesve.

- Ah, **perdersi là, distendersi e abbandonarsi**, così tra l'erba, al silenzio dei cieli; **empirsi** l'anima di tutta quella vana azzurrità, facendovi naufragare ogni pensiero, ogni memoria!
- Ah, **të humbasësh aty, të shkrihesh e ta lëshosh veten**, kështu mes barit, në heshtjen e qiejve; **të mbushësh** shpirtin me gjithë atë kaltëri të zbrazët, duke mbytur atje çdo mendim, çdo kujtim! (ÇELA, Libri i Tetë, II, 173);
- Ah, **të zhytesh aty, të shtrihesh e të lëshohesh** ashtu mes barit, në heshtjen e qiejve; **ta mbushësh** shpirtin me gjithë atë kaltërsi të zbrazët, duke bërë të të humbasë çdo mendim, çdo kujtim! (VUKAJ, Libri i Tetë, II, 194)

Në këtë rast kemi të bëjmë me përsëritjen e formës së pashtjelluar të foljes. Me anë të këtij përdorimi autori do të theksojë në njëfarë mënyre dëshirën e protagonistit për t'u arratisur, për t'u zhytur tërësisht në natyrë. Vëmë re se në përkthim foljet janë dhënë në të njëjtën formë të përsëritur, në mënyrën lidhore, në përshtatje kjo me veçantinë e gjuhës shqipe.

#### 1.2.4. Elipsi

Elipsi është një figurë sintaksore që konsiston në shmangien e përdorimit të një apo më shumë termave të fjalisë, duke i lënë të nënkuptohen. Elipsi lejon përshpejtimin e ritmit të ligjërit, duke e bërë më sintetik, duke hequr elemente që mund të nënkuptohen lehtësisht, edhe pse strukturalisht të domosdoshme.

Edhe fjalitë emërore futen te kjo kategori dhe konsistojnë në heqjen e sintagmës foljore dhe në përcjelljen e përmbytjes së saj dhe të një pjese të funksioneve në një sintagmë emërore që mbetet e pranishme në fjali:

- Già, storia vecchia, difatti.
- Histori e vjetër tashmë, në fakt. (ÇELA, Libri i Dytë, III, 36);
- Epo, histori e vjetër, ç'është e vërteta. (VUKAJ, Libri i Dytë, III, 43).
- Un uomo, così, e basta, nella vita.
- Një njeri ashtu dhe kaq. Në jetë. (ÇELA, Libri i Tretë, II, 59);
- Një njeri, dhe kaq. Në jetë. (VUKAJ, Libri i Tretë, II, 68).
- Nessun nome. Nessun ricordo oggi del nome di jeri; del nome d'oggi, domani. /.../ Quest'albero, respiro tremulo di foglie nuove. Sono quest'albero. Albero, nuvola; domani libro o vento: il libro che leggo, il vento che bevo. Tutto fuori, vagabondo.
- Asnjë emër. Asnjë kujtim sot nga emri i djeshëm; nesër, nga emri i sotëm. /.../ Kjo pemë, frymëmarrje drithëruese gjethesh të reja. Jam kjo pemë. Pemë, re; nesër libër apo erë: libri që lexoj, era që pi. Gjithçka jashtë, endacak. (ÇELA, Libri i Tetë, IV, 178);
- Asnjë emër. Asnjë kujtim sot për emrin e djeshëm; për emrin e sotëm; nesër. /.../ Ky dru, frymëmarrje e dridhur gjethesh të reja. Jam ky dru. Dru, re; nesër libër ose erë: libri që lexoj, era që thith. Gjithçka jashtë, endacake. (VUKAJ, Libri i Tetë, IV, 199).
- E codesta vostra cravatta pure rossa... Che gioja in questa vana frescura, azzurra e verde, d'aria chiara di sole! /.../ Giù, giù la giacca!
- Dhe kjo kravata juaj gjithë e kuqe... Ç'gazmend në këtë freski të zbrazët, të kaltër e të gjelbër, prej ajri të pastër me diell! /.../ Uleni, uleni xhaketën! (ÇELA, Libri i Dytë, VIII, 43).
- Dhe, ajo kravatë e juaj gjithashtu e kuqe... Ç'hare në këtë freski të zbrazët, të kaltër e të blertë, në dritën e qartë të diellit!... Hiqeni, hiqeni xhaketën! (VUKAJ, Libri i Dytë, VIII, 50)

Është një shembull domethënës i sintaksës me të cilën Pirandelo arrin të shprehë tëhuajtjen nga gjërat dhe qëndrimin në njëfarë mënyre jashtë dhe sipër realitetit. Periudhat shumë të shkurtra dhe emërore, ose pa folje, shprehin gjithë atë pa-lëvizshmëri atemporale tipike të periudhës së fundit të krijimtarisë pirandeliane (Pirandello 1994: 89).

Përdorimi i fjalive emërore te Pirandelo e bën ligjërimin më të shpejtë, më të thjeshtë dhe është një karakteristikë që duhet ruajtur në tekstin e përkthyer. Vëmë re se të dy përkthyesit i ruajnë këto fjali emërore edhe në përkthim.

### 1.2.5. Parataksa

Është një procedim sintaksor që konsiston në koordinimin e dy a më shumë fjalive në një periudhë, të gjitha të pavarura, të vëna pranë njëra-tjetrës. Fjalitë lidhen mes tyre me asindet, me anën e shenjave të pikësimit ose me anën e lidhëzave bashkërenditëse. Është tipike e një të folure të thjeshtë, bisedore dhe popullore.

➤ La storia della mia famiglia nel mio paese: non ci pensavo; ma era in me, questa storia, per gli altri; io ero uno, l'ultimo di questa famiglia; e ne avevo in me, nel corpo, lo stampo e chi sa in quante abitudini d'atti e di pensieri, a cui non avevo mai riflettuto, ma che gli altri riconoscevano chiaramente in me, nel mio modo di camminare, di ridere, di salutare.

- Historia e familjes sime në fshatin tim: nuk e mendoja, por ishte brenda meje, kjo histori për të tjerët. Unë isha dikush, i fundmi i kësaj familjeje dhe, në trupin tim, kisha kallëpin e saj, ashtu si në kushedi sa zakone veprimesh e mendimesh, për të cilat nuk e kisha shtrydhur kurrë mendjen, por që të tjerët i dallonin qartë tek unë, në mënyrën time të të ecurit, të të qeshurit, të të përshëndeturit. (ÇELA, Libri i Tretë, II, 60)

- Historia e familjes sime në vendin tim: nuk e mendoja; por ishte brenda meje, kjo histori për të tjerët; unë isha një i fundit i kësaj familjeje; dhe, vulën e saj, e kisha në veten time, në trup, dhe, kushedi në sa zakone, veprime e mendime, për të cilat nuk e kisha vrarë mendjen kurrë, por që, të tjerët, i dallonin qartë tek unë, në mënyrën

time të të ecurit, të qeshjes, të të përshëndeturit. (VUKAJ, Libri i Tretë, II, 68)

Në tekste të përkthyer vëmë re se të dy përkthyesit në përgjithësi e kanë ruajtur parataksën.

### 1.2.6. Prolepsis

Është një figurë që konsiston në evokimin e një ngjarjeje që do të ndodhë pas çastit në të cilin po flitet. Kjo është një teknikë shumë e përdorur nga autori. Me anë të saj kalohet nga rrëfimi në kohë reale tek evokimi, te retrospektiva.

➤ Si signori, come vedrete, scappò via.

- Po zotërinj, siç do ta shihni, iku. (ÇELA, Libri i Dytë, II, 55);

- Po zotërinj, siç do ta shihni, ia mbathi. (VUKAJ, Libri i Dytë, II, 63).

Figura retorike e prolepsit është kuptuar dhe është dhënë si rrjedhim edhe në të dyja tekste të përkthyer.

### 1.2.7. Analepsi

Është një figurë që konsiston në futjen gjatë rrëfimit të ngjarjeve që i referohen së shkuarës.

Alternimi mes kohëve të ndryshme foljore, herë narrative si e pakryera dhe e kryera e thjeshtë, herë e tashme, shënon kalimin nga plani objektiv i rrëfimit në planin subjektiv të reflektimit.

➤ Non mi **proverò** (e ardhme) a esprimere l'impressione che mi **fece** (e kryer e thjeshtë) quella voce inattesa nel bujo, di là dalla gratta.

- Nuk **do të përpiqem** (e ardhme) të shpreh mbresën që më **la** (e kryer e thjeshtë) ai zë i papritur në terr, matanë kafazit të dritares. (ÇELA, Libri i Shtatë, II, 146);

- **S'do të mundohem** (e ardhme) të shpreh përshtypjen që më **bëri** (e kryer e thjeshtë) ai zë në terr, përtej kafazit të dritares. (VUKAJ, Libri i Shtatë, II, 165).

➤ Mi **duole** (e tashme), a ripensarci, se egli quel giorno se n'**andò** (e kryer e thjeshtë) da casa mia con l'impressione ch'io volessi burlarmi di lui.

- Më **dhemb** (e tashme) në shpirt tek e risjell ndërmend, nëse ai **iku** (e kryer e thjeshtë) atë ditë nga shtëpia ime me përshtypjen sikur unë doja të tallesha me të. (ÇELA, Libri i Tetë, II, 173);

• Më **vjen keq**, po ta shohësh hollë, sikur ai të **ikte** atë ditë nga shtëpia ime me përshtypjen se unë doja të tallesha me të. (VUKAJ, Libri i Tetë, II, 194).

Në shembullin e mësipërm kemi një gabim nga ana e VUKAJT. Segmenti gjuhësor nuk është kuptuar drejt dhe prandaj përftohet në gjuhën shqipe një segment që rezulton të ketë kuptim të kundërt me segmentin original.

➤ **Vedo** (e tashme) bene adesso che questi violenti diverbii, così a botta e risposta, **sono** (e tashme) veri e proprii pugilati tra due avversarie volontà che cercano (e tashme) d'accoparsi a vicenda... E la più ridicola figura l'**hanno fatta** (e kryer) intanto i pugni veri levandosi istintivamente ad accompagnare irosi quelli parlati, o meglio, urlati, proprio fino all'altezza del grugno avversario ma senza toccarlo, e i denti che **si serrano** (e tashme) e i nasi che **s'arricciano** (e tashme) e le ciglia che **s'agrotano** (e tashme) e tutta la persona che **freme** (e tashme).

Con l'ultima scarica di quei tre «**voglio**» (e tashme), «voglio», «voglio» dovevo aver bene ammaccata la resistenza di Quantorzo. Gli **vidi** (e kryer e thjeshtë) congiungere le mani in atto di preghiera:

«Ma si può sapere almeno perché? Così da un momento all'altro?».

**Ebbi** (e kryer e thjeshtë), vedendolo in quell'atto, come una vertigine.

• **Shoh** (e tashme) mirë tani që, këto grindje të egra, kështu, hidh e prit, **janë** (e tashme) kacafytje të vërteta e të mirëfillta mes dy vullneteve të kundërta, që kërkojnë të vrasin njëri-tjetrin... Dhe, ndërkohë, figurën më qesharake e **kanë bërë** (e kryer) gushtat e vërtetë, të ngritur instiktivisht për të shoqëruar plotë zemërim ata të së folurës, ose më mirë, të ulërimave, mu deri në lartësinë e turirit kundërshtar, por pa e prekur; e dhëmbët që **shtrëngoheshin** (e pakryer) e hundët që **kreshpëroheshin** (e pakryer), e vetulla që **ngryseshin** (e pakryer) dhe gjithë personi që **fërgëllonte** (e pakryer).

Me zbrazjen e fundit të atyre tri «**dua**» (e tashme), «dua», duhet t'ia kisha thyer mirë brinjët

rezistencës së Kuantorcit. Ia **pashë** (e kryer e thjeshtë) t'i bashkonte duart në veprimin e lutjes: Po, a mund të dihet të paktën pse? Kështu nga çasti në çast?

**Pata** (e kryer e thjeshtë), tek e shihja në atë veprim, një si marrje mendsh. (ÇELA, Libri i Pestë, VIII, 146)

• E **shikoj** (e tashme) mirë tani që këto zënka të dhunshme, hidh e prit, **janë** (e tashme) grushtime të vërteta mes dy vullnetesh të kundërta që rreken të zhdëpin njëri-tjetrin... Dhe figurën më qesharake e **bënë** (e kryer e thjeshtë) grushtat e vërtetë, tek u ngritën vetiu për të shoqëruar plot zemërim grushtat e fjalëve, a më mirë të them, të ulërimave, mu deri te lartësia e turirit të kundërshtarit, por pa e prekur, dhe dhëmbët **shtrëngohen** (e tashme), hundët **rrudhen** (e tashme), vetullat ngrysen e i tërë trupi **dridhet** (e tashme).

Me shkarkimin e fundit të atyre tre «**dua**» (e tashme), «dua», «dua» duhet ta kisha plandosur mirë qëndresën e Kuantorxos. E pashë tek bashkoi duart si për t'u lutur:

Po të paktën a mund ta di përse? Kështu krejt papritur?

Tek e **pashë** (e kryer e thjeshtë) në atë gjest, pata një si marramendje. (VUKAJ, Libri i Pestë, VIII, 129).

Në përkthim vëmë re se kohët foljore në përgjithësi janë ruajtur dhe si rrjedhim janë krijuar planet e ndryshme të rrëfimit.

### 1.3. Figurat e kuptimit

Figurat e kuptimit apo metasememat, traslatet dhe tropet të cilat tregojnë zhvendosjen e kuptimit, i përkasin *elocutio*-s. Kjo kategori figurash, që ka një rol themelor në shprehjen letrare, është shumë e ndërlikuar, sepse problemi i kuptimit është qendror jo vetëm në retorikë, por edhe në çdo shkencë apo filozofi të ligjërit.

#### 1.3.1. Metafora

Metafora paraqet një nga tropet tradicionale më prodhimtare të gjuhës letrare. I ndërgjegjshëm që kjo figurë ka qenë objekt i përkufizimeve të shumta nga perspektiva gjuhësore dhe retorike, Rabadán-i (1991: 135-36) mendon se nga pikëpa-

mja përkthimore më e mira është të përshtatet një përkufizim që ka të bëjë me karakteristikën themelore të kuptimit që transferohet dhe që rezulton operativ. Nga kjo qasje ai e përkufizon metaforën si «emërtimi i një objekti apo fenomeni me emrin e një tjetri, falë një lidhjeje ngjashmërie mes të dyve». Newmark-u (1992: 147-48), nga ana e tij, thekson se metafora i përgjigjet thelbësisht një objektivi të dyfishtë: objektivi referencial apo konjitiv, që konsiston në përshtatimin e një koncepti, një personi, një objektivi apo një veprimi në mënyrë sa më të thukët, dhe objektivi pragmatik apo estetik, që kërkon të stimulojë shqisat, të tërheqë vëmendjen apo të befasojë.

Me objektivin për të paraqitur shkurtimisht disa prej këndvështrimeve më domethënëse lidhur me përkthimin e metaforës, është zgjedhur si pikë referimi kriteri i «përkthyeshmërisë». Lidhur me këtë parametër, prurjet teorike klasifikohen në katër grupe:

(a) autorët që konsiderojnë se përkthimi i metaforës nuk paraqet ndonjë problem specifik që të kërkojë një trajtim specifik;

(b) ata që mbështesin idenë se është i mundur përkthimi i saj;

(c) kritikët që mbrojnë idenë se metafora është e papërkthyeshme; dhe

(ç) grupi i fundit, një sjellje pajtuese.

Lidhur me procedimet e përdorura për të përshtuar se si janë përkthyer metaforat, ndiqet propozimi i Toury-së (1985: 26-27). Sipas tij, mundësitë për trajtimin e kësaj figure në tekstin e përkthyer janë këto: e njëjta metaforë (do të ishte një përkthim thuajse fjalë për fjalë, në të cilin shpeshherë zgjerohen përbërësit leksikorë të figurës origjinale dhe reduktohen të tjerë); metaforë e ndryshme; pa metaforë; heqje e metaforës nga teksti origjinal; futje e një metafore kur segmenti përkatës i tekstit burimor nuk është një metaforë dhe futje e metaforës kur nuk ka asnjë segment burimor për t'ua përkthyer.

Francesco Pacifico në një artikull të tijin *Se Mao-metto non va dalla montagna* shkruan: «duke kërkuar metafora, Vitaxhelo Moskarda gjen një të çmueshme: një qenie njerëzore është si një mal: mali na jep shkëmbin dhe drurin për të bërë

shtëpitë; gjithnjë mal mbetet, por nga ai merren shumë pjesë, me të cilat njerëzit bëjnë çfarë të duan. Mali nuk e humbet identitetin e tij, por ndërkohë /.../ ajo çka ishte një copë mali është bërë një shtëpi».

Të shohim disa shembuj metaforash dhe përkthimet përkatëse të nxjerra nga ky roman.

➤ Avete mai veduto costruire una casa? lo, tante, qua a Richieri. E ho pensato: «Ma guarda un po' l'uomo, che è capace di fare! Mutila la montagna; ne cava pietre; le squadra; le dispone le une alle altre e, che è che non è, quello che era un pezzo di montagna è diventato una casa».

• A keni parë ndonjëherë të ndërtohet një shtëpi? Unë plot, këtu në Rikieri. Dhe kam menduar. «Pa shihe pak njeriun, çfarë është i zoti të bëjë! Gjymton malin, nxjerr gurë prej tij, i skallit, i vë njëri mbi tjetrin dhe, ajo që ishte një copë mali, u bë një shtëpi». (ÇELA, Libri i Dytë, VI, 40)

• A keni parë ndonjëherë të ndërtohet një shtëpi? Unë, gjithë ato, këtu në Rikieri. Dhe kam menduar. «Pa shiko pak njeriun, çfarë është i zoti të bëjë! Këput malin; nxjerr prej tij gurë, u jep trajtë; i vë njëri mbi tjetrin dhe, papritur e pa kujtuar, ajo që ishte një copë mali është bërë një shtëpi». (VUKAJ, Libri i Dytë, VI, 47).

➤ È bene che lei anzi si turi gli orecchi per non udire il terribile fragore d'una certa rapina sotto gli argini, oltre i limiti che lei, da buon giudice, s'è tracciati e imposti per comporre la sua scrupolosissima coscienza. Possono crollare, sa, in un momento di tempesta come quello che ha avuto la signorina Anna Rosa. Che rapina? Eh, quella della gran fiumana, signor giudice! Lei l'ha incanalata bene nei suoi affetti, nei doveri che s'è imposti, nelle abitudini che s'è tracciate; ma poi vengono i momenti di piena, signor giudice, e la fiumana straripa, straripa e sconvolge tutto.

• Dhe mirë është madje që të mbyllni veshët për të mos dëgjuar rrapëllimën e tmerrshme të një farë rrëmbimi poshtë pritave, përtej caqeve që ju, si gjykatës i mirë, i keni ravijëzuar e i keni vënë vetes për të krijuar në ndërgjegjen tuaj kaq të kujdesshme. Mund të shemben, e dini? Në një çast stuhie si ajo që përkapi zonnjushën Ana Roza. Çfarë rrëmbimi? Eh, ai i vërsimit të madh, zotëri. Ju e keni kanalizuar mirë



në përzemërsitë tuaja, në detyrat që i keni vënë vetes, në zakonet që i keni përvijuar vetes; por mandej vijnë çastet e vërshimit, zoti gjykatës, dhe lumi bliron, bliron dhe trondit gjithçka. (ÇELA, Libri i Tetë, II, 174)

- Është mirë që ju madje t'i zini veshët për të mos dëgjuar rapëllimën e tmerrshme të njëfarë grabitjeje, nën pritën, përtej kufijve me të cilët ju, prej gjykatësi të mirë, jeni përvijuar e vendosur për të formuar ndërgjegjen tuaj skrupuloze. Mund të shemben, e dini? në një çast fortune si kjo që ka pasur Zonja Ana Roza. Ç'grabitje? Eh, e vërshimit të madh, Zoti gjykatës!. Ju e keni kanalizuar mirë në ndjesitë tuaja, në detyrat që i keni vënë vetes, në zakonet me të cilat jeni përvijuar; por pastaj vijnë momentet e vërshimit, zoti gjykatës, dhe lumnaja del nga shtrati, vërshon dhe përmbyt gjithçka. (VUKAJ, Libri i Tetë, II, 195)

Kemi të bëjmë me metafora origjinale të shkrimtarit, madje një fjali e tërë e ndërtuar mbi një konceptim metaforik, prandaj edhe në tekstet e përkthyer autorët kanë ndjekur strategjinë e përkthimit të metaforës. Efekti figurativ që krijohet te lexuesi i tekstit të përkthyer është i njëjtë me atë që krijohet edhe te lexuesi i tekstit origjinal.

Duket e çuditshme, por siç parashikon edhe Toury-ja kemi raste kur në tekstin origjinal nuk kemi një metaforë, por që na del në fakt në tekstin e përkthyer. Tek teksti i përkthyer nga ÇELA kemi disa raste kur një segment i tekstit origjinal është përkthyer me një metaforë të leksikalizuar apo thënë ndryshe me një shprehje idiomatike, frazeologjike.

➤ ...ma sì! ma sì!, potrei **giurare**...

- po ore! po! – mund **ta vija dorën në zjarr**... (Libri i parë, II, 12).

➤ La solitudine **vi spaventa**.

- Vetmia **ju kall datën**. (Libri i Dytë, I, 31)

➤ ...cioè proprio per la ragione per cui mi stima **avvedutissimo** l'altro...

- ...domethënë tamam për arse që tjetri më çmon **me një barrë mend**... (Libri i Tretë, VIII, 73).

➤ «Che fai» mia moglie mi domandò, vedendomi insolitamente **indugiare** davanti allo specchio.

- Ç'bën? – më pyeti ime shoqe, tek më pa që **jepja e merrja** para pasqyrës më gjatë se përherë. (Libri i Parë, I, 7)

- 

### 1.3.2. Similituda

Është figura që vepron në planin e kuptimeve, duke zgjeruar kuptimin e një shprehjeje. Konsiston në vendosjen e një raporti mes dy a më shumë imazheve, duke i krahasuar. Similituda i përket kategorisë së traslateve, sepse kërkon zhvendosjen dhe afrimin e dy fjalëve që u përkasin dy sferave të kuptimeve (fushave semantike) të ndryshme, por që kanë të përbashkët së paku një aspekt të kuptimit; është pikërisht ngjashmëria e këtij aspekti të kuptimit që lejon afrimin mes dy fjalëve, duke të autorizuar të thuash se termi i parë X është si termi i dytë Y.

➤ ... mi scavavano dentro e bucheravano giù per torto e su per traverso lo spirito, **come una tana di talpa**; senza che di fuori ne paresse nulla.

- ... më rrëmihnin së brendshmi dhe zhbironin nëpër shpirt **si një strofkull urithi**, pa u dukur gjë së jashtmi. (ÇELA, Libri i Parë, I, 9)

- më zhbironin kryq e tërthor **si një llagem urithi**, në çdo fjalë që të thuhej apo mizë që shihja të fluturonte; paçka se përjashta asgjë nuk shfaqej. (VUKAJ, Libri i Parë, I, 11)

Shembuj similitudash dhe krahasimesh gjejmë shumë në roman. Strategjia e përkthyesve është përkthimi dhe dhënia e kësaj figure retorike edhe në tekstin e përkthyer.

### 1.3.3. Antonomazia

Është një figurë e kuptimit që konsiston në shndërrimin e një emri të përveçëm në të përgjithshëm, duke ruajtur kuptimin e tij.

➤ Tuttavia, quelle rimesse con quei vecchi **landò d'affitto**, con l'attacco a tre...

- Gjithsesi, ato garazhe me ato **pajtone** të vjetra që jepeshin me qera, me mbrehje treshe... (ÇELA, Libri i Dytë, II, 35)

- Gjithsesi, ato hangare me **landotë** e vjetra treshe me qira... (VUKAJ, Libri i Dytë, II, 40)

Bëhet fjalë për një karrocë fisnikësh me katër rrota, e tërhequr nga kuaj, e cila e merr emrin nga qyteti gjerman ku u ndërtua për herë të parë. Në tekstet e përkthyer vëmë re se VUKAJ e jep antonomazinë, ndërsa ÇELA jep vetëm kuptimin e përgjithshëm semantik të fjalës, por jo antonomazinë.

- ...un abito di velo color **isabella**...
  - ...një petk prej veli ngjyrë **kullme**... (ÇELA, Libri i Tretë, VI, 65)
  - ...një rrobë pëlhere ngjyrë **izabelë**... (VUKAJ, Libri i Tretë, VI, 74)
- «Isabella» është një ngjyrë e ndërmjetme mes së bardhës dhe të verdhës kuqalashë. Emri vjen nga një episod i jetës së Izabelës së Austrisë, e bija e Filipit II të Spanjës, gruaja e Albertos së Austrisë. Izabela u betua që nuk do ta ndërronte këmishën pa mbaruar rrethimi i Ostendës (1601-1604). ÇELA ka përkthyer kuptimin semantik të fjalës, ndërsa VUKAJ e ka ruajtur antonomazinë, por segmenti i prodhuar në tekstin e përkthyer është semantikiisht bosh. Lexuesi, që nuk di etimologjinë e fjalës, nuk e kupton se për çfarë ngjyre bëhet fjalë.

#### 1.3.4. Sinestezia

Figurë retorike elegante që konsiston në vendosjen pranë të fjalëve që në dukje u përkasin sferave të ndryshme sensoriale, me qëllim që të përftoheshin ngjyrimet semantike që u përshtaten situatave të ndërlikuara psikologjike.

- Stava un po' sulla soglia, nella **penombra liquida** della cameretta...
  - Rrinte ca te pragu, në **gjysmëhijen e lëngët të dhomëzës** (ÇELA, Libri i Shtatë, VIII, 167)
  - Qëndronte pak në prag të derës, në **gjysmë-rrësirën e lëngët** të dhomës së vogël (VUKAJ, Libri i Shtatë, VIII, 167)
- Të dy përkthyesit e kanë dhënë këtë figurë retorike në tekstin e përkthyer në gjuhën shqipe.

#### 1.4. Figurat e mendimit

Figurat e mendimit, apo logjike, apo metalogjizmat, kanë të bëjnë me një fjalë apo me një thënie të tërë dhe i përkasin *inventio*-s, sepse veprojnë në nivel mendimi, përtej ligjërit, madje edhe duke kundërshtuar të dhënat e menjëhershme të

perceptimit apo të ndërgjegjes. Metalogjizmi alternon përshkrimin e referentit.

##### 1.4.1. Oksimori

Mund të konsiderohet një formë e veçantë e antitezës: vë pranë në të njëjtën shprehje termat e kundërt, që duket se përjashtojnë njëri-tjetrin. Duke qenë se përbën një paradoks intelektual, oksimori tërheq vëmendjen duke krijuar në një moment të parë një efekt largimi, por në realitet thekson konceptet me mprehtësi.

- Il **buon** figliolo **feroce**.
  - Djalka i **mirëmizor**. (ÇELA, Libri i Tretë, VI, 65);
  - Biri i **mirë mizor**. (VUKAJ, Libri i Tretë, VI, 74).
  - ...che quasi ne avevo angoscia, una **dolcissima angoscia**.
  - ...sa pothuaj ndjeja ankth për këtë, një **ankth kaq të ëmbël**. (ÇELA, Libri i Tetë, II, 173);
  - ...prej së cilës kisha pothuajse një ankth, një **ankth shumë të ëmbël**. (VUKAJ, Libri i Tetë, VI, 194)
- Në të dyja rastet përkthyesit e kanë dhënë këtë figurë retorike.

##### 1.4.2. Reticenca

Është figurë e mendimit që konsiston në ndërprerjen e një fjalisë përgjysmë, duke lënë pezull ligjërimin, ndonjëherë duke ndryshuar argumentin. Reticenca nxit fantazinë e bashkëbiseduesit për të integruar sipas dëshirës së tij mendimin.

- Dunque dunque... concludiamo.
- Mirë pra... le ta mbyllim. (ÇELA, Libri i Dytë, IV, 39)
- Hë de, hë... mbaruam. (VUKAJ, Libri i Dytë, IV, 46).
- Che se poi qualcuno vi fa notare che il naso vi pende un pochino verso destra... no? Che jeri avete detto una bugia... nemmeno? Piccola piccola, via, senza conseguenze...
- E nëse dikush ju bën me dije që hunda ju hepohet paksa kah e djathta... hë? Që dje thatë një gënjeshtër... as edhe kjo? një gënjeshtër...

tër të vockël fare, hajt, nga ato që s'prishin punë... (ÇELA, Libri i Dytë, I, 30)

- Që pastaj nëse dikush ju bën të ditur se hunda ju varet një çikëz nga e djathta... jo? Që dje kemi thënë një gënjeshtër... aspak? të vogël, të vogël, hajt, pa qeder... (VUKAJ, Libri i Dytë, I, 35)

➤ Ah, che scoperta! Mio padre... La vita di mio padre...

- Ah, ç'zbulim! Im atë... Jeta e tim eti... (ÇELA, Libri i Tretë, II, 60)

- Ah, çfarë zbulimi! Im atë... Jeta e tim eti... (VUKAJ, Libri i Tretë, II, 50)

Në tekstet e përkthyer në gjuhën shqipe, të dy përkthyesit e kanë dhënë këtë figurë retorike.

### Përfundimet

Kur flasim për formën e një teksti nënkuptojmë mënyrën e të shkruarit të shkrimtarit, stilin e tij. Dhënia e stilit të shkrimtarit është, pra, një ndër detyrat e përkthyesit letrar, prandaj përkthyesit letrar përveç problemeve leksikore dhe gramatikore i duhet të zgjidhë edhe probleme retorike dhe ritmike. Përkthimi i figurave retorike përbën një ndër pikat më të brishta në përkthimin e një vepre letrare, sepse jo gjithmonë përcillen siç duhet në tekstet e përkthyer duke u bërë shkatërtare të mjaft humbjeve në procesin përkthimor. Vështirësia lind aty ku figura retorike nuk kuptohet nga ana e përkthyesit ose atëherë kur gjuha e përkthimit nuk të ofron stukturat e duhura për dhënien e figurës retorike në tekstin origjinal.

Si përfundim duhet të themi se përkthyesit e këtij romani të Luixhi Pirandello kanë ndjekur në përgjithësi strategjinë e përkthimit të figurave retorike të krijuara nga autori. Më i lehtë është rasti kur imazhet e krijuara në tekstin e përkthyer janë të njëjta me ato të tekstit origjinal si pasojë kjo edhe e strukturave të imagjinatës që janë të përfërta. Respektohet në këtë mënyrë edhe *intentio-auctoris*.

### Bibliografia

BASSNETT Susan, 1993. *La traduzione teorie e pratica*, Bompiani, Milano.

BATTAGLIA S., 1967, *Pirandello narratore* në *Atti del Congresso Naz. di studi pirandelliani*, Firenze, Le Monnier, f. 25-36.

BLANCO Antonia Navarro, 1990, *La lengua y el estilo de Luigi Pirandello*, Sevilla (teze doktorate).

ÇUÇKA Shpëtim, 1989, *Metodologia della traduzione*, shblu, Tiranë.

DEVOTO G., 1950, *Studi di linguistica*, Firenze.

ECO Umberto, 2003, *Dire quasi la stessa cosa, Esperienze di traduzione*. Bompiani, Milano.

GENTZLER Edwin, 1998, *Teorie della traduzione, Tendenze contemporanee*, UTET, Torino.

GUIRAUD P., 1980, *Essais de stylistique*, Paris.

HURTADO ALBIR Amparo, 2001, *Traducción y traductología: Introducción a la Traductología*, Cátedra, Madrid.

KOKONA Vedat, 2003, *Mbi përkthimin, me përkthyesin*, Botimet Kokona, Tiranë.

LEKA F., SIMONI Z., 2000, *Fjaloritisht-shqip*, Infbotues, Tiranë.

LLOSHI Xhevat, 1971, *Figurat letrare dhe simboli*, «Nëntori», No. 7, f. 22-54.

LLOSHI Xhevat, 2001, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatica*, shblu, Tiranë.

NAPOLI Marisa, 1995, *I linguaggi della retorica*, Zanichelli Editore, Bologna.

NEWMARK Peter, 1981, *Approaches to Translation*, Pergamon Press, Oxford.

ORTEGA Y GASSETT J., 2001, *Miseria e splendore della traduzione, përkthim nga Claudia Razza*, Il Melangolo, Genova.

OSIMO Bruno, 2004, *Manuale del traduttore*, Hoepli, Milano.

PIERO CAPPELLO Angelo, 1995, *Come leggere «Uno, nessuno e centomila di Luigi Pirandello»*, Mursia, Milano.

PIRADELLO Luigi, 1994, *Uno, nessuno e centomila, Testo integrale, schede storiche e letterarie, note al testo*, Meravigli Editrice, Vimercate.

PIRADELLO Luigi, 2001. *Një, asnjë dhe njëqindmijë*, përkthyer nga Zija Vukaj, Elite, Tiranë.

PIRADELLO Luigi, 2002. *Një, asnjë dhe njëqindmijë*, përkthyer nga Dritan Çela, Sejko, Elbasan.

SHEHRI Dhurata, *Retorika*, Cikël leksionesh për studentët e Fakultetit Filologjik, Dega Letërsi.

SPITZER L., 1954, *Critica stilistica e storia del linguaggio*, Bari.

TERRACINI Benvenuto Aronne, *Analisi Stilistica, Teoria, storia e problemi*, Feltrinelli, Milano.

TERRACINI, 1982, *Analisi stilistica*, Feltrinelli, Milano.

THOMAI Jani, 2010, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, EDFA, Tiranë.

TUPJA Edmond, 2000, *Këshilla një përkthyesi të ri*, Onufri, Tiranë.

ZINGARELLI N., 2002, *Vocabolario della lingua italiana*, Zanichelli, Bolonjë.

---

## “THE NEW MAN” AND DHE NOVEL IN ALBANIAN SOCREALIST LITERATURE “NJERIU I RI” DHE ROMANI NË LETËRSINË SHQIPE TË REALIZMIT SOCIALIST

LIRIM SULKO

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, SHQIPËRI  
e-mail: lirimsulko@yahoo.com

### Përmbledhje

Qëllimi ynë është të hetojmë se si romani u bë zhanri kryesor letrar në letërsinë shqipe të realizmit socialist, siç në fakt në letërsinë evropiane kjo ndodhte prej dy shekujsh. Por realizmi socialist do të huazonte, për më tepër do theksonte, mënyrën autoritative të rrëfimit, si shprehje e dehumanizimit, në kuptimin e nënshtrimit të plotë të personazhit (nënkupto të lexuesit, i cili identifikohet me personazhin përgjatë procesit të leximit) ndaj informa-cio-nit total brenda veprës letrare të zotëruar nga autori në bashkëpunim me narratorin. Por që në të njëjtën kohë do të shpallte si heretike mënyrat narrative që e çlironin personazhin nga nënshtrimi pa lavdi i dyshes autor-narrator. Gjithashtu realizmi socialist do të përvetësonte dy tipologjitë e romanit sipas E. Mjur: romani i ngjarjeve, që ndër-to-het si një tërësi ngjarjesh ku afirmohet hero i romanit, për të cilin lexuesi ka ndjeshmëri pozitive dhe bëhet pjesë e strategjive narrative duke u identifikuar me heroin kryesor dhe romani i personazheve që ka në qendër pe-r-so-nazhe të plantë, të rëndomtë ndaj të cilëve lexuesi ka ndjeshmëri negative dhe lexuesi bëhet pjesë e stra-te-gjive na-rra-tive duke i ndjekur ato nga këndvështrimi i narratorit. Pra realizmi socialist do t'i shkrinte në një të vetme këto dy tipologji të romanit të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe do të ndërtonte romanin skematik të realizmit socialist me bashkëpraninë e njëkohshme të heroit pozitiv dhe personazheve negative, shoqëruar kjo me patologjitë përka-të-se të leximit, gjithmonë në funksion të propagandës.

**Fjalët çelës:** Realizmi socialist, autori, narratori, dehumanizim.

### Summary

Our aim is to cast light how the novel became the leading literary genre in Albanian literature of socialist realism. Ho-vever, it this fact has been occurring in European literature for about two centuries. Socialist realism went fu-r-ther not only adopted but also put emphasize on authoritative manner. As an expression of dehumanization in the se-nse of complete submission to the character (meaning to the readers, who identified with the character in the pro-cess of reading) towards total information within master literary work by the author in collaboration with the na-rrator. But at the same time would announce as heretical narrative ways which freed character of the sub-mi-ssion without glory author - narrator. Also socialist realism will embrace two typologies novel by E. Muir; novel events, which is built as a set of events which affirmed the hero of the novel, to whom the reader has po-si-ti-ve se-n-si-tivity and becomes part of the narrative strategies by identifying with the main hero characters and no-vel ce-n-te-red characters Plante, mundane to whom the reader has negative sensitivity and reader becomes part of the na-rra-tive strategies by following them through the narrator's point of view. Therefore socialist realism will me-rge in-to a single these two genres of nineteenth-century novel, and build the schematic novel with co-existe-n-ce both po-si-tive hero and villains, accompanied with relevant pathologies of reading, always to serve as a mean of propaganda.

**Key words:** social realism, the author - narrator, dehumanization.

---

### HYRJE

Prej tre shekujsh (XVIII, XIX, XX) romani ka qenë zhanri kryesor letrar në letërsinë perëndimore, i

cili përmes zhvillimit të romanit psikologjik (romani jopsikologjik, parapsikologjik, është vetëm një formë e eposit apo satirës, ekuivalentë të të

cilave i gjejmë edhe në kulturat joperëndimore) bëhet shprehje e vokacionit individualist që karakterizon qytetërimin perëndimor kur ky i fundit kaloi nga shoqëria tradicionale në shoqërinë moderne. Ekspansioni i romanit ndjek këtë linjë: në shoqërinë perëndimore tradicionale, ashtu siç në çdo shoqëri tradicionale joperëndimore, ku mbizotëron interesi i bashkësisë mbi individin, mbizotëron lëvrimi i poezisë mbi romanin, në shoqërinë perëndimore moderne ku mbizotëron interesi i individit mbi bashkësinë, mbizotëron lëvrimi i romanit mbi poezinë.

Në letërsinë shqipe një vokacion i tillë individualist nuk arriti të kurorëzohej për shkak se shoqëria shqiptare trashëgonte ndikime të forta tradicionale, por edhe procesi i orientimit perëndimor, që kishte nisur në vitet e mbretërisë u ndërpre si rezultat i vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore. Tashmë, në kuadër të realizmit socialist, arti shndërrohet në një mjet ndihmës i propagandës ideologjike dhe si i tillë ai kishte në qendër frymën e kolektivizimit dhe vënien e interesave të përgjithshme mbi ato individuale. Aspekt ky që bie ndesh me tendencën moderne të qytetërimit perëndimor dhe po ashtu shtyn në kohë lëvrimin e romanit në letërsinë shqipe dhe ku prioritet, sipas skemës së sipërpërmendur, do të ketë lëvrimi i poemës dhe i poezisë lirike. Pikërisht poema dhe poezia lirike do të jenë mjeti ndihmës i propagandës ideologjike, e cila me qëllim instalimin e komunizmit në Shqipëri, synoi së pari krijimin e kushteve ku do të instalohet "njeriu i ri", pasi sipas ideologëve marksistë njeriu në thelb është i mirë, por janë rrethanat, kushtet ato që e përlyejnë atë, nuk lejojnë ndërtimin e tij.

### **Mimesisi përballë trillimit**

Menjëherë pas krijimit të këtyre kushteve (vitet 1945-1960) vemendje e posaçme i kushtohet ndërgjegjjes individuale të 'njeriut të ri', se vetëm kështu transformimet stukturore të shoqërisë do të ishin të thella dhe sipas ideologëve marksistë-leniniste, do të shënonin triumfin përfundimtar të socializmit në rrugën drejt komunizmit, pra instalimin e plotë të njeriut të ri. Tashmë interesi zhvendoset drejt individit (ngjajshmërisht me

individualizmin në qytetërimin perëndimor) dhe pikërisht kjo do mundësojë mbizotërimin e lëvrimin të romanit mbi poezinë në letërsinë shqipe (vitet '60, '70, '80). Në letërsinë perëndimore tendenca ekspansioniste e romanit konkludon me romanin avangardist ku përmes teknikës së përroit psikik format, të çliruara nga pesha e përmbajtjeve, ndjekin në mënyrë të pandërprerë njëra-tjetrën, apo romani absurd, si aplikim metodik, dëshmon pamundësinë e përmbajtjeve në funksionin e tyre klasik të motivimeve të formave.

Ndërsa romani në letërsinë shqipe të realizmi socialist (si i gjithë arti në socializëm), jo vetëm që i shmanget një tendence të tillë formaliste, por i nënshtrohet një procedure të egër censurimi. Censurimi nënkupton ndalimin e çdo tendence formaliste në artin e romanit, sepse e konsideron artin, në përgjithësi dhe romanin, në veçanti si vazhdim i realitetit përmes imitimit (mimesisit). Kjo nënkupton se nuk ka kufij midis botës së njëmendësisë dhe botës së trillimit letrar, duke konfunduar marrëdhënien midis sendeve, qenive njerëzore të botës së njëmendësisë me imazhet e botës së trillimit, e cila nuk e shmang dot joshjen që vjen prej trillimit artistik, siç janë efektet e ligjërit poetik të karakterizuar nga shenjimi që imazhet i bëjnë njeri-tjetrit, vetidentifikimin e lexuesit me personazhet dhe ngjarjet brenda veprës letrare. Por në të njëjtën kohë kjo shoqërohet edhe nga shkujdesja për t'i zhvendosur në botën e njëmendësisë imazhet e trillimit artistik, të cilat mundësojnë shmangien e objekteve universale (imazhet e njëmendëta) përmes identifikimit midis tyre (imazheve të trillimit artistik dhe universaleve në funksion të imazheve të njëmendëta). Imazhet e trillimit artistik duke qenë të kthjellëta në cilësitë e tyre individuale, kur qasen dhe ballafaqohen me imazhet e botës së njëmendësisë, të cilat ekzistojnë të turbullta në kujtesë (përvetshëmëri) përmes linjave të tyre të përgjithshme, asgjësohen dhe e lënë praktikisht botën e njëmendësisë pa universale, ku tashmë vendin e tyre e zënë imazhet e botës së trillimit letrar. Si e tillë kjo e fundit (bota e trillimit) ngrihet në sistem dhe elaborohet prej realizmit socialist duke e konsideruar romanin specifikisht si komplementar të pralajmërimeve apo sugjestionimeve, që zhvi-

llonte diktatura përmes makinës së saj propagandistike, me synimin për të depërtuar me çdo kusht në botëpërjetimin e anëtarëve të vet. Pra diktatura dhe 'levat e saj' synonin të vëzhgonin në botëpërjetimin e anëtarëve të të gjithë shoqërisë, duke qenë ato rrëfyesi dhe tjetri, pra lexuesi dhe njëkohësisht personazhi i skllavëruar, për aq kohë sa ata identifikohen mes tyre me synim injektimin e 'njeriut të ri', potencialisht në çdo lexues, thënë ndryshe në mbarë shoqërinë, përmes stërvitjes nga leximi i romaneve.

Si i tillë, romani i realizmit socialist do të theksohte mënyrën autoritative të rrëfimit, si shprehje e dehumanizimit, në kuptimin e nënshtrimit të plotë të personazhit (nënkupto të lexuesit, i cili identifikohet me personazhin përgjatë procesit të leximit) ndaj informacionit total brenda veprës letrare të zotëruar nga autori në bashkëpunim me narratorin. Por që në të njëjtën kohë do të shpallte si heretike mënyrat narrative që e çlirojnë personazhin nga nënshtrimi pa lavdi i dyshtes autor-narrator. Kjo skemë manipulimi e ka bazën në nënshtrimin e plotë, total ndaj dijes në qarkullim, ideologjisë marksiste-leniniste, në aleancë me pushtetin absolut të partisë dhe liderit të saj, një lidhje simbiozë sipas së cilës arsyeja e ideologjisë (në funksionin e dijes) ishte të promovojë dhe të legjitimojë pushtetin monopartiak, e baraspshuar me arsyen e këtij pushteti që të ruajë, mbrojë dhe përhapë marksizëm-leninizmin. Si rrjedhim të gjitha llojet dhe nivelet e dijes duhet të integrohen në ideologjinë në fjalë, marksiste-leniniste, dhe zotëruesit e dijes duhet të integrohen duke u identifikur me pushtetin për t'i shërbyer atij, në të kundërt konsiderohen armiq të pushtetit, deri në atë masë sa konsiderohet e natyrshe që pushteti t'i keqtrajtojë, izolojë apo eliminojë ata.

Një marrëdhënie e tillë midis ideologjisë marksiste-leniniste (në funksionin e dijes) dhe pushtetit monopartiak (partisë-shtet) e ngurtësoi dijen, duke e vendosur në funksion të ruajtjes së unitetit mbarëshoqëror përmes aplikimit të të vërtetave të përbashkëta, në trajtën e citateve dhe parullave, vërtetësia e të cilave konsiderohej e padiskutueshme, absolute.

Gjithashtu një marrëdhënie e tillë (midis dijes dhe pushtetit) e monopolizoi dijen në duart e pushtetit, pra në duart e partisë-shtet dhe liderit të saj, duke u dhënë atyre një autoritet të padiskutueshëm, pavarësisht nga vërtetësia e pohimeve të tilla në formë citimesh apo sloganesh. Kjo bëri që për shumicën e anëtarëve të shoqërisë vëzhgimi i reales dhe kërkimi i të vërtetës të jetë në mos i pamundshëm, padyshim i pakonsumueshëm. Pra, në masë, shoqëria është e orientuar të ketë të vërteta të përbashkëta, ku roli i institucioneve të saj (në fakt levat e partisë) është të shmangin, ruajnë, neutralizojnë angazhimet individuale në shërbim të së vërtetës dhe njëherësh të gjithë përcaktimin e besueshmërinë t'ia atribuonë kriterit të autoritetit, pra partisë-shtet, me synim ruajtjen e unitetit (parti-popull).

Arritja dhe ruajtja e këtij uniteti funksionon si kriter besueshmërie dhe shtron si detyrim se vetëm ajo që i shërben këtij uniteti dhe që përputhet me interesat 'e larta' të ndërtimit të socializmit duhet të jetë e vërtetë. Dhe është ajo që garanton kushte që njerëzit të jetojnë së bashku, por tashmë me sakrifikimin e madh të së vërtetës.

Si pasojë e mbrojtjes së kësaj strukture u bë disponim përpjekja për t'ia imponuar mbarë shoqërisë dijen marksiste-leniniste, jo përmes argumentit dhe bindjes, që në fakt përbën natyrën e vërtetë të dijes, por përmes konfrontimit dhe dhunës, përfshirë dhe artin e romanit, përmes censurës. Në kushte të tilla, në kontekstin e realizmit socialist, është e kollajtë të ndodhë, në fakt është e pamundshme të mos ndodhë, sa kohë botët e trilluara të romaneve i konsiderojmë (përmes mimesisit) si vazhdim i botës së njëmendësisë, pra kur i hapim kufijtë midis botëve dhe i konsiderojmë të natyrshe depërtimet e tyre tek njëra-tjetra.

### **Ekzagjerimi si karakteristikë rrëfimore**

Në këto kushte dija që vjen nga bota e njëmendësisë përmes vëzhgimit të autorit, transferohet në botën e romanit, duke iu bashkangjitur dijes së rrëfyesit, me qëllim jo më të shpjegimit të së vërtetës së kësaj bote dhe personazheve, por me qëllim garantimin e pushtetit përfundimtar të rrëfyesit mbi personazhet.

Në këtë mënyrë romanet e realizmit socialist të mbizotëruar nga ndërhyrjet autoriale, me paktin e lartpërmendur për t'i shërbyer pushtetit, realizojnë këtë aleancë me narratorin që i vetkorrup-ton, i manipulon personazhet duke përfitur nga pavetëdijshmëria e tyre. Dhe triumfi apo dështimi i personazheve ndodh ose në varësi të ligjeve të shoqërisë dhe, në këtë rast, masën e vëzhgimit që kalon në rrëfim e përcakton autori, ose në varësi të sinergjisë së rrethanave brenda veprës letrare, dhe në këtë rast masën e vëzhgimit që kalon në rrëfim e përcakton narratori. I gjithë informacioni përqendrohet në një qendër të vetme, pikërisht tek narratori i gjithdijshëm, i cili mundëson shpërndarjen kontrolluese të këtij informacioni, në funksion të ruajtjes së ritmit të zgjatjes së botës së trilluar.

Në fakt kjo mungesë e përkushtimit dhe e përfutimit të dijes nga ana e personazheve është karakteristikë absolute në romanet tipike të realizmit socialist të tilla si *Kënetë* e F. Gjatës, *Përsëri në këmbë* e Dh. Xhuvanit etj. Si një e dhënë e drejtëpërdrejtë e mimesisit (konceptimi i veprës letrare si vazhdim i botës së njëmendësisë), i ndërhyrjeve autoriale në bashkëpunim me narratorin e gjithdijshëm (në kuadër të vëzhgimit të jashtëm – ngjarjeve subjektore dhe në kuadër të vëzhgimit të brendshëm - analizat psikologjike) është ekzagjerimi, që vihet re më së pari tek personazhet kryesorë, Stavri Lara e Din Hyka.

Kështu Stavri Lara jepet i dominuar nga përkushtimi, fanatizmi dhe rigoroziteti. Përkushtimi ekzagjerohet duke përshkruar sakrificat e Stavri Larës në përpjekjet për të tharë kënetën (qëndrimi vetëm pak kohë në shtëpi sa për tu çmallur pas një kohe të gjatë larg njerëzve të familjes, Shkuarja drejt e në kantierin e vështirë të Maliqit, organizimin e gjithë punës pavarësisht vështirësive), kurse fanatizmi dhe rigoroziteti i tij ekzagjerohen në besimin e tij te partia për tharjen e kënetës brenda afatave që ajo ka vendosur dhe bindjet e palëkundura që ai ka për tradhëtinë e grupit të inxhinierëve, shkatërrimin e komplotit etj.

Din Hyka jepet i dominuar nga ndershmëria dhe vetëmohimi kur nuk pranon mëshirë dhe rryshfet, flak librezën e pensionit apo kërkon të punojë

si gjithë të tjerët, të mos jetojë si parazit në kurriz të shoqërisë.

Por ekzagjerimi aplikohet edhe tek ngjarjet, edhe tek dialogët, edhe tek përshkrimet. Kështu përmes ekzagjerimit jepen ngjarjet (Ngjarja e plagosjes së Stavri Larës dhe kthimi i tij në shtëpi pa asnjë lajmërim paraprak, takimi i Fullcit me inxhinierët dhe porositë e tij, shkuarja në Maliq vullnetarisht e familjes së Stavri Larës, po ashtu edhe e ish mësuesit të tij pensionist, ish të dashurës së tij tashmë të martuar, ndarja e saj nga bashkëshorti patriarkial dhe rilidhja e saj me Stavrin në kantierin e Maliqit (romani *Kënetë*); qëndimi në spital i Din Hykës, largimi e tij i vetëm nga spitali, përgatitja e protezave të drunjtja prej kumbullës që kishte në oborr, puna e tij e rëndë edhe për një njeri normal në magazinën e rikuperos e madje shpikja e tij novatore e një pajisje shkarkuese për makinat reportabël, së fundi hyrja në parti e Din Hykës si akti më i lartë dhe domethënës i tij (romani *Përsëri në këmbë*).

Përmes ekzagjerimit jepen pothuajse gjithë dialogët e Stavri Larës, qoftë me familjarët e tij, me inxhinierët, me sekretarin e partisë së rrethit, me punëtorët e madje edhe me ish të dashurën e tij (romani "Kënetë"). Po kështu edhe Din Hyka në dialogun e tij me doktorin, me shokët e punës – veçanërisht me Titin, me të motrën, me sekretarin e partisë së rrethit (romani *Përsëri në këmbë*). Një vend të veçantë zënë përshkrimet ekzagjeruese të vullnetarëve në romanin *Kënetë*, që edhe pse jetojnë në kushte shumë të vështira, përsëri janë shumë të gëzuar, puna me hov revolucionar për tharjen e kënetës me kazma e lopata e vetëm me një ekskavator, po aq ekzagjerohet edhe puna komlotuese e inxhinierëve të udhëhequr nga Fullci, që shkon deri atje sa ata duan të rrëzojnë socializmin e madje të çënojnë lirinë e vendit sipas planeve amerikane.

Në mënyrë ekzagjeruese përshkruhet ardhja e shokëve të punës së Din Hykës në spital, përballimi që ata i bëjnë bllokadës së rëndë në romanin *Përsëri në këmbë*.



**Përfundim**

Si rregull paraqitje të tilla të ekzagjeruara të personazheve janë të panatyrshme dhe si të tilla janë të projektuara artificialisht me një synim të qartë ideologjik për të qenë shëmbëllime të drejtpërdrejta të 'njeriut të ri'. Këta personazhe nuk janë të lirë të bëjnë asgjë, sepse janë skllëvër të cilësive të tyre të mbiçmuara. Kjo ndodh si pasojë e mënyrës së kontrolluar të përhapjes së informacionit brenda veprës letrare nga dyshja autor-narrator, përjashtimi total i personazheve nga e vërteta jo vetëm e botës së veprës letrare, por edhe e tyrja personale, duke mos gjetur as edhe një motiv të jashtëm apo të brendshëm për të motivuar përhapjen e informacionit brenda verës letrare.

**Bibliografi**

- ARISTOTELI (2004), *Poetika*. Përktheu, Hajri Zotomadhi. Uegen, Tiranë.
- BAHTIN, Mihail (1980), Epi dhe romani: *Çështje të romanit*. f. 19-62. Përktheu Muhamet Kërnja. Rilindja, Prishtinë.
- DADO, Floresha (2011), *Letërsi e paimterpretuar*. Onufri, Tiranë.
- MJUR, Edvin (1980), Romani i ngjarjeve dhe romani i personazheve: *Çështje të romanit*. f. 174-196. Përktheu Muhamet Kërnja. Rilindja, Prishtinë.
- LIOTAR, Zhan F. (1996), *Gjendja postmoderne: raporti mbi dijen*. Përktheu M.Kullashi. Dukagjini, Prishtinë.
- NIKOLLA, Albert P. (2012), *Njeriu i ri shqiptar*. Onufri, Tiranë.
- ZEKTHI, Rudian (2012), *Vëzhgimi pa sfond*. Dy Lindje dhe dy Perëndime, Tiranë.

---

---

## A SHORT LOVE STORY OF MIGJENI TREGIMI I SHKURTËR I DASHURISË TEK MIGJENI

LORETA LOLI  
Universiteti i Tiranës, Tiranë, SHQIPËRI  
Email: loreta.loli@gmail.com

### Përmbledhje

Tregimi "Puthja e Cubit" përket në llojin e tregimit të shkurtër të dashurisë për shkak të linjës strukturore dhe përmbajtësore që ka. Tregimi përcjell dhe flet vetëm për ndjenjën. Në asnjë moment gjuha nuk të largon nga ndjenja e dashurisë, bota e brendshme e femrës, tablotë romantike, natyra, leksiku thellësisht lirik etj. Falë analizës tekstore për tri pjesët që organizojnë tregimin arrijmë në përfundimin se çdo gjë që thuhet dhe përshkruhet i referohet botës së brendshme të personazhit, Dilës, e cila mund të identifikohet vetëm nëpërmjet modalitetit "Dua". Dila dëshiron dhe kërkon dashurinë, një dashuri që i shfaqet vazhdimisht në formën e iluzionit, sepse "objekti i saj me vlerë" - Cubi, më së shumti është mungesë se prani. Në prozën migjeniane ky tregim ka rëndësi, sepse shërben si kurora e erotikës së pastër. Nëse më parë në tregimet e tjera të shkurtra të këtij poeti ka gjurmë të fakteve objektive dhe të copëzave të ndjenjës, ku dukshëm të parat janë dominuese ("Qershijat") duke i klasifikuar tregimet e mësipërme në llojin e tregimeve të faktit, "Puthja e Cubit" është tregimi që flet nga fillimi deri në fund për dashurinë. Cfarë na ndihmon në këtë përfundim është analiza e modalitetit "Dua" që personazhi kryesor vendos me gjithçka që e rrethon. Dila = modalitetin e dëshirës, dashurisë, me DUA-n. Llojet e marrëdhënieve që Dila vendos me këtë modalitet, varësisht kur pranë saj është dhe largohet objekti me vlerë,- Cubi, na zbulon edhe llojin e dashurisë që personazhi ynë mendon se ka. Analiza e modalitetit "Dua" na tregon se Dila kujton se është e dashuruar por ky është iluzion, pasi prania dhe mungesa e Cubit, i cili shfaqet vetëm për të shkaktuar lindjen e ndjenjës dhe jo si Subjekti që e prodhon atë,- në asnjë moment nuk thuhet se Cubi e puth vajzën 17-vjeçare, edhe pse kjo fjalë, Puthja, i vihet si pronë atij që në titull, vetëm sa argumenton natyrën e iluzionit.

**Fjalët çelës:** dashuria, modaliteti "Dua", prania, mungesa, iluzioni.

### Summery

The story "Kiss of the thief" belongs to the type of short love story because of structural and substantive line there. The story gives and speaks only for the feeling. At no moment does the language put you away from the feeling of love, inner world of woman, romantic landscapes, nature, deeply lyrical vocabulary etc. Thanks to the textual analysis of three parts that organize the story we conclude that everything that is said and described refers to the inner world of the character, Dila, which can only be identified through the modality "I love". Dila wants and asks for love, a love that constantly appears in the form of illusion because "its valuable object" – the thief, is more absent than present. In the migjenian prose this story is important because it serves as the crown of pure eroticism. If previously in other short stories of this poet there are traces of objective facts and parts of feelings, the first are dominant ("cherries") by classifying the above stories as the kind of fact stories, "Kiss of the thief" is the story that speaks about love from the beginning to the end. What helps us to this conclusion is the analysis of modality "I love" that the main character decides all around. Dila = modality of desire, love, and "I love". Types of relationships that Dila sets to this modality, depending when next to her it is and it is removed the earthly object, the thief, finds out the kind of love that our character thinks it has. Analysis of "I love" modality indicates that Dila thinks that she is in love but this is only an illusion, since the presence and absence of the thief, who appears only to cause the start of feeling and not as the subject who produces it, it is never said that the thief kisses the 17-year-old girl, even though this word, kiss, is put as a possession to him as in the title, it only argues the illusory nature of the feeling of love.

**Key words:** Love, "I want" modality, the presence, the absence, illusion.

---

## Hyrje

Punimi “Tregimi i shkurtër i dashurisë tek Mi--gjeni” ka si objekt studimi shfaqjen dhe ana-li-zën tekstore të elementeve erotikë te ky shkri--mtar. Në gjininë e prozës ajo, erotika, për-fa-që-so-het vetëm nga një tregim, ku rëndësi të dorës së parë ka përdorimi i modalitetit “Dua”, thënë ky sipas konceptit Greimasian. Objekt i analizës do të jetë i gjithë teksti, ku vëmendje të posaç-me do të marrë analiza e marrëdhënieve që fo-r--mon modaliteti “Dua”, i cili i përket vetëm Di-lës, personazhit kryesor të tregimit.

Tregimi i shkurtër i dashurisë dhe mbizotërimi i modalitetit “Dua”

Me një gjuhë thellësisht lirike, nëpër rre-sh-tat e tregimit “Puthja e Cubit” ndihet dashuria dhe bota e Diles, personazhit qendror të dashu-ruar. Lajmi se ka ardhur pranvera na jepet që në fjalinë e parë, ndërtuar me sintaksë shpje-guese: “Edhe një pranverë ka ardhë” duke na sjellë ndërmend poezinë: “Ekstaza pranve-ro-re”, që nis po kështu afërsisht: “...dhe pran-ve-ra erdhi...” Pas kësaj fjalie ndërtohet menjëherë ta-bloja romantike e ndjenjës:

(“Prendvera e 17-të për Dilën, e cila, e shtri-me në bar, ndjeu se ka tamam, as ma pak as ma tepër se 17 vjet”)

Fabula është shumë e thjeshtë: Dila dashu-ron Cubin, i cili më shumë është mungesë se pra--ni. Cubi është prani, aq sa të shkaktojë tek Di-la ndezjen e ndjenjës së dashurisë: (“Dila ka-një-herë me dashje dhe pa dashje e shikonte në sy dhe kuqej, kanjëherë me dashje e pa dashje, tue bamë punë nëpër shtëpi, në të kaluem e pre-kte me krah dhe nga ajo prekje iu rritshin gji-të”), për gjithçka tjetër pas kësaj Cubi është mu-ngesë, duke e kthyer tregimin e dashurisë në tregimin e Dilës së dashuruar, vetëm në të sa-jin.

Hapësira i takon plotësisht vajzës, botës së saj të brendshme. Modaliteti i vetëm që merr ku-ptim dhe zbatim te personazhi është mo-da-li-te--ti “Dua”, çdo gjë që ndodh ndodh për Dilen, pi--këvështrimi, edhe pse nga ana e narratorit të gji-thëdijsëm objekt ka vajzën 17-vjeçare.

Kate--goritë foljore, fusha e emrave dhe shenjat e tje-ra tekstore, të gjitha bashkë, veprojnë në kë-të linjë.

Karakterizimi i personazhit bëhet në mënyrë të plotë, ndryshe nga ç’ndodh me tregimin e shkurtër të Migjenit. Për të dimë emrin- e quaj-në Dile, dimë moshën – sapo ka mbushur 17 vjet, identifikojmë vendin – Malësia, njerëzit e afërt – nëna, babai, vëllai i Dilës dhe në fund pe--r-ceptojmë botën e saj – ndjenjën e dashu-ri-së, dëshirat, ëndërrimet.

Marrëdhënia që ndërtohet midis vajzës dhe Cu-bit është e çuditshme. Ndërsa teksti flet va-zh--dimisht për ndjenjat e Dilës, sa herë që ajo ndesh me sy Cubin, aq sa “Ndjenja e lë pa gju-më”, për këtë të fundit nuk jepet asnjë lloj she-nje tekstore, të tillë që ta lidhë me dashurinë. Ai nuk i përgjigjet dashurisë së vajzës. Nuk i di-më arsyet, teksti nuk na thotë gjë, vetëm thu-het: “Dhe një ditë Cubi u largue...”. Rruga e Cu-bit është prania dhe largimi.

Kë dashuron në të vërtetë Dila?

Tregimi ndahet në tri pjesë, të organizuara sipas logjikës pasojë-shkak, ku secila mbahet nga subjekti i vet përkatës (pjesa e parë dhe e dytë nga Dila, ndërsa e treta nga Cubi).

Hyrja (pjesa e parë) na njeht me gjendjen e Di-lës, momentet e përjetimit të dashurisë që ka për Cubin.

Pjesa e dytë jep shkakun e gjendjes, e rea-li-zuar nëpërmjet analepsës.

- Shfaqja e Cubit, prania e tij në shtëpinë e Dilës - ky është shkakun e dashurisë: “Një ndjesi e fshe-htë rritej në zemrën e Dilës dhe sa më shu-më ditë kalojshin aq më e madhe bahej. Dhe ndje-sia u ba dëshirë, dëshirë që të len pa gjumë.”

Pjesa e tretë bën rikthim në pasojë, pra në gje-ndjen e Dilës, por me një tipar më shumë në pë-rmbajtje. Nëse në fillim Dila vetëm përje-to-n-te: “Ajo mësoi se kishte 17 vjet dhe ëndërronte te-ksa shikonte qiellin e kaltër me një dëshirë të vo-kët në gji”, në fund të tregimit Dila vepron, kë-rkon dashurinë e saj:

“Si e dehun, n’ekstazë, ecte Dila, dhe nuk e pa bariun që ndenjun buzëqeshte. Ecte Dila,

va-zh-doi edhe pa gjurmë dhe gjithënjë n'ekstazë. La grigjen, as që i binte ndër mend, pse kër-ko-n-te Cubin."

Janë foljet ato që bëjnë ndarjet mes këtyre dy pjesëve të mbajtura nga i njëjti subjekt. Ndë-r-sa tek i pari subjekti është subjekt i gjendjes, në rastin e dytë ai është subjekt veprues, del nga pasiviteti në veprim për të kërkuar dashu-ri-në e vet.

### Pranëvënia mes foljeve

Foljet e pjesës së parë i përkasin gjendjes, pe-rceptimeve shqisore: "Shikon, ndigjon, i rreh gja-ku, mbyll sytë, i terte...", të dytat përkasin me veprimin e Dilës: "U hodh në kambë, shikoi pë-r-qark, u drodh, u vue në ndjekje të Cubit, ec-te, kërkonte, doli në rranxë të malit, përpla-se-shin, ndëgjoheshin ..." I vetmi që nuk pëson ndry-shim është mbiemri foljor: "e shtrime", i ci-li tregon gjendjen e personazhit.

Në pikëpamje sa-siore mbiemri foljor është më shumë i për-do-ruri dhe gjithmonë është i lidhur pazgji-dh-sh-më-rishtë me subjektin e Dilës dhe botën e saj të da-shu-risë.

Në pjesën e parë ai përdoret pesë herë: "E shtrime në bar, ndjeu se ka tamam, as ma pak as ma tepër se 17 vjet", "Edhe Dila, e shtrime në bar, ndjeu se ka tamam 17 vjet", "Ashtu e shtri-me shikon qiellën e kaltërt", "Çohet herë he-rë e shikon bagtinë dhe prap shtrihet, me një dë-shirë të vokët në gji" dhe "ven shplakët nën krye dhe ma fort shtrihet, ndjen si nder veshë dhe nder tamtha i rreh gjaku..."

Në të pestë ra-s-tet mbiemri foljor ndiqet nga folja "ndjen" ose nga emri "ndjenjë" dhe deri-va-tet e tij, të cilët, gjithsesi, na mbajnë brenda të njëjtës fushë leksikore.

Në pjesën e tretë përdoret sërish mbiemri fo-ljor "e shtrime", por kësaj radhe teksti e shfaq vetëm dy herë. Kjo për arsien e dhënë më sipër. Tani është koha e veprimit. Megji-tha-të, edhe në dy rastet e fundit, mbiemri "e shtri-me" ndiqet nga folja "ndjen" dhe emri "ndje-një": "E shtrime në bar, ndjen se si i rreh gjaku ndër dej." dhe "Ashtu e shtrime dhe n'andrrim Dila nuk desht t'i çeli syt' edhe se ndjeu mbi tru-pin e vet një peshë dhe të

dihatunit e një mash-ku-lli dhe mbi buzët e veta të përvlueme një njo-m-si."

Përdorimi i mbiemrit foljor bën lidhjen mes Di-lës dhe vendit ku ajo ndërton dëshirat: "Bari dhe qiella e kaltërt në një ditë të shkëlqyeshme pre-ndvere.". Mbiemri është "katalizatori" që sjell formimin e ndjenjave dashurore të Dilës, fo-rrohohet bota e saj subjektive, plotësisht për-kue-se me modalitetin "Dua", si dëshirë për da-shu-ri, ndërkohë që mjedisi i jashtëm paraqitet the-llësisht lirik.

Si ndërtohet bota e Dilës dhe cilat janë she-njat gjuhësore-letrare që çojnë në të?

- Dila ndjen premdverën, sepse: "Ajo ndjen gja-kun që i rreh me rrjedha të forta dhe e ban me ndie dhe me dëshruë ma tepër."

- Dila do të ëndërrojë: "Atëherë Dila mbyll sy-të. Ashtu me sy mbyll pret diçka."

- Dila me-n-don për Cubin: "Ndonjëherë me da-shje e pa dashje, tue bamë punë nëpër shtëpi në të kaluem e prekte me krahë..."

- Dila do të dojë: "Një ndjesi e fshehtë rritej në zemrën e Dilës, dhe sa më shumë ditë ka-lo-j-shin aq më e madhe bahej." - "Dila don me kri-jue atë që s'ka."

- Dila do Cubin: "17 premdverat e saja janë 17 thirrje të nxehta, të heshtuna drejt Cubit."

Lista e modalitetit "Dua" mund të vazhdojë akoma, por edhe kaq sa u dha, mjafton për ta ve-ndosur atë në vendin e parë. Ai është për-faqë-suesi i botës së Diles.

Në këtë përfundim na shpie dhe argumenti tje-tër i nxjerrë nga teksti: "Dita e premdverës", gjendja e Diles, të gjitha detajet që rrotullohen rreth saj nuk ndryshojnë asnjëherë, po ashtu edhe Cubi, - Ai është përherë iluzion.

Nëse për Dilen dimë se është vajzë 17-vje-ça-re, se gjith-ç-ka që do është dashuria e Cubit, për këtë të fundit nuk dimë asgjë. Thuhet në pjesën që mban ky personazh (pjesa e dytë) se zbriti nga malet atëherë kur zbritën edhe bishat e eg-ra: "Bashkë me bishët e malit zbriti edhe Cubi", du-ke lënë të kuptohet se egërsia qëndron edhe në të, tipar që shërben në ndarjen mes botës së tij dhe botës së Dilës.

Tjetër tregues janë foljet që u përkasin dy personazheve, për Cubin ato janë: "Vret, grabit,

pë-rdhunon”, ndërsa te Dila qëndrojnë foljet e ndje-njës. Nëse Dila përqëndrohet tërësisht mbi “Objektin e saj me Vlerë” (Cubin – është ai që synohet të arrihet) çfarë kuptimi ka në të vër-te-të ky objekt? Dhe për më tepër, si mund të kri-jo-het një marrëdhënie, aq më tepër romantike, kur dy subjektet janë kaq të ndryshëm nga njëri – tjetri, të destinuar që në fillim për të qenë larg?

- Dila nuk dashuron Cubin: “AJO DON ME KRI-JUE ATË QË S’KA...”. Cubi është mungesa e fo-rmës konkrete, ai është iluzion i dashurisë.

Skema e gënjeshtërs (iluzioni që krijohet)

Te jesh e dashuruar te dukesh  
si e dashuruar

Te mos dukesh e dashuruar te mos  
jesh e dashuruar

Sekreti i Diles:

- “Do të jetë” e dashuruar, sepse ka moshën për të qenë.

- “Të mos duket” e dashuruar.

Në kuptimin normal, nëse nuk është Cubi objekti konkret i dashurisë, atëherë si mund të thuhet se ajo e dashuron atë?

Sekreti, Iluzioni: “Don të krijojë atë që s’ka. S’ka...nuk u pa më Cubi”.

- Është njëlloj si të thuash Dila dashuron mungesën.

E Vërteta e Diles:

- “Do të jetë” e dashuruar, -Dila e do Cubin, edhe pse sipas mënyrës së vet.

- “Duket” si e dashuruar, -Ëndërrimet, lek-si-ku, elementet e botës së brendshme.

E Vërteta është: -“Dashuria e Dilës”.

Gënjeshtërta e Diles:

-“Të dukesh si”, - Dila duket si e dashuruar me Cubin.

- “Të mos jesh” e dashuruar, - Cubi nuk është, ai përbën “gënjeshtërs” në lidhjen e Diles.

E Gënjeshtërtë:

- “Të mos dukesh” , -Cubi nuk është, as i pra-ni-shëm, as i dashuruar.

- “Të mos jesh” , - Cubi nuk është konkret në bo-tën e Dilës. Dashuria e ndërtuar mbi të vë-r-te-të + sekret + gënjeshtërs, nuk mund të jetë veçse në formën e iluzionit dhe Cubi veçse ob-je--kti me vlerë që synohet nga personazhi (su-b-je-kti veprues).

**Përfundime:**

Nëpërmjet analizës tekstore të modalitetit “Dua” provuam se dashuria e Diles është iluzioni që vajza ka. Në asnjë moment teksti nuk arrin të provojë se Cubi është Dashuria konkrete e vajzës, rreshtat e tregimit dhe më së shumti titulli që ai mban,- “Puthja e Cubit”, vazhdimisht krijojnë tek lexuesi “gënjeshtërs” se ky është një tregim që flet për dashurinë në proces të dy të rinjve, tek e fundit Puthje do të thotë kontakt mes dy buzëve, 2 personave, e në fakt, “Puthja e Cubit” dhe Dashuria për të ndodh brenda kokës, botës dhe në vetëdijen e Diles. Ky është tregimi që flet për dashurinë si nevojë që ajo të jetë, të shfaqet, të provojë dhe vërtetojë formën konkrete të vet, si ndjenja më e madhe dhe determinuese për njeriun. Dashuria tek “Puthja e Cubit” është Dëshira/Nevoja për të dashuruar.

**Bibliografia:**

POZZATO, Maria Pia (2005), Semiotika e Tekstit, përkth. Dhurata Shehri. Tiranë.

GREIMAS, A. (2005), Kapitulli 4 dh 5, fq. 31 -51, në Semiotika e tekstit, përk. Dhurata Shehri, Tiranë.

MIGJENI (1961), Veprat. Mbledhur dhe përgatitur nga Skënder Luarasi, Tirane.

---

## SHQYRTIME RRETH EVOLUCIONIT TË SË FOLMES SË MATIT NËN TRYSNINË E FAKTORËVE JASHTËGJUHËSORË DHE GJUHËS STANDARDE REVIEWS ABOUT THE EVOLUTION OF MATI'S DIALECT UNDER THE PRESSURE OF EXTRA LINGUISTIC FACTORS AND STANDARD LANGUAGE

MERITA HAS HYSAJ  
Email: ritahysa1@gmail.com

### Përmbledhje

Përgjatë kësaj teme do të shqyrtojmë rolin e disa faktorëve të rëndësishëm brenda dhe jashtëgjuhësorë, me peshë për një të folme qendrore, si e Matit, e cila vazhdueshëm gjendet nën tryzni prej tyre. Ligjërimi ynë si akt i identitetit, vetë përvoja jonë gjuhësore, përbën diversitet nga një individ tek një tjetër dhe sakaq, gjithmonë lidhet ngushtë me faktorë të jashtëm shoqërorë, me të cilët ai shpesh solidarizohet. Në punim janë përvijuar ndikime të tilla si: mosha, arsimit, përkatësia gjinore, ndryshimi i përgjithshëm i modelit jetësor në kohë të ndryshme, standardi gjuhësor. Janë vëzhguar me imtësi shkaqet që favorizojnë ndryshimin gjuhësor, ruajtjet dhe përtëritjet. Ajo që kemi konstatuar përmes shembujve, është se, me kalimin e kohës, me gjithë përpjekjet e brezit të vjetër për të trashëguar variantin e tyre gjuhësor, prapëseprapë, edhe në të folmen e këtij brezi, vihet re një lloj prirje kah normat e rregullta të shqipes së sotme.

**Fjalët çelës:** e folme, faktorë jashtëgjuhësorë, evolucion, breza, gjuhë

### Abstract:

In this topic, we have tried to examine the role of several important factors inside and extra linguistic, ponderous for a central dialect as it is dialect of Mati, which is under constant pressure from them. Our discourse as an act of identity, our own linguistic experience, constitutes diversity from one individual to another, although, it is always closely related with external social factors, with which is often sympathized. In the paper are outlined impacts such as age, education, gender, general change of living style in different times, the standard language. Constantly, we have observing in detail the reasons that favor linguistic change, preservation and renewal. What we have always found through examples, is that, over time, despite the efforts of the older generation to leave their linguistic version, however, even in the dialect of this generation, is noticed a tendency towards the norms and rules of nowadays Albanian language.

**Key words:** the dialect, extralinguistic factors, evolution, generations, languages

---

### Hyrje

Ligjërimi ynë si akt i identitetit, vetë përvoja jonë gjuhësore, përbën diversitet nga një individ tek një tjetër, e njëkohësisht, gjithmonë lidhet ngushtë dhe me faktorë të jashtëm shoqërorë, me të cilët shpesh solidarizohet. Përgjatë kësaj pune do të trajtojmë rolin që kanë disa faktorë të rëndësishëm jashtëgjuhësorë, në ndryshimet që ndodhin brenda të folmes së Matit. Duke qenë e pozicionuar gjeografikisht në qendër të të folmeve geqe dhe një vatër e hershme e inovacioneve

gjuhësore, ky variant vazhdueshëm gjendet nën tryzni dhe rezulton të jetë objekt i lakmueshëm studimi.

Lënda gjuhësore, është vjelë në mënyrë empirike, përmes kërkimeve në terren, mbi tre breza përdoruesish, në të cilën janë vëzhguar shkaqet që favorizojnë ndryshimin dhe ruajtjet në planin gjuhësor, qofshin ato me karakter dialektologjik, etnografik, apo etnologjik. *Ajo që mbetet kryefjalë e konstatimeve tona, është se, me kalimin e kohës, me gjithë përpjekjet e brezit të*

*vjetër për të trashëguar gjuhën e tyre dhe nëpërmjet saj gjithë trashëgiminë kulturore të bashkësisë matjane, edhe në të folmen e këtij brezi, vihet re përsëri njëlloj prirje kah normat e rregullta të shqipes së sotme.*

Kështu, për të folmen tonë, kemi dalluar këto faktorë që çojnë peshë në ndryshimin e saj në gojën e brezave të ndryshëm: moshën, përkatësinë gjinore, arsimimin, ndryshimin e përgjithshëm të sistemit (që solli pasoja në kulturë, zhvillim, gjuhë etj.) emigrimin, martesat e përziera, standardin dhe teknologjinë.

Diferencat gjuhësore që prodhohen si rezultat i trysnisë së tyre, janë të natyrës leksikore, fonetike, morfologjike, përdorime dysorësh dhe trajtash të ndikuara; dukuritë që vërejmë janë të natyrës ruajtëse, bjerrëse, ripërtëritëse, të cilat dëshmojnë përmes shpërfaqjes në të folurit e tre brezave.

I pari faktor jashtëgjuhësor, me karakter natyror e me vlera të mëdha sociolinguistike është *mosha*. Ky kriter, e diferencon të folurit në tre breza së paku, ku më të moshuarit – ruajnë, brezi i mesëm – barazpeshon, ndërsa të rinjtë – përtërijnë.

Po i karakterit natyror, është dhe faktori tjetër mjaft ndikues, i njohur si *përkatësia gjinore*. Dallimi sipas gjinisë, është gjithmonë i pranishëm në çdo të folme apo gjuhë njerëzore. Ky, lehtësisht i identifikueshëm në ligjërimin e sekseve të ndryshme, të moshave gjithaq të ndryshme, bën që të identifikohen përmasa diferencuese gjuhësore, kryesisht të natyrës fonetike e leksikore. Ajo që mbetet specifike e dallimit sipas këtij kriteri, është natyra konservative e të folurit të grave, veçan të brezit më të moshuar, e lidhur kjo me rrethana arsimore (ky brez është në masë i paarsimuar ose me pak klasë shkollim), me stilin e të jetuarit kryesisht izolacionist në shtëpi.

Ndërsa, *arsimimi*, si një faktor social me shumë peshë, ka luajtur dhe vijon të ndikojë në afrimin e të folmes me normën e standardit. Ndryshimet në ligjërim, mes folësve të arsimuar dhe atyre të paarsimuar, janë më të qarta, qofshin dhe brenda të njëjtit brez. Por, pavarësisht kësaj, sado që folësi e dredh gjuhën sipas rastit, e pëlqyeshme

në ambiente të ngushta, mbetet të folurit me gjuhën e familjes.

Të natyrës ndikuese janë edhe *ritmet e ndryshimit dhe zhvillimit shoqëror* të ardhura nga ndërrimi i sistemit, të cilat lanë gjurmë në drejtim të gjuhës, kulturës, emancipimit. Këto i dhanë të folmes ngjyrat e veta. Megjithatë ritmi i këtyre ndryshimeve nuk është i njëjtë, qoftë brenda një të folmeje, apo dhe për të folmet në tërësi. *Emigrimi, rritja e rolit të flukseve të padukshme, kontaktet e shtuara me kryeqendrën, ndikimi kurdoherë e më i madh i standardit* përmes mjeteve dhe formave më aktive, shtimi i *martesave të përziera, vetëdija e folësve* për të dalë nga qerthulli krahinor etj. janë faktorë të tjerë që tentojnë lëkundjen e variantit dialektor.

*Hapja ndaj të resë dhe jo vetëizolimi, ka qenë prirje e kahershme e të folmes së Matit.*

Duke i marrë sipas radhës këto faktorë që përmendëm dhe duke u dhënë vëmendjen e duhur me anë të trajtimit teorik e veçan atë praktik, le t'i shohim:

*Mosha*, është një nga parametrat kryesorë për të identifikuar gjuhën dhe të folurit e individit. Ky kriter, ka rëndësi të dyfishtë: qoftë për të bërë klasifikimin e folësve sipas brezave, qoftë për të matur ndryshimet gjuhësore ndërmjet tyre. Ndeshmëria e gjuhës ndaj këtij faktori:

#### **Folësi 1:**

*Marka Bruņa vōit ni her' n' Dibër ke Mura Kalōshi// ky ka qan burr i mēr/po Zoti i mur ene cultt/ene vllan/ene grun/ene u prais̄h meç//u ulën me hanjër buk//lugjët kishin qan t'vokla/ene përcane futte ni kamçait buk' e merrte dy a trai her' lugjën me xhell a lāq mishi//e vu narōe Mura Kalōshi /ene i thot'//ortaj, ju meritort sa t'dek futni mi vorr// Marka Bruņa i dha dum ku rraifte muhabeti/ene ja thkeu//na vorrin e bajm' taman/po me qan njerëzit e vokël fusim ka dy a tre për niher/e me qan t'mdhōj fusim njā//mēt Mura Kalōshi pa fjal n'gjōj/ene i ep Marka Bruņës nji naplan florini/për çato fjal' si tha //i çoi kart' ne Xhōn Markut për çar i noth me tāt//grēhet Xhōn Marku ene i ep Marka Bruņës ne ni xhws naplani flori//po Marka Bruņa i thot'ne ati//taj nuk je xhypk/ne Mura Kalōshi m'dha nji naplan /e taj ni xhymy//Xhōn Marku për çto fjal' i ep dy naplana*

flori//e keçja o bi: t'ba t'paqân t'le shkreq/se  
Marka Bruña nuk ka pas qân i lé budall/ si i ka  
mét tahe fjala/ je ba si Marka Bruña/.

N. Hysa, 85 vjeç, Mat (folës i paarsimuar)

**Folësi 2:**

Kur lidhen dy vet' hé njâ si i lith/e ba miç dy  
familje//ky quhet shkojs a shkus//kur vje vakti për  
martes grehët méku e vé ke méku ene i thot'/or  
mék söid kam arth ke taj/se du t'presim ditën me  
m'dhan cucën//vallahe or mëk sun ta pkus fja-  
lën/ke arth herët se un' cucën e kam t'vokël //ene  
méku i thot' t'menohem/mas dhet ditsh a dy ja-  
vësh/ i vé ke shpaija ene i thot'/mersetxheta or  
mék/u menova e ta kam dhan cucën/po fjalt' t'i  
kina si burrat/un' sun e baj gati vraik/pranej me  
m'najf ne taj pak//ha mor burr se bajm' hall për  
kit pun'//ene i epte pare sa t'gërkote méku //or  
mék a dajm' dit'mas dy javsh/or mëk falemi-  
ners//për darzëm i çote berrat e shoke: /okn' e  
kafes/neret e dajës//nji jav para grishin njerzit  
/miçt dashamerët e xhak e xhini/t'mkurrën  
filloshin t'u arth miçt //n'ras se bahej dasma  
t'ejten//ose t'shtunën po t'bahej t'dilën//n'fillim  
vishin bijat motrat nepat/mijt ma t'afërt vishin  
me dash a sqap/simas takatit ene me mzat a löp /  
t'mkurrën a t'shtunën vishin ne dajat a kuma-  
ra//ne aj vite me dash a ka:/kur martote nepin  
/se për cucën nuk bite xha t'xhall n'kam//daja  
veç dashit bite ne lödrën a hegun//t'dilën bahej  
darzma e shkoshin e merrshin nusen//kan pas  
shku: ja nân, ja dymdhet vet' për krushk/po  
simas rastit ne mëku gërkote nân vet' se tre vet' i  
vetë m'tvetit/ene baheshin dymdhet vet'/cuca  
dilte t'u qa e t'u bërtait me të madhe //dei ke  
kufëni i vet//çështu ja merrte cucën mëku /po me  
pas qân mëk pizeveg e sillte nja dy a tre mu:j  
vërdall'/

H. Hysa, 65 vjeç, Mat (me arsim shkollor  
tetëvjeçar)

Nënvizimet në tekstet e mësipërme, mes  
përfaqësuesve të brezave, janë dallime të natyra-  
ve të ndryshme: fonetike, morfologjike, leksikore.  
Duhet thënë që shumë folës, paraqesin dallime  
edhe më të shumta mes tyre.

Përsa i takon dysorësisë, vëmë re se në përdorim  
kjo dukuri është më e madhe në të folurit e brezit  
më të ri. Fjalë të tilla si: *miçt e mijt, darzma e*

*dasma, hânjër e hâgër, vöit e vöt*, etj. edhe pse të  
njëjta si fjalë, kanë ndryshime fonetike, ose dhe  
në raste kur ndryshon përbërja formale ruajnë të  
njëjtin kuptim: (*bodrum – burgji, grazhdöre – ko-  
tec, vrre: - ushqim*). Por kjo dukuri, është e prani-  
shme edhe në ligjërimin e folësit të parë, dhe pse  
më i thyer në moshë. Aty spikat me përdorim dy-  
sor, fjala *xhws/xhyms*. Shkurtimeisht, dukuritë që  
vërejmë janë bjerrje, e ripërtëritje, të cilat vërte-  
tohen më së miri përmes dysorësisë në të folur,  
që janë më të pranishme në gojën e brezit të me-  
sëm dhe atij të ri.

*Përkatësia gjinore*, luan rol gjithashtu në dallimin  
e ligjërimin të folësve. Që herët ky kriter ka të-  
rhequr vëmendjen e gjuhëtarëve dhe ka shënuar  
trajtime pioniere edhe nën dorën e prof. E. Çabej,  
Gj. Shkurtaç etj. Të gjithë sa janë marrë me të,  
bien dakord për sa i takon prirjes konservuese apo  
përtëritëse, tek meshkujt dhe femrat. Po sipas  
tyre, seksi është një kriter me rëndësi që shërben  
për të bërë dallimin mes të folurit të individëve.

Në të folmen e Matit, sipas këtij parimi, bëhet një  
ndarje e të folmes së gjinisë femërore ndaj asaj  
mashkullore. Kjo ndarje, nuk është dhe aq e ma-  
dhe sa në të folme të tjera skajore mbase, ku rre-  
thanat dhe konteksti historik ua ka imponuar fu-  
qimisht polaritetin grua-konservacion dhe burra-  
inovacion.

Sipas të dhënave, vëmë re se e folmja e grave  
edhe në këtë krahinë, vijon të ruajë prirjen e ka-  
hershme të folmeve të tjera të shqipes, ku më të  
moshuarat janë më ruajtëse, sesa simoshatarët e  
tyre meshkuj. Kështu duke parë ligjërimin e një  
folësjë, tek të 80-tat kemi:

**Folësi 3:**

*Kishte qân gjegj një pöll//ene një njeri tu hec udhës  
/has mi xharpën/ - aman thot' xharpni pshtom se  
u dōxha //ene ai e çiti pri zarmi xharpnin /se i erth  
xhynaf / at'her' xharpni / se çahu si ka emrin  
â//udh's a tu kalu ni dhelpën //na i thot' ky njeriu  
/ aman na e daj çit xhyxh//û e çita xharpnin pri  
zarmi /ene ky dō me m'zan//xharpni grëfet ene i  
thot' ktij njeriut//ku dō me t'zan ma mer/po i  
thot' ky njeriu u t'çita pri zarmit //e tai dō me  
m'zan tahe/ nerin dō me me thke me vner//xhar-  
pni i përxxhixhet /un' baj zanatin tim /se jam xhar-  
pën//dhelpna i thot' /masi i ngjëj //- ulu taj xha-*



*rpën m'tok' / e va daj u xhyxhin// u ulka xharpni m'tok' / ene i thot' ky njeriu dhelpnës //po tahe si i bahet//tahe thot' dhelpana shtëpi krét/çata bâ//*  
S. Hysa, 82 vjeç, Bruç – Mat, (me arsim shkollor 4-vjeçar)

Në ligjërimin e saj, spikat dukuria e ruajtjes së trajtës së vjetër të përdorimit të përemrit vetor të vetës së parë *unë – û* (ashtu si e ndeshim tek shkrimet e vjetra të shqipes), që sot del si në format e standardit me /ë/ të rrëguar (*un'*). Po ky përemër, me këtë trajtë, del rrallë ose për të thënë aspak, në të folurin e meshkujve. Një dukuri tjetër e hasur tek e folmja e grave të kësaj zone, është edhe kthimi i /f/-së siç e kemi në shqipen e sotme, në fonemën /th/ tek fjala *fëmi-ja – thmi-ja*, ose dhe anasjella, *thëllëzë – fllânx*. Edhe në këtë rast bëhet fjalë për një spikatje në gjuhën e seksit femëror, veçan atyre të brezit të moshuar. Duhet përmendur, se kjo dukuri nuk vihet re tek femrat e moshës së mesme apo të re, në raste edhe të rralla. Pra, kjo shkon drejt tretjes me humbjen e përfaqësueseve të këtij brezi.

Tjetër dallim në të folurit e gjinisë femërore, është edhe përdorimi i trajtave leksikore të veçanta, që lidhen me sfera të caktuara, si ajo e gatimit, orendive shtëpiake, fjalë dhe shprehje të folklorit popullor, të pjesëve të trupit të lidhura me togun “punë grash”. Mund të sjellim raste si: *nrajz, krahure, bile, flökje, thmi, maxhe, përrzhajç, mtë, bökshë* etj. Pra, në dallimin mes gjuhës së dy sekseve, ajo që bën diferencën, na duket të jetë e lidhur dhe e kushtëzuar, me rrethin e veprimtarisë jetësore dhe të praktikave të përditshme. S'mund të themi asesi, të njëjtën gjë edhe për brezin e ri dhe të mesëm. Përsa i përket ndryshimeve shoqërore, politike e për rrjedhojë ekonomike, në periudhën e sistemit diktatorial, ato kanë pasur peshë më të madhe mbi brezin e dytë. Ligjësia dhe mendësia kolektivistike e imponuar nga ky sistem, kërkonte medoemos që gruaja të punonte krah për krah me burrin, andaj zbatimi i kësaj parulle në mënyrë masive dhe të detyrueshme, bëri që gratë, jo vetëm ato matjane, të ishin pjesë e ambienteve të përbashkëta që ndaheshin për pjesën më të madhe të ditës me meshkujt.

Megjithatë, nuk ndodhi përputhja totale, as në këtë sistem, duhet thënë. E folmja e grave dhe e burrave mbante ende një fill ndarës, përsa i takonte familjes. Nuk duhet anashkaluar edhe fakti se meshkujt e brezit të mesëm janë më të prirur për ndryshim. Në repertorin e meshkujve e kanë më të lehtë të futen forma e trajta, të cilat janë mungestare në të folurit e grave: siç është rasti i paskajores së standardit, *për të larë, për të ardhur*; përdorimi i grupeve të bashkëtingëlloreve *mb, nd, ng*. të cilat dalin të rrëguara në gjithë të folmen: *mbaj në dorë, bëj nder, ngre lart*; përdorimet e rralla të së pakryerës me mbaresat e standardit: *laja, lante, lanin*; përdorimi i pronorëve *yt, jote, jona*, etj. një pjesë e mirë e tyre haset në të folurin e brezit më të ri, pra atij që qëndron në fillim të fashës kufizuese mes grupmoshave.

Nëse, këta të fundit kanë lirinë në avantazh, janë gratë ata që kanë përshtashmërinë në krahun tjetër si pikën e tyre më të fortë, në drejtim të gjuhës, kur kjo është e harmonizuar dhe me faktorë të tjerë. Pra, gruaja, në shtëpi apo jo, është konservative më shumë në drejtim të dialektit, ndërsa gruaja në karrierë përshtatet më lehtë se meshkujt me gjuhën “e re”.

*Arsimimi*, si kriter social, ka rëndësi të madhe për afrimin e të folmeve me normën standarde, si dhe në përmirësimin e tyre mjaftueshëm. Pra, është njëllor laborator që gjeneron ndryshim në favor të standardit dhe të të ecurit kah rregullsia të dialektit. Lehtësisht diferencat gjuhësore vihen re kur krahasojmë të folurit e individëve të të njëjtës gjini dhe brez, por me arsim të ndryshëm:

#### **Folësi 4:**

*N'koh' t'koperativës/njâ:j burri si ka pas qân bariu i tufës/i hûmën nja dhét dhên//e murën n'polici/ene e pötën //po kta e patën msu/ me than //dhent' qên t'döbta/ koha qe me shai e me nje-gjull//e mi mur uku//si e rrafën aqé mrena /ai harroi si e patën msu / e tha koha qe e mer' si pisha e dhit' qen' si löpa / po mu m'zu xhumi //e tregöi vet' t' vërtetën//ene e dënun me ... vjet burg//*  
N. Feti, 49 vjeç, (me arsim shkollor 8-vjeçar)

#### **Folësi 5:**

*Kur e kam mbaru: un' ushtrin' / ka pas qen' dy vjet detyrim// mbaj men një her' se si u zûn nja dy ushtar' në një shalqin//e blem' shalqinin t'gjith'*

*bashk'e ndam' me rrisa secili t'vetën // po dy sho:k tanët/ushtar' dhe ato /madje sho:k' t'ngusht' me njëri-tjetrin u zûn' me një cop' shalqin // ai e ke më t'madhe ti /ai e ke ma t'madhe ti// fjal' fjal' u zûn' dhe u kapën me grushta// n'fillim ne i pam' e si lujtëm/ po kur filloi t'u u nxehtë lloja / hym' dhe i ndam' // njëri ndër ta/ qe më i shkathtë/iku e mori thikën që patëm pre shalqinin /dhe ja nguli shokut t'vet në bark//u bë problem i madh at'her' n'repart//erdhi vet' komandanti /dhe të dy i dënuan//njërin e çuan m'spital/e tjetrin m'burg//*

K. Osmani, 52 vjeç, (me arsim shkollor të lartë)

Duke vëzhguar dy fragmentet mëlart, vëmë re se secili ka shmangie nga norma. Mirëpo, në rastin e parë, këto parregullsi janë më të mëdha. Kjo lidhet me faktin se folësi i parë që është i një shkalle më të ulët arsimore e ka më të kollajtë shprehjen në dialekt, përkundër normës që zë më shumë vend në ligjërimin e folësit tjetër, i cili e ka përvetësuar shumë më mirë standardin dhe e bën pjesë të ligjërimin të vet. Ky folës, varësisht shpengimit të tij, në përgjithësi i shmang çrregullimet dialektore, duke ruajtur ato elemente që përputhen me standardin nga e folmja (si gjithëgjue shqipe), e duke përsosur më tej ligjërimin e vet sipas normës.

Arritjet intelektuale të individëve shoqërohen gjithmonë dhe më tepër me pjesëmarrjen e tyre nga dita në ditë në veprimtari të ndryshme politike, shoqërore, kulturore etj. Sipas këtyre të fundit, folësit gëzojnë edhe statuse të caktuara, që në vetvete kërkojnë njëllor përmirësimi të të folurit dhe përdorimit të një gjuhe më të moderuar. Roli i arsimimit është akoma më specifik në ligjërimin e brezit të ri. Nëse lëkundjet dialektore janë më prezente në brezin e mesëm, tek brezi i ri prirja është ajo e pastrimit të dialektit dhe afria sa më shumë me normën letrare.

*Ndërrimi i sistemit dhe ritmi i ndryshimit në përgjithësi, në gjuhë, në kulturë, zhvillim etj.* ka lënë gjurmët e tij edhe në të folmen e Matit. Prania e afërt gjeografike me kryeqendrën ka bërë që masa e ndikimeve të jetë më e dukshme, ndaj ritmi i këtyre ndryshimeve e ka prekur më lehtë dhe më intensivisht këtë të folme.

Të ndryshuarit e mënyrës së jetesës, përfshirja e vetëdijshme dhe e shumëdëshiruar në këtë stil të ri jetese të pas viteve '90 dhe ritmi i ri me të cilin mori vrull jeta dhe shoqëria shqiptare në përgjithësi pas kësaj periudhe, la shenjë edhe në të folmen e krahinave, të individëve të përfshirë më shumë në këtë ndryshim dhe të atyre që ikën dhe morën me vete variantin dialektor siç e kishin në stadin e paprekur. Përplasjet gjuhësore në këtë lloj konteksti janë të paevitueshme.

Shembullin e kemi marrë mes dy folësve, njëri nga krahina e Matit, tjetri nga zona e Fierit, në kontaktet e tyre në emigrim, ku shohim njëllor "miksimit" gjuhësor të ekuilibruar midis të folmeve përkatëse:

A.- *Sa fmij ke?*

B.- *Kam dy. Të vegjël të dy. Një çupë dhe një djalë.Ti?*

A.- *T'i kesh me jet'! Un' kam një cuc e dy meca.*

B.- *...ee..., sa the? Çfarë the? Meca...???*

A.- *Kam një vajz' e dy çuna. Djem, si thoni ju.*

A.- *(I. Doda, 47 vjeç)*

B.- *(A. Muçaj, 42 vjeç)*

Vërejmë nga tre sinonime për dy fjalë: *vajzë, çupë, cuc'* dhe *djalë, çun, meca*. Vetëm nga një prej tyre, i takon standardit, ndërsa dy të tjerët respektivë, janë të varianteve dialektore. Gjatë këtij akti kuptohet se që të dy folësit kanë dijeni për "diferencat" që ekzistojnë midis dy varianteve dialektore, dhe në mënyrë të vetëdijshme, ata mundohen ta kapërcejnë këtë pengesë për të përçarur mesazhet e njëri-tjetrit.

Vetë mënyra sesi ishte e organizuar jeta dhe shoqëria në atë model dhe sistem pararendës, ishte krejtësisht e ndryshme me atë që pasoi. Mbyllja në vetvete nuk kishte më kuptim; as në aspektin gjuhësor nuk mund të pretendohet. Hapja që e menjëhershme dhe sheshi ku u përplasën këto më së parit, ishte fusha e ligjërimin, më tepër në brezin e mesëm. Shumë fjalë që lidheshin me praktika të caktuara u tërhoqën nga ligjërimi dhe hynë të tjera që zëvendësuan apo iu shtuan repertorit të shqipes, edhe si përshtatje me kohën dhe zhvillimet e saj. Kësisoj, u krijua një shtresë e re leksikore që mbledhi krijimet huazimet dhe prurjet gjuhësore të shqipes së re.

Një tjetër element që çon peshë në favorizimin e ndryshimeve gjuhësore dhe shpie në krijimin e situatave bilinge, është dhe *martesa e përzier*. Në krahinën e Matit, për nga vetë shtrirja e gjerë gjeografike, edhe e shkuara homogjene e traditave, dokeve, zakoneve, përbërjes fetare dhe popullsisë, ka ekzistuar një lloj mendësie e realizimit të martesave brendapërbrenda krahinës; madje edhe përbrenda saj, në zona akoma më të vogla, marrjet dhe dhëniet e vajzave për martesë, kanë qenë akoma më fanatike. Kjo përveç se siguronte jetëgjatësinë e martesës, zgjidhej miku i duhur që i përshtatej derës, puqeshin të rinjtë që bashkoheshin në këtë lidhje duke analizuar një më një tiparet dhe virtytet, kishte të shtuar edhe argumentin ‘janë nesh’, e cila nënkuptonte përbashkësinë në doke, tradita, zakone, mendësi, qasje dhe ‘huqe’, por mbi të gjitha që ‘kanë gjuhë si ne’.

Mirëpo, me kalimin e kohëve dhe veçanërisht me dukuritë e reja demokratizuese, edhe në rang të martesave dhe lidhjeve miqësore, pati një heterogjenizim dhe përzierje të aktorëve të procesit. U kalua tej fshatit, krahinëzës së vogël, rrethit dhe u shtuan lidhjet martesore me të krahinave të largëta, qoftë të Veriut, të Shqipërisë së Mesme, apo të Jugut. Mjaft interesante veç gjuhës së të rriturve, në të tilla raste shfaqet gjuha e fëmijëve, me larmi përzierjesh dhe zëvendësimesh të ndryshme.

Nga një vëzhgim i afërt dhe i drejtpërdrejtë i të folurit të dy fëmijëve (Klara dhe Andi përkatësisht 6 dhe 5 vjeç) dhe i dy nipërve (Noani dhe Gersi, 4 dhe 3-4 vjeç), të cilët kanë jetuar me gjyshërit, vëmë re dy fëmijët e parë shquhen për dallime fonetike, morfologjike e leksikore, ndërsa tek të dytët reduktohen këto dallime duke ruajtur ndonjë dallim të vogël nga modeli paraparak, por dhe ai kontekstual në familje.

Klara 6 vjeç (babai nga Mati dhe nëna nga Tirana): si një dukuri zotëruese shfaqet prania e elementeve fonetike në formën e fjalës sipas modelit të gjyshes: *o nona, po thoji ksaj gocës tate se më ngacmon / ha se do t’i thom babit ene ta tregon ai ty*. Andi 5 vjeç (me të dy prindërit nga e njëjta origjinë): vihen re më tepër dallime të natyrës leksikore. E folura e tij është e pasur

me trajta leksikore matjane e ushqyer më së shumti nga jetesa me gjyshërit e vet në fshat, si: *shterre, fkat, té-ja (nëna)*, etj. Noani 4 vjeç (babai nga Gjirokastra dhe nëna nga Mati): spikat me dallime të natyrës fonetike, morfologjike dhe leksikore, si: *xhysh, sy, ky, ça thaje?* etj. Gersi 3-4 vjeç (nga prindër të së njëjtës origjinë): është e dukshme ngulitja e disa fjalëve që nuk përdoren pothuajse fare nga brezi i ri urban i ditëve të sotme: *mçaje bukën* (ngyjeje mirë ushqimin në pjatë – fshije pjatën me tul buke), *mçaje pllakën, çile dritën*, etj.

Pra, për sa kohë që Noani, dhe moshatarët e tij do të vijojnë të luajnë dhe të ndajnë hapësira të njëjta argëtimi, ata do të kenë marrëdhënie e ndikime edhe gjuhësore.

*Varianti standard*, është pranuar gjerësisht, që luan rol në unifikimin e gjuhës dhe rrafshimin e diferencave në sjelljen gjuhësore të individit. Kjo mbështetet së pari, në studimin e diferencave gjuhësore mes standardit dhe variantit krahinor; së dyti, përmes shqyrtimit të diferencave që lidhen me fushën e paragjykimit gjuhësor.

Për të parën, mund të themi se ajo që ofron realiteti gjuhësor i pas viteve ‘90, në përballjet mes varianteve krahinore dhe gjuhës standarde, kohë kur lëvizjet mekanike të popullsisë dhe shpërnguljet masive u shtuan së tepërmi, nga zonat rurale e të thella drejt zonave urbane e të hapura, shpuri në evidentimin e qartë të hendeqeve që kishin mes tyre këto dy variante, hendeqe të cilat, linin dorë edhe për paragjykimet e sjelljes gjuhësore të folësve.

Mirëpo, ndjeshmëria e të folmeve ndaj standardit është në nivel jo homogjenik. Ata kanë qasje të ndryshme ndaj standardit dhe nuk orientohen të gjitha njëllë. Ritmi i ndryshimeve varion dhe kushtëzohet nga faktorët jashtëgjuhësorë. Si rrjedhim, disa të folme ecin më ngadalë kah prirja e përgjithshme e shqipes, që është ajo drejt standardit e disa të tjera më shpejt.

Mendojmë se e folmja e Matit në këtë diversitet të folmesh tenton t’i ofrohet gjuhës standarde. Karakteri i saj inovativ si dhe afërsia me kryeqendrën, japin dorë gjithashtu për këtë. Në gjendjen e sotme kjo e folme, do të thonim se është dinamike. Të dyja rrafshet, si ai sinkronik, ashtu

dhe ai diakronik i shërbehen njëri-tjetrit, në kuptimin që, sado e vogël të jetë masa e ndikimeve që ka e folmja e sotme mbi atë të së djeshmes (ku parakuptohet marrëdhënia mes brezit të ri dhe atij të moshuar), prapëseprapë, kjo është me madhe se ajo që ushtron e djeshmja mbi këtë të fundit.

Aty dallohen qartë tiparet e dy varianteve të të folurit; varianti tradicional, ku spikat ruajtja e elementeve të qëndrueshme të sistemit të vjetër, e nga krahu tjetër, varianti i ri, i cili pasqyron më gjerë shndërrimet dhe ndryshimet e sistemit nën trysinë e makrosistemit. Mirëpo, këto dy variante nuk ndahen me thikë ndërmjet tyre; ura që i lidh në mënyrë të zbutur diferencat mes tyre, dhe bën të mundur ndërkalimet gjuhësore pak më lehtë nga njëri brez tek tjetri, është e mesmja e variantit të përzier, ose të folurit e brezit të mesëm, në të cilin shkrihen harmonikisht tipare të varianteve të sipërpërmendura dhe njëkohësisht lehtësohet procesi i kalimit nga njëri tek tjetri.

Ky proces përzierjeje, ka në thelb parimin e hinkëzimit të dukurive a shoshitjeve gjuhësore të vazhdueshme si një proces natyral dhe i nevojshëm që vendos se cilat nga ata do t'i nënshtrohen bjerjes, ruajtjes, risive, shndërrimeve, ndryshimeve, situatave bilinge, shkeljeve në normën e të folurit etj. Këto të fundit gjithmonë të kontrolloara nga norma zyrtare.

Faktorët që kushtëzojnë ligjërimin e këtij brezi janë më të dukshëm dhe më influencues. Përmendim këtu faktorët jashtëgjuhësorë. Ky brez vetë, tenton më shumë standardin. I ndihmuar këtu edhe nga nevoja komunikuese që ia imponon brezi i ri, të cilin ka detyrë ta edukojë, atëherë, mund të themi se prirja e përgjithshme e tij është të synojë të folmen e shqipes standarde.

E folmja e brezit të ri orientohet kryesisht drejt standardit. Megjithatë ajo nuk është krejtësisht standarde. Gjejmë në të edhe elemente të dy varianteve të tjera; të atij të brezit të moshuar dhe të atij të mesëm. Parakusht për këtë orientim është institucioni i shkollës. Në vitet e fundit i është shtuar dhe një element i ri: teknologjia. Duke qenë gjatë pjesës më të madhe të ditës në ko-

ntakt të detyrueshëm me standardin, atëherë të rinjtë e kanë më të lehtë përvetësimin e tij dhe janë më të hapur ndaj ndikimit të standardit. Në këtë brez standardi ushtron më mirë se kudo funksionet dhe presionin e tij unifikues.

Bartësit e këtij varianti në rrugën për kah standardi nuk kanë pasur ndonjë "kushtëzim" psikologjik, dmth që nuk janë detyruar të mbrohen nga rrezikimi i zhdukjes, e kësajsoj të kenë kultivuar në mendësinë e tyre njëlloj koncepti të fortë konservues në drejtim të gjuhës.

Diferencat gjuhësore mes brezave skajorë nuk është shumë e madhe. Ndërmjet tyre nuk ka një fashë të mbrojtur gjuhësore, e cila është e pakapërcyeshme. Ruajtja dhe risimi, si dy dukuri të rëndësishme gjuhësore nuk kanë një largësi të madhe. Ata nuk shtyjnë njëra-tjetrën. Tendencat e tyre është që të afrohen. Jo vetëm brezi i mesëm shërben si ekuilibruer mes këtyre varianteve, por edhe brezi i moshuar është i hapur ndaj ndryshimeve, më shumë se ç'janë përfaqësuesit respektivë në të tjera të folme.

Së fundmi, themi se ekzistojnë një larmi rrethanasash dhe faktorësh, të cilët na shpjen në përfundime interesante rreth natyrës së sotme të marrëdhënieve e folme krahinore – gjuhë standarde. Në to janë të shkrija edhe marrëdhëniet kulturore e krahinës me kulturë të qytetit. Kësajsoj, asnjëherë këto marrëdhënie nuk duhet të shihen jashtë raportit kulturë – gjuhë dhe mendim – gjuhë.

### Bibliografia

- BERRUTO. G. (1994), *La Sociolinguistica*, Bologna
- GJINARI. J. (1985), *Marrëdhëniet e sotme të gjuhës letrare me dialektet*, SF.
- GJINARI. J. (2012), *Dialektet e shqipes*, (ribot.)Tiranë.
- SHKURTAJ. Gj. (1998), *Disa dukuri të së folmes së Kurbinit në dritën e sociolinguistikës*, SF.
- SHKURTAJ. Gj. (2001), *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, SHBLU, Tiranë.
- SHKURTAJ. Gj. (2009), *Sociolinguistikë e shqipes*, Tiranë.
- VINCA. A. (2010), *(Po)jetika e fjalës*, ARS-ZZ, Tetovë.

## MULTILINGUALIZMI DHE GJINIA MULTILINGUALISM AND GENDER

MUSTAFA IBRAHIMI

Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë/ Maqedoni

Email: m.ibrahimi@seeu.edu.mk

### Përmbledhje

Ajo që ne dimë sot për shumëgjuhësinë, gjininë dhe relacionet e saj e kemi të mësuar nëpërmjet debateve të gjallë dhe hulumtimet që kanë ndodhur gjatë katër dekadave të fundit. Studimi i gjuhës dhe gjinisë fillimisht u shfaq si një fushë hulumtuese në vitet 1970 mes lëvizjes feministe politike lidhur me pabarazitë gjinore në Perëndim. Në periudhën e hershme, Lakoff (1975) dhe Thorne dhe Henley (1975) hodhën bazat e kërkimeve gjinore në praktikën gjuhësore. Roli i gjinisë në kontekste gjuhësore dhe në mësimin e gjuhëve të dyta është konsideruar edhe si "një zonë premtuese e hulumtimeve të reja". Në të njëjtën periudhë studiuesit si Pavlenko & Piller (Pavlenko & Piller, 2001) kanë vënë në dukje, se studimet midis mësimin të gjuhës së dytë dhe gjinisë nuk kanë pasur një zhvillim të fortë deri me paraqitjen e studiuesve Burton, Dyson dhe Ardener (1994), të cilët ngjallën një interesim të veçantë për këtë çështje. Ne do të shqyrtojmë mënyrat se si identiteti gjinor i (ri)prodhuar në kontekste shumëgjuhësore dhe ideologjitë midis gjuhës dhe gjinisë mishërojnë rendin e ri shoqëror dhe pabarazitë në të gjitha fushat e globalizimit.

**Fjalë çelës:** multilingualizëm, gjini, gjuhë, praktikë shumëgjuhësore.

### Summary

What we know today about multilingualism, gender and their interrelationship has been learned through vibrant debates and research that have taken place over the last four decades. The study of language and gender initially emerged as a field of inquiry in the 1970s amid the rising feminist political movement concerning gender inequalities in the West. In the early period, Lakoff (1975). and Thorne and Henley (1975) laid the groundwork for gender research on linguistic practices; the role of gender in multilingual and second language learning contexts was also considered "a promising area of inquiry" in the same period (Pavlenko & Piller, 2001, p. 18). Pavlenko and Piller (2001) note, however, that the study of multilingualism, second language learning and gender did not gain a strong currency until Burton, Dyson and Ardener's *Bilingual Women* (1994) sparked a renewed interest. I explore the ways in which gendered identities are (re)produced in multilingual contexts, and how ideologies of language and gender embody social order and inequalities across the terrain of globalisation.

**Keywords:** multilingualism, gender, language, linguistic practices.

### 1. Hyrje

Dallimet gjinore në gjuhë në mënyrë të pjesshme i gjejmë në literaturën antropologjike dhe misionare duke filluar nga shek. XVII (Jespersen 1922: 13), megjithatë hulumtimet serioze për këtë dukuri paraqiten në shekullin XX. Ajo që ne dimë sot për shumëgjuhësinë, gjininë dhe raportin mes tyre e kemi të mësuar përmes debateve të gjalla dhe kërkimeve që kanë ndodhur gjatë katër dekadave të fundit. Studimi i gjuhës dhe gjinisë fillimisht u shfaq si një fushë

hulumtimi në fillim të viteve '70-ta, gjatë kohës kur feminizmi u paraqit në Perëndim, si lëvizje politike për pabarazinë gjinore (Lakoff 1975). Ndërkaq Thorne dhe Henley (1975) hodhën bazat e kërkimeve gjinore në praktikën gjuhësore, rolin e gjinisë në kontekste gjuhësore dhe mësimin e gjuhës së dytë (Pavlenko & Piller 2001: 18). Në këtë periudhë flitej se gjuha e mashkullit është normë dominuese e sjelljes gjuhësore ndaj gjuhës së gruas, duke përdorur teorinë e mungesës (*deficite theory*), me të cilën mendohej se një

dukuri gjuhësore e ngulitur në gjuhën e burrave më shpesh lidhet me mungesën e të saj në gjuhën e grave.

Në fillim të viteve '80, paraqiten edhe kritikata e para lidhur me teorinë e mungesës. Mënyra e re ka të bëjë me *teorinë e dallimeve (difference theory)*, e cila dallimet midis gruas dhe burrit i shpjegon si pasojë e socializimit të ndryshëm të djemve dhe vajzave në civilizimin tonë. Moskuptimet e tyre të mundshme të reflektuara në gjuhë dhe shprehje vetëm se janë pasqyrë e dallimeve të tilla. Prandaj kjo qasje shënohet si teori e dallimeve, ose teoria *e dy kulturave (two cultures theory)*. Përfaqësuese e kësaj teorie është sociolinguistja amerikane Debora Tanen (Deborah Tannen, 1984, 1989, 1990).

Në dekadat e fundit, çështjet lidhur me shumëgjuhësinë dhe gjininë janë në rritje, si nga mendimet e studiuesve, ashtu dhe shoqërisë në përgjithësi. Globalizimi ka hapur shumë mundësi për njerëzit që të vijnë në kontakt, qoftë ballë për ballë ose nëpërmjet rrjetave sociale apo mediave elektronike, duke sjellë sfida të reja gjuhësore që shpesh ndërpresin pabarazinë gjinore. Siç dihet meshkujt kanë dominuar ndaj grave në të gjitha civilizimet (jo vetëm në atë ballkanike apo shqipe).

Kërkimet e fundit nga puna hulumtuese e Piller dhe Pavlenko (2009) janë fokusuar në një qasje poststrukturaliste duke shqyrtuar zgjerimin e fushës së gjuhës dhe gjinisë në kontekst të shumëgjuhësisë dhe gjuhës së dytë. Këtë kryqëzim midis shumëgjuhësisë dhe gjinisë e shqyrtojnë në dy kontekste kyçe transnacionale: politika globale e punës riprodhuese dhe marrëdhëniet intime ndër-gjuhësore.

Sot, studimi i gjinisë, shumëgjuhësisë dhe mësimi i gjuhës së dytë është një fushë e gjallë, me një numër të madh studimesh dhe botimesh, nga studiues të ndryshëm si: Goldstein 1996; Lan 2006; Norton 2000; Okita 2002; Burton 1994; Norton & Pavlenko 2004; Piller & Pavlenko 2001 2007 2009 etj.

## 2. Format gjuhësore diskriminuese

Ekzistojnë shumë dëshmi se jetojmë, kryesisht në botën mashkullore, në të cilën edhe vetë Zoti,

merr trajtën e shquar në gjininë mashkullore. Edhe vetë emri *njeri*, që duhet të përfshihen të dy gjinitë, shpesh tregon vetëm njeriun mashkull, siç tregon edhe togfjalëshi "*një njeri dhe një grua*".

### 2.1. Stereotipizimi i roleve gjinore në tekstet shkollore

Stereotipizimi i veçorive mashkullore dhe femërore haset që në fëmijëri, siç dihet librat e leximit, abetaret dhe librat e tjera shkollore, gjithkund djemtë dhe vajzat i trajtojnë në mënyrë jo të barabartë. Pothuaj, gjithmonë trima dalin meshkujt (e me këtë dominojnë emrat mashkullorë dhe gjinia gramatikore mashkullore). Ata janë super aktiv dhe janë në gjendje të bëjnë gjithçka, kurse vajzat i vështrojnë nga prapavija ose merren me çështje trivialiteti.

### 2.2. Statusi i gruas në kulturën popullore shqiptare

Se çfarë na tregon gjuha për statusin e gruas në kulturën popullore shqiptare, mund ta shohim nëpërmjet fjalëve të urta nga përmbledhja e Thimi Mitkos "Bëleta Shypëtare": "*Gruaja ka perëndi burrin*", "*shtëpi është gruaja*", "*Flokët e gjata – mend e shkurtra*". Mjaft interesant janë edhe fjalët e urta për burrin: "*keq me burrë, keq pa burrë*", "*Mundimi është për burrat*". Me rëndësi është të shihen edhe sinonimet për fjalësit : "*grua, burrë dhe njeri*" në fjalorë të ndryshëm, ose të kërkohen shprehje në fjalorin e zhargonit (Ibrahimi 2007, si dhe në ueb-faqen [www.zhargonisht.com](http://www.zhargonisht.com)).

Nëse i shikojmë dallimet sipas niveleve të strukturës gjuhësore, do të vërejmë se ato dallime pothuaj nuk ekzistojnë në fonologji, morfologji, sidomos në sintaksë, kurse pak më të pranishme janë në leksik dhe frazeologji. Kështu në repertorin gojor të grave më të shumta janë fjalët që lidhen me shtëpinë dhe jetën familjare. Ndërkaq preokupimet tipike femërore lidhen me modën dhe kozmetikën, me llojet e ngjyrave etj. Kurse në regjistrat e meshkujve më të pranishme janë fushat lidhur me biznesin, paratë, sportin etj. Dallime midis gjinive kemi edhe gjatë martesës, ku dominojnë parimet e burrit. Kur dy të rinj lidhin kurorë zakonisht thuhet se një burrë e *mori* për grua, kurse gruan e *kanë dhënë* për filan

burrë. Nga dy foljet, qartë shihet se në fokusin e tërë operacionit është përsëri – *burri*. E njëjta gjë ndodh me vdekjen e burrit, gruaja ngelet “*vejusha*” e tij, por nëse vdes gruaja, burri nuk ngelet “*vejushi*” i saj.

Dallime midis gjinive mund të vërehen edhe në emërtimin e mjeteve të ushqimit. Kështu për shembull në gjermanisht *luga* është e gjinisë mashkullore, *piruni* i gjinisë femërore; kurse *thika* e gjinisë asnjansë (*der Luffel, die Gabel, das Messer*), në gjuhët sllave *luga* dhe *piruni* të gjinisë femërore, kurse *thika* e gjinisë mashkullore. Në gjuhën shqipe *luga* dhe *thika* të gjinisë femërore, kurse *piruni* i gjinisë mashkullore. Por në shumës ato marrin formën mashkullore, *lugët*, *pirunët* dhe *thikat* janë të arta.

### 3. Format gjuhësore jodiskriminuese

Në shumë vende evropiane si rezultat i marrëdhënieve të pabarabarta të pushtetit mes burrave dhe grave, edhe dallimet e tyre gjuhësore tanimë janë bërë të zakonshme dhe janë marrë masa që në opinionin publik të përdoren forma gjuhësore jodiskriminuese, kjo jo vetëm si pasojë e rrymës aktuale gjinore, por edhe si pasqyrë e realitetit, ku gjuha ka aftësi të ndikojë mbi realitetin.

Gruaja formalisht në shumë shoqëri perëndimore është e barabartë me burrin dhe merr përsipër të njëjtat rreziqe dhe shanse. Për këtë arsye është shumë e rëndësishme për shumë femra që të fitojnë vëmendje edhe nga ana gjuhësore dhe jo thjesht të jenë të bashkëpërfshira. "Pra gjuha jo vetëm se është një mjet shumë i rëndësishëm komunikimi, por ajo nënkupton edhe më shumë. Përmes gjuhës ne fitojmë identitetin. Dhe, po qe se gratë nuk shfaqen në gjuhë, po përmenden vetëm në përkufizimet mashkullore, atëherë ato nuk mund të gjejnë aq lehtë identitetin e tyre si meshkujt. Një gjuhë e tillë do të thotë që gratë, si edhe burrat, të jenë prezentë në gjuhë në masë të barabartë dhe kjo të jetë gjuhësisht e kapshme. Një mundësi për këtë ofrojnë përkufizimet e dyfishta, që do të thotë përmendja e formës femërore dhe asaj mashkullore. Kjo është një zgjidhje e mirë, për sa kohë që ekziston forma femërore e përkufizimit.

Në Gjermani ligji për barazinë gjinore është rregullator edhe për barazinë në gjuhë mes burrit e gruas në administratën shtetërore. Një shtab i ngritur nga shoqata e gjuhës gjermane merret rregullisht me korrektimin e formulimeve ligjore dhe jep rekomandimet e tij për ndryshimet eventuale në gjuhë.

### 3.1. Përkufizimet femërore për persona, tituj, funksione dhe profesione

Përdorime të tilla të “formave gjuhësore jodiskriminuese” në audiencën publike të ne në bazë të orientimit seksual deri më tani nuk e kanë tërhequr vëmendjen e gjuhëtarëve, të komunikologëve dhe as të komunitetit feminist, për dallim të shteteve evropiane, si Franca, Belgjika, Holanda dhe Zvicra, të cilat kanë hartuar lista fjalësh për personat dhe profesionet me përkufizime femërore. Për shembull kur ne flasim për kancelaren, atëherë mund të përfytyrojmë që është fjala për një grua, siç është rasti edhe tani. Shoqata e gjuhës gjermane e ka zgjedhur këtë fjalë, pra “kancelare” si fjalën e vitit për 2005. Shmangie të tilla ndaj mospërputhjeve gramatikore kanë ndodhur edhe në gjuhët ballkanike, si p.sh. në gjuhët sllave në vend „*kancelar je izjavila* (kancelari theksoi)“ gazetarët janë mësuar me forma si *kancelarka, premijerka, prevoditeljica* (përkthyes) etj, por nuk duhet tepruar, duke krijuar derivatet e zvetënuara si “*архитекткиња, боркиња, ловачица*” etj. (Klajn 2013).

Si shprehje të ndikimit ndërkulturor global edhe në gjuhën e sotme shqipe ka zënë e po shfaqet një dukuri e tillë e re e gjuhës seksiste, që ka si referencë “barazinë gjinore”, sidomos në gjuhën e politikanëve dhe të zyrtarëve të lartë shtetërorë. Në shumë gjuhë *ministrash, mjekësh* etj., nuk janë më grua e ministrit apo mjekut, por janë gra që janë vetë ministër apo mjek. Kur flasim për emrat kryetare dhe sekretarësh (kjo e dyta moti ka qenë e përcaktuar si profesion, sesa fjala e parë). Formulatat tradicionale kur drejtohem në publik, të selitura në periudhën e komunizmit: “*Shoqe dhe shokë*”, “*Vëllezër dhe motra*”, që janë përdorur deri në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar, më pas ato u zëvendësuan me

“Zonja dhe zotërinj”, kurse më vonë edhe me një varg sajeshash feministe të reja, si: “Të nderuar kolege dhe kolegë”, “Të dashur qytetarë dhe qytetare”, “Të dashur sportistë dhe sportiste”, “Të dashur studente dhe studentë”, “Të dashur shqiptare dhe shqiptarë”, “Të dashur pjesëmarrës dhe pjesëmarrëse”, “Fermere dhe fermerë”, “Vogëlushe dhe vogëlushë”, “ju uroj të gjithave dhe të gjithëve”. Tek titujt akademikë, tashmë është e rëndomtë të përdoret profesoreshë, mjeke, mirëpo gjatë nënshkrimit të ndonjë akti shënohet vetëm forma themelore (p.sh. profesor). Gjithashtu, përdoren edhe format: *asistente, docente, ligjëruese* edhe pse me një tingëllim feminist. Në këtë mënyrë na tingëllojnë edhe kur dikush na paraqitet si: *autore, poete, kritike letrare, analiste politike, magjistre ose doktorante shkencore, teoreticiante, hulumtuese, psikologe, sociologe, fotografiste* etj.

Çfarëdo që të mendojmë për këto fjalë “të feminizuara”, nuk ka dyshim se disa prej tyre e mënjanojnë problemin e kongruencës në disa konstruktive sintaksore. Megjithatë, përdorimi i tepërt i gjuhës seksiste, si p.sh. “shqiptare dhe shqiptarë”, “studente dhe studentë”, “ju uroj të gjithave dhe të gjithëve”, konsiderojmë se çon në shpërdorim të stërhollimit gjuhësor dhe e rëndon komunikimin. Vështirë është të kopjosh kodin suedez të barabarësisë së gjuhës seksiste në kontekstin ballkanik e shqiptar (Murati 2014).

### 3.2. Neutraliteti gjinor

Kohëve të fundit Suedia ka krijuar një përemër të ri gjinor me semantikë neutrale “hen”, që lejon t’i drejtohen një personi me gojë a me shkrim që nuk identifikohet me rolet tradicionale gjinore. Përemri “hen” është një version i modifikuar i fjalëve suedeze “han” (ai) dhe “hon” (ajo) dhe është krijuar me sugjerimin e gjuhëtarëve suedezë qysh në vitin 1960. Ky përemër, si i tillë është përfshirë në Enciklopedinë Kombëtare Suedeze dhe ka pasur një përdorim të rregullt dhe të shpeshtë në gjuhë. Një neutralitet gjuhësor kemi te gjuha shqipe, gjatë martesës, ndryshe nga gjuhët sllave ku thuhet se burri mund të martohet “oženiti”, por gruaja nuk mund të martohet “omužiti”, që

në gjuhën shqipe kemi një emër neutral “u martua” edhe për gruan edhe për burrin.

Kur është fjala për neutralitetin gjinor, Suedia është një nga vendet më të përparuara në botë me përqindjen më të lartë të grave të punësuar, dyqaneve të rrobave të cilat jo gjithmonë kanë sesione të veçanta për burrat dhe gratë, madje dhe edukim parashkollor me qëllim të eliminimit të gjinisë.

### Përfundim

Në këtë punim shqyrtoam rolin e gjinisë në kontekste gjuhësore brenda dy hapësirave kryesore transnacionale: midis politikës globale e punës riprodhuese dhe intimitetit ndër-gjuhësor në shoqëritë shumëgjuhësore.

Është e qartë se pabarazitë gjinore janë të ngulitura thellë në hierarkitë dhe aspektet e ndryshme shoqërore, qoftë kur është në pyetje identiteti i tyre, e veçanërisht dallimet dhe pabarazitë sipas racës, etnisë dhe shtresave klasore. Dallimet midis gruas dhe burrit u shpjeguan si pasojë e socializimit të ndryshëm të djemve dhe vajzave në civilizimin tonë. Moskuptimet e tyre u reflektuan në gjuhë si rezultat i shprehjeve dhe dallimeve të tilla.

Arsimi mbi barazinë gjinore në gjuhë duhet konsideruar si një çelës ose vend ku dallimet midis ideologjive të gjuhës, gjinisë dhe intimitetit ndërkulturor duhet mënjanoar, ndryshe nga pikëpamjet tradicionale ku nocioni i gjuhës kapte marrëdhënie dialektike mes interesave të fuqishme të tregut dhe dëshirës private, duke lënë anash aspektin e pabarabartë gjuhësor midis gjinive, ku roli mashkullor në gjuhë ishte më hegjemonist se ai femëror. Gjuha, në këtë mënyrë bëhet një faktor ndërlidhës midis hierarkisë së identiteteve dhe koncepteve normative të marrëdhënies midis dy gjinive.

### Bibliografia

- BESNIER, N. (2007). Language and gender research at the intersection of the global and the local. *Gender and Language*, 1(1), 67-78.
- BUGARSKI, Ranko (1995). *Jezik i kultura*. Bigz: Beograd.



- BURTON, P., Dyson, K. K., & Ardener, S. (1994). *Bilingual women*. Oxford: Berg.
- CAMERON, D. (1985). *Feminism and Linguistic Theory*. London: MACMILLAN.
- EHRlich, S. (1997). Gender as social practice: Implications for second language acquisition. *Studies in Second Language Acquisition*, 19, 421-446.
- GOLDSTEIN, T. (1996). *Two languages at work: Bilingual life on the production floor*. Berlin: Mouton de Gruyter.
- HELLER, M. (2007b). Gender and bilingualism in the new economy. In B. McElhinny (Ed.), *Words, Worlds, and Material Girls: Language, Gender, Globalization* (pp. 287-304). Berlin, New York: Mouton de Gruyter.
- IBRAHIMI, Mustafa (2009). *Fjalor i zhargoneve dhe eufemizmave shqiptare*. Shkup.
- JESPERSEN, O. (1922). *Language -Its Nature, Development and Origin*. London: Allen and Unwin.
- KOFMAN, E., & Raghuram, P. (2006). Gender and Global Labour Migrations: Incorporating Skilled Workers. *Antipode*, 38(2), 282-303.
- LAKOFF, R. (1975). *Language and Woman's Place*. New York: Harper and Row Publishers.
- LAN, P. C. (2006). *Global Cinderellas: Migrant Domesticity and Newly Rich Employers in Taiwan*. Durham: Duke University Press
- MITKO, Thimi (1961). *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912) II*. ("Bëleta Shypëtare). Instituti i folklorit. Tiranë.
- MURATI, Qemal (2014). *Gratë në gjuhë*. <http://shenja.mk/index.php/gjuhesi/11371-grate-ne-gjuhe.html>
- NORTON, B. (2000). *Identity and language learning: Gender, ethnicity and educational change*. Harlow, England: Longman.
- OKITA, T. (2002). *Invisible Work: Bilingualism, language choice and childrearing in intermarried families*. Amsterdam, Philadelphia: John Benjamins
- PAVLENKO, A., Blackledge, A., Piller, I., & Teutsch-Dwyer, M. (2001). *Multilingualism, second language learning, and gender*. Berlin, New York: Mouton de Gruyter.
- PILLER, I., & Pavlenko, A. (2004). Bilingualism and gender. In T. K. Bhatia & C. W. Ritchie (Eds.), *The Handbook of bilingualism* (pp. 489-511). Oxford, England: Blackwell.
- PILLER, I., & Pavlenko, A. (2009). Globalization, multilingualism, and gender: Looking into the future. In L. Wei & V. Cook (Eds.), *Continuum*
- TANNEN, D. (1990). *You Just Don't Understand: Women and Men in Conversation*. New York: Morrow.
- THORNE, B., & Henley, N. (1975). *Language and Sex: Difference and Dominance* (Vol. Rowley, MA): Newbury House.
- КЛАЈН, Иван (2013). *Грешке срећем чим отворим новине*, „NIN”, 26. 8. 2013, Beograd.

---

## UNIVERZALITETI, TRADITA DHE SPECIFIKAT LINGUISTIKE GJATË TË MËSUARIT E NJË GJUHE TË HUAJ UNIVERSALITY, TRADITIONS AND LINGUISTIC SPECIFICITIES DURING THE LEARNING OF A FOREIGN LANGUAGE

LENDITA GJIKOLLI

Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prihtinë, Kosovë

Email: lenagjikolli@gmail.com

### Përmbledhje:

Analizat teorike të lingvistëve të shquar shpeshherë krijojnë mundësi për të debatuar dhe për të paraqitur prespektiva të reja në lidhje me çështjen e të mësuarit që edhe sot, paraqet një sfidë të madhe për perfeksionimin e një ose me shumë gjuhëve të huaja. Megjithatë, konfuzionet që paraqiten gjatë dhënies dhe marrjes së porosisë në gjuhën bazë paraqesin vështirësitë e të deshifruarit, transmetuarit ose integruarit e porosisë së "koduar" që në të vërtetë ka të bëjë me traditën e gjuhës bazë e cila ndikon në të mësuarit e gjuhës së huaj. Prandaj, në këtë abstakt do të mundohemi të shqyrtojmë dhe analizojmë vështirësitë që paraqiten gjatë procesit të mësuarit. Komunikimi gjatë integritit gjuhësor paraqet tendencën për perfeksionimin e njohjes së traditës, qytetërimit dhe gjuhës të cilën e mësojmë.

**Fjalët çelës:** univerzaliteti, traditë, perfeksionim, kod, qytetërim.

### Abstract

Theoretical analysis of distinguished linguists often creates the opportunities for debate and to present the new perspectives on the issue of learning that even today, presents a major challenge for the perfection of one or more foreign languages. However, the confusions which appear while giving and taking messages on the basic language present a difficulties of the deciphered, so, the messages transmitted or integrated in the "code" that actually has to do with the tradition of the basic language which affects the learning of a foreign languages. Therefore, in this abstract we will try to explore and to analyze the difficulties that appears during the learning process. The communication during a integration represents the tendency for linguistic perfection of traditional knowledge, civilization and language which we learn.

**Keywords:** universality, tradition, perfection, code, civilization.

---

### Hyrje

Ne mund të themi se synimi ynë në këtë punim është lansimi, njohja e një tentative gjithë evropiane për ekuilibrim, nivelizim dhe ulje të paragjykimëve në mes popujve sa i përket traditës dhe kulturës. Çasjet e ndryshme për të arritur të njëjtin qëllim pra një gjuhë të përbashkët komunikimi për të gjithë popujt gjë që mundëson realizimin e pritjeve qoftë në avansimin intelektual të palëve të interesuara por, edhe realizimin e marrëdhënieve diplomatike ndërkombtare si dhe zhvillimin ekonomik në ra-

jon dhe më gjerë. Gjatë këtij procesi të gjatë vazhdimisht ballafaqohemi me specifikat, objektivat lingvistike që kanë të bëjnë me univerzalitetin kulturor dhe gjuhësor. Komunikimi gjatë integritit gjuhësor paraqet tendencën për perfeksionimin e njohjes së traditës, qytetërimit dhe gjuhës të cilën e mësojmë. Rëndësia e këtij punim qëndron në faktin që sjell risi në përjasjen dhe realizimin e objektivave bazë në mësimin e gjuhëve të huaja dhe e tërë kjo bëhet e mundur me njohjen e mirëfilltë të një ose më shumë gjuhëve të huaja.

## **Materialet dhe Metodat**

Materialet bazë padyshim janë punimet e ndryshme shkencore që citohen në bibliografi nga linguist të shquar që mirren me çështje socio-linguistike. Analiza teorike mbështetet në mbledhjen e materialit, klasifikimin, kategorizimin, interpretimin dhe implikimin e tyre në praktikë.

## **Univerzaliteti, tradita dhe specifikat linguistike gjatë të mësuarit e një gjuhe të huaj**

Në shiqim të parë ku flasim për kulturën, traditën e një populli, gjuhën e të cilit ne mësojme padyshim që, terminologjia e nocioneve na tingëllon e njëjtë në aspektin semantik, me gjuhët me të cilat ne se paku rrethohemi ose ndeshemi ndoshta, qysh nga fëmjëria me dëshirë ose jo, disa gjuhë na imponohen p.sh. në Jug dhe në veri të Shqipërisë me greqishtën dhe italishtën, Kosova me serbo-kroatishten, boshnjakishten dhe turqishten, shqiptarët e Maqedonisë me maqedonishtën. Kjo dukuri ishte e shprehur sidomos nëpër qytete ndoshta për shkak të rrethanave të imponuara historike dhe atyre gjeografike e më pas edhe për shkak të mbijetesës pra, të nevojave ekonomike dhe sociale të cilat shtynj shumë shqiptar të Kosovës në vitet e 70- ta dhe të 80-ta pra, në kohën e Ish-Jugosllavise të shkonin në Gjermani, Francë, Belgjikë etj. Në fillim ata shkonin vetëm pa familje e më vonë me familje por, gjithsesi gjenerata e parë nuk mundi të integrohej qoftë nga mungesa e arsimimit, qoftë nga mos njohja e gjuhës dhe kulturës së popullit me të cilin bashkëjetojte. Në Kosovë është tashme e njohur se arsimimi ka filluar shumë vonë, ne vitin 1970 (është hapur Univerziteti i Prishtinës ), në krahasim me vendet Evropiane madje edhe vet Shqipërinë edhe pse gjatë periudhave të ndryshme ka pasur individ të arsimuar, të kulturuar, të ndikuar me kultura nga vendet ku ata shkolloheshin në perendim ose në lindje, ose me vendet ku ata tregtonin dhe sillnin kulturat, traditat, kalket dhe gjestikulacionet d.mth përcillnin konceptet e huaja, kodet e huaja. Duke u bazuar në dokumentet arkivale frënge të Fondit të ministrisë së Punëve të Jashtme të Francës

Arkivit Diplomatik, korespondenca politike dhe ajo konsullore sipas sipas të dhënave të përpunuara, përkthyer dhe të sistemuara nga Prof.Shehu<sup>1</sup> diplomatët francez qysh në gjysmën e dytë të shekullit XIX janë marrur në mënyrë intenzive me çështjen shqipëtare si Colona Ceccaldi (1878-1879), G.Pons (1879), A. Le. Ré (1879 1883) etj. diplomat të punëve të jashtme të Francës, që korespondonin kryesisht me ministrat e punëve të jashtme të Francës si me Wadingtonin, Barthélemy Saint-Hi, Duffaure etj. Përshtypjet ishin nga më të ndryshmet. Shpeshë herë diplomatët freng shprehnin mendime objektive pa marrë parasysh qëndrimin zyrtar prandaj këto përshtypje në fakt paraqesin filltet e interesimit të të huajve për traditën kulturën dhe gjuhën shqipe duke mos u thelluar në aspektin historik mund të themi se në rrethana të tilla si ndodheshin shqiptarët në atë kohë ,vështirë se do të kishte ndonjë përparim në nivelin arsimor por prurjet si në aspektin gjuhësor ashtu edhe kulturor ishin tejet të pranishme. Ndërkaq, sa i përket çështjes së universalitetit na sfidojnë disa pyetje si:

Çfarë nënkuptojme me Universalitet? A është i mundur? Mos ndërlihet me globalizim, traditë, kulturë? Çfarë mund të bëhet dhe si të ndryshohet?

Cili është kodi dhe a është i mundur integrimi? A është me interes etj?

Janë çështje për të cilat debatohet dhe të cilat zgjojnë kureshtjen e shumë socio-linguistëve edhe sot.

Francis Debyser sipas këndvështrimit të tij çështjen e ndikimit të një gjuhe në tjetrën, prurjeve si dhe të gjitha ekuacionet që ndodhin mbrenda saj dhe jashtë saj i quajti " transfer i didaktikes" ndër të tjera ai thotë" Didaktika e gjuhëve kohë pas kohe ka propozuar një çasje strukturaliste deskriptive të të mësuarit e gjuhëve, e më pas një model me abstrakt të kompetencave linguistike, dhe më në fund pas disa vitesh një model pragmatik ose" komunikativ" thënë funksional - nocional.

Aktualisht, prej nga kanë ardhur këto modele dhe nga vijnë këto të fundit, me gjasë do të duhej të bëhej një lloj akordimi? Një theks i veçant i është bërë modelit logjiko - semantik të komunikimit

racional, që korresponon me të vërtetë me riprezentimet të cilat bëhen në kulturat tjera, në hierarkinë e funksioneve të gjuhës? Dhe se me të drejtë nuk korrespondojnë dhe se janë gabim” pamëvarsisht nga koncepti i autoritetit që gjithnjë jep arsye”.

Ndërkaq sipas D.Lehmann-it“, nuk vendosim për risitë radikale të transferteve didaktike dhe nevojën për të përqafuar pastërtin apo, thjeshtë modelet dominante të secilës shoqëri por, është e rëndësishme siç thotë Debyser është “Një reflektim didaktik ndërkulturor “ duke i peshuar me kujdes kushtet dhe modalitetet e këtyre transfereve. /.../ ai gjithashtu e vlerëson të rëndësishme riprezentimin e të mësuarit për të cilin jemi koshient dhe kemi njohje të egzistencës dhe karakterit të tyre”. Në të vërtetë këto janë dukuri të cilat ndodhin nëpër faza të ndryshme të zhvillimit shoqëror ose nëse i japim një vështrim regresiv të tërë kësaj çështjeje atëherë kemi një ngecje të theksuar ku nuk mund të bëhet fjalë për një avansim apo një pikëprekje me modalitetet e transferit ndërgjuhësor dhe kulturor kur kemi një zbrapsje të të gjitha vlerave shoqërore sidomos në vendet e dalura nga luftërat ose në vendet të cilat janë duke kapërcyer fazat e tranzicionit përkundër dëshirës së mirë ndonjëherë shtohen pyetjet se: Cilën kulturë ne duam ta afrojmë? A është ajo e duhura? A përkon ajo me kulturën shqiptare? Dhe çfarë është kultura shqiptare sot Nuk është se nuk kemi pasur kontakte fare me vendet e ndryshme sidomos ato të Evropës por, shtrohet pyetja a është tani Franca, gjegjësisht kultura franceze ajo që ka qenë ose a është ende sipas imazhit që ne kemi krijuar për te kur kemi të bëjmë me muzikën franceze, filmin, letërsinë etj. Apo do të duhej të bëjmë një lloj seleksionimi apo informimi. Të ndërlihdemi me mënyrën e reflektimit të Andre Trikos i cili zhvilloj teorinë e nevojës për tu informuar me ç’rast ai thekson: Në rrethana të veçanta, nevoja për informim koresponon me një prisë të konshjences, të një mungese të njohjes, një satisfakcioni për tu informuar që nuk e shuan atë përkundrazi e zhvillon”.<sup>5</sup> Një dilemë e madhe kur kultura angleze

më mirë të themi ajo amerikane pa dyshim se dominon madje shpeshherë edhe pa u vretur.

Duhet theksuar se kompetenca linguistike dhe ndërkulturore e mësimeve është shumë e rëndësishme dhe se ajo do të” duhej etabluar në një relacion në mes të kulturës së origjinës dhe kulturës së huaj dhe të luante rolin e ndërmjetsuesit në mes të dy kulturave”. Të gjitha kompetencat humane kontibojnë, në një mënyrë apo tjetrën me kapacitetin e komunikimit të nxënësit”. Me që rast sipas CECRL-së paraqiten tri akcese të kompetences “ajo linguistike ku hyjnë( leksiku, fonetika dhe sintaksa), pastaj, kompetencën socio-linguistike( që ka të bëjë me rregullat e mirësjelljes, kodifikimit dhe riteve...), kompetenca pragmatike ( maîtrise të diskursit, kohezionit dhe koherencës...)”. Kompetenca të cilat duhen të barten për të arritur rezultatin e duhur të bartjes së informatës, kodit dhe kulturës së gjuhës të cilën e synojmë ta perfeksionojmë. Ndërkaq, koncepti i përjetimit, distancës kulturore ndryshon sipas shoqërive, racës besimeve, regjioneve etj. Prandaj të gjitha këto tendenca linguistike mund të arrihen vetëm me anë të bashkëpunimit dhe relacioneve të mira diplomatike, të cilat do të pasuronin njohuritë e mësimeve përmes aktiviteteve të ndryshme.

### Përfundim

Në fund mund të konkludojmë se gjithë ajo që u tha më lart është një proces i pa shmangshëm, i paevitushëm, tejet i nevojshëm në mënyrë që njerëzit në tërë botën të jenë në gjendje të komunikojnë, të bashkëpunojnë, t’i lehtësojnë të gjitha proceset që ndihmojnë ata. E tërë problematika qëndron aty se shpeshherë vrehen tendenca të menjanim të vlerave të mirfillta tradicionale, kulturore, gjuhësore duke iu përshtatur gjuhës ose kulturës që mësohet duke ndryshuar në të njëjtën kohë tërë strukturën gjuhësore, zakonet, mënyrën e të jetuarit etj. Megjithatë e tërë kjo nxjerr në pah tendencën e univerzalitetit, globalizmit që ndërthet në vete shumë çështje të diskutueshme, problematike, që nxisin debate tek sociologët, linguistët etj. Edhe pse në fakt, qëllimi i kësaj iniciative është shqyrtimi dhe përqafimi ose jo i kësaj ideje,

përrjashtimi apo mohimi i problematikës së globalizimit ndërgjuhësor, që në të vërtet do të duhej të nënkuptonte thjesht një komunikim të denjë, të barazvlefshëm si në aspektin gjuhësor ashtu edhe në atë diplomatik, kulturor, shkencor, ekonomik dhe tregtar të garantuar ndërkombtarisht, duke mos nënvlerësuar njëren apo tjetrën traditë, kulturë ose gjuhë.

E për të realizuar iniciativën ndërkombtare të nivelizimit të njohurive, dhe dhënien barazvlerëshme të mundësive padyshim që pengesë kryesore do të ishte mosfunksionimi i kompetencave, objektivave të duhura për realizimin e mirëqenies gjithnjë duke u mbështetur në përvojën dhe ndihmën e vendeve të zhvilluara, duke u përshtatur traditës, gjuhës dhe kulturës tonë dhe duke krijuar ura ndërlidhëse në mes të vendeve, popujve për të krijuar të dobishmën dhe univesrsalen për të gjithë.

#### **Bibliografia:**

Barbara Ben Naser, Langues, éducation et interculturalité , Conference internationale: L impact du stéréotype” Tirane 2009, fq.89

Conseil de L Europe (2001), Cadre européen commun de référence pour les langues, Paris, Didier, fq.84

Conseil de l'Europe, Un Cadre européen commun de référence pour les langues, Didier 2001, fq.811 DEBYSER.F, "Pédagogies venues d'ailleurs. Transferts de didactiques et de cultures", Le français dans le monde 170, 1982, fq.26.

Denis Lehmann "Objectifs spécifiques en langue étrangère" Les programme en question" Hachette F.L. 58, Rue, Jean-Bleuz 92170 Vanves fq.38

HALOÇI Andromaqi, Langues, éducation et interculturalité , Conference internationale , Tiranë Entre l'approche communicatives et l'approche actionnelle fq.35

SHEHU Gjyltekin Lidhja shqiptare e Prizrenit në dokumentet françeze (1878-1881). Prishtinë 2010, fq. 19, 20. 214.

## NARRATORI I DYFISHTË I JERONIM DE RADËS THE DUAL NARRATOR OF JERONIM DE RADA

ZEQIRJA NEZIRI

Universiteti 'Sh. Cirili dhe Metodi', Fakulteti i Filologjisë 'Blazhe Koneski', Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare, Shkup, Maqedoni  
Email: zekoneziri@yahoo.com

### Përmbledhje

Në poemën *Serafina Topia* të Jeronim De Radës përdoren forma të ndryshme metatekstuale. Këto forma metatekstuale bëhen objekt i studimit tonë. Poema është ndërtuar në dy pjesë: poemën kornizë (pjesa e jetës së Serafinës) dhe poemën shtesë (pjesa e jetës së Paraylles).

(1) në aspektin teorik procesi i krijimit është brendasuar në stukturën e tij diegjetike. Pjesa e Paraylles është ndërtuar në harmoni me ligjësitë e vjershërimit pararomantik e sentimental të dashurisë së dy të rinjve dhe jo sipas parimeve romantike sentimentale, si është ndërtuar pjesa kornizë;

(2) Prurja më e rëndësishme romantike në poemë është futja në të e lexuesit (përmes dëgjuesit Pal Dukagjini), i cili nuk është paraqitur në pozitë vlerësuese, por afirmuese. Me vetë praninë e kësaj kategorie, në shkallën e krijimit, në poemë faktohet parimi i njëjtësimi (barazimit) të lexuesit (në cilësinë e dëgjuesit) me autorin (narratorin).

**Fjalët çelës:** poemë në poemë, narrator i dyfishtë, lexuesi implicit, dëgjuesi;

### Abstract

In the poem of Serafina Topia Jeronim De Rada used meta-textual forms. These meta-textual forms become the subject of our study. The poem is constructed in two parts: the poem frame (part of Serafina life) and additional poem part (the life of Paraila).

(1) in theoretical terms is the process of creating the framework is profounded diagetive structure. Part of Paraila first stars was built in harmony of versification pararomantic lawfulness of sentimental love of two young and not by sentimental romantic principles as part built frame;

(2) Bringing the most important is the introduction romantic poem to the reader (via listeners Paul Dukagjini), which is not shown in the position evaluation, but affirmative. With the very presence of this category, the degree of creation, the poem proved the principle of sameness (equalizing) the reader (in quality of listeners) with the author (narrator) /Translated by Evis Çelo/.

**Keywords:** poem to poem, double narrative, implicit reader, listener.

### Hyrje

Për shënimin e këtij përvjetori të dyqindtë të lindjes së këtij poeti më të madh arbëresh e shqiptar vëmendjen tonë do ta përqendrojmë në dy çështje që lidhen me metafiksionin si procede krijues në poemën *Serafina Topia*. Vëmendjen e kemi përqendruar në fenomenin e **narratorit të dyfishtë**, përmes të cilit do të dëshmohet ekzistimi i dy tipave të narratorëve që paraqiten në këtë poemë.

### 1. Rrjedhat narrative

Studiuesit e opusit krijues të De Radës kanë nënvizuar se poema *Serafina Topia* është shkruar si ditar intim i personazhit me të njëjtin emër: Serafina Topia, por se këndvështrimi të tyre i ka shpëtuar nga vëmendja depërtimi në thellësinë e analizës së këtij procesi krijues. Kështu pozita e narratorit bartet nga autori te personazhi. Poema si formë poetike është ndërtuar në dy rrjedha narrative: njëra është kryesore, bartëse e gjithë

veprimi; dhe tjetra është shtesë, e cila është futur brenda rrjedhës së parë narrative. Në këtë mënyrë vepra përbëhet prej dy poemave të pavarura. Të parën do ta quajmë *poemë kornizë*, ndërkaq të dytën *poemë shtesë*. Do theksuar se e dyta, pjesa shtesë duke u ngritur si poemë e pavarur nga e para dhe funksionon si intrigë për ta ngadalësuar ecurinë e veprimi bazë.

Narracioni kornizor i poemës është rrëfimi i fatit jetësor të Serafinës, intelektuales nga Arta të përfshirë në proceset jetësore të mjedisit shqiptar. Ndërkaq, narracioni shtesë, të cilin, po ashtu e shkruan Serafina është rrëfimi për fatin jetësor të Paraylles dhe Radhavanit të Janinës. me këtë dëshmohej se fabula e poemës *Serafina Topia* është ngritur mbi dy rrjedha narrative dhe përbëhet prej dy poemave të pavarura: *poemës kornizë* dhe *poemës shtesë*.

Rrëfimi në të ngritet në vetën e tretë njëjës. Edhe pse forma e ditarit kërkon që të jetë përdorur veta e parë njëjës, sepse vetë ditari nënkupton ndërtimin e rrëfimit me elemente biografike dhe me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të personazhit, përmes të cilit në vepër futen elementet autobiografike. Kështu poema në njërin anë bart elemente të formave tregimtare biografike, domethënë të vërtetësisë historike dhe në anën tjetër elemente të letërsisë rrëfimtare. Mirëpo, përkundër mbizotërimit të përgjithshëm të kësaj mënyre rrëfimtare në gjithë veprën (në të katër pjesët), sidomos në pjesën e tretë dhe pjesërisht në të katërtën, vërejmë se në brendinë e saj është bërë një ndërhyrje, një shpëputje e ndërprerje e rrjedhës narrative. Kjo ndërhyrje hap diskutimin rreth përcaktimit të faktorëve (shpjegimit të elementëve përbërës) si të funksionimit të saj të brendshëm, ashtu edhe të funksionimit të pavarur, pastaj të gjetjes së lidhjeve të saj me tërësinë dhe të faktorëve që marrin pjesë në përveçimin e saj prej tërësisë.

Meqë, në këtë studim do të zbatojmë një analizë sistemore të elementeve metatekstuale të *Serafina Topisë* mendojmë se është e nevojshme të jepet një pasqyrë e shkurtër teorike e çështjeve metatekstuale mbi të cilat mbështetet aktualizimi i tyre në këtë vepër narrative. Çështja që rrihet është shtruar në gjashtë pika që japin

përgjigje në pyetjet: *kush e rrëfen ngjarjen dhe kujt i rrëfëhet, kush e sheh dhe kush e nxit ngjasën, kush dhe kur rrëfen, fiksioni në fiksion, raportet midis të dyja pjesëve, horizonti i lexuesit.*

## 2. Kush e rrëfen ngjarjen dhe kujt i rrëfëhet?

Kush e rrëfen ngjarjen dhe kujt i rrëfëhet? Janë dy ndër pyetjet themelore që shtrohen sot në studimet narratologjike. Në teorinë e narracionit, mbështetur sidomos në krijimet postmoderniste janë aktualizuar çështje që vetëm ishin prekur në të kaluarën e largët antike, por që edhe në studimet e mëvonshme nuk u thelluan më shumë. Studimet e thelluara të kësaj disipline shkencore, në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar midis çështjeve të tjera kanë shtruar edhe çështje që lidhen me rrëfimtarin, bartësin e narracionit. Këto studime janë përpjekur të japin përgjigje në pyetjet: kush e rrëfen ngjasën dhe kujt i rrëfëhet? Që këtu ka lindur edhe dallimi i dy narratorëve: (a) i jashtëm (ekstern), i vrojtuar; dhe (b) i brendshëm (intern), vrojtues.

Në shikim të parë fabulat e këtyre dy rrjedhave narrative janë shumë të thjeshta. Fabula kornizore dallohet me drejtpërdrejtshmërinë e rrëfimit të ngjarjes dhe ajo i rrëfëhet një lexuesi të imagjinuar, lexuesit model. Ndërkaq në fabulën e futur, rrëfimi për Parayllen dhe Radhavanin është ndërtuar si një poemë familjare e familjes qytetare shqiptare që i rrëfëhet personazhit, Pal Dukagjini dhe, në këtë pjesë narracioni zhvillohet në prani të lexuesit, në cilësinë e dëgjuesit. Me këtë rast pozita e marrësisë është e identifikueshme dhe, me këtë element, pjesa e shtuar në aspektin përshkrimor dallon nga pjesa kornizë, në të cilën, në këtë të fundit marrësi i porosisë poetike është në pozitë të paidentifikueshme.

Fillimisht do të kënaqemi me konstatimin se kemi të bëjmë me dy pozita të narratorit. Serafina si rrëfimtare/folëse na del në pozitë të dyfishtë: *si mbajtëse e ditarit* në pjesën kornizë dhe *si krijuese e poemës* në pjesën shtesë. Në këtë mënyrë i shpjegojmë dy pozitat folëse dhe të dy roleve që luan Serafina:

(1) njëri është *rol* dhe *pozita* e **narratorit**, në pjesën kornizë; dhe

(2) tjetri është *rol* dhe *pozita folësit* të veprimit në pjesën shtesë.

(1) në **pjesën kornizë** Serafina është folëse (fokalizatore) e jashtme, sepse duke përdorur formën e ditarit jetën e saj e përshkruan nga jashtë dhe në këtë drejtim pozita e rrëfimitarit dhe e narratorit, sipas Zhenetit do të njëjtësoheshin, pra do të ishin pozitën zero. Më tej kjo histori jetësore i rrëfëhet një lexuesi të imagjinuar:

(2) Në **pjesën shtesë** Serafina është rrëfimitar i brendshëm, folëse e rrëfimit. Ajo si personazh përshkruan historinë jetësore të Paraylles dhe këtë histori ia rrëfen një lexuesi/dëgjuesi konkret, personazhit tjetër.

(3) Në rrafshin e *pozitës së narratorit* çka vërejmë në këtë mënyrë të ndërtimit të rrëfimit? Vërejmë se Serafina paraqitet në dy pozita, me të cilat distancohet, përkatësisht identifikohet me krijuesin/narratorin: (3.1) si narratore; dhe (3.2) si folëse.

(3.1) Në pjesën kornizë ajo është në *pozitë interne*, sepse si personazh duke përshkruar jetën e saj në *formë të ditarit*, edhe pse përshkruan përjetimet e saj nga pozita e narratorit të distancuar, të gjithëdijsëm paraqitet nga pozitë e narratorit të identifikueshëm dhe identifikohet me autorin.

(3.2) Në pjesën shtesë Serafina nuk mban pozitë të njëjtë, por pozitë të jashtme: është jashtë ngjasës.

Sa i përket çështjes së distancimit apo identifikimit të autorit nga narratori apo folësi i veprimit është e natyrshme se të dyja pjesët i ka shkruar Jeronim de Rada. Kjo dëshmohet me shënimet që jepen për secilën këngë të kësaj poeme. P.sh. këngët e pjesës kornizë, si dhe në ato të pjesës shtesë gjithkund kemi shënimin: “*E bënur Maq te viti 1837*”, 1842, 1854, 1858.

Distancimi i narratorit nga folësi i ngjasës më së miri dëshmohet me data në fillim të secilës këngë: Janar 1446; që identifikohen me kohën për të cilën rrëfëhet në poemë. Këto data bëjnë që narratori të distancohet nga folësi, përkatësisht nga autori. Sepse pjesa kornizë, si dhe pjesa shtesë dëshirohet të paraqiten si ditar i Serafinës.

### 3. Kush e sheh dhe kush e nxit ngjasën?

Gjithnjë në kontekst të *Serafina Topisë* dhe përgjithësisht në studimet narratologjike një çështje tjetër, po ashtu e rëndësishme dhe problematike është: *kush e sheh, e vrajton* (e flet) *ngjarjen* dhe kush bëhet shkaktar për përfshirjen e saj në rrafshin diskursiv. Me një fjalë problematika do të përmbliidhej në pikën: *nga cila perspektivë ngritet rrëfimi që tregohet*; në është bërë fokalizimi **nga perspektiva e personazhit**, apo **nga perspektiva e narratorit**, përkatësisht **e autorit të tekstit**? Shumë prej këtyre pyetjeve të shtruar përgjigjet i gjejmë në poemën *Serafina Topia* të Jeronim de Radës.

Në **pjesën shtesë**, siç shihet rrëfimi ngritet nga perspektiva e personazhit, prej tij bëhet fokalizimi dhe, po ashtu nga perspektiva e personazhit lind dëshira (shkaku), lind nevoja e ndërhyrjes, e ndërftjes së pjesës shtesë.

Interesimi lind jo nga personazhi folës, por nga personazhi shtytës / dëgjues. Ky është Pal Dukagjini, i cili, si lexues implicit shumë lehtë bëhet pre, me vetëdëshirë bie në grackën e ngritur nga Serafina.

### 4. Kush dhe kur rrëfen?

Një problem e interesant që sot shtrohet në studimet narrative është edhe çështja: **kush dhe kur rrëfen**? Këtu kemi të bëjmë me dy kategori të hronotopit: kohën në të cilën tregohet teksti dhe koha për të cilën rrëfëhet në tekst. Në rastin tonë të Serafinës procedeu i dytë metatekstual është i pranishëm në pjesën shtesë dhe të dy kohët realizohen atypëraty. Rrëfimi në të bëhet pasi ka përfunduar ngjasa dhe ajo aktualizohet në brendinë e rrjedhës narrative themelore.

Koha **për të cilën rrëfëhet** në të dyja pjesët është periudha historike e shekullit XV. Sa i përket kësaj çështjeje nuk vërejmë ndonjë mospërputhje. Ndërkaq mospërputhjet paraqiten në linjën **e kohës kur tregohen** këto dy rrëfime. Sepse:

(1) në **pjesën kornizë koha e tregimit të rrëfimit** është e baraskohshme me kohën e leximit të veprës dhe mund të presupozohet (konsiderohet) si kohë e përbashkët e të dyja pjesëve. Mirëpo,  
(2) **pjesa shtesë** njeh edhe kohën tjetër, kohën implicite: të lexuesit. Domethënë koha e tregimit



të saj është e brendasuar në vepër dhe lexohet e përjetohet para kohës së Serafinës.

Në këtë kontekst koha e tregimit të historisë së Serafinës, pra e pjesës kornizë është e papërfunduar; ndërkaq koha e tregimit të ngjasës së Paraylles është e përfunduar. Kjo, në aspektin kohor ashtu si hyn në pjesën kornizë të poemës, ashtu edhe del prej saj. Në këtë mënyrë shpjegohet se koha e rrëfyer e Paraylles bëhet pjesë përbërëse e plotësimit të kohës rrëfimore të Serafinës në tërësi.

### 5. Fiksioni në fikson

Në këtë kontekst rrëfimi metafiksional, që futet në brendinë e rrëfimit kryesor të poemës realizon efekt të dyfishtë. Ndërfutja në rrjedhën kryesore e aktit të krijimit (imitimit) të rrëfimit metafiksional narracionin njëkohësisht edhe e ngadalëson edhe e përshkruan. Midis rrëfimit të ditarit të Serafinës (të jetës së saj) dhe rrëfimit të poemës së vogël familjare (të jetës së Paraylles), d.m.th. midis realitetit (fiksionit) dhe fiksonit (fiksionit të dyfishtë, fiksonit në fikson) është kontrapunkti mbi bazën e të cilit mund të presupozohet zhvillimi i mëtejshëm i narracionit. Është e qartë se mise-en-abîme-i paraqitet në funksion struktural të protestës (rrebelimit) të një fragmenti të narracionit kundër tërësisë, pjesë përbërëse e të cilës është dhe kështu paraqet aktin e vetëzbulimit të statusit fiksonal të rrëfimitarit.

### 5. Raportet midis të dyja pjesëve

Për këtë arsye në poemën *Serafina Topia* paralelisht zhvillohen dy rrafshe diegjetike, duke u reflektuar në njëri - tjetrin. Të dyja këto shtresa narrative të poemës simulojnë ngjasën dhe fiksonin dhe secila është e shkruar me kod të ndryshëm narrativ. Bashkëkohësia prezantohet si formë e jetësimit subjektiv dhe e përvetësimit semantik të traditës, e cila në indin narrativ të poemës realizohet si lojë parodike e strukturave poetike. Historia e Serafinës është në kundërshti me historinë e Paraylles. Këto elemente kundërrthënëse, si dhe ndarja konstituive brenda kësaj poeme rrihet në raportin dialogjik. Befasia më e madhe është se të dy këto rrafshe diegjetike kanë vetëm një narrator: personazhin Serafinë.

Jeronim de Rada nuk mbetet i kënaqur me këtë pozitë të Serafinës folëse të rrëfimit të poemës. Ai bën hapin e dytë. Brenda kësaj tërësie ndërfut pjesën shtesë, e cila, në aspektin rrëfimor ndryshon shumë nga e para. Rrëfimi në të nuk është ndërtuar sipas poemave romantike, por sipas poemave pararomantike, përkatësisht klasiciste e më tej baroke, humaniste e mesjetare deri edhe klasike epike. Kjo pjesë shtesë e ndërfutur kështu, në shikim të parë duket sikur funksionon si ironi e pjesës kornizë. Nuk ngjet kështu, por e kundërta: pjesa kornizë duke ndjekur parimet romantike, si novatore, moderne për kohën ironizon me tipin e rrëfimit të pjesës shtesë të ndërtuar sipas parimeve klasiciste e më tej.

### 6. Horizonti i lexuesit

Kuptohet kjo është pasojë e parimeve romantike që ka ndjekur De Rada dhe jo vetëm ai, por edhe të gjithë romantikët. Njëri prej këtyre parimeve është edhe kufizimi i horizontit të lexuesit. Kështu, në rrëfimin kornizor autori është identik me personazhin dhe me rrëfimitarin (folësin), pra rrëfimtari dhe personazhi janë të njëjtë, sepse, siç e dijme poema është paraqitur si ditar i Serafinës. Kjo do të thotë se në pikëpamje të formës rrëfimore të ndërtimit të narracionit dhe të pozitës së narratorit në të dy rastet nuk vërehet ndonjë dallim dhe në aspektin strukturor kemi të bëjmë me rrëfimitarin e identifikuar.

Në kontekst të lexuesit: Pal Dukagjini si personazh sheh aq sa i servon (i lejon) Serafina. Kështu narracioni është i brendasuar.

### Përfundim

Ky interpretim i brendasuar i veprës detyrimisht kërkon afirmimin e diskursit teorik kritik dhe letrar. Narracioni tradicional i Serafinës (si folëse) dhe narracioni modern i narratorit hedhin dritë të re në procesin krijues të Jeronim De Radës. Leximi edhe në këtë mënyrë i poemës *Serafina Topia* të Jeronim De Radës do t'ia shtojë dhe rrisë vlerën e saj estetike sipas të cilave është konsideruar midis veprave më të rëndësishme të letërsisë shqipe të periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe hedh dritë të re në procesin e tij krijues.

Naracioni në poemë është i thjeshtë, por pak i papritur. Shmangien nga linja fabulative themelore me anë të kësaj pjese, si dhe futjen e saj brenda etapave të zhvillimit të kornizës fabulative të poemës De Rada e ka përdorur për ta përfituar lexuesin, por edhe për ta befasuar atë. Poema në poemë e Serafinës e vendosur brenda kornizës themelore të poemës në tërësi ofron të dhëna të mjaftueshme tekstuale për ta zbuluar mënyrën dhe mekanizmat e ndërtimit e të funksionimit të saj brenda tërësisë rrëfimore të poemës, si dhe ndihmon ta kuptojmë rëndësinë e futjes së saj brenda tërësisë së tekstit.

Leximi në këtë mënyrë i poemës *Serafina Topia* të Jeronim De Radës do t'ia shtojë dhe rrisë vlerën e saj estetike sipas të cilave është konsideruar midis veprave më të rëndësishme të letërsisë shqipe të periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe hedh dritë të re në procesin e tij krijues.

#### Bibliografi:

ALTER, R. (1978), *Partial Magic: Novel as a Self-Conscious Genre*, University of California Press, Berkeley-Los Angeles-London.

BITI, Vladimir:  
<http://www.matica.hr/vijenac/289/identitet/trauma/>

ÇALE Knezheviç, Moran (1995), *Intertekstualnost i autoreferencijalnost u radovima mlađih teoretičara: Trag i razlika. Čitanja suvremene*

*hrvatske književne teorije*, ur. V. Biti, N. Ivić, J. Užarević, Naklada MD / HUDHZ, Zagreb.

DÄLLEMBACH, Lucien (1977), *Le récit speculaire. Essai sur la mise-en-abîme*, Paris 1977

DE RADA, Jeronim (2005), *Opera Omnia III*, I Canti di Serafina Thopia, Rubbettino, Catanzaro.

HUTCHEON, L.(1983), *Narcissistic Narrative: Metafictional Paradox*, Methuen, New York – London.

LUHMANN, N. (1981), *Teorija sistema: svrhovitost i racionalnost*, Globus, Zagreb.

LUHMANN, N. (1996), *Ljubav kao pasija*, Naklada MD, Zagreb.

MCHALE, Brian (1987), *Postmodernist fiction*, Routledge, London-New York.

MORANJAK – BAMBURAÇ, Nirman (1991), *Metatekstovi*, Sarajevo.

PAVLIČIĆ, Pavao (1988), *Intertekstualnost & Intermedijalnost*, ur. Z. Maković, P. Pavličić etj., Zavod za znanost o književnosti Filozofskoga fakulteta, Zagreb.

PERUSHKO, Tatjana (2000), *Roman u zrcalu. Suvremena talijanska proza između samosvijesti i pripovijesti*, Naklada MD, Zagreb.

SLABINAC, Gordana (2006), *Bezdanost: Sugovor s literarnim javlom. Eseji o čitateljskoj nesanic*, Zagreb.

WAUGH, Patrizie (1990), *Metafiction: Theory and Practice of Self-Conscious Fiction*, Rotledge, London-New York.

---

## TIPAT E ORËVE TË MËSIMIT TË GJUHËS ANGLEZE TYPES OF CLASSES FOR LEARNING ENGLISH

SHPRESA HOXHA

Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, REPUBLIKA E KOSOVËS  
Email: shppreessaa@hotmail.com

### PËRMBLEDHJE

Mësimdhënia është një detyrë komplekse dhe me përgjegjësi, që kërkon angazhim dhe përkushtim të madh nga mësimdhënësi. Andaj duhet kushtuar rëndësi të madhe përdorimit të metodave të mësimdhënies e në veçanti tipit të mbajtjes së orës së gjuhës së huaj, me këtë rast gjuhës angleze, si gjuhë e dytë, për të arritur objektivat e parapara dhe nivelin e duhur të mësimnxënies tek nxënësit/studentët. Tipat e orëve mund të zhvillohen përmes metodave të ndryshme si: metoda e drejtpërdrejtë e a.q. natyrale, metoda komunikative, metoda gramatikore-përkthyes, metoda audiolinguale, më pak e përdorshme në Europë etj. Ndryshimet në mësimdhënie dhe mënyra e orëve të mbajtura ndodhin në pajtim me zhvillimet shoqëro – ekonomike, zbulimet e reja teknike dhe të informatikës. Paraqitet nevoja të punohet me nxënës / studentë në pajtim me ndryshimet dhe kërkesat e kohës për mësimdhënie më të përshtatshme dhe më cilësore.

**Fjalët çelës:** tipat e orëve, mësimdhënia, gjuha angleze, metodat.

### SUMMARY

Teaching is a complex and responsible duty that needs commitment and loyalty by teachers. So, we have to pay attention to the use of methods and ways of teaching and especially to the type of a foreign language classes we use, in this case English as a second language, in order to achieve the expected objectives and the proper level of pupils' / students' learning. Types of classes may be organized through different methods like: direct method, the so called natural method, communicative method, grammar – translation method, audio-lingual method that is less used in Europe. Changes in teaching and methods of the held classes must be in connection to the socio – economic developments, new technical and informatics discoveries of nowadays. It is necessary to work and act with pupils and students in accordance to the changes for proper and qualitative teaching.

**Key words:** types of classes, teaching, English language, methods.

---

### Hyrje

Metodologjia e mësimdhënies së gjuhëve të huaja është një art më vete, që kërkon angazhim, maturi, gjindshmëri dhe investim të duhur të mësimdhënësit gjatë punës me nxënës, studentë ose kandidatë të tjerë të interesuar për mësimin e gjuhës së huaj.

Mësimdhënia është një detyrë e vështirë dhe komplekse, kërkon njohuri, aftësi e shprehi të shumta (Musai 2003: 11).

Të mësuarit e gjuhës angleze sot është edhe imperativ i kohës, në kuadër globalizimit, kërkesat janë të shtuara prandaj paraqitet çështja se

cilat metoda do të ishin më të suksesshme për të arritur qëllimin e caktuar.

“Një nga karakteristikat kryesore të metodës njohëse, është vënia e nxënësit në qendër të procesit të të mësuarit, dmth. t’i japësh përparësi veprimtarisë mendore. Çdo folës ka tashmë një përvojë gjuhësore, të fituar nga gjuha amtare dhe të pasuruar ndonjëherë nga zotërimi i një gjuhe të dytë dhe nga praktika e një tjetër gjuhe të huaj.” (Pendax 2004: 15).

Me përparimin e vullshëm të teknologjisë dhe të informatikës, mundësitë e mësimin të gjuhës së huaj mund të ndihmohen edhe përmes formave

të ndryshme lehtësuese me kompjuter, internet, telefona celularë të avancuar etj., gjë që është një ndihmesë e veshme në mësimin e gjuhës angleze, në përgjithësi. Rëndësi të veçantë në mësimdhënie dhe mësimnxënie ka stili i mësimdhënësit dhe mënyra e interpretimit të gjuhës nga ana e tij ose e saj, metodologjia e përdorur etj.

“Të mësuarit e një gjuhe të huaj ka të bëjë me tre dimensione: nga njëra anë, kuadri kulturor, konjuktiv dhe afektiv në të cilin nxënësi (studenti – plotësim i imi) zhvillon veprimtarinë e vet, dhe që përcakton mënyrën se si ai e koncepton gjuhën e huaj dhe të mësuarit e saj në rolin e komunikimit në klasë; së fundi, vetë veprimtaritë në klasë që përcaktojnë veprimtarinë e nxënësit dhe i japin një drejtim të caktuar procesit të tij të të mësuarit”. (Musai 2003: 1).

### **Metodat e mësimit të gjuhës angleze**

Të mësuarit e gjuhës angleze më herët është ndihmuar edhe përmes laboratorëve të gjuhës, “një ose më shumë magnetofona, të cilët kanë shërbyer si burime të zërave të incizuar të cilët studentët i dëgjonin. Janë përdorur shiritat e incizuar gjithashtu. Magnetofonat kanë shërbyer edhe për incizimin e zërit të studentëve për qëllime testimi.” (Hayes 1968: 1 – 2).

Sot, kur teknika ka ecur me hapa shumë të shpejtë, mundësitë për zhvillimin e mësimit të gjuhës së huaj janë edhe më të përsosura dhe të shumëllojshme. Shumë kompani të ndryshme, anë e kënd botës bëjnë përpjekje dhe shpenzojnë mjaft mund e kohë për të siguruar tekste dhe pajisje të shumta, të avancuara, shpesh edhe konkurruese në treg, për lehtësimin e mbajtjes së mësimit të gjuhës angleze.

Mësimi i gjuhës angleze dhe tipat e orëve mund të ndahen sipas moshave dhe në bazë të niveleve të njohjes së gjuhës së huaj, duke filluar nga parashkollorët, fillestarët (varësisht nga moshja), mësimi në ciklin e ulët, të mesëm dhe të lartë. Mjeti kryesor është teksti shkollor/universitar, tejet i dobishëm, që përdoret nga mësimdhënësit e gjuhëve të huaja sipas njohurive që kanë nxënësit/studentët për mësimin e anglishtes në këtë rast. “Teksti është një mjet universal për mësim-

dhënie. Miliona ekzemplarë shiten çdo vit dhe miliona projekte hartohen për t’i botuar ato në vende të ndryshme” (Hutchinson & Torres 1994: 125).

Aktiviteti i arsimitarit socializohet me demonstrime, komentim ilustrimesh, përgatitje mjetesh didaktike, materiale vizuale, si: fotografitë, vizatimet e ndryshme, pikurat, këngët, videot dhe pjesët nga filmat artistikë, të cilat janë burime që mund të përdoren në mënyrë të dobishme për qëllimin e mësimit të gjuhës. Ato mund të krijohen nga vetë mësimdhënësit, nga nxënësit e talentuar me kërkesë të mësuesit, nga tekstet, librat artistikë, nga gazetatat dhe revistat e ilustruara dhe botime të tjera si: fletëpalosjet, broshurat, manualët etj. Ndërsa pjesët e filmave mund të sigurohen nga qendra të specializuara për prodhimin e tyre. Këto mund të jenë një shtytje e mirë dhe të nxisin interesimin e nxënësit/studentit lidhur me atë që shohin dhe dëgjojnë, mund të ndihmojnë në të përforcuarit e mësimit dhe pasurimin e mëtejshëm të komunikimit, zhvillimin e aftësive të mësimit, të arsyetuarit kritik, dhe së fundi ndihmojnë në qartësimin e vlerave.

### **Tipat e orëve të mësimit të gjuhës së huaj**

Tipat e orëve të mësimit mbështeten në zbatimin e metodave të ndryshme mësimore.

Metoda gramatikore-përkthyesë është aplikuar nga fundi i shek. XVIII dhe kryesisht është bazuar në përkthime përmes rregullave gramatikore dhe strukturave të saj. Ndërsa metoda e drejtpërdrejtë, e quajtur metodë natyrale është vënë në përdorim nga viti 1900 në Francë dhe Gjermani. Sipas kësaj metode, mësimi kryesisht zhvillohet në gjuhë të huaj përmes sinonimeve, demonstrimeve fizike dhe ndihmës vizuale (Richards & Rogers 1986: 9-10).

Metoda audio-linguale është metodë e drejtpërdrejtë dhe objektive me komunikim gjuhësor. Këtu gjuhëtarët konsiderojnë, se gjuha nuk është vetëm tingull, por edhe kulturë, aftësi për të folur, për të lexuar dhe për të përjetuar letërsinë. Mësimdhënia sipas kësaj metode përbëhet nga përsëritja, atëherë kur nxënësi përsëritë atë që dëgjon nga mësimdhënësi; të ndryshuarit e

formës së fjalës nga ana e nxënësit; zëvendësimi me një fjali tjetër nga nxënësi dhe rifrazimi i fjalës nga nxënësi. Kjo metodë nuk është treguar shumë e suksesshme, andaj në disa pjesë të Europës është hequr nga përdorimi nga fundi i shek. të XIX dhe nuk është pranuar shkencërisht edhe pse përdoret në orët e mësimit të gjuhës së huaj dhe mund të shërbejë në kombinim me metodat tjera (Morgan & Neil 2001: 3).

Metoda Assimil është një prej atyre metodave më të hershme, që është përdorur rreth 80 vite më herët, e cila është përqendruar në komunikim të drejtpërdrejtë për mësim të pavarur, duke filluar me të mësuarit pasiv, nëpërmjet leximit dhe dëgjimit.

Punimi në fjalë mbështetet në tipat e orëve të mësimit të gjuhës angleze përgjithësisht në arsimin e lartë, mënyrën e të mësuarit, strategjitë dhe metodat e përdorura nga ana e mësimdhënësit. Orët e mësimit të anglishtes zhvillohen dhe mbahen sipas fushave të studimit, në pajtim me plan-programin e degëve përkatëse. Njësitë mësimore kryesisht mbështeten në materien të cilën ata e mësojnë dhe e studiojnë në fakultetet gjegjëse.

Në Fakultetin ekonomik, materia e lëndës së gjuhës angleze ka të bëjë me përmbajtje nga të gjitha degët e ekonomisë sot, duke filluar nga Departamenti Banka, Financa, Menaxhment dhe Informatikë, Marketing, Ekonomiks dhe Kontabilitet. Në tekstin me të cilin zhvillohen mësimet janë përfshirë materie mësimore të larmishme, të të gjithë lëmenjve të studimit të ekonomisë përgjithësisht, një pjesë e tyre janë marrë nga autorë të shquar, ekonomistë të njohur dhe që kanë të bëjnë me risitë ekonomike në Europë dhe botë.

Duhet theksuar, se plan-programi i paraparë i mësimit të anglishtes për ekonomistë qëndron në të kuptuarit dhe të aplikuarit e koncepteve kryesore të degëve ekonomike. Bëhen përpjekje që studentët të zotërojnë fjalët dhe shprehjet e fushave të ndryshme ekonomike, të njihen me praktikën e institucioneve ekonomike dhe financiare për nevoja të veçanta të profesionit të tyre të ardhshëm, duke bërë përpjekje që tipi i orës mësimore t'iu përshtatet njohurive të tyre

paraprake dhe kërkesave të tregut të punës në të ardhmen për punë dhe studime të mëtejme. Studentët mësojnë për të lexuar dhe analizuar materialet autentike, duke përfshirë artikuj të ndryshëm nga literatura profesionale dhe nga revista. Ata gjithashtu e ushtrojnë gjuhën duke dëgjuar muzikë, pjesë teatrale e filma.

Teksti mësimor i anglishtes në Fakultetin juridik mbështetet në njësi mësimore, të cilat përfshijnë materie nga fusha e jurisprudencës, përkatësisht të drejtimit juridik, të cilin studentët e studiojnë, d.m.th. të të gjitha drejtimeve të këtij fakulteti, nevojë kjo e domosdoshme për t'u paisur në mes tjerash edhe me terminologji profesionale të drejtimit, të cilin e kanë përzgjedhur.

Në fakultetet e tjera, si në atë të filologjisë, të inxhinierisë mekanike, të inxhinierisë elektrike, të arkitekturës, të ndërtimtarisë, të gjeoshkencës dhe teknologjisë, të shkencave të aplikuara, të bujqësisë dhe veterinarisë, të arteve, të mjekësisë, të shkencave matematiko - natyrore etj., mësimet e gjuhës angleze në të shumtën e rasteve mbështeten në plan - programet mësimore të gjuhës së huaj, të cilat bëjnë fjalë për fushën përkatëse, studimore të fakulteteve të lartëpërmendura dhe i kanë syllabusët e veçantë.

Qëllimi kryesor është që studentët të pajisen me njohuri nga gjuha angleze e profesionit të tyre dhe të pasurojnë fondin e fjalëve dhe shprehjeve, që kanë të bëjnë me terminologjinë profesionale, adekuate të fushës të cilën ata e studiojnë.

Orët e mësimit përfshijnë njësi prej librave dedikuar studentëve të fushave përkatëse të studimit, me tema të ndryshme nga të gjitha departamentet e fakulteteve në të cilët studiojnë. Fatmirësisht, sot përveç botimeve dhe ribotimeve të mëhershme ka edhe botime të reja, të ndryshme të fjalorëve të terminologjisë profesionale, të cilët ju rekomandohen nxënësve/studentëve për përkthimin e fjalëve dhe shprehjeve të panjohura, që kanë të bëjnë me terminologjinë profesionale dhe shkencore të fushave përkatëse të studimit, ndihmesë kjo e nevojshme dhe e patjetërsueshme për studentët, e propozuar nga mësimdhënësit. Për të lehtësuar të kuptuarit e mësimëve, përmes sinonimeve dhe antonimeve (fjalëve të kundërta) ju mundësohet

shpjegimi i fjalëve dhe shprehjeve të panjohura, gjë që është treguar me shumë sukses edhe gjatë zbatimit të këtij lloji të mësimdhënies dhe të ushtrimeve me studentët. Pyetjet rreth mësimave iu mundësojnë të shprehen dhe të dëshmojnë se mësimi i shpjeguar është kuptuar dhe përvetësuar plotësisht. Ushtrimet gramatikore janë të pashmangshme dhe të nevojshme edhe pse nga disa metodistë të gjuhëve të huaja ka mendime dhe komente të ndryshme, si p.sh.:

“Pak e pëlqyer, gramatika ka marrë një vend të dorës së dytë në punën e mësuesve të gjuhës. Mendohet se kompetenca gjuhësore do të krijohet vetvetiu duke marrë pjesë në veprimtaritë komunikuese: këto zënë vendin kryesor në klasë dhe e kalojnë në një plan të dytë punën me format gjuhësore” (Musai 2003: 93).

Lidhur me këtë, ndaj mendimin se lidhja e mësimi me gramatikën është e pashmangshme, por ajo duhet lehtësuar me shpjegime plotësuese dhe me shembuj të ndryshëm konkret.

Mësimi i gjuhës angleze në arsimin e lartë, jash-të Katedrës së gjuhës dhe të letërsisë angleze, bëhet në atë mënyrë, që studenti anglishten ta mësojë dhe përforcojë përmes plan programit të caktuar dhe të njihet me terminologjinë e duhur profesionale, të arsimohet dhe të pajiset me njohuritë e duhura, të nevojshme dhe shumë të domosdoshme të fushës, të cilën e studion. Duhet bërë përpjekje që mësimdhënia të mbështetet në tema aktuale mësimore, të cilat janë në hap me kohën, për t’i pasuruar dhe për t’i përmirësuar aftësitë gjuhësore të studentëve, duke përdorur tekste dhe mjete të dobishme për mësim, diskutime, debate profesionale etj.

Kronologjikisht, mësimi dhe përvetësimi i anglishtes nuk është fenomen i ri, por me të madhe është shfaqur me epokën e globalizimit, nevojë e cila ka rrjedhur me kohën. Është edhe imperativ kohor kur dihet se pjesa më e madhe e literaturës së të gjitha fushave të studimit është në gjuhën angleze, përparësi kjo e madhe për ata që janë njohës të kësaj gjuhe të folur dhe të shkruar në pjesën më të madhe të rruzullit tokësor.

Megjithatë, sa i përket mësimdhënies së gjuhës angleze pedagogët duhet ta kenë parasysh nivelin e njohjes së gjuhës angleze të studentëve dhe do

të duhej ndihmuar ata përmes metodave të ndryshme mësimore dhe tipave të orëve të mësimi.

Puna me grupe të ndara është një nga mënyrat më të mira për të siguruar pjesëmarrje më të madhe dhe më të rregullt në diskutime dhe debate për të arritur qëllimin e caktuar, gjithnjë duke u mbështetur në njohuritë paraprake të studentit, me synimin e vetëm për të vazhduar me përpjekjet e duhura, motivimin, inkurajimin dhe nxitjen e tij, që studenti t’i vijojë mësimet, të mësojë përmes ushtrimeve dhe të përvetësojë materien profesionale, e cila do t’i shërbejë në të ardhmen pas përfundimit të studimeve në profesionin e tij të zgjedhur. Këto janë procese përbërëse thelbësore në mësimdhënie dhe disiplinë bazë e të nxëniti të vetëdijshëm. Përfitimet nga përcjellja e mësimi të gjuhës angleze dhe e komunikimeve përbrenda orëve mësimore janë të shumta dhe frytdhënëse, gjë që shërbejnë për t’i aftësuar studentët të përdorin literaturën e shkruar dhe të ndihmohen përmes saj për t’i zhvilluar kapacitetet profesionale dhe intelektuale të tyre.

E domosdoshme është edhe dhënia e sqarimeve dhe e instruksioneve të posaçme nga drejtuesi i orës së mësimi.

### **Përfundim**

Tipat e orëve të mësimi dhe metodat e ndryshme të mësimdhënies mbështeten nga mënyra e zbatimit të tyre nga ana e mësimdhënësit në mësimin e gjuhës angleze, duke u bazuar në krahasimin e përvojave të ndryshme konkrete. Qëllimi kryesor është aplikimi i metodave tradicionale i ditëve të sotme dhe zhvillimi profesional i mësimi të gjuhës së huaj përgjithësisht. Edhe pse teorinë e përvetësimit të gjuhës së huaj janë të ndryshme, mund të vijmë në përfundim se ato kanë të njëjtin qëllim, të përvetësuarit e gjuhës së dytë.

Faktorët të cilët ndikojnë në të mësuarit e gjuhës angleze janë të shumtë. Ata burojnë nga njohuritë e përgjithshme të nxënësve/studentëve, nga përgatitja shkollore paraprake, kultura kombëtare e tyre, shtjellimi i orëve mësimore, motivimi dhe metodat e mësimdhënies së arsimtarit, të cilat luajnë rol shumë të

rëndësishëm në mësimnxënie dhe në nxitjen e tyre për punë produktive dhe kërkimore të mëtejme

**BIBLIOGRAFIA:**

MUSAI, Bardhyl (2003), *Metodologji e mësimdhënies*, Tiranë.

PENDAX, Michele (2004), *Veprimtaritë e të mësuarit në orën e gjuhës së huaj*, përkthyer nga Severina Pasho, UEJL, Logos – A. Shkup.

HAYES, A. S. (1968), *Language Laboratory Facilities*, Oxford University Press, London.

HUTCHINSON, T. & TORRES, E. (1994), "The Textbook as Agent of Change": *ELT Journal*, Vol. 48/4.

RICHARDS, J.C. & ROGERS, T.S. (1986), *Approaches and Methods in Language Teaching: A description and Analyses*, Cambridge University Press.

MORGAN, Carol & NEIL, Peter (2001), *Teaching Modern Foreign Languages, A Handbook for teachers*, British Library Cambridge in Publication Data.

---

## LULJETA LLESHANAKU'S DEVELOPING POETICS POETIKA NE ZHVILLIM E LULJETA LLESHANAKUT

ENTON BIDO

Biblioteka Publike, Durres, Shqiperi

Email: bidoenton@yahoo.fr

### PERMBLEDHJE

Analizimi i tekstit të Lleshanakut "Pothuajse dje". Mëtojmë ta përjasë këtë poezi me prurjen e deritashme të poetes; të cilësorë të përbashkëtat themelore, që përbëjnë boshtin e poetikës, strukturën e mëvetësishme të vargut dhe filozofinë e mendimit poetik. Përqëndrimi në hulumtimin e tekstit për të ndriçuar risitë që vijnë me ndryshime, të cilat, sipas nesh, përbëjnë një pasurim të stilistikës, figurshmërisë, veçanërisht metaforës dhe gjuhës. Sidomos te e dyta, ka ndryshime në rrafshin sintaksor. Hetohen ndikime nga poezia e sotme postmoderniste, veçmas amerikane, sidomos në vargëzim. Arrihet në vlerësimin se, ndoshta kemi të bëjmë me fillimin e një etape të re në veprën e autores. Kjo ka të bëjë me përpjekjen për pasurim të poetikës dhe shmangien përsëritjeve. Poetika te "Pothuajse dje" ka ndryshime në raport me pararendësit prej shtimit të narracionit poetik, zgjatjes dhe herë-herë ndryshimit strukturor të vargut dhe dendësimit të figuracionit.

**Fjalët-çelës:** poetikë, narracion poetik, metaforë, postmodernizëm, sintaksë poetike

### SUMMARY

Analysis of text, "Almost yesterday" - L.Lleshanaku. The paper aims to compare this volume with the current literary product; to qualify basic common points, which constitute the axle of originality, independent verse structure and impersonal philosophy.

Focus in research to illuminate the poetic's innovations some significant changes, which, constitute an enrichment writing style, figures of speech, especially metaphor and language. Especially, there are differences in syntax level. Investigated any impact from today's postmodern American poetry, especially in the versification.

Achieved in the assessment that, we have the beginning of a new era in the poetic. This concerns mainly with trying to poetry enrichment to avoid the repetitions.

Completion of the poetic text changes in relation to the predecessor. This as a result of increasement of the poetic narrative, and extending structure string change and densification literary figure.

**Key words:** poetics, poetic narrativity, metaphor, postmodernism, poetic synthacs.

---

### INTRODUCTION

Well-known poet Luljeta Lleshanaku is the author of seven books of poetry in Albanian beginning with "The Somnambulist's Eyes" (1994) and up to her most recent title "Almost Yesterday" (2012). Her poetry has been translated in five other languages (a total of six poetry collections): English (with editions in the US and the UK), Italian, German, Polish, and Slovenian. She is also the recipient of several important international prizës

### MATERIALS AND THE METHODS

Figures of speech

In this particular book there is a further sophistication on her part regarding her use of metaphors and similes (we should bear in mind that there is a long time in between this volume of poetry and her previous collection "Children of Nature" in 2006).

*Their backs a single starless fabric  
like fishing nights,  
or like a low cloud of gunpowder  
at a temporary ceasefire zone.*



Nocturne fishing<sup>1</sup>

She often opts for free associations of ideas that surprise in being placed side by side and with their imaginative play, as is the case with her last book too:

*The rest  
simply memorized a new flavor of death  
on their tongues and palates without swallowing  
like a winetaster his drink.  
People may tolerate everything<sup>2</sup>*

Example of metaphors:

*But the loops that circle words are isobars;  
one needs to have reached rock-bottom to  
understand these.*

Used books.<sup>3</sup>

With this book the poetess has entered a new stage of her writing and of her poetic work. Her thematic and poetic geography has been enhanced and she now adds to her previous poetic topoi new ones from overseas. For instance, in the poem "World Which Was Denied to Me"<sup>4</sup> – the lyrical "I" keeps notes of his travels around the world, and more specifically his trip to Vienna.

Fearing repetitions, a common feeling this one among many talented writers, has caused her to be cautious, to process and to plan her poetic matter well before presenting it for publication and then offering it to the readers and to literary public opinion.

**LITERARY RECEPTION**

Lleshanaku writes for two audiences at once: the Albanian-speaking public and the foreign one. Naturally, there is a difference between these two kinds of readers in both their expectations and their reception of her work. The poetess illustrated this difference well when, in an interview taken after a bookfair in Leipzig, she stated that her Western readers are still looking for the drama of Communism in her verse.

The same holds true with the critical reception of Lleshanaku's poetry and the respective studies on it. Foreign critics relate differently to her verse

than their Albanian counterparts. Eliot Weinberger and Peter Constantine are among well-known foreign critics who have written on L. Lleshanaku's poetry; among the Albanian scholars we may mention Ramadan Musliu<sup>5</sup> and Shaban Sinani<sup>6</sup>. In foreign critical writings we notice their emphasis on political elements of her poetics, even though at times such references may be inexistent in her verse. This is in contradistinction to Albanian criticism which has observed the quiescence of the poetry at hand.

**POETICAL SYSTEM**

Her poetical system is closed and elitist. It belongs to a kind of singular poetics, in that it exhibits a closed poetics in terms of thematic codes and motivation. In distinction from a more pluralistic system, her poetic system is self-referential and communicates only minimal terms with other poetical systems such as those of L. Poradeci, Migjeni, Camaj, Zef Zorba etc. Her poetics bears very little, if any, resemblance to contemporary Albanian authors and even less so to past canonical ones. This brings to mind isolated cases of some of the above-mentioned authors whose poetic art has absorbed the past literary experience, and specifically the poetic heritage, to the point where it is very difficult, if impossible, to spot references from earlier poets of Albanian language. "Poetic nature is not seen in the choice, subject signals, but in particular nonpragmatic relation with the language" says Roman Jakobson.

The poem "Almost Yesterday"<sup>7</sup> is based on narrative verse, typically reminiscent of modernist and postmodernist poetry. Perhaps her preference for, and climatization with, the American world has created a link with contemporary American poets like John Ashberry and Charles Simic, to whom the poem "Conversation with Ch. Simic"<sup>8</sup> is dedicated .

The closing poem of this book, titled "Negative Spaces"<sup>9</sup> is probably the first in her entire poetical works where versification is in keeping with her typical vocabulary and in cohesion with her poetic "I", but where the philosophy of

demythologizing techniques applied make it untypical of her original style

## RESULTS AND DISCUSSIONS

Her poetic vocabulary has always included scientific terms like: electrolyze, ions, carbon, dyslexia, typical for modernism but rarely to be encountered in earlier Albanian poetry (with the exception of some rare poems like Kadare's "Poem Built with Concrete"<sup>10</sup>, etc.

The graphic form of many of her poems in this book is closer to prose, which is a characteristic of contemporary poetry.

In another book of essays, "From Tradition to Contemporaneity"<sup>11</sup>, we have discussed the book "Children of Nature" (2006) where we have observed the presence of some ordinary "characters" such as mother, father, neighbor, but also some characters from childhood like: ice cream seller or pie seller; and furthermore, the presence of real people who are borrowed from American areal whom her poetic "I" refers to often recently. More concretely, these references are taken from Charles Simic and Elizabeth Bishop as in the case of the poem "Used Books"<sup>12</sup>. Thus, through a gallery of characters her poetry gains a greater amplitude in the aesthetic plane, oscillating between the ordinary and the extraordinary, the simple and the sublime, the everyday and the eternal.

## CONCLUSIONS

In closing, we are of the opinion that this last poetry collection has set L. Lleshanaku's poetry to

a higher level. The originality of her poetic thought, the avant-garde stance of her poetics, the surprising variety of her tropes, excluding similes, make her one of the few exceptional Albanian poets who have an international recognition. It is now up to criticism to seek for new approaches and to perfect its methodology and instruments in order to raise its level to that of poetic art.

## BIBLIOGRAPHY

1. *Lleshanaku, L., (2009), Almost yesterday, Ombra GvG, Tirana; 46.*
2. *Idem, , 86.*
3. *Idem, , 69.*
4. *Idem, 79.*
5. *Musliu, R (2009): The dimensions of a poethic mytology, in Lleshanaku, L. Palca e verdhë. Rilindja, Prishtinë; 5-35.*
6. *Sinani, SH (2008): Albanian literature in the modern era, Perla 1, 50-72.*
7. *Lleshanaku, L., (2009), Almost yesterday, Ombra GvG, Tirana, 13.*
8. *idem, 51.*
9. *Idem, 88.*
10. *Kadare, I(1976), The Time. Naim Frashëri, Tirana, 46.*
11. *Bido, Enton (2012), Children of poetry, 60-62.*
12. *Idem, 69*

## GABIMI QË VJEN NGA RËNIA E CILËSISË SË INTERVISTIMIT THE ERRORS DUE TO QUALITY DECLINE OF THE INTERVIEWINGS

SANIELA XHAFERI, ALEKSANDËR KOCANI  
Department of Political Sciences, SSF at UT, ALBANIA  
alkocani@gmail.com

### Përmbledhje

Kur flitet për gabimin që bëhet gjatë kryerjes së anketimeve, zakonisht raportohet vetëm një lloj gabimi, ai më i thjeshti, më i identifikuari që lidhet me zëvendësimin e popullatës në studim me kampionimin. Një gabim i tillë përbën, si të thuash, "majën e ajsbergut" në tërësinë e gabimeve që kryhen gjatë një procesi anketimi. Gabim tjetër, por që nuk njihet, është ai që futet nga rënia e cilësisë së intervistimeve. Në këtë rast lodhja apo faktorë të tjerë psikologjikë shkaktojnë ndryshime në mënyrën se si bëhen pyetjet. Edhe në se këto ndryshime nuk do të jenë të ndjeshme, le të supozojmë se ato do të kenë të bëjnë vetëm me intonacionin, prapë se prapë efektet "në hyrje" do të amplifikohen "në dalje". Domethënë, ndryshimet e vogla në bërjen e pyetjes mund të perceptohen nga respondentët e ndryshëm si dëgjim i pyetjeve jo të njejta. Në këtë rast mund të parashikohet që përgjigjet ndaj tyre nuk do të jenë të njëjta. Në ekzistencën e supozuar të këtyre diferencave bazohet eksperimenti që kërkon të matë gabimin në fjalë.

**Fjalë çelës::** gabim i matjes, cilësi e intervistimit

### Abstract

When we talk about mistakes made during the conduct of surveys, usually is reported only one type of error, which is the simplest, and the most identifiable one. This is related with the replacement of the population under study with the sampling. Such an error constitutes, as it were, "the top of the iceberg" in the totality of the errors that are made during the survey process. Another mistake, but that is not recognized is one that enters by the decline of the quality of the interviews. In this case, fatigue or other psychological factors cause changes in how the questions become. Even if these changes will not be significant, let us suppose they will have to do only with intonation, nevertheless the effects in "entrance" will be amplified on "exit". I.e., the small changes in questioning can be perceived by different respondents as not hearing the same questions. In this case we can predict that their responses would not be the same. If it is assumed that here there is an error that is conditioned by the lowering of the quality of the interviews, then it is expected to find the difference in the value of aggregate statistical indicators of the responses given to the same questions asked at the end of the interviewing process versus those made at the beginning of this process. On the assuming existence of these differences is based the experiment that seeks to measure the error in question.

**Key words:** error, quality decline of the interviewings

---

From observations during different surveys conducted in the Department of Political Science at the UT's FSS in the period 2009 - 2013, it is noticed that in the survey the 3 - 4 first interviews are made with better quality than the 3 - 4 last interviews. In the latter case due to

declining quality of interviewings is introduced an additional error in relation to the first 3-4 interviews. Because no data on the books for research methods for the margins of such an error, it should be determined by building a procedure ad hoc to measure it.

For such measurement is need to define some aggregate indicators that allow to be represented the multiple responses that will be compared to the difference of values that comes only from interviews quality deterioration caused mainly by fatigue and psychological effect of monotony during the interview. Such indicators are, for example, indicators of descriptive statistics like the average, median, mode, standard deviation and variance. But it can also be used as aggregates other indicators, for example, that of "subjective wellbeing" created by R.Inglehart to measure the legitimacy that gives the electorate a political force.

For the measurement of the error produced by the decline of quality during interviews, specifically for it can be built the measurement procedures, with specific sampling and questionnaire construction. But this, though allows a easily workable process and without much trouble for the measuring the error in question, however is not necessary, or even advisable in view of the cost of the survey. Is more profitable to build a measurement process for something else and draw as a derivative product the data for the margin of error in the survey produced by the quality decline of the interviews. In this pragmatic line is built an ad hoc procedure for the measuring of the margin in question, focused to directly measure two other errors which are unstandardized in terms of their values margins. They are the measuring of the margin of the sampling error introduced with the quote at the end of the "chain" of the sample and of the one that introduces the non consideration of anonymity to respondents in surveys when survey questions may seem to them as delicate.

To measure the margin of error that is introduced by quota is used a questionnaire that was not perceived as having the delicate questions and is used in the street the sample by quote and in the same size in the family (in the same street) with a systematic sample of the type "by gate to gate ". As such questionnaire is used a type of

questionnaire that measures the value profile of the social actors. While for the measurement of the margin of error produced by the non considering the anonymity of respondents in conditions of a survey with questionnaire having questions that are perceived as delicate, is used a quota sampling on the road and in the same size in the family (in the same road) with the systematic sampling of type "from gate to gate". As such questionnaire was used a questionnaire to measure the type of voting behavior of social actors.

From databases generated by these two surveys, are created four smaller bases, where are included the answers to 3 questions first and last 3 questions for the cases of survey in the road and the family to measure the margin of error that introduces quotas and those introduced by the non consideration of the anonymity. This is done to avoid from the differences calculated the specific error that is inserted namely by the quota and by the non considering of the anonymity of respondents in surveys where the questionnaires used are perceived as delicate questions by them. Staying or within the family or within the road, the differences between the three last responses and those three first ones cause the elimination of the specific error (by quotas or non anonymity), because in each answers it is the same as for the first three questions, as well as for the last ones.

Each of these bases is regulated for to be called by a program called SPSS and further are calculated separately 5 statistical indicators of the descriptive presentation: ie, the Mean, the median, the mode, the standard deviation and the variance for the answers to the first three questions and the answers of the last three questions. If the answer to a question has lack in values (missing values), can be replaced its response with them of another question that is close to it. Their tables are placed one below the other in order to compare the respective values of the indicators and to calculate the differences between them.

If there are relatively large difference, coming mainly from the lack of one of value, these differences can be considered as deviation and they can not be taken into consideration. Thus if one of the values for the digits 99 or 88 (respectively denoting neutral answers "No answer" and "do not know"), and the corresponding value in the other table is small (less than 10) or absent, then significant difference emerges artificially big and represents a deviation from other distribution of differences. For this reason it is best to not consider it.

With margins are created the series of margins with the minimum and maximum value and, or are taken the smaller values minimum and the larger maximum ones to create the final margin, or deal averages of the minimum and maximum values to create the final margin.

From the survey data in the road with the quota sampling we have as difference of two indicators ("mean" and "mode") between 3 first answers and 3 last responses, respectively the margins [-**3.42**, **+8.18**] and [-**4**, **+4**]. But for the indicator "median" have margin of error [**+1**, **+8**].

From the survey data on families with systematic sampling we have as differences of the three indicators (the "mean", the "median" and the "mode") between 3 first answers and 3 last responses, respectively the margins: [-**3.3**, **+3.68**], [**+1**, **+7**] and [**+1**, **+7**].

So for each indicator we can determine as the margin of error that introduces the decreasing of quality the ones as following.

For the "mean" we have as the lower minimum limit **-3.42%** and as the upper maximum limit of **+8.18%**. The margin of error is: [-**3.42%**, **+18.8%**].

For the "median" we have as the lower minimum limit **-4%** and as the upper maximum limit of **+7%**. The margin of error is: [-**4%**, **+7%**].

For the "mode" we have as the lower minimum limit **+1%** and the as the upper maximum limit of **+8%**. The margin of error emerges [**+1%**, **+8%**].

By comparing these three margins, it appears that the margin that includes all of them and which represents the measurement error introduced by the quality decline of the interviewing, will be: [-**4%**, **+8%**].

### Bibliography

1. Popper K.R., (1982) *La logique de la découverte scientifique*, Payot, Paris.
2. Feraj H., Kocani A., (2013) *Anonymous or Confidentiality in Opinion Survey?(The Selective Approach for Sampling in Surveys ëhere are Included Delicate Questions)*, Mediterranean Journal of Social Sciences, Vol 4 N. 2, May 2013, ISSN 2039-9340.
3. Feraj H., (2004) *Hyrje në shkenca politike*: Tiranë, Pegi.
4. Kocani A., (2010) *Një qasje metodologjike: gabimi në matje në anketim kur nuk merret në konsideratë ndryshimi i mjedisit socio-politik (rasti i sondazheve Zogby në Shqipëri)*, AKTET Revistë shkencore e Institutit Alb-Shkenca, Vëll.III, Nr.4, ISSN 2073-2244.
5. Kocani A., (2011) *Përcaktimi i marzhit të gabimit që fut kuota në hallkën e fundit të kampionimit të një anketimi kundrejt kampionimit sistematik*, AKTET Revistë shkencore e Institutit Alb-Shkenca, Vëll.IV, Nr.4, ISSN 2073-2244.
6. Kocani A., (2006) *Metodat e kërkimit sociologjik*: Tiranë, UFO .

**NARRATIVE CONFIGURATIONS IN NOVEL *GREAT IS THE CALAMITY OF SIN* WRITTEN BY  
MITRUSH KUTELI  
KONFIGURIME NARRATIVE NË NOVELËN *E MADHE ËSHTË GJËMA E MËKATIT* NGA  
MITRUSH KUTELI**

JORINA KRYEZIU

Qendra e Botimeve Zyrtare, Tiranë, SHQIPËRI

Email: jorina.kryeziu@gmail.com

**Përmbledhje**

Në artikullin me titull Konfigurime narrative në novelën *E madhe është gjëma e mëkatit* rrëfenja *E madhe është gjëma e mëkatit* analizohet nga pikëpamja narrative, duke evidentuar përbërësit narrativë. Do të përqendrohemi te roli i autorit, si ndërmjetësues midis narratorit dhe lexuesit. Ndërhyrjet e shpeshta të Kutelit në rrëfim, kur i drejtohet lexuesit, bëjnë që në prozën e tij të realizohet procesi i kalimit të gjuhës së folur në atë të shkruar. Kjo kupton se proza e Kutelit synon ta mistifikojë raportin shkrimtar-lexues, në një raport tjetër më imediat, mes rrëfimtari dhe lexuesit. Kuteli herë delegon një personazh që të rrëfejë rrëfimin për ngjarjen, e herë këtë rrëfim ai e kryen vetë, duke bërë që në rrëfenjën e tij të kalohet nga rrëfimtari i jashtëm në atë të brendshëm. Gjithashtu, do të analizohen shtresat kuptimore, tipat e episodeve, izotopitë, elementet fantastike etj.

**Fjalët çelës:** rrëfenjë, rrëfim, izotopi, kronotopos, anakroni, prolepsë, analepsë

**Summary**

In the article entitled Narrative configurations of the novel *Great is the Calamity of Sin* will be analyzed the tale *Great is the Calamity of Sin*, including almost all the narrative ingredients. We will focus on the role of the author, who takes an intermediary role between the narrator and the reader. Kuteli's frequent interventions in the tale, addressing to the reader, do that his prose accomplishes the transition process of spoken language to the written one. This means that Kuteli's prose tends to mystify the relation writer-reader, in another report with the media between the narrator and the reader. Kuteli sometimes delegates a character to tell the story about the event, and sometimes does it himself, in this way his story passes from the external narrator to the internal one. Also, it will analyze the types of episodes, isotopes (terrestrial and celestial), fantastic elements, concept of cronotopos etc.

**Key words:** Tale, narrative, isotope, chronotope, anachronism, ellipse, prolepsis, analepsis

---

**HYRJE**

Zanafilla rrëfimore fillon me përcaktimin “Rrëfime nga liqeri i kaltër”, *E madhe është gjëma e mëkatit*, legjendë. Historia e rrëfyer huazohet nga legjenda, prej botës virtuale – ndikimi i Kutelit nga letërsia popullore. Kuteli pohon se rrëfimet e tij janë kryesisht reflektim i tregimeve të pleqve dhe jo reflektim i ndonjë letërsie të shkruar. Kumti i përcillet drejtpërdrejt lexuesit, duke ruajtur besnikërinë e rrëfimit: *Ne po e shkruajmë*

*në kartë ashtu si e kemi dëgjuar* <sup>[1]</sup>. Nga pikëpamja e gjenezës, Mitrush Kuteli deklaroi se prozat e tij janë të dëgjuara. Për këtë novelë, autori shënon se vepra është punuar pas dy legjendash të dëgjuara në Pogradec. Veprat e veta, Kuteli i quan *rrëfime ose rrëfenja*, ngaqë ato mbështeten në një tregim jetësor ose në një rrëfim gojor.

Në novelë misionin e të rrëfyerit të ngjarjeve e ndërmerr autori, i cili është i vetëshprehur, me

aftësi për të komentuar e gjykuar atë çka rrëfen. Ai e parapërgatit lexuesin për ngjarjet që do të ndodhin. Gjenezja e rrëfimit nis me evidentimin e mëkatit njerëzor dhe me mëshirën e Perëndisë.

### Perspektiva në rrëfim

Prespektiva në rrëfim është e autorit-rrëfimtari. Prespektivë të cilën shpeshherë Kuteli ia ‘imponon’ edhe lexuesit (lëçitësit). Ndërhyrjet e shpeshta të autorit në rrëfim, kur i drejtohet lexuesit, bëjnë që në prozën e tij të realizohet procesi i kalimit të gjuhës së folur në atë të shkruar. Ndërhyrjet kur i drejtohet lexuesit, zakonisht janë të karakterit paralajmërues, por me simbolikë të fortë, në një vend ku është mëkatuar fort nuk kishte sesi mos e shembnin tërmetet apo dhe luftërat (*Paralajmërojmë lëçitësit të mos e kërkojnë këtë katund të lashtë në vëndin ku pat qënë kllhisur sepse e kanë shembur tërmetet e luftrat dhe vëndin sot e mbulon një pyll i dendur*. f. 13), duke u futur në dëshirat ose mosdëshirat, pranimet ose mospranimet e lexuesit (*Lëçitësit mundet të mos i pëlqejnë një gjëmë e tillë po neve preps ta themi si pat qënë, pa shtuar e pakësuar gjë*. f. 16) ose përdorimi i thirrorit “o” për të përforcuar thirrjen kur i drejtohet lexuesit (*o lëçitës*).

Ndërhyrjet e autorit-narratorit nënkuptojnë se rrëfenja e Kutelit synon ta mistifikojë raportin shkrimtar – lexues, në një raport më imediat mes rrëfimtari dhe lexuesit. Sipas studiuesit Sabri Hamiti, Kuteli nuk rrëfen ngjarjen, por rrëfimin për ngjarjen. Autori merr një rol të ndërmjetëm midis narratorit dhe lexuesit.

Rrëfimi i autorit në këtë novelë bën që të trajtohen të gjitha mënyrat rrëfimtare: Kuteli herë delegon një personazh që të rrëfejë rrëfimin për ngjarjen – rasti kur Tanushi ia rrëfen historinë e tij Imzot Nikanorit; e herë rrëfen autori. Në të dyja rastet perspektiva (këndvështrimi) mbetet e rrëfimtari. Shkrimtari e nxit lexuesin që të ndjekë me vëmendje rrjedhën rrëfimore. Rrëfimi është objektiv, realizohet në vetën e tretë, autori-narrator nxjerr në plan të parë përjetimet e personazheve.

Në prozën e Kutelit hasen elemente të oralitetit, të cilat autori i përdor në letërsinë e shkruar, duke iu referuar rrëfimtarisë, prania e

këtyre elementeve lidhet me përpjekjen e autorit për t’iu përmbajtur mënyrës tradicionale të të treguarit – të rrëfejë gjithçka, ashtu siç e ka dëgjuar prej gojëve të të tjerëve. Kjo teknikë realizohet për të shkurtuar diferencën që ekziston mes autorit dhe lexuesit. Te Kuteli janë shumë të pranishme elementet e oralitetit, ndikuar prej formimit të tij me baza në krijimtarinë popullore.

### Mëkati e “mëkatari” – rrëfimi bibliik e referencat biblike

Në novelën *E madhe është gjëma e mëkatit*, rrëfohen në mënyrë të njëpasnjëshme të gjitha mëkatet që kryen protagonistin, prifti Tat Tanush i Bubutimës. Një nga karakteristikat kryesore në prozën e Kutelit është thellimi në botën shpirtërore të personazhit, pikërisht atje ku formohet dashuria njerëzore dhe adhurimi hyjnor. Dashuria njerëzore e tejkalon dashurinë hyjnore e kjo është zanafilla mëkatore e personazhit.

Në të gjithë novelën rrëfohen **mëkatet e njëpasnjëshme të Tat Tanushit**:

– Tanushi, ose Urata, siç quhet shpesh prej rrëfimtari, nuk ishte një mëkatari i zakonshëm, por ishte një mëkatari që gëzonte hirin e priftërisë.

– Dashuria që ndiente për të shoqen i shembi dashurinë ndaj Perëndisë: Ai i thotë Noemit se do t’i thotë një të vërtetë të vulosur në shumë vula<sup>[2]</sup>:

– *Dua të them, Noemi, se të dua kaq shumë /... – /.../ dhe s’ka tjetër gjë, as në dhe, as në qjell, as ujra që ta dua sa ty*<sup>[3]</sup>

Noemin, të cilën e kishte pagëzuar me emrin Kalie, e kishte marrë nga Lindja, nga Galilea e Judesë. Ajo pat lënë fenë e prindërve, prindërit dhe vendin për dashurinë e Tat Tanushit.

– Kur Tata sheh në ëndërr Kalien e vdekur. Në kishë kishte ardhur Krishti për ta bekuar. Tanushi ndjen dy emocione të kundërta: *hidhërim*, se shikon gruan e tij të vdekur; *gëzim* se shikon Krishtin (kontrast). Tata i hidhëruar prej ëndrës që paralajmëron realitetin zemërohet me Perëndinë. Kjo ëndërr shërben si paralajmëruese (analepsë) e ngjarjeve që do të vijojnë: vërteton fatin e Kalies, e cila vdes, si dhe fatin e Tanushit, i shembur në greminë me eshtra të vdekurish në kra-

hët e tij.

– Tata gdhendte në dru dhe bënte kora me fytyra shenjtoreësh, profetësh e, më vonë, me fytyrën e Kalies, së shoqes së vdekur. Kalia e paralajmëronte se është shkruar se nuk duhet të bëjë të gdhendura që i ngjasojnë Zotit dhe njerëzve.

– Komunikimi me Kalien e vdekur; dëshira që të kishte vdekur ai e jo Kalia; dëshira për t'i hapur varrin – këto mjaftonin që t'i shënoheshin si mëkate në Librin e jetës.

– Tat Tanushi kreu mëkatin e madh të mishit, brenda në shtëpinë e tij, e madje përpara korave dhe të gdhendurave me fytyrën e Kalies. Tata tundohet nga një grua e qytetit që kishte ardhur të blinde kora, por në të vërtetë ishte djalli. Sipas narratorit *djali kish marrë asohere fytyrë e shtat gruaja*, pra kemi referencat e pastra nga Bibla, ku djalli u fut te Juda për të tradhtuar Krishtin<sup>[4]</sup>.

Çmimi që la gruaja (djalli) për korat ishte *tridhjetë copa argjendi*, ashtu sikurse edhe Juda me tridhjetë sikla argjendi<sup>[5]</sup>. Narratori vazhdon me paralelizmat mes kësaj novele dhe shkrimeve biblike: *Tat Tanushi u mendua të ndjekë rrugën e Judhës Iskariotit, dyke u varur në degën e një peme*. Pra, pasi kupton rëndesën e mëkatis që ka kryer, Tata hedh tridhjetë copat e argjendit, pasi ishin çmimi i humbjes së tij dhe kërkon të vetëvritet ashtu si dhe Juda<sup>[6]</sup>.

– Pas mëkatis të mishit Tata nuk duhej të ishte futur në kishë e të meshonte, një tjetër mëkat prej Tanushit, ndërkohë që ai duhej të pastrohej me rrëfim, agjërim e pendim të vërtetë. Mëkati i Tatës mbetet njerëzor, ligji i hirit të priftërisë nuk i lejonte atij që të merrte grua tjetër, e ai filloi të dashurojë qengjat e kopesë (totemi).

– Këndimit të këngëve të Solomonit u jepte kuptimin e mishit, e jo të frymës.

– Shfaqja si jomëkatar përpara Zotit – mospërparimi i mëkateve: *Nuk jam mëkatar!*

– Përmendja e Zotit vetëm me fjalë, por zemra i mbante mëri.

Në novelë, veç mëkateve të tjera të kryera prej Tat Tanushit, tri konsiderohen si mëkatet më të mëdha (trinia) të tij, para se të dënohej prej Perëndisë me pavdekësi:

1. Dashuria njerëzore mbi dashurinë hyjnore;

2. Zemërimi që pati ndaj Perëndisë për vdekjen e Kalies, duke kundërshtuar vullnetin e Zotit;

3. Mëkati i mishit – dëshirat, tundimet e mospërmbajtja ndaj mishit Tatës i shkruhen si mëkate të rënda, kjo ishte shembja e tij më e madhe.

Protagonisti dënohet me pavdekësi, por përsëri tek ai lind shpresa për falje. Tat Tanushi shkeli dy urdhërime:

– Besimin se nuk ishte mëkatar para Perëndisë, pasi ai ende e gëzonte hirin e priftërisë.

– Gazi i dytë i uratës ishte Kalia – tejkalimi i dashurisë njerëzore para asaj hyjnore.

Mëkatet e Tat Tanushit rëndohen kur shemb këto dy urdhërime. Personazhi është mëkatar përpara Perëndisë, por fjalët e Perëndisë janë: *...e urrej mëkatin, por jo mëkatarin*.

Falja e Tatës prej Perëndisë ndodh atëherë kur ai pendohet për mëkatet e kryera dhe ndjen me zemër dashurinë hyjnore – në çastin kur rrëfëhet para Imzot Nikanorit. Ai e dëshironte *kátharsin e madh*, pastrimin e shpirtit të tij prej mëkateve, duke iu lutur Zotit jo më me fjalë, por në heshtje e me zemër. Dëshira e tij e vetme tashmë ishte vdekja. Novela përmbillet me pendesë, faljen e mëkateve nga Perëndia, me vdekje dhe adhurimin e Perëndisë. Në fund, të njëmbëdhjetë së bashku me Timzot (duke plotësuar numrin 12 - apostujt) hyjnuan e lavdëruan Zotin.

### Funksioni i izotopive në rrëfimin kutelian

Sipas Greimasit<sup>[7]</sup>, izotopia përbën një grup kategorish semantike të tepërta, nëpërmjet të cilave bëhet i mundur leximi i një historie. Ajo mund të merret si një karakteristikë e brendshme e tekstit narrativ, kompetencë të cilën lexuesi duhet ta njohë mirë. Në rrëfenjën e Kutelit izotopitë kanë funksion të dyfishtë dhe sigurojnë vazhdimësinë e tekstit në nivelin semantik. Tek *E madhe është gjëma e mëkatis* ndërveprojnë dy izotopi:

(a) *izotopia tokësore* (njerëzit – mëkatarët); dhe

(b) *izotopia qiellore* (perëndia – falësja e mëkateve).

Bashkëprania e izotopive mundëson raportin



brendatekstor mes personazhit (mëkatarit) dhe Perëndisë (faljes hyjnore); raport, i cili është në marrëdhënie kundërshtie mes reales (njëmendësisë) dhe ideale.



**Figura 1.** Izotopitë e rrëfenjës

Autori i bashkon këto izotopi në çastin kur Tat Tanushi bisedon me zërin e panjohur. Loja ligjërimore **áksios–anáksios** (a jam i drejtë - nuk je i drejtë) lexsema që përsëriten tri herë (trinia), sjell dënimin e Tatës nga Perëndia me pavdekësi – shkrija dhe rrafshit tokësor e rrafshit kozmik (qiellor). Dënim të cilin mund ta përkthejmë edhe si dënim për të mos u bashkuar me Kalien në botën e përtejme.

### Shtresat kuptimore - tipat e episodeve

Sipas Ivor Armstrong Richards<sup>[8]</sup>, interpretuesit e letërsisë duhet të jenë në gjendje të depërtojnë në mendimet e autorit, prandaj, lexuesi duhet t'i bazojë interpretimet në një lexim të kujdesshëm, në hulumtime dhe në analiza. Sipas tij, për të kuptuar më mirë një vepër letrare janë të dobishme të kuptuarit e jetës së shkrimtarit, besimi dhe periudha kur u shkrua vepra. Në rastin e novelës *E madhe është gjëma e mëkatit*, të dhënat që Richards-i i quan të rëndësishme, na kanë ndihmuar në analizimin dhe në interpretimin e elementeve të novelës, sidomos ato që lidhen me formimin e Kutelit si shkrimtar.

Novela përbëhet nga tri shtresa kuptimore:

(a) *Së pari*, përshkruhet deri në dhembshuri dashuria njerëzore, e krahasuara me *Këngët e këngëve* të Solomonit (Libri biblik nr. 22; viti 1020 p.e.s.). Kjo është pjesa e fuqisë së jetës njerëzore.

(b) *Së dyti*, novela ndërtohet nëpërmjet shkrimeve të shenjta biblike dhe ka domethënie

morale – rrëfimi ka karakter teologjik, pas besnikërisë në rrëfim thuhet “Amin!”.

(c) *Së treti*, rrëfenja ka kuptim simbolik e filozofik – kërkohet shpëtimi i shpirtit të njeriut, si dhe është e shtresëzuar me simbole biblike e sensuale. Një kuptim filozofik i kësaj novele do të përbënte edhe përcaktimi i trupit si burg për shpirtin (*Kaqe fli i kish bërë ay trupit të gatuar me baltë*<sup>[9]</sup> që është burgu i shpirtit. f. 15), përcaktimi filozofik për trupin sipas orfikëve.

Kuteli paraqet gjendjen psikologjike dhe vuajtjet e brendshme të personazhit; trajton temën e dashurisë ndaj gruas, Biblës (Ungjillit) dhe Perëndisë. Trajtohet tema e dashurisë së dy të rinjve me kombësi të ndryshme, motiv të cilin do ta rimarrë më vonë Petro Marko në romanet e tij.

Novela *E madhe është gjëma e mëkatit* nuk vjen te lexuesit si një episod i vetëm, i njëtrajtshtëm, por në të kemi ndodhjen e një fatkeqësie natyrore, që përbën shkakun fillestar të zemërimit të Tanushit me Perëndinë. Në novelë hasim dy tipa episodesh:

i) kur ngjarjet japin kalimin nga një gjendje në një tjetër, nga lumturia në hidhërim: dashuria – vdekja;

ii) kur ngjarjet përshkruhen si të pandryshueshme – nga çasti kur Tanushi dënohet me pavdekësi deri kur falet nga Perëndia.

Rrëfenjat e Kutelit, nuk lidhen thjesht me të kaluarën, por janë ndodhi ose dukuri njerëzore të jetuara.

### Marrëdhëniet kohore në rrëfim

Problemi i kohës te Kuteli duhet analizuar në dy aspekte:

(a) *Së pari*, koha si konvencion artistik kontekstual – koha e rrëfimit të ngjarjeve është e përcaktuar, si element stilistik. Kjo dukuri është quajtur nga studiuesit e Kutelit, si *distancim kohor*. Ndërmjet kohës së shkruar, kur zakonisht rrjedhin subjektet e rrëfyera, dhe kohës aktuale, në të cilën zakonisht pozicionohet rrëfimtari, ka gjithmonë një distancë kohore.

(b) *Së dyti*, ngjarjet zhvillohen në një mjedis të përcaktuar fizik, në fshatin Bubutimë.

Rendi kohor në rrëfenjë është tepër i thyeshëm – **rend anakronik**, lidhet me mënyrën se si janë renditur ngjarjet në rrëfim.

**Tabela 1.** Rendi anakronik i novelës

<b>ELIPSA</b> heqja e një gjymtyre kohore	Me anë të elipsit, Kuteli kalon me një fjali disa shekuj. <i>Dhe vjetët u mblodhë u bënë shekuj.</i> (f. 41)
<b>PROLEPSA</b> kur ngjarjet paralajmërohen	Kur Tanushi sheh në ëndërr Kalien të vdekur. Ëndrra bëhet paralajmëruese e ngjarjeve që do të ndodhin. (f. 25)
<b>ANALEPSA</b> kur ngjarjet ritregohen	Kur Tat Tanushi ia tregon historinë e tij Imzot Nikanorit. (pjesa III, f. 59-62)
<b>KATAKRONIA</b> të ndiesh se koha po të ikën	Kur Kalia sëmuret ndien peshën e vdekjes. (f. 27)
<b>EPIKRONIA</b> të jesh mbi kohë	Kur Tata dënohet nga Perëndia me pavdekësi. Ai është zot i kohës. (f. 38-39)
<b>METAKRONIA</b> të jesh përpara kohës	Element i përdorur në letërsinë profetike. Kur gjithçka kthehet si më parë, përveç argjendit (referencat biblike). (f. 39-40)

Raporti kohë-hapësirë (*kronotoposi*) është pothuajse ireal, e deri diku fantastik (përrallor), pasi tiparet që karakterizojnë personazhin kalojnë përtej kufijve të njëmendësisë, drejt legjendës, mitit e përrallës. Trajtimin e marrëdhënieve kohore, autori e ka huazuar nga përrallat. Është autori ai që vendos marrëdhëniet mes kohës dhe hapësirës. Te Kuteli jepet shkrimi e kufijve kohorë dhe hapësinorë gjatë veprimit dramatik. Përdorimi i së shkuarës, që është karakteristikë për rrëfimin kutelian, paraqitet për të krijuar idenë e tejkohësisë.

Për sa i përket rrafshit gramatikor e atij se-

mantik mund të themi se përveç dialektit pogradecar, hasim një gjuhë arkaike me përdorime të gjuhës së shenjtë biblike, si dhe ndikimin e shkrimeve sensuale të Solomonit – në subjektin e novelës kemi vargje të shkëputura nga libri *Këngët e këngëve* (mbitekstorësia me shkrimet e shenjta biblike).

#### Konkluzione

Kuteli i përdor të gjitha teknikat e të rrëfyerit, të cilat janë: përshkrimi, portreti, dialogu, monologu, peizazhi, ligjërata e zhdrejtë e lirë, analiza e thellë psikologjike e personazhit etj. Tek *E madhe është gjëma e mëkatit* kemi një rrëfimtar-autor, i cili krijon marrëdhënie mes lexuesit dhe narratorit. Personazhet e Kutelit kanë konflikt të brendshëm, i cili në fillim jepet si parandjenjë, e më pas tensionohet e shpërthen, në saje të situatave që i vendos paracaktimi hyjnor. Ata nuk thyhen si tipa, duke shfaqur kështu thelbin dramatik e tragjik të tyre.

Kuteli e sheh dashurinë si forcë jetësore. Po aq të shenjtë ai e sheh dashurinë hyjnore, e cila të çon në lumturi shpirtërore. Ideja kryesore në novelë është fuqia e dashurisë njerëzore. Ajo është një formë e përsosur e përshkrimit shpirtëror.

#### Referencat

- [1] [3] KUTELI, Mitrush (2001). *E madhe është gjëma e mëkatit*. Tiranë. Botimet Kuteli '04, f. 12, f. 21
- [2] BIBËL. ZBULESA. 5:1
- [4] BIBËL. LUKA, 22:3
- [5] BIBËL. MATEU. 26:14,15
- [6] BIBËL. MATEU. 27:5
- [7] NÖth, Winfried (1990). *Handbook of Semiotics*. Bloomington. Indiana University Press, p. 319
- [8] RICHARDS, I. A. (2001). *The Principles of Literary Criticism*. London, Routledge, p. 282
- [9] Në Biblël thuhet se Zoti e krijoi njeriun e parë nga balta.

---

## ÇËSHËTJE TË TERMINOLOGJISË SHQIPE NË FUSHË TË SHKENCËS LETRARE ISSUES OF TERMINOLOGY IN THE FIELD OF LITERARY SCIENCE IN ALBANIAN

KRISTAQ JORGO

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Letërsisë

kristjorgo@yahoo.com

### Përmbledhje

Identifikimi i një objekti të ri të njohjes shkencore, njëherësh e më tej i një fushe të re të hulumtimit shkencor, implikon për studiuesin në mënyrë të natyrshme përqendrimin më maksimal të mundshëm në çështjet praktike, por dhe në ato teorike të terminologjisë, aq sa mund të flitej për një proces të mirëfilltë bashkëkrijimi ndërveprues të të dyja instancave. Kumtesa synon të ndriçojë disa aspekte të procesit në fjalë, mbështetur në përvojën vetjake rreth fenomenit të “kuantifikimit harmonik të tekstit letrar” e të ‘kuantematikës’ si disiplinë që do të kishte objekt studimin e përqendruar të këtij fenomeni. Bëhet fjalë, në thelb, për funksionin e kuantitetit e të raporteve kuantitative në tekstin letrar, gjegjësisht të marrëdhënieve të matematikës me estetikën, shkencën e letërsisë e shkencat e ligjërimit në përgjithësi.

**Fjalë kyçe:** terminologji, njohuri e re shkencore, bashkëkrijim, kuantematikë

### Abstract

The identification of a new object of the scientific knowledge, once beyond a new field of scientific research, the researcher naturally implies the maximum possible concentration in practical matters, but also in theoretical terminology, so how can to speak of a genuine process of interactive co-creation of both instances. The paper aims to illuminate some aspects of the process in question, based on personal experience about the phenomenon of “harmonious quantification of literary text” and “quantematics” as a discipline that would have focused the study of this phenomenon. It is, in essence, the function of the quantity and of the quantitative reports in the literary text, namely of the relations of mathematics with the aesthetics, the theory of literature and literature criticism.

**Key words:** terminology, the new scientific knowledge, co-creation, quantematics

---

### HYRJE

Në dy dekadat e fundit diskutohet gjithnjë e më shumë për nevojën e për domosdoshmërinë e krijimit të teorie të unifikuar të terminologjisë, e cila do të duhej të ndërlihte në mënyrë organike parimet themeluese të pionierit të disiplinës G. Wuesterit, me shkollat kryesorë të mëtejme: të orientuara nga linguistika (shkollat e Pragës, të Moskës, të Vjenës), nga përkthimi dhe nga planifikimi linguistic si dhe me tendencat teoriko-metodologjike bashkëkohëse (qasja sociolinguistike, qasja ontologjike, qasja komunikative, qasja konjitive, qasja kulturore). Artikulli ynë vendoset në këtë kontekst

ndërkombëtar përmes konkretësisë që implikon zbulimi i një fushe të re të hulumtimit shkencor si dhe përpjekjes për ndërtimin e rrjetës së koncepteve e të termave të tyre gjegjëse.

1. Përshkruajmë në vija të përgjithshme hipotezën sonë të kuantifikimit harmonik të tekstit, të problemeve terminologjike me të cilat jemi ndeshur e të mënyrës së zgjidhjes së tyre.

2. Meditojmë mbi arsytet implicite (të paformalizuara në krye të herës) të zgjidhjeve të caktuara terminologjike, mbi drejtësinë a jo të tyre/këtyre zgjidhjeve si dhe mbi implikimet a rrjedhojat që ato sjellin/ kanë sjellë. Si dhe mbi përfundimet që mund të nxirren sosh.

3. Mbi bazë të përvojës sonë, guxojmë së fundi të bëjmë një varg vëzhgimesh që lidhen me teorinë e metodologjinë e terminologjisë si disiplinë.

### 1. Çështja e parë

1.1. Teksti letrar i nivelit të lartë (në radhë të parë e kryesisht ai poetik) konceptohet prej nesh si një sekuencë ligjërimore e kuantifikuar dhe/apo e kuantifikueshme harmonikisht njëherësh në nivele të ndryshme mbi bazë të parimeve të pikëprerjes së artë dhe/ose të plotpjesëtueshmërisë së tri bashkësive: bashkësisë së përgjithshme të tekstit, bashkësisë së madhe e asaj të vogël, të identifikuar këto në terma të kuantitetit, gjegjësisht të njësisë thelbësore të organizimit estetik të strukturës tekstore, kuantemës, koncept fundamental ky i teorisë së kuantifikimit harmonik.

1.2. Në vijë të punës për identifikimin konceptual e veshjen terminologjike të realiteteve/ligjësive tekstore të zbuluara në një numur të madh tekstesh, jo vetëm poetikë, të autorëve të ndryshëm në disa gjuhë, u krijua bërthama e korpusit të koncepteve-terma të ngrehinës shkencore në proces, që ne e kemi pagëzuar *teori e kuantifikimit harmonik të tekstit*: kuantematikë, teori e kuantifikimit harmonik të tekstit, kuantifikim fonetik, kuantifikim semantik, kuantifikim metrik, kuantifikim ritmik, kuantifikim kompozicional, kuantifikim morfologjik, kuantifikim sintaksor, kuantemë, kuantë, koeficient i pikëprerjes së artë, plotpjesëtueshmëri kuantematike, vlerë numerike e raportit të bashkësive kuantematike (raport kuantematik), bashkësi kuantematike, bashkësia e plotë ( e madhe, e vogël) kuantematike, funksion estetik i raportit kuantematik, kuantemë një/dy/tri/katër/pesë fonemore, kuantemë rrokjesore, kuantemnancë, jokuantemnancë, analizë kuantematike e tekstit, aspekt statik (vs. dinamik) i kuantifikimit harmonik të tekstit, (pa)përcaktueshmëri kuantematike, kohezion kuantematik i tekstit, strukturë kuantemore, simetri statike, simetri dinamike e tekstit (e sekuencës tekstore), potencial harmonik i ritmit; mbingarkesë ritmike;

dobësi ritmike; izotopi kuantematike; bashkësi izotopike e kuantematizuar.

1.3. Kuantema është një njësi e ligjërimit poetik (rrjedhës ligjërimore), identiteti i së cilës është intuitivisht i njohshëm, por e cila në procesin e analizës kuantematike të tekstit mbetet të përcaktohet.

1.4. Kuantemat e një bashkësie shenjohen nga një tipar i përbashkët a element ndërlidhës, i cili nga pikëvështrimi i kuantifikimit ka aftësinë të rrafshojë tiparet e tyre dalluese për hir të tiparit të tyre lidhës. Ky tipar duke qenë i njëjtë, i përbashkët, realizon përnjësimin e bashkësisë kuantematike.

1.5. Parimi i përgjithshëm i kuantifikimit harmonik të tekstit mund të formulohej shkurtimisht kështu: Në tekstin poetik (A) mund të hetohen një shumësi bashkësish kuantematike trinare (A vs. B vs. C) të niveleve të ndryshëm. Raportet numerike të së tërës A me bashkësinë kuantematike B dhe të kësaj me bashkësinë e vogël kuantematike C priren t'i afrohen koeficientit të prerjes së artë: 1.618 ose të jenë madhësi të plotpjesëtueshme me më të voglën prej tyre.

1.6. Kuantemnanca - një term yni përmbledhës për të gjitha figurat e përsëritjes [aliteracioni, asonanca, homeoteleuti, rima, homofonitë e ndryshme, përsëritja e plotë apo e pjesshme e fjalëve a sintagmave (anafora, anadiploza, epifora, përsëritja e vargjeve etj.)] – është sipas nesh një fenomeni bazal, gjenerues dhe mbarështrues i të gjitha këtyre formave të përsëritjes në tekstin poetik. Ky koncept (kuantemnanca) shenjon rrokjet apo njësitë dy-amëshumëfonemore që përsëriten të paktën dy herë në vijë të rrjedhës së ligjërimit.

### 2. Çështja e dytë

Analiza e zgjidhjeve e zgjedhjeve terminologjike na ka çuar në këto përfundime themelore:

- Asnjë term nuk shfaqet si trajtë homonimike e ndonjë termi tjetër - bartës i një koncepti të ndryshëm; po ashtu sinonimia terminologjike është e përjashtuar.

- Sigurohet në maksimum izomorfizmi ndërgjuhësor, duke synuar trajta lokale termash apo neologjizmash terminologjikë ndërkombëtarë apo të ndërkombëtarizueshëm.
- Lënda gjuhësore për termkrijimin vjen nga leksiku i specializuar: Asnjë term nuk krijohet prej të quajturave leksema endocentrike.
- Asnjë term nuk përfaqëson një neologjizëm absolut; më së shpeshti kemi të bëjmë me togfjalësh terminologjikë të formuar nga njësi terminologjike ekzistuese/paraardhëse.
- Shfrytëzohen në maksimum gjedhe termformuese (Kuantemë vs. sememë, lekseme, morpheme). Asonancë, konsonancë vs kuantemnancë.
- Analogjia leksikore ndërmjet termit të ri dhe termave ekzistues (që kanë në bazë të njëjtën gjedhe termformuese) e bashkëshoqëron po ashtu një analogjia ndërmjet koncepteve që ato përfaqësojnë.
- Janë huazuar terma që tradita shkencore në të njëjtën fushë të hulumtimit ofron, duke shmangur maksimalisht prirjen e novacionit terminologjik si qëllim në vetvete.
- Është shtënë në përdorim parimi i ekonomisë gjuhësore që mund të emërtohej parim i ekonomisë terminografike: krijimi i sa më shumë termave të rinj me sa më pak lëndë terminologjike ekzistuese, të normativizuar e ndërkombëtare.
- Koncepteve që bashkëndajnë me njëri-tjetrin një a më shumë tipare është synuar t'u vishen shenjues terminologjikë analogë me këtë gjendje, domethënë terma që bashkëndajnë me njëri-tjetrin një a më shumë se një elementë.
- Koncepteve të reja të kuantematikës të cilat shfaqin analogji të dukshme me koncepte ekzistuese të një fushe tjetër të njohjes u vishen shenjues terminologjikë të pëafërt me të parët.
- Përafrimi, analogjia a pikëpreprerja e koncepteve në fusha të përafërta apo qartazi të

dallueshme të njohjes të reflektohet edhe në realitetin termonologjik përgjegjës.

- Analogjitë konceptuale (ndërmjet kuantematikës e një fushe tjetër të njohjes) të identifikuar dhe të verifikuar në një nivel qelizor na kanë shtyrë të vemë në pyetje mundësinë e analogjive më të gjera në nivelin e pemës së koncepteve e të identifikojmë kështu fenomene e koncepte të reja në lëminë tonë të interesit/hulumtimit. [P.sh. papërcaktueshmëria kuantike përkundrejt papërcaktueshmërisë kuantematike].
- Termi në fushën analoge të njohjes si sinjalizues për identifikimin e një objekti të ri të njohjes e rrjedhimisht të një koncepti përkatës. [Kuantemnancë vs. jokuantemnancë; përmasa fushë vs. përmasa grimcë e lëndës].

### 3. Çështja e tretë

Mbi bazë të përvojës sonë, guxojmë së fundi të bëjmë një varg vëzhgimesh që lidhen me teorinë e metodologjinë e terminologjisë si disiplinë si dhe me debatin aktual në këtë lëmi.

Është në pyetje një teori integruese apo e unifikuar e gjuhëve të specialitetit, të cilat Dante Aligieri i shihte si rrugët ve vetme përmes të të cilave njerëzimi i kishtë shpëtuar mallkimit të Babelit. Por kjo natyrisht është pamja ideale apo terminologjia ideale, e cila, në asnjë fushë të specialitetit në trajtën e vet të panjollë nuk ka ekzistuar ndonjëherë; përkundër, kemi pamjen reale apo terminologjinë reale, e cila më shumë a më pak është prekur prej sëmundjes a “mallkimit” babeliane në trajtat e polisemisë, homofonisë, sinonimisë, ambiguitetit e variabilitetit terminologjik si dhe të joizomorfisë ndërgjuhësore terminologjike. Një pjesë e rëndësishme e energjive në fushë të punës terminologjike/në fushë të terminologjisë u kushtohet përballimit të gjurmëve, kur më të lehta, kur më të rënda që ky “mallkim” ka lënë edhe mbi këtë/këto rrugë. Kjo krijon atë që ne emërtojmë “kurthi terminologjik”: është gjendja që i ofron praktika globale terminologjike teorisë dhe metodologjisë së disiplinës. Shtrohet pyetja: një teori integruese apo e unifikuar e

terminologjisë do të duhet ketë për bazë terminologjinë ideale apo terminologjinë reale.

Një teori e unifikuar e terminologjisë nuk mund të niset, sipas pikëpamjes sonë, nga gjendja reale (çka do të thotë nga traditat e deritashme plurimorfe si dhe nga problemet terminologjike, lëndë dhe objekt hulumtimi i këtyre traditave), jo nga gjendja reale e problematikave të disiplinës, por nga trajta ideale që terminologjia, në të tri kuptimet, si “tërësia e fjalëve teknike që i përkasin një shkencë, një arti, një autori apo një grupi social”, si “disiplinë gjuhësore që i kushtohet studimit shkencor të koncepteve dhe të termave në përdorim në gjuhët e specialitetit” do të duhet të ketë.

Një teori e unifikuar e terminologjisë do të duhej të mbështetej në terminologjinë ideale, apo në idealin terminologjik; dukuritë e terminologjisë reale ajo do t’i trajtonte si raste të veçanta të diakronisë, diastratisë e të pluralitetit gjuhësor; të tjera si përjashtime dhe si patologji.

Një teori e tillë do të duhej të përcaktonte një hierarki të punës terminologjike e të detyrave të disiplinës, në majë të së cilës do të qëndronte teoria dhe metodologjia e termkrijimit.

Dhe kjo, së treti, kjo parakupton që primati i interesimit terminologjik t’i kushtohet konceptit dhe jo mbulesës së tij gjuhësore.

Së fundmi, një teori e tillë ontologjike e terminologjisë në mënyrë të natyrshme do t’i shohë fushat konceptuale të specialiteteve të ndryshme të njohjes si bashkësi vetëm relativisht autonome dhe në mënyrë organike të ndërthurura me njëra-tjetrën.

Vetëm një ontoterminologji që primatin e interesimit të vet ia cakton konceptit dhe jo mbulesës së tij gjuhësore, është e aftë të t’i përgjigjet dinamikës së lartë të përparimit të njohjes, prirjes organike të hulumtimeve ndërdisiplinare, zbulimeve në fusha të veçanta të kërkimit, lindjes së paradigmave të reja shkencore, lehtësimit të komunikimit shkencor e terminologjik ndër-gjuhësh si dhe zvogëlimit në maksimum, në mos shmangies, të problemeve që

orientimi linguistiko-terminologjik është i detyruar të përballojë.

### **Përfundime**

Në mbyllje të kumtimit tonë, nisur nga një përvojë vetjake në fushë të zbulimit shkencor si dhe të krijimtarisë terminologjike të lidhur ngushtë me këtë, duam të theksojmë se formimi terminologjik është i domosdoshëm për kërkuesin shkencor të çdo fushe të dijes, që primati i vëmendjes terminologjike do të duhet të jetë koncepti përkundët termit, që kjo zhvendosje nga linguistikoterminologjia në ontoterminologji e bën ekspertin subjekt kyç, nëse jo të vetëm, e gjuhëtarin subjekt ndihmës të punës terminologjike, se kjo punë, kështu e konceptuar, është instrument i fuqishëm bashkëkrijues i njohjes së re shkencore dhe se, së fundi, por më e rëndësishmja, studiuesi i çdo lëmie-njëherësh terminolog do të duhet ta shohë rrjetën e dijeve të fushës së tij të specialitetit – nyjet e së cilës (rrjetës) janë konceptet-terma – si pjesë përbërëse të rrjetës globale të dijes; zona të tëra të të dy rrjetave, të së voglës ngushtësisht të ndërthurur me të tërën janë të ndriçuara apo të zbuluara, ndërkohë që zona të tjera ende të errëta – shenjuese të asaj që nuk ka mbërritur ende e që pritet të vijë në dritën e zbulimit shkencor

### **LITERATURA**

- CABRE, Teresa M. (1999), *Terminology. Theory, Methods and Applications*. Edited by Juan C. Sager. Translated by Janet Ann DeCesaris, Jon Benjamins Publishing Company, Amsterdam/Philadelphia, 249 p.
- CABRE, Teresa M. (2003), *Theories of terminology. Their description, prescription and explanation*. In: *Terminology* 9:2 (2003), 163–199.
- JORGO, Kristaq (2007): *Koha në lirikë. Mbi funksionin themelor të kohës në ligjërimin letrar*, në: AA.NN., Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, gusht 2007, Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Filologjisë dhe Universiteti i Tiranës – Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Prishtinë, 2007, f. 197-202

JORGO, Kristaq (2008): *Mbi kuantifikimin harmonik në poezi. Pyetje për një paraskicë të një filologjie të tretë*, në : AA.NN., Studime filologjike shqiptare, . Konferencë shkencore, 21-22 nëntor 2007, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës – Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Prishtinë, 2008, f. 309-314

JORGO, Kristaq (2008): *Për një analizë kuantematike të tekstit poetik (At Gjergj Fishta, Nji lule vjeshtet)*, në “Studime albanologjike”, II, Letërsi, Universiteti i Tiranës – Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, viti XIII, 2008/2, f.77-82

JORGO, Kristaq (2012): *Kuantemnanca në poezinë dhe shqipërimet e F. S. Nolit, në: Jashari*, prof.dr. Ali etj. (red.). Fan. S. Noli : *Në 130-vjetorin e lindjes (1882-2012). Konferenca Shkencore*

*Ndërkombëtare*. [Përmbledhja e materialeve kushtuar F. S. Nolit në 130-vjetorin e lindjes], Universiteti F. S. Noli, Korçë, 2012. ff.150-159.

JORGO, Kristaq (2015): *Mbi kuantifikimin harmonik të tekstit letrar. Teori, metodë, metodikë*. Studim monografik në përgatitje për botim.

SAGER, Juan C. (2000), *Essays on definition. With an Introduction by Alain Rey*, Jon Benjamins Publishing Company, Amsteden/Philadelphia, 257 p.

STERKENBURG, Piet van (edited by) (2003), *A practical guide to lexicography*, Jon Benjamins Publishing Company, Amsteden/Philadelphia, 430 p.